

DR. NUHI VESELAJ

**PASKAJORJA – ÇËSHTJE
E SHQIPES STANDARDE**

(vështrim sinkronik)

**DARDANIA SACRA
SHTUFI
Pristinë
2000**

DR. NUHI VESELAJ

**THE INDEFINITE – AN ISSUE
OF THE STANDARD ALBANIAN**

(A Synchronic Review)

**DARDANIA SACRA
SHTUFI
Pristinë
2000**

Botimet

DARDANIA SACRA

Libri nr. 2

Redaktor

Prof. Dr. Engjëll Sedaj

Recensues

Mehmet Gjevori, veteran i arsimit

Dr. Abdullah Zymberi, profesor i SHLP të Prizrenit

Mr. Mehmet Halimi, bashkëpunëtor shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës

Ballina

Rrezeart Galica

PASQYRA E LËNDËS

| | |
|---|----|
| Parathënie..... | 9 |
| Hyrje..... | 11 |
| 1. Sqarim paraprak..... | 13 |
| 2. Dy qëndrime të kundërta për zgjidhjen e çështjes së paskajores me + pjesore në shqipen standarde kombëtare | 14 |
| 3. Nocioni i paskajores dhe format leksiko-gramatikore me të cilat shprehet ky koncept në shqipe..... | 18 |

Kreu I

SHTRIRJA, TRAJTIMI DHE KARAKTERI ORIGINAL I FORMËS SË PASKAJORES ME + PJSORE

| | |
|---|----|
| 1. Shtrirja vertikale dhe horizontale e paskajores me + pjesore..... | 21 |
| 2. Trajtimi i paskajores me + pjesore si formë përfaqësuese e foljes edhe në gjuhën shqipe | 22 |
| 3. Karakteri analitik origjinal i paskajores me + pjesore të shqipes, kundrejt atij kryesisht sintetik të gjuhëve simotra indoevropiane | 24 |

Kreu II

SHKAQET SUBJEKTIVE E OBJEKTIVE PËR MOSFAVORIZIMIN E FORMËS SË PASKAJORES ME + PJSORE NË SHQIPEN E SOTME LETRARE

| | |
|--|----|
| 1. Katër arsyt objektive që ndikuan në mosfavorizimin e paskajores me + pjesore në shqipen e sotme letrare | 27 |
| a) Parapëlqimi i toskërishtes si bazë për formimin e gjuhës së sotme letrare të njësuar..... | 28 |

| | |
|---|----|
| b) Shtrirja e formës së paskajores së dytë e tipit me “për të” në të dy dialektet si përparësi e saj..... | 29 |
| c) Dukuria e gjuhëve ballkanike për zëvendësimin e paskajores me forma të lidhores e pranishme edhe në gjuhën shqipe..... | 30 |
| ç) Format heterogjene të pjesores së gegërishtes si shtytës jo favorizues..... | 31 |
| 2. Qëndrimi subjektiv shkak për mënjanimin e plotë të paskajores me + pjesore nga norma e shqipes së sotme letrare..... | 32 |
| 3. Reagimi i pamjaftueshëm i studiuesve tanë shkak i pasivizimit të paskajores me + pjesore në shqipen letrare kombëtare..... | 39 |
| 4. Riaktualizimi i çështjes sforcim i qëndrimit subjektiv apo qasje e re në zgjidhjen me integrim të paskajores me + pjesore..... | 43 |

Kreu III

RRETH NEVOJËS PËR INTEGRIMIN E PASKAJORES ME + PJESORE NË SHQIPEN STANDARDE KOMBËTARE

| | |
|---|----|
| a) Rezervë e shprehur ndaj zgjidhjes me mënjanim të paskajores me + pjesore nga norma letrare..... | 46 |
| b) Paskajorja me + pjesore – problem i hapur aktualisht edhe në gjuhën e shkrimit..... | 49 |
| c) Paskajorja me + pjesore si çështje jo e thjeshtë e të folmeve dialektore..... | 52 |
| ç) Forma e paskajores me + pjesore si koncept i pambuluar me një formë të vetme sinonimike..... | 55 |
| Struktura e formave të ndërkëmbimit të paskajores me + pjesore me format e tjera sinonimike..... | 56 |
| d) Katër vëzhgime si fakte të nëpërdikshme që dëshmojnë nevojën e përdorimit të paskajores me + pjesore në shqipen letrare kombëtare..... | 59 |
| 1. Domosdoja e përdorimit të formës së paskajores me + pjesore në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhëve të huaja..... | 61 |
| 2. Domosdoja e përdorimit të paskajores me + pjesore në thëniet frazeologjike me abstraksion të lartë..... | 66 |
| Shembuj të ndërkëmbimit të shprehjeve frazeologjike e të tjera..... | 68 |

| | |
|--|-----|
| 3. Paskajorja me + pjesore si mjet joshës simbolik për qëllime ideo-estetike e të tjera..... | 73 |
| 4. Paskajorja me + pjesore sinonim i mundshëm dhe i nevojshëm paralel krahas formave mbi bazë të lidhores e me forma të tjera të ndërkëmbjeshme..... | 77 |
| Shembuj krahasues të varianteve të kallëzuesit në fjalitë e varura..... | 78 |
| 1) Rregullat e ndërkëmbimit të formave kohore mbi bazë të lidhores ndaj formave të paskajores me + pjesore..... | 81 |
| Skema e ndërkëmbimit..... | 81 |
| a) Rasti i kundërvënies së ardhmes së domosdosë ndaj së ardhmes së dëshirës..... | 83 |
| b) Raste të ndërkëmbimit të paskajores me “me” jo parësisht me format kohore mbi bazë të lidhores..... | 85 |
| Disa shembuj të ndërkëmbimit jo parësisht me + pjesore me format kohore të lidhores..... | 85 |
| 2) Sinonimi e nevojshme dhe aspak e dëmshme e me mundësi përdorimi dhe ndërkëmbimi paralel..... | 88 |
| 3) Treguesi i vetes nga folja parashoqëruese zbutës i abstraksionit të paskajores me + pjesore..... | 90 |
| Skema e strukturës kallëzuesore..... | 91 |
| 4) E drejta e paskajores me “me” për konkurrencë lojale..... | 91 |
| 5) Prirja e zëvendësimit të paskajores me “me” me vetë e dytë njëjës të së tashmes së lidhores..... | 94 |
| dh) Disa shfaqje devijuese të shkaktuara te ne nga mënjanimi i paskajores me + pjesore..... | 97 |
| e) Konceptet bashkëkohore hulumtuese linguistike në favor të integritit të paskajores me + pjesore në shqipen letrare..... | 101 |
| ë) Struktura e shqipes së sotme letrare sistem i hapur me obligim për të pranuar edhe paskajoren me “me”..... | 110 |

Kreu IV

RRETH INTEGRIMIT KONKRET TË PASKAJORES ME + PJESORE NË KUADËR TË STRUKTURËS MORFOSINTAKSORE TË SHQIPES STANDARDE

| | |
|--|-----|
| Sendërtimi konkret i paskajores me + pjesore në kuadër të normës së shqipes letrare kombëtare..... | 117 |
|--|-----|

| | |
|--|-----|
| 1. Formanti “me” si element formëndërtues i paskajores me + pjesore dhe shtrirja e përdorimit të tij..... | 118 |
| 2. Vendi i paskajores me + pjesore në kuadër të vargut të preppjesorëve..... | 123 |
| Pasqyra e vargut të preppjesorëve | 124 |
| 3. Përfaqësja, dallimi, prirjet fjalëformuese të formave konkurruese të pjesoreve më: -UR : -Ë dhe -R(E) : -O(zero)..... | 126 |
| a) Kundërvënia -UR: -Ë dhe raporti mbështetës i preppjesorëve..... | 127 |
| b) Kundërvënia -R(Ë): 0 (ZERO) dhe raporti mbështetës i preppjesorëve..... | 127 |
| 4. Përparësitë trefsh parapëlqimit të formës përkatëse të pjesores | 130 |
| a) Përparësitë e alternativës së parë | 131 |
| Skema e trajtave të mbiemrave preppjesorë..... | 135 |
| b) Përparësitë e alternativës së dytë..... | 136 |
| 5. Forma dytore e pjesores – hëpërhë alternativë e ofrueshme..... | 143 |

Kreu V

ALTERNATIVË PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES SË PASKAJORES ME + PJESORE NË SHQIPEN E STANDARDIZUAR KOMBËTARE

| | |
|---|-----|
| 1. Mbështetja në faktet precedente | 146 |
| 2. Propozim – zgjidhjet alternative | 146 |
| Katër rregulla të këshillueshme alternative | 149 |
| 3. Arsyetim i shkurtër | 150 |
| 4. Konstatim përmbyllës përfundimtar | 151 |
| Përfundim | 153 |
| Përmbjllje..... | 159 |
| The Indefinite – an Issue of the Standard Albanian (Summary)..... | 161 |
| Literatura | 167 |

Parathënie

Vështrimin Paskajorja – çështje e shqipes standarde të dr. Nuhi Veselaj, që, në të vërtetë, është një monografi, e lexova me vëmendje dhe më pëlqeu shumë. Ky punim është një studim i thukët, shumë i qëlluar e me vlerë.

Me thënë të drejtën, një punim i ngjashëm si ky ka qenë dashtë të shkruhej e të botohej qysh kur u botua “Drejtskkrimi i gjuhës shqipe” (1976). Por, megjithatë, *më mirë vonë se kurrë*, thotë një fjalë e urtë e popullit tonë.

Me këtë rast theksoj diçka, që nuk duhet harruar se, në fund të Rezolutës së vet, Kongresi i Drejtskkrimit të gjuhës shqipe apelon e porosit që, “*duke marrë parasysh ndryshimet që pëson gjuha letrare gjatë zhvillimit të saj si dhe çështjet e reja që nxjerr praktika gjuhësore, Rregullave të drejtskkrimit t’u bëhen, në të ardhmen, kur të jetë e nevojshme, përmirësimet e plotësimit e duhura*”. Pastaj, ndër të tjera, shton: “*Kongresi shpreh besimin e tij të plotë se kjo thirrje do të përkrahet me entuziazëm dhe do të frymëzojë arsimtarët, shkrimtarët, punonjësit e shkencës dhe të kulturës, gjithë inteligjencën dhe të gjitha masat punonjëse, që, me veprimtarinë e tyre krijuese të zhvillojnë, pasurojnë e ta ngrenë gjithmonë më lart gjuhën letrare kombëtare*”.

S’ka dyshim se apelit të Kongresit i janë përmbytur e përligjur deri më tani shumë gjuhëtarë, mësues, krijues e punonjës të ndryshëm të arsimit, kulturës e shtypit, duke përkrahur, por duke bërë herë pas here edhe disa vërejtje e duke dhënë sugjerime e propozime nëpërmjet shtypit, me qëllim që ta pasurojnë e përsosin gjuhën tonë letrare kombëtare.

Mirëpo, fatkeqësisht, deri më tash, pas afro tri dekadash, pas mbajtjes së Kongresit, s’është ndërmarrë asnjë iniciativë që të organizohet, të përgatitet e të mbahet një konsultë e posaçme gjuhësore, ku të shqyrtohen në hollësi e me kujdes dhe të miratohen me koncensus të gjitha vështrimet kritike, vërejtjet, sugjerimet e propozimet me vend, që i janë bërë gjer më tani *drejtskkrimit të gjuhës sonë amtare*, gjuhë kjo e cila “është e kuptueshme për të gjithë shqipfolësit, kurse, si gjuhë e shkruar, ajo ka edhe më shumë pika afirmimi. Prandaj, përsosja dhe njësimi i mëtejshme i një gjuhe letrare kombëtare, jo

vetëm që është i mundshëm dhe i realizueshëm, por është edhe më se i nevojshëm dhe i domosdoshëm” – thekson M. Halimi në një vështrim të vetin në Gjurmime albanologjike – Seria e shk. fil. 23 – 1993, faqe 125.

Porse tani, më duket se ka ardhur koha që t’i angazhojmë të gjitha forcat tona krijuese e të institucioneve arsimore–shkencore dhe t’i hyhet me themel kësaj çështjeje kaq me rëndësi e të studiohen e të shohiten mirë të gjitha vërejtjet, sugjerimet e propozimet që i janë bërë drejtshkrimit të gjuhës sonë prej 1973–shit e gjer më sot dhe të trajtohen çështjet më aktuale të shqipes që lidhen ngushtë me zgjidhjen e shqipes së njësuar letrare.

Me dije qoftë, në atë konsultë gjuhëtarësh do të rrihen e shqyrtohen nga të gjitha anët, sidomos shumë çështje me rëndësi që kanë mbetur pezull, ndër të cilat, pa dyshim, një ndër çështjet kyçe, të drejtshkrimit tonë, është edhe **paskajorja me “me”** e kryedialektit verior, për të cilën flitet në mënyrë të qartë e të shkoqitur në monografinë e dr. Nuhi Veselajt, çështje me shumë rëndësi kjo, e cila, e them me keqardhje, ka qenë mënjanuar nga norma e gjuhës letrare, ose, më mirë me thënë, ka qenë lënë nën hije. E kanë pasë injoruar, pra, pikërisht këtë trajtë, të cilën e kanë përdorur me shekuj dhe ende e përdorin dy të tretat e tërë popullit shqiptar.

Është e vërtetë se për hir të dëshirës së flakët një komb – një gjuhë letrare të njësuar, si të themi, u sakrifikuua çdo gjë nga studiuesit e përfaqësuesit përkatës, sepse, fundi i fundit, ata e kanë ditur se dikur patjetër do të rivlerësohet e përligjet qëndrimi ndaj paskajores me “me”, që çon kah nocioni thelbësor: **gjuhë standarde kombëtare e normëzuar mbi bazën e dy kryedialekteve tona**. Me një rivlerësim të tillë gjithsesi do të niveleohej edhe më mirë baraspesha ndër-dialektore në shqipen tonë standarde të njëzuar, e cila në këtë mënyrë do të ketë gjithsesi një bazë më të shëndoshë dhe një ardhmëri edhe më të ndritshme.

Prishtinë, më 8. 12. 1999

Mehmet GJEVORI

HYRJE

Norma letrare e çdo gjuhe, ashtu edhe jona, edhe pse në thelb ka karakter fleksibil, përmbledh aso rregullash konvencionale, respektimi i të cilave ka për qëllim të frenojë zhvillimin spontan e stihik të gjuhës. Rregullat e tilla duhen ruajtur sa më gjatë që është e mundur, por kur situatat kërkojnë ato paksa edhe mund të ndryshojnë, mund të përpunohen, mund të përsosen e të përplotësohen. Është mirë që ndryshimet a përplotësimet e tilla të natyrshme të bëhen, ashtu siç edhe janë vënë, d.m.th., po me marrëveshje, nën mbikëqyrjen e bekimin e gjuhëtarëve. Me një fjalë, rregullat e tilla përherë duhet të jenë objekt vëzhgimi, trajtimi e vlerësimi të faktorësi të caktuar, me gjuhëtarët në krye.

Në këtë kontekst duhet parë, mirëkuptuar dhe arsyetuar edhe diskutimi **Paskajorja – çështje e shqipes standarde (vështrim sinkronik me synim ortologjik)** që është objekt trajtimi në këtë punim. Punët si kjo nuk duhen parë e kuptuar si një goditje për të rënur bazën e godinës së gjuhës letrare të njëzuar kombëtare, por duhen cilësuar pikërisht si një veprim që ndihmon sforcimin dhe përplotësimin e asaj baze, aq më tepër duhen parë si një përndërtim të brendshëm dhe njëherazi edhe si një fasadim a shtojcë përforcuese të nevojshëm dhe si një zburim të jashtëm të godinës së tillë. Dhe për të qenë kjo vepër monumentale sa më funksionale dhe sa më madhështore lypset kujdesur vazhdimisht për të, me një fjalë, lypset përkujdesje e mirëmbajtje të vazhdueshme dhe të niveluar, në mënyrë që ndërtesa e tillë të mund t’u bëjë ballë sfidave që i sjellin rrymat e moteve. Njëkohësisht për këto qëllime ekzistenciale është e natyrshme që gjuha standarde kombëtare, e sidomos norma e saj, në radhë të parë, duhet të jetë e pajisur si duhet me tërë thesarin e vet burimor që, në rastin konkret, mendoj unë, edhe letrarishtja jonë, siç del nga trajtimi, duhet të përfshijë në gjirin e vet edhe paskajoren me + pjesore, thesar ky që lypset përpunuar e shfrytëzuar si duhet. Risimet a huazimet përkatëse që dalin si domosdo e jetës dhe e mbijetesës së gjuhës duhet të bëhen duke pasur në konsultim tërë thesarin posedues.

Gjithsesi gjuha jonë e standardizuar, si mjete më i mirë i komunikimit masiv për të gjitha fushat e jetës e të shkencës, por edhe si mjet i pazëvendësueshëm i bashkimit tonë fizik e shpirtëror dhe shoqëror e kombëtar, i cili edhe na përfaqëson dhe na ndërlidh me kulturën botërore, duhet të njihet sa më mirë, të vlerësohet sa më drejt dhe të shfrytëzohet deri në maksimum, prandaj për këtë arsye ne shfrytëzuesit e këtij mjeti kaq me vlerë, me mundësitë tona, duhet t'ia kultivojmë e përsosim të gjitha veçoritë karakteristike të saj, duke ia respektuar të gjitha format si të një gjuhë të njëzuar mbarë-kombëtare. Në të vërtetë, norma e gjuhës standarde e ka sidetërim të vetin që të ngërthejë në vete të gjitha vlerat gjuhësore të idiolekteve, dialekteve e varianteve të caktuara të cilat i përfaqëson, madje të ndjekë evolucionin si dhe risimet që mund të shfaqen në këtë kompleks.

Në këtë kuadër e ka vendin e vet, pra, edhe forma e paskajores me + pjesore, fakt ky i cili nga disa gjuhëtarë e intelektualë po theksohet me tepri e nga disa të tjerë mjerisht po injorohet. Zgjidhja e kësaj çështjeje të mprehtë të gjuhës sonë letrare mbase duhet të gjendet në mes të këtyre dy qëndrimeve të skajshme, pra, as nuk duhet të ekzagjerohet plotësisht, as nuk duhet të injorohet tërësisht si çështje, por duhet të shqyrtohet gjithanshëm dhe të zgjidhet në mënyrë objektive.

Para se të kalohet në trajtimit më të hollësishme sipas krerëve përkatës e shoh të arsyeshme të sqaroj paksa këto tri çështje:

së pari, të ceket fakti se problemi i paskajores me + pjesore nuk është problem i tashëm, por ai, si i tillë, qe anashkaluar, përkatësisht qe lënë nën hije që në *Rregullave drejtshkrimore të shqipes (projekti)* (1967) si dhe në *Drejtskrimin e gjuhës shqipe* (1973);

së dyti, të vihen në pah dy qëndrimet e kundërta rreth zgjidhjes së çështjes në shqyrtim aktualisht dhe

së treti të përmenden format leksiko-gramatikore me të cilat mbulohet koncepti i përgjithshëm i infinitivit në gjuhën shqipe duke cekur edhe çështjet që shtrihen për analizë më të hollësishme në krerët përkatës të këtij punimi.

1. Sqarim paraprak

Konsulta gjuhësore e Prishtinës (1968) duke i mbështetur pa rezervë "*Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekti)*" (1967) dhe duke ia bërë me dije opinionit të gjerë se tubimi në emër të "shqiptarëve në Jugosllavi" njëherazi "njeh njëzëri si gjuhë të vetën gjuhën letrare të vendit ëmë", ngase "njësimi i shqipes letrare është rezultat i natyrshëm i proceseve progresive të shoqërisë shqiptare, veçanërisht nga Rilindja e këndeje", edhe pse nuk deklarohet rreth elementeve të caktuara të varianteve të ish-shqipes letrare mbi bazë dialektore (gege apo toske), pa dyshim i parapriu dhe e përshpejtoi procesin e kristalizimit të një varianti letrar të shqipes si gjuhë të njëzuar letrare, kryesisht mbi bazën e toskërishtes. Është fakt se varianti letrar mbi bazën e toskërishtes pas Luftës II Botërore në Shqipëri kundrejt variantit mbi bazë të gegërishtes ishte më i favorizuar, e vërtetë kjo që ishte përvijuar qartë jo vetëm në gjuhën zyrtare-administrative të kohës, në gjuhën e radios, të shtypit, të administratës, të shkollës etj., por u parapëlqye institucionalisht në sesionet shkencore të vitit 1952, por edhe më mirë, si me thënë, u sanksionua edhe me "Fjalorin e gjuhës shqipe" (1954) si i vetmi a i pari fjalor shpjegues i mirëfilltë normativ ky i kohës, materiali i të cilit në këtë drejtim pati jehonë në të gjitha trojet shqipfolëse. Prandaj efekti i "Konsultës gjuhësore" të Prishtinës do parë e nënkuptuar si anim dhe mbështetje të po asaj baze, e cila u kurorëzua me sukses në "Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes" (1972), në "Rezolutën" e të cilit u pohua solemnisht e me plot entuziazëm se "populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njëzuar".

Gjithsesi nuk është pa mbështetje konstatimi se rregullat e miratuara të "Drejtskrimit të shqipes" si dhe "parimet" që kanë të bëjnë me kristalizimin, përpunimin dhe përsosjen e mëtejshme të gjuhës letrare të njëzuar janë suksese të pamohueshme të gjuhësisë shqiptare, ashtu siç janë edhe veprat kapitale (edhe pse nuk janë pa të meta) që u hartuan nga gjuhëtarët shqiptarë e të tjerë në mbështetje të tyre, siç janë: Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (Fonetika, Morfologjia, Sintaksa), Fjalori drejtshkrimor, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980), Studime mbi leksikun (...), I, II (1972), III (1989) etj. të botuara në Tiranë, të cilave nuk u mbeten mbrrapa as disa vepra të botuara në Prishtinë, Shkup e gjetiu.

Kështu që me këto dhe me punime të tjera iu dha mbështetje e fortë njëzimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe duke i zgjidhur në këtë mënyrë shumë çështje relevante me interes nga fusha e ndërlikuar e gjuhës letrare të

normëzuar, saqë sot për sot nuk bën të vihet në dyshim qëndrueshmëria e një varianti të gjuhës letrare të njësuar për të gjithë shqipshkruesit. Mirëpo është e vërtetë se nën hije të çështjeve të zgjidhura mbeten të prekura lehtë ose të pazgjidhura plotësisht jo pak çështje, të cilat nuk kanë të bëjnë gjithaq me rrafshin e drejtshkrimimit e të drejtshqiptimit, sa kanë të bëjnë me rrafshin morfo-sintaksor, e sidomos me rrafshin formëzues e fjalëformues si dhe me rrafshin leksiko-semantik e më gjerë. Ndonjë çështje që atëherë mund të konsiderohej e zgjidhur, sot mund të dalë e diskutueshme edhe për arsye të zbatimit të metodave të reja bashkëkohore të hulumtimit shkencor si dhe për arsye se mund të jenë gjetur a zbuluar fakte të reja që kërkojnë rivlerësim e interpretim tjetër, që mund të bjerë paksa ndesh me interpretimin që është dhënë më përpara. Prandaj, nuk është gjë e jashtëzakonshme në ndonjë konstatim nga burimet e sipërpërmendura mos t'i qëndrojnë kritikës së kohës, të jetë jo i plotë, i diskutueshëm, madje edhe i paqëndrueshëm, fakt ky që shtron nevojën për rishqyrtimin me një sy kritik të çështjeve të tilla. Në këtë kontekst, sipas mendimit të një numri jo të vogël gjuhëtarësh, do parë edhe çështja e paskajores së tipit me + pjesore në gjuhën shqipe, formë kjo e cila, gjithsesi, bën pjesë në sistemin global të gjuhës sonë standarde. Ka supozime se ajo u mënjana a u fshi arbitrarisht nga norma e gjuhës së sotme letrare në vitet '70.

Sidoqoftë, si çdo problem tjetër edhe çështja e paskajores në fjalë pa paragjykimie ia vien të diskutohet dhe të (ri)vlerësohet.

2. Dy qëndrime të kundërta për zgjidhjen e çështjes së paskajores me + pjesore në shqipen standarde (kombëtare)

Kur është fjala reth integritimit të paskajores me + pjesore në normën e shqipes letrare kombëtare, hiq heshtakët,¹ edhe të zbatuesit më konsekuentë e të ndërgjegjshëm të normës së sotme letrare, ndeshen dy mendime të kundërta, njëra palë e mohon, ndërsa tjetra e mbështet një veprim të tillë. Si të parët ashtu edhe të dytët kanë argumentet e veta.

a) Përkrahësit e mendimit të parë (më tepër toskërishtfolës) konsiderojnë se çështja e paskajores me + pjesore e zgjidhur me mënjanimin e saj

¹ Këtu nuk janë marrë në konsideratë mendimet e atyre studiuesve, të cilët janë distancuar nga legjitimiteti i "Kongresit të drejtshkrimimit të shqipes", përkatësisht nga gjuha e njësuar letrare shqipe.

nga norma letrare mund të quhet si çështje e mbyllur, d.m.th. forma në fjalë për shkak të karakterit dialektor që ka, ashtu si edhe elementet e tjera nga struktura morfosintaksore e ish-shqipes letrare mbi të gegërishtes u mënjana jo pa arsye, përkatësisht jo pa arsye ajo nuk u mor në konsideratë fare për strukturën përkatëse të normës së gjuhës letrare, prandaj pse u lanë jashtë rastet e tilla, nuk ka nevojë të diskutohen, por vetëm të konstatohen a të sqarohen, nëse diçka e tillë kërkohet. Nuk ka nevojë të diskutohet veças as paskajorja në fjalë, kur dihet fakti se formimet me këtë formë kanë ardhur gjithnjë duke u reduktuar edhe në vetë variantin letrar të gegërishtes, sidomos në gjuhën e shkrimit zyrtar. Pothuajse, të shumica e rasteve nocioni i saj u zëvendësua plotësisht me forma të tjera, siç janë format kohore të lidhore dhe paskajorja e dytë e tipit me "për të". Është fakt i pamohueshëm se, edhe pa këtë formë, gjuha e sotme letrare po e kryen me sukses funksionin e vet, prandaj integrimi i saj "gjuhësisht" del i panevojshëm. Duhet të pajtohemi me faktin se fati i saj si fati i çdo "kategorie mbeturinore"² si element jo normativ do të pësojë: njëherë do të pasivizohet e pastaj herët a vonë edhe mund të shuhet a të zhduket fare, dhe kjo do të varet nga shtrirja, prestigji dhe përvetësimi që i bëhet shqipes së njësuar letrare, trajtat e së cilës duhen propaganduar e zbatuar në mënyrë të organizuar nga shkolla, shtypi, administrata si dhe nga asociacionet e tjera shoqërore – politike dhe shtetërore në mbarë truallin shqipfolës.

Riaktivizimi i formës në fjalë do t'i sillte dëm normës së strukturës morfosintaksore tashmë pothuajse të stabilizuar "të mbyllur e të plotë"³ të shqipes së sotme letrare, pasi që forma në fjalë do të zgjojë nostalgjinë për "rigjallërimin" e strukturës përkatëse foljore të ish-gegërishtes letrare, e cila pothuajse u la komplet jashtë normës letrare, përkatësisht, në njëfarë mënyre, ajo u sakrifikua nga vetë gjuhëtarët e intelektualët gegërishtfolës për hir të gjakimit: "një komb – një gjuhë letrare të njësuar".⁴

b) Përkrahësit e mendimit tjetër, atij pohues, konsiderojnë se çështja e paskajores së tipit me + pjesore nuk mund të quhet çështje e zgjidhur me

² Shprehja "kategorie mbeturinore" është shkëputur nga një punim i A. Kostallarit me titull "Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë", St. mbri leksikon ...III, Tiranë 1989 f. 11.

³ Sipas M. Totonit të shprehur në artikullin "Struktura sintaksore e gjuhës letrare dhe probleme të normës" të botuar në gazetën "Bujku", të Prishtinës, më 14. VII.1993 f. 6.

⁴ Shprehje e thënë nga prof. Ali Hadri në "Kongresin e Drejtshkrimimit të Shqipes" (1972) që simbolizon njëfarë mënyre mendimin e shumicës së intelektualëve kosovarë të kohës.

mënjanimin e saj. Ajo gjithsesi mbeti çështje e hapur, mbeti si dallimi më i madh e i rëndësishëm strukturor ndërmjet gjuhës së sotme letrare, në njërin anë dhe të gegërishtes, në anën tjetër. Ajo, ç'është e vërteta, ishte trajtë normative në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes dhe me rastin e konsolidimit të normës së shqipes së sotme letrare asaj iu ndërpre arbitrarisht e drejta e konkurrencës së lirë lojale për koncepte të caktuara, megjithatë autoriteti i saj, besa edhe nevoja për të nuk u shua dot, as nga pikëpamja gjuhësore as nga ajo psiko-sociologjike, sepse paskajorja në fjalë edhe sot e gjithë ditën paraqitet jo vetëm në ligjërimin e atyre që e kanë të përvijuar në sistemin ligjërimor, që është shumica e popullatës shqipfolëse, por edhe nga vazhduesit e normës së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes dhe nga të tjerë. Ajo del në përdorim, qoftë për nevoja shkencore (shkollore), qoftë për nevoja të komunikimit të përditshëm masiv. Gjithsesi qëndrimi ndaj paskajores me "me"⁵ duhet rivlerësuar.

Argumenti se forma e tillë është e zëvendësueshme me forma të tjera, pastaj fakti se edhe pa këtë "element" gjuha e sotme letrare po vepron me sukses në planin e përfaqësimit zyrtar, kulturor-shkencor e publicistik etj., dhe kjo po dëshmohej me vepra, qoftë origjinale, qoftë të përkthyer si dhe arsyeja se forma e tillë nuk përputhet me sistemin bazë të kësaj gjuhe, zor se mund t'i qëndrojnë kritikës, ngase:

së pari, nuk janë pak forma a shprehje fjalore të pajisura me paskajoren me +pjesore, që në njëfarë mënyre, nuk janë të zëvendësueshme plotësisht me forma të tjera barsvlerëse sinonimike a perifrastike;

së dyti, përdorimi i gjuhës letrare si dhe veprat e botuara nuk besohet se mund të ishin më pak të suksesshme ose do të pësonin nga cilësia po të ishte e integruar në to edhe forma me + pjesore dhe

së treti, letrarshija e sotme ka përvehtësuar mjaft elemente të gegërishtes që, si duket, nuk i kishte të theksuara në bazën e vet, prandaj as teorikisht as praktikisht s' duhet të ketë pengesë për të integruar në gjirin e normës së vet edhe këtë "element të veçantë", natyrisht, së paku, për nënfusha të caktuara semantike.

⁵ Termi togfjalësh paskajore me + pjesore dhe paskajore me "me" janë sinonime identike. Këtu manipulohet me të dyja format.

Gjithsesi problemi i paskajores me + pjesore nuk bën të krahasohet me peshën e elementeve të tjera të karakterit të ngushtë dialektor, por duhet cilësuar si një "element të veçantë". Koha po vërteton se fusha (a nënfushat) semantike që shprehet me formën e paskajores së tipit me + pjesore nuk ka mundur të mbulohet tërësisht me ansjërën nga format sinonimike ndër-këmbëse (as me ndonjë formë kohore të lidhore dhe as me paskajoren II të tipit me "për të"), qoftë në fushën e abstraksionit mendor, qoftë në fushën e konkretizimit praktik, prandaj trajtës së tillë meriton t'i kthehet vendi që i takon brenda strukturës morfosintaksore të gjuhës sonë letrare dhe si e tillë duhet të merret nën patronazhin a përkujdesjen e normës letrare. Po të gjykohej me objektivitet paskajorja në fjalë nuk është dashur fare të sakrifikohet ose të mënjanohej nga norma. Ç'është e vërteta, ashtu siç është duke u kuptuar jo si duhet ose duke u keqinterpretuar nga disa individë, lënia e saj jashtë norme i ka sjellë dhe po i sjell dëm të konsiderueshëm edhe vetë sintaksës së gjuhës shqipe përgjithësisht, ndërsa me integrimin e saj në gjirin e vet struktura e tashme morfosintaksore do të dalë më e stabilizuar dhe më e plotë, ashtu siç është në të vërtetë, dhe kështu do ta rrisforcojë barspeshën e shtyllës së vet kurriore, e cila, gjithsesi, në aspektin përfaqësues gjithëkombëtar tash për tash duket se e ka njëfarë mangësie në paraqitje. Është tjetër gjë përzgjedhja a favorizimi i trajtës së caktuar sinonime e tjetër gjë kur një trajtë përjashtohet apriori duke i rënë ndesh kështu normës tradicionale si dhe asaj pragmatike (situatore, konversationore), sipas së cilës asnjë formë e gjallë e gjuhës s' mund të përjashtohet nga përdorimi i normëzuar. Me përligjen e formës së paskajores në fjalë, baza e gjuhës sonë letrare me nënstrukturat përkatëse të veta, do të fitojë shumë e nuk do të humbasë asgjë. Në të vërtetë, vetëm me integrimin a përfshirjen e vlerave formëzuese e fjalëformuese nga tradita që është burim i pashtershëm dhe që janë, si me thënë, vlera me tapi, gjuha e sotme letrare shqipe do ta arsyetonte emërtimin, të quhet me koncept të ri përmbajtësor: *gjuhë standarde kombëtare*.⁶

⁶ Në këtë punim edhe pse nuk bëhet diferencim i qartë mbizotëron mendimi se togfjalësh "gjuhë e sotme letrare" që përdoret para e pas Kongresit të Drejtshkrimi, përkatësisht pas njësimi për t'u quajtur vërtet gjuhë letrare kombëtare ose gjuhë e standardizuar kombëtare" duhet të integrojnë në sistemin e vet, përveç paskajores me "me" edhe disa elemente të tjera nga dialekti verior (ish-shqipja letrare mbi bazë të gegërishtes), përkatësisht nga baza e vet e hershme, sidomos nga fusha e semantikës, e formëzimit dhe e fjalëformimit.

Kështu pra në mbështetje të mendimit të të dyja palëve, duke respektuar si të parin ashtu edhe të dytin, por i udhëhequr nga parimi se zgjidhja më e mirë a "njësimi si qëllim i fundit nuk arrihet me mohimin, por me kultivimin e ndryshimeve"⁷ është hartuar ky punim, i cili mëton të jetë "diskutim shkencor".

Vlerësimi objektiv që imponohet do të jetë shpërblimi a satisfaksioni, më i shtrenjtë për qëllimin që synohet, d.m.th. të shikohet mundësia e zgjidhjes me integrim të paskajores me + pjesore a ngërthimin i saj në normën letrare për ndonjë nënfushë semantike, siç janë p. sh.: përfaqësimi, abstraksioni i lartë, qëllimi ideo-estetik dhe sinonimia, nënfusha këto në të cilat, në të vërtetë, paskajorja me + pjesore edhe është duke dalë në përdorim e sipër në jetën tonë të përditshme, si në gjuhën e folur, ashtu edhe në atë të shkruar.

3. Nocioni i paskajores dhe format leksiko-gramatikore me të cilat shprehet ky koncept në shqipë

Paskajorja (infinitivi) si "një formë e pashtjelluar e foljes, e cila shpreh një veprim a një gjendje në mënyrë të përgjithshme, pa u lidhur me një kohë a vetë të caktuar",⁸ përkatësisht që "emërton një veprim si proces"⁹ a "një veprim a proces abstrakt"¹⁰, si nocion në gjuhën shqipe nuk është i panjohur, madje edhe si termë nuk është e pastudiuar, qoftë nga studiues vendës, qoftë nga ata të huaj. Është konstatuar me të drejtë se nocioni i tillë në shqipë në aspektin pohor del i mbuluar kryesisht prej dy formash analitike: me anë të paskajores së tipit me + pjesore: me dalë dhe me anë të paskajores së tipit për të + pjesore: për të dalë, ndërsa në aspektin mohor mbulohet kryesisht me formën pa + pjesore të tipit: pa dalë.

Në kontekste të caktuara, qoftë në raport me gjuhë të tjera indoevropiane¹¹ e më gjerë, qoftë në kuadër të strukturës së brendshme të gjuhës sonë, nocioni i paskajores me + pjesore (në aspektin pohor) për nënfusha të caktuara spe-

⁷ Është përdorur shprehja e studiuesit George J. Morvan në punimin "Jezik spoznaje – spoznaja jezika", të botuar në "Filozofska istraživanja" 30/89, Zagreb 1989 f. 987.

⁸ Formulimi u mor nga "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe", Tiranë 1980, f. 1337.

⁹ Sh. Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988 f. 1007.

¹⁰ Rikard Simeon, Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva, Matrica Hrvatska, Zagreb 1969, f. 533.

ciflike semantike del i shprehur a i këmbështim edhe me disa forma të tjera sinonimike si p.sh.:

1. Me anë të "formave kohore të mënyrës lidhore"¹¹ të tipit: të dal (të dalësh).
2. Me anë të pjesores (jo në të gjitha situatat) kur përdorimi i paskajores përputhet me përdorimin e pjesores të paraprirë nga folja modale gjysmëndihmëse e ngurtësuar përkatëse: mund, duhet, do (lypsët).¹²
3. Me anë të emrit përkatës abstrakt të nyjshëm, tipi: të dalët ose të emrit prejfoljor të veprimit (të panyjshëm) tipi: dalje.¹³
4. Me anë të formës së dëftores, sidomos me anë të së tashmes së dëftores njëjës, tipi dal,¹⁴ kur kjo trajtë kryen funksionin e trajtës përfaqësuese të foljes si barasvlerës ndaj foljes së huaj a të ndonjë shprehjeje frazeologjike në ndonjë fjalor, në punime shkencore etj.
5. Vlen të përmendet edhe ndërkëmbimi që bëhet me anë të formave analitike të foljeve të shtjelluara në njërin anë dhe me paskajoren me + pjesore në anën tjetër si formë e pashtjelluar, siç janë: e tashmja dhe e pakryera e kushtores; e pakryera, e kryera dhe më se e kryera e lidhore dhe sidomos e ardhmja e dëftores e tipit ballkanik si një "futur volitiv".¹⁵ (i dëshirueshmërisë) siç është tipi: do të dal (do + lidhore), e cila del në oponencë ndërkëmbimi me formën e përbërë të tipit evropëndimor si "futur i domosdoshmërisë"¹⁶, siç është tipi: kam me dalë (kam + paskajore).

Ndërkëmbime ndeshen edhe me forma të tjera siç janë format e urdhërores, të përcjellores, të foljeve në fjalitë pyetëse, në togfjalësha, në fjalitë e ndërmjetme etj. por këto ishin më kryesoret.

Që të gjitha format e sipërcëkura, pos ndonjë vërejtjeje më tepër të karakterit stilistik, siç është ndërtimi me emrin prejfoljor të tipit: dalje, në normë e gjuhës së sotme letrare janë të tolerueshme dhe të favorizuara, përveç trajtës së mirëfilltë: paskajores së tipit me + pjesore, e cila jo vetëm se nuk

¹¹ Shaban Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Prishtinë 1989 f. 244.

¹² A. Xhuvani, Paskajorja në shqipet, Vepra I, Tiranë 1980 f. 260–261.

¹³ Shih te gazeta "Bujku" e Prishtinës: U pajtuan për dalje në votime, 31. X. 1992, f. 3.

¹⁴ Është gjykim i im si dhe konsideratat e pikave 2., 3., 4., dhe 5.

¹⁵ Shih edhe te A. V. Desnackaja, Gjuha shqipe dhe dialektet e saja, Prishtinë 1972 f. 40.

¹⁶ Shih edhe te M. Halimi, Kërkime dialektologjike, Prishtinë 1985 f. 332.

del e favorizuar, por ajo del e privuar, si të themi, që të mbetet jashtë normës letrare, edhe pse forma në fjalë është formë e vetme që mbulon mirëfilli fushën kuptimore të nocionit të inifitvit në raport me gjuhët e tjera indoevropiane dhe të tjera që janë të pajisura me një formë të tillë. Prandaj, për të sqaruar një paradoks të tillë a për t'u njohur sa ma afër me këtë çështje kryesisht në aspektin sinkronik, shtrihen këto pyetje:

- 1) Ç' shtrirje ka dhe si është trajtuar përgjithësisht forma e paskajores *me + pjesore* në gjuhën tonë?
- 2) Pse forma e tillë, edhe pse ishte e pranishme në ish-shqipen letrare u mënjana nga norma e shqipes së sotme letrare?
- 3) A del e nevojshme që një formë e tillë të (ri)integrohet a të rifutet në suaza të shqipes së standardizuar kombëtare dhe për cilat nënfusha semantike?
- 4) Si mund të bëhet ky integrim pa lënë pasojë për strukturën e tashme foljore të shqipes letrare?
- 5) Cila është propozim – zgjidhja më e mirë si porosi alternative për temën e shtruar?

Edhe pse në këtë punim qëllimi parësor mbetet vështrimi sinkronik me synim ortologjik a të shtruarit e problemit për diskutim, megjithatë, në kërret vijues krahas paraqitjes së çështjes, do të bëhet përpjekje që sado pak të jepen edhe përgjigje në pyetjet e sipërshtuara duke theksuar të dhëna që duket se janë me interes të dihen për opinionin e gjerë e ndërsa për disa specialistë, ndoshta, vetëm sa të rikujtohen. Jam i vetëdijshëm se për ndonjë nëntëmë të veçantë që preket këtu nevojiten studime më të thukta e rrahje mendimesh më të thella, dhe që priten të bëhen në të ardhmen jo të largët, sidomos nga sintaksologët tanë. Sidoqoftë, ky punim–diskutesë le të shërbejë si nisim e mbarë që të sfidojë studiuesit kompetentë për ta marrë në shqyrtim dhe për ta zgjidhur njëherë e përgjithmonë çështjen e paskajores *me + pjesore* në shqipen standarde.

Kreu I

SHTRIRJA, TRAJTIMI DHE KARAKTERI ORIGINAL I FORMËS SË PASKAJORES ME + PJESORE

Për t'i hyrë në thelb çështjes që po trajtohet këtu, është me interes që së paku në vija kryesore të përmenden: shtrirja, trajtimi si dhe karakteri original i formës së paskajores *me + pjesore* në gjuhën shqipe.

1. Shtrirja vertikale dhe horizontale e paskajores *me + pjesore*

Forma e pashtjelluar analitike e paskajores së tipit *me + pjesore* ka përhapje mjaft të gjerë në shqipen e folur sot. Sipas disa dijetarëve (Gabinski, Sh. Demiraj, S. Riza, B. Bokshi etj.) ajo kishte shtrirje në mbarë shqipen e lashtë, mirëpo tashti ajo ka mbetur si tipar dallues i dialektit të gegërishtes, por nuk është formë e panjohur edhe për disa të folme të toskërishtes. Ka të dhëna se më se dy e treta e shqipfolësve autoktonë, formën në fjalë e kanë të përvijëzuar në sistemin e tyre ligjërimor¹ dhe sigurisht është formë që njihet nga mbarë bashkësia shqipfolëse e trualit të shqipes.

Përgjithësisht një formë e tillë ndeshet në përdorim të gjerë edhe në gjuhën e shkrimit që nga periudha e shqipes së dokumentuar si dhe etapa e Rilindjes sonë Kombëtare, por kjo formë del më e përdorshme, sidomos në etapën e Pavarësisë, kur ishte element i normëzuar pikërisht në fazën e përpunimit të shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes (elbasanishtes). Vulën e formës normative të shqipes letrare e mbante edhe pas Luftës II Botërore deri në vitet '60 – '70², por me vëllim a prirje të zvogëluar përdorimi, sidomos

¹ Kjo e dhënë është cekur edhe në Konferencën gjuhësore të mbajtur në Tiranë në nëntor të vitit 1992.

² Shih: Ortografia e gjuhës shqipe, Beograd, 1964 f. 53 – 58.

në gjuhën e shkrimit në stilin “administrativ–zyrtar”. Thuhet se vetëm pas zyrtarizimit të gjuhës së sotme letrare shqipe, në vitet ‘50 – ‘60, që u kuroreza në *Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes* (1972) forma e paskajores me + pjesore u mënjana u a hoq pothuajse plotësisht nga gjuha e shkrimit në të gjitha stilet funksionale. Ç’është e vërteta, edhe pas viteve ‘60 e ‘70 kjo formë vazhdon të përdoret a të shfaqet edhe në gjuhën e shkrimit (edhe në gjuhën e autorëve), por më tepër në diasporë nga vazhduesit e ish–shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes edhe në ndonjë qendër studimore, ndërsa si raste brenda letrarishtes së sotme jo rrallë ndeshet edhe sot e kësaj dite, madje në kohë të vona vërehet një prirje shumimi i rasteve të tilla, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, Maqedoni e gjetiu, fakt ky që do të argumentohet edhe në këtë punim.

Shkurt me i ra, forma e paskajores me + pjesore në gjuhën tonë ka shtrirje historike si në kohë ashtu edhe në hapësirë, fakt ky i pamohueshëm që meriton vëmendje e përkushtim më të madh, qoftë nga aspekti thjesht gjuhësor, qoftë nga ai psiko–sociolinguistik, ngase nga të dyja këto aspekte kjo çështje deri në ditët tona është lënë, si të thuash, pak si pasdore.

2. Trajtimi i paskajores me + pjesore si formë përfaqësuese e foljes edhe në gjuhën shqipe

E lyp puna të ceket këtu se forma e paskajores me + pjesore e shqipes i jo me kuptim të ngushtë nëndialektor a idiomatik, por me kuptim të gjerë përfaqësues, është trajtuar në punime shkencore e të tjera që nga Da Leçe e këndeje.³ Mjafton të përmend faktin se prof. E. Çabej,⁴ edhe pse e njëh të shtrairit të gegërishtes “të cilës në toskërishte i përgjigjet funksionalisht lidhorja”, në përqsaje me gjuhë të tjera indoevropiane vetëm këtë formë e njëh si “paskajore të mirëfilltë” të shqipes, madje edhe si të tillë e përdor. Në të vërtetë në kontekst të përfaqësimit për nevoja shkencore kundrejt gjuhëve të huaja, trajtim

³ Në Fjalorin e “Bashkimit” (1908) për pjesëzën “me” thuhet se është “grimçë që tue i pri pjesësit kalues (të pariticio pasato albanese) hin n’përbame t’pasosës t’gith fill-kave”, d.m.th. hyjnë në përbërje të paskajores të të gjitha foljeve të gjuhës shqipe. Edhe studiuesi T. Këlmendi, siç përmendet në gazetën “Bujku” të datës 4. VII.1992 f. 6 një punim e ka të titulluar “Paskajorja me “me” në gjuhën shqipe”.

⁴ E. Çabej, Studime gjuhësore VII, Prishtinë 1986, f. 120.

e paskajores së tipit me “për të” nuk e përmend fare. Prof. Mahir Domi në sintaksën e tij trajtën e paskajores me + pjesore e quan “paskajore të zakonshme”⁵, ndërsa formën e paskajores me “për të” e quan “paskajore të dytë”. Studiuesi Tafil Këlmendi⁶ trajtën e paskajores me “për të” e quan “paskajore dytësore” duke e nënkuptuar antonimin “paskajore parësore” për formën e paskajores me + pjesore. Edhe më qartë shprehet prof. Shaban Demiraj⁷ duke e quajtur formën me + pjesore “paskajore të mirëfilltë”, e cila “përdoret me të gjitha funksionet karakteristike të paskajores”, ndërsa formën me “për të” e quan “paskajore me funksion të kufizuar sintaksor”, formulim ky të cilit studiuesi B. Bokshi i shton elementin shkallëzues “shumë”: “me funksione shumë të kufizuara” sintaksore (B. Bokshi, Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik), ASHAK, Prishtinë 1998, f. 165).

Pra, shkencërisht kjo formë është përkufizuar mjaft qartë e drejt nga studiuesit tanë.

Në disa vepra leksikografike e shkencore tipi i paskajores me + pjesore është përdorur si formë përfaqësuese e foljes së caktuar, dhe kjo ende vazhdon tek–tuk si traditë përdorimi. Me fjalë të tjera, nevoja e përdorimit të formës së tillë, as sot e kësaj dite nuk ka pushuar. Sa për ilustrim po i përmendim disa vepra, të cilat rastësisht i pata nëpër duar, ku është zbatuar përfaqësimi i tillë i paskajores në fjalë që nga hershmëria e deri në ditët tona, si p. sh.: Fjalori latinisht – shqip i F. Bardhit (1630), “Fjalorthi i psikologjisë”⁸ i A. Xhuvanit, Fjalori i H. Bariqit (1950)⁹, Fjalori i S. Dobroshtit (1953)¹⁰, Fjalori terminologjik serbokroatisht – shqip (1961)¹¹, “Fjalorthi” i A. Pipës (1959)¹²,

⁵ M. Domi, Gramatika e gjuhës shqipe, Sintaksa për shkollat e mesme (ribotim), Prishtinë 1969, f. 139.

⁶ Tafil Këlmendi, Paskajorja, përdorimet e saj dhe ndërtimet me paskajore në gjuhën popullore shqipe, Seminari ndërkomëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare 7/82, Prishtinë 1982, f. 57.

⁷ Shaban Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988, f. 284 dhe 1004.

⁸ A. Xhuvani, Vepra II, Tiranë 1990, f. 150.

⁹ H. Bariq, Fjalori i gjuhës serbishte ose kroate dhe i shqipes, Zagreb 1950.

¹⁰ S. Dobrosht, Fjalor serbokroatisht – shqip, Prishtinë 1953.

¹¹ Fjalor terminologjik serbokroatisht – shqip, Prishtinë 1961.

¹² Arshi Pipa, “Fjalorthi” të “Libri i burgut”, New York 1959.

Fjalorthi i fjalëve të rralla i A. Zymerit (1979)¹³; punimi i Sh. Hoxhës (1990)¹⁴, punimi i bashkautorëve M. Halimi dhe S. Gashi (1989)¹⁵, punimet e T. Kelmendit, R. Doçit'etj.

Në Fjalorin e "Bashkimit"¹⁶ si dhe në Fjalorin latinisht – shqip të H. Lacajt dhe F. Fishtës¹⁷ përkrah të së tashmes së dëftores, si formë përfaqësuese, del edhe paskajorja me + pjesore, e cila gjithsesi qëndron si barasvlerës i plotë ndaj infinitivit të gjuhës së huaj përkatëse.

Trajta e tillë, si trajtë përfaqësuese, qoftë si formë praktikë në punime shkencore, qoftë në gramatika del e përdorur të një shumice autorësh duke filluar nga Xanoni, Sheperi, S. Riza e të tjerë, siç do të cekem në vazhdim, edhe pse këta dy të fundit në raste të caktuara e identifikojnë me formën e pjesores.

3. Karakteri analitik original i paskajores me + pjesore të shqipes, kundrejt atij kryesisht sintetik të gjuhëve simotra indoevropiane

Përveç shtrirjes vertikale e horizontale si dhe veçorisë përfaqësuese që e karakterizon paskajoren me + pjesore të shqipes atë e karakterizon edhe karakteri original analitik i formëzimit të saj në shqipe, kundrejt karakterit sintetik që ka forma e paskajores (infinitivit) në shumicën e gjuhëve të tjera simotra indoevropiane. Ç'është e vërteta, barasvlerësia e formës së paskajores me + pjesore, kundrejt infinitivit të gjuhëve përkatëse indoevropiane e të tjera nuk vihet në dyshim nga asnjë studiues, edhe pse në ato gjuhë zakonisht infinitivi del kryesisht në formë sintetike, kurse në shqipe, pothuajse del kryekëput në formën analitike, përveç mendimeve se forma analitike e paskajores së shqipes del ashtu që nga "lindja", ka mendimtarë që thonë se edhe shqipja në fillim kishte paskajoren sintetike që dëshmohej me format e pjesores së sotme, tipi: duhet (lypsen) thënë, mirëpo me kohë ajo doli me

¹³ Abdullah Zymeri, Fjalorthi i fjalëve të rralla, Prishtinë 1979 dhe në punimin monografik "Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi", Prishtinë 1996.

¹⁴ Shefqet Hoxha, E folmja e Arnit, Dialektologjia shqiptare VI, Tiranë 1979.

¹⁵ M. Halimi – S. Gashi, Nga leksiku i pasivizuar në të folmet popullore, Studime mbi leksikon ... III, Tiranë 1989.

¹⁶ Fjalori i "Bashkimit" (1908) (ribotim) Prishtinë 1978.

¹⁷ Fjalor latinisht – shqip (H. Lacaj – F. Fishta), Prishtinë 1980.

trajtën analitike siç e ruan edhe sot. Sidoqoftë, lidhur me këtë d.m.th. ne po nisemi nga gjendja e sotme analitike dhe në krahasim me gjuhë të tjera sa për ilustrim po i cek nja tre shembuj në këto katër gjuhë: shqip, latinisht, gjermanisht e serbokroatisht.¹⁸

| | shq. | lat. | gjerm. | serb. |
|------------------------|---------|----------|--------------|-------|
| 1. (lëvdohj) me lëvdue | laudare | loben | (po)hvaliti; | |
| 2. (besoj) me besue | credere | glauben | verovati; | |
| 3. (dal) me dalë | exire | ausgehen | izici. | |

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm paskajorja sintetike e gjuhëve përkatëse karakterizohet me formantin përkatës special sufiksor a mbaresor, p.sh: lat. –a/RE, gjerm. –EN, serb. –TI (–ĆI), ndërsa paskajorja e shqipes nuk karakterizohet me prapashitesën temëformuese të pjesores (si gjymtyrë e dytë e paskajores në fjalë), por pikërisht me pjesëzen **me** (si gjymtyrë e parë e paravendosur), e cila së bashku me pjesoren, si një formë e vetme analitike, gramatikiht e semantikiht e pandashme, si një formë *sui generis*, shpreh nocionin përkatës të paskajores. Ç'është e vërteta, në disa raste edhe në gjermanishte infinitivi mund të parashqehëhet me formantin **zu**, ashtu si edhe në anglishte që del me formantin **to** (got. **du**), holandisht **tot**, suedisht **att**¹⁹, gjuhë këto që sot nuk kanë afërsi territoriale me shqipen, prandaj ndëmdikimi i afërt kohor historik ndërmjet tyre është i përjashtueshëm. Gjithsesi vlera e formantit **me** në shqipe mbetet si diçka specifike, e cila në njëfarë mënyre mund të konsiderohet si një format i veçantë special formëzues e fjalëndërtues që vlen për trajtën në shqyrtim.

Nga sa u tha më sipër del se forma e paskajores me + pjesore jo vetëm se ka stazh të gjatë përdorimi si në gjuhën e folur, ashtu edhe në atë të shkruar, por ajo duke e përfaqësuar "kulmin e abstraksionit gramatikor në sistemin foljor"²⁰ është kategori e vetme foljore me barasvlerësi të plotë kundrejt

¹⁸ Shembujt ilustrues janë përpiluar në mbështetje të fjalorëve përkatës.

¹⁹ Per këtë shih edhe te "Capitol" s concise dictionary", f. 322. Studiuesi francez Robert d' Angely për trajtën e anglishtes shprehet se "to-ja e anglishtes është një ndikim i sigurte i gjuhës pellazgo-albane" (Shih te "Bujku", 10.II.1996 f. 9).

²⁰ Sh. Demiraj, vepra e cituar në shënimin 7., f. 1008.

infinitivit të gjuhëve indoevropiane dhe të tjera, të cilat janë të pajisura me këtë kategori. Ajo si formë-koncept mund të quhet si një element ndërlidhës në mes të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera të zhvilluara evropiane, gjuhë këto ku forma e paskajores mund të dalë si formë e vetme përfaqësuese e foljes, ashtu siç dilte a mund të dalë edhe sot edhe forma e paskajores me + pjesore në shqipe, funksion ky që nuk i shkon kurrsesi paskajores së dytë të tipit me “për të”.

Kjo formë, d.m.th. paskajorja e tipit me “me”, është anase (burimore), sigurisht e formuar a e farkëtuar nga nevoja mjaft herët (para paraqitjes së nyjeve në shqipe dhe gjithësi para shfaqjes së rotacizmit si veçori dalluese ndërdialektore të shqipes) dhe, në një proces të gjatë kohor, ajo mbijetoi dhe shërbeu si një fryt i nevojshëm i zhvillimit të brendshëm të gjuhës sonë, fryt ky që mund të cilësohet si një thesar me vlerë komunikative e mendimore me fuqi potenciale përgjithësisht, prandaj me të drejtë shtrohet pyetja, pse një formë e tillë nuk e gjeti vendin përkatës në strukturën morfosintaktore në normën e shqipes së sotme letrare? Pse një pasuri e tillë, jo vetëm që u la nën hijen e formave të tjera, siç është “paskajorja e dytë” e forma të tjera, por ajo u tentua të “zhduket” ose të shuhet fare nga gjuha letrare, e së këtejmi edhe nga fondi i gjuhës standarde shqipe?

Përgjigjen sigurisht mund ta japin më mirë vetë hartuesit e normës së gjuhës së sotme letrare shqipe të njësuar, megjithatë në kreun vijues të këtij punimi do të përipiem t’i përmend arsyet që konsiderohen si më kryesoret, të cilat edhe objektivist do të kenë pasur ndikim në marrjen e gjykimit për mosfavorizimin e paskajores me + pjesore, madje edhe për mënjanimin e plotë të saj.

Kreu II

SHKAQET SUBJEKTIVE E OBJEKTIVE PËR MOSFAVORIZIMIN E FORMËS SË PASKAJORES ME + PËJESORE NË SHQIPEN E SOTME LETRARE

1. Katër arsyt objektive që ndikuan në mosfavorizimin e paskajores me + pjesore në shqipen e sotme letrare

Për mosfavorizimin a mënjanimin e formës së paskajores me + pjesore nga norma e shqipes së sotme letrare ndikuan faktorë të ndryshëm objektivë e subjektivë. Nder faktorët objektivë a të objektivizuar do të përmendim klima politike e kohës, e cila mundësoi përqëndrimin në favorizimin e variantit letrar të toskërishtes, variant ky, i cili u parapëlqye si bazë për gjuhën e njësuar letrare dhe së këtejmi në mbështetje të këtij fakti dolën edhe favorizimet lidhur me çështje konkrete. Kështu që faktorë objektivë e subjektivë (subjektë të objektivizuar) në ndërlidhje të ndërsjella dialektike në ato faza të caktuara kohore, ku më tepër shihej ana praktike e zgjidhjes së problemeve të caktuara gjuhësore, sesa ajo teorike, bënë që paskajorja me + pjesore mos të gjejë zgjidhje me “integrim” por me “mënjanimin” e nxjerrjen e saj jashtë normës letrare. Shkaqet për një veprim të tillë, qofshin ato objektive a subjektive, të cilat shërbejnë si pretekst, është vështirë të paraqiten me pak fjalë, megjithatë, nga kjo ndërlidhëshmëri studiuesit shkëputin këta katër faktorë objektivë (subjektë të objektivizuar):

- 1) e para, parapëlqimi i toskërishtes si bazë për gjuhën e sotme letrare të njësuar,
- 2) e dyta, shtrirja e formës së paskajores së dytë e tipit me “për të” në të dy kryedialektet e shqipes,
- 3) e treta, dukuria gjuhësore ballkanike që ka të bëjë me zëvendësimin e paskajores përgjithësisht me trajtat kohore të lidhore dhe
- 4) e katërta, dukuria e paraqitjes së pjesores së gegërishtes (si gjymtyrë e dytë e paskajores me “me”) në forma heterogjene, kundrejt formave kryesisht homogjene të pjesores së toskërishtes.

a) Parapëlqimi i toskërishtes si bazë për formimin e gjuhës së sotme letrare të njësuar

Meqenëse pas Luftës II Botërore në Shqipëri fitoi Revolucioni Popullor me të cilin propagandohej një sistem i ri shoqëror, d.m.th. sistemi socialist kundrejt atij feudo–kapitalist, që ekzistonte para luftës, atëherë, edhe normat gjuhësore, si dhe një sërë normash shoqërore, nga kuadrat e caktuar filluan të shikohen, si të thuash, me një tjetër sy vështrimi. Edhe drejtshkrimi, si fazë e parë e rëndësishme e gjuhës letrare, e cila nuk kishte arritur të njësohej më përpara, ashtu si edhe çështje të tjera gjuhësore të karakterit zyrtar (letrar), siç e thekson A. Kostallari, “*u trajtuan jo si çështje e thjeshtë teorike, por në radhë të parë si çështje e ngutshme praktike*”.¹ Në këtë kontekst, kur nevoja kërkonte që ndonjë çështje të zgjidhej praktikisht edhe me “nguti”, u bë parapëlqimi i toskërishtes si bazë e gjuhës së njësuar letrare, e cila, në të vërtetë, edhe ishte varianti më i konsoliduar në krahasim me variantet mbi bazë të gegërishtes. Së këtejmi, siç dihet, edhe klima politike e asaj kohe ishte e tillë, e cila mundësonte që erërat e Jugut të ndiheshin dhe të kishin prani gjithnjë e më të madhe edhe në Veri. Asociacionet e organizuara (në kuadër të tyre edhe ato gjuhësore) të asaj kohe (të vitit 1952 e më përpara) në procesin e konvergencës së gjuhës letrare i dhanë krah më tepër sistemit foljor paradigmor të dialektit të toskërishtes ndaj atij gegë, i cili në këtë pikë në njëfarë dore, vërtet, paraqitej më heterogjen. Përkritazi me këtë anim të forcave të caktuara gjuhësore të kohës mjafton të përmend sqarimin që jepet në Fjalorin e gjuhës shqipe (1954)², ku në *Shënime mbi përdorimin e fjalorit* thuhet se teksti, d.m.th. teksti i fjalorit normativ është “punuar në bazë të toskërishtes: përkufizimet janë shkruar toskërisht e janë vënë zakonisht në fjalët e në trajtat toskërishte. Pra në këto rrethana, meqenëse paskajorja me + pjesore kishte mbetur si formë karakteristike e dialektit të Veriut (gegërishtes), vetvetiu kuptohet se aktivizimi i saj dilte i privuar disa vjet përpara viteve ‘70. Mirëpo me gjithë gjykimin e shqiptuar të nënkuptuar implicitisht më parë, në fjalorin në fjalë me formën e paskajores me + pjesore janë shënuar këta shembuj: **me qenë, do me thënë, me shkue** dhe si shembull ilustrues është

¹ Androkli Kostallari, Gjuha e sotme letrare dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj, “Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe”, Prishtinë 1974 f. 50.

² Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 1954.

shënuar fjalia: **Merr me dalë po s’mundet**, shprehja “**nuk do me thanë gja**” si dhe fjalia pyetëse: **Ku do(n) me dalë?**

Pra si arsye e parë për pasivizimin e paskajores me + pjesore në shqipen e sotme letrare qëndron fakti se toskërishtja paraqitej si varianti më i konsoliduar dhe për shkaqe të “ngutshme praktike” e sociale, u parapëlqye si bazë për formimin e gjuhës letrare. Kështu, meqë paskajorja me “me” i takonte kryesisht strukturës paradigmore të sistemit foljor të gegërishtes, atëherë ajo së bashku me tërë atë strukturë u godit. Ky është shkaku që më vonë edhe mbeti si një formë jo e normëzuar.

b) Shtrirja e formës së paskajores së dytë e tipit me “për të” në të dy dialektet si përparësi e saj

Përveç parimit bazë që u cek më sipër trajta e paskajores me “me” u godit edhe nga simotra e saj: paskajorja e dytë e tipit me “për të”, sepse, kjo kishte shtrirje më të theksuar në dialektin e toskërishtes, por, ishte e pranishme edhe në gegërishte, fakt ky që do të mjaftonte për t’u favorizuar subjektivisht, ngase përputhej me parimin tjetër ortologjik, jo të pabazuar, të kohës se: “*bërthamën qëndrore të bazës së gjuhës letrare e përbëjnë elementet e përbashkëta të të dy dialekteve*”³, parim ky, si me thënë, qëndronte si paraf me vull të dhënë rekomandimi edhe në Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (1967), në Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit (1972) si dhe në “Parimet e përgjithshme” të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1974).⁴ Sigurisht, me një veprim të tillë favorizues u përforcua përdorimi i “paskajores së dytë” në vend të “paskajores së zakonshme”, por pasi që paskajorja e tipit me “për të”, ka “funksione shumë të kufizuara sintaksore”⁵, ngase, siç e thotë prof. B. Bokshi: “*tipi për të bërë* edhe si formë e pashpjelluar foljor ka mbetur në funksion të SP–së (sintagmës prepozicionale) pa arritur të kalojë në funksion të një

³ A. Kostallari, Diaspora e sotme shqiptare dhe gjuha letrare kombëtare e njësuar, “Gjurmime albanologjike”, seria e shkencave filologjike, 20/90, Prishtinë 1991 f. 67.

⁴ Më gjerësisht: “Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe”, Prishtinë 1974 dhe “Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe”, Prishtinë 1974.

⁵ Shaban Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988, f. 1015.

SN-je (sintagmë nominale), d.m.th. në funksion të kryefjalës, kundrinës etj. as në toskërishte edhe kur nuk ishte në përdorim paskajorja e vjetër...”, përkatësisht vazhdon më tej ai: “*meqë tipi për të bërë në të dy dialektet ka funksione njësoj të kufizuara rreth kuptimit dhe qëllimit na imponohet të përfundojmë se edhe në toskërishte zgjerimin e funksioneve të saj e ka penguar prania e paskajores më të lashtë e tipit me + emër prejpresor i panyjshëm. Kështu, përjashtimi nga përdorimi i kësaj paskajoreje (d.m.th. me + pjesore) në toskërishte, do të jetë relativisht i vonshëm”* (Vepra e cit. f. 167).

Së këtejmi doli, pra, se as forma për të + pjesore nuk mundi ta zëvendësonte a ta mënjante nga përdorimi formën e paskajores me “me”, pranë detyra e tillë praktikisht, si të themi, iu ngarkua formave kohore të lidhores, të cilat, në të vërtetë, patën shtrirje të gjerë përdorimi në toskërishte, por që kishin shtrirje jo të vogël edhe në gegërishte, dukuri kjo që kishte përfshirë gjuhët ballkanike jugore.

c) Dukuria e gjuhëve ballkanike për zëvendësimin e paskajores me forma të lidhores e pranishme edhe në gjuhën shqipe

Si arsye tjetër, që mund të cilësohet si e fortë, për mosfavorizimin e paskajores me + pjesore në shqipen e sotme letrare mund të konsiderohet, pra, fakti se në toskërishte zakonisht nocioni i paskajores prirët të zëvendësohet funksionalisht me format kohore të lidhores, dukuri kjo që ka ndodhur dhe është e pranishme sot e gjithë ditën edhe në gjuhët e tjera ballkanike, si p. sh. në bullgarishte, maqedonishte, rumanishte, në disa të folme jugore të serbishtes dhe sidomos në greqishten e re, me të cilën shqipja e arealit jugor ishte dhe është në kontakt, madje në njëfarë dore edhe në ndërmikim. Edhe gegërishtja është e prekur nga një dukuri e tillë, por jo në atë masë siç ndodhi me toskërishten. Në gegërishte trajtat e lidhores dalin si sinonimi të lejueshme krahas paskajores së mirëfilltë si dhe të paskajores së dytë në raste të caktuara. Faktet tregojnë se një sinonimi e tillë triformëshe në gegërishte, pa marrë parasysh ndërferkimet, ka bashkëjetesë normale, natyrisht duke e gjetur vendin e vet secila formë përkatëse në nënfusha të caktuara semantike e stilistike. Kështu p. sh., forma e paskajores së dytë ka përparësi në formimin e periudhës me fjali qëllimore, në të “dy dialektet”, ndërsa forma e paskajores

me me del më e dalluar ndër sishoqet për koncepte të caktuara abstrakte në periudhat me fjali kryefjalore e kundrinore e lidhvoja shumëformëshe del e shtrirë edhe në më shumë nënfusha etj.

Me fjalë të tjera, në gjuhën e sotme letrare u favorizuan trajtat kohore të lidhores si dhe forma e paskajores së dytë, jo me aq të drejtë, në dëm të formës së paskajores së tipit me + pjesore.

c) Format heterogjene të pjesores së gegërishtes si shtytës jofavorizues

Për mosfavorizimin e formës së paskajores me + pjesore mund të ketë ndikuar, paksa, edhe forma mbaresore a sufiksore heterogjene e pjesores së gegërishtes (si gjymtyrë e dytë e paskajores në fjalë), e cila te tipa i foljeve me –UR dhe sidomos tek ai i foljeve më –(R)Ë ndryshon nga trajta e letrarishtes së sotme mbi bazë të toskërishtes. Këtu e kam fjalën për foljet e tipit mat matur, mbaj mbajtur, pjek pjekur, pajis pajisur etj., të cilat në ish–gegërishten letrare dinin zakonisht me prapashtesën temëformuese –Ë: mat matë, me matë, mbaj mbajtë me mbajtë, pjek pjekë me pjekë, pajis pajisë me pajisë – prapashtesë kjo që, siç po shihet nga shembujt e sapocukur, del e theksuar sidomos në formën e paskajores me “me”. Gjithashtu e kemi fjalën edhe për tipat e foljeve: bëj bërë, laj larë, shkruaj shkruar, punoj punuar, pëlqej pëlqyer – të cilat në ish–gegërishten letrare dhe aktualisht dalin me mbaresë zero, përkatësisht në trajtën e shkurtër të pjesores: bëj bë (bà), laj la, shkruaj shkruë, punoj punue, pëlqej pëlqye, etj., së këtejmi paskajorja në shqyrtim del: me bë, me la, me shkruë, me punue, me pëlqye. Ja si duken format e pjesores sipas burimeve të caktuara të të folmeve dialektore e të tjera të gegërishtes, trajta këto sot jo të normëzuara, por që nuk ishin aq të qëndrueshme në normën letrare mbi bazë të gegërishtes, para njësimi të shqipes letrare: **mat (me matë)**: (me) matën, matun, matunë; **mbaj (me mbajtë)**: (me) mbajten, mbajtun, mbajtunë; **bëj (me bë)**: (me) bë, bà, banen, bamë, banun, bamun, bë, batë; **shkruaj (me shkruë)**: (me) shkruë, shkruem, shruemun, shkru, shkruë, shkruën, shkrua (shkruom), shkruet; **punoj (me punue)**: punu, punuë, punuen, punuenun, punuem, pununen, punua (punuom), punuet; **pëlqej (me pëlqye)**: pëlqyen, pëlqyem, pëlqyë, pëlqynen, pëlqyet = e kështu me radhë.

Përkundër një heterogjenie të tillë formash në të folmet e gegërishtes, në toskërishte trajtat e pjesores dalin edhe historikisht njëjtë homogjene a

fare pak të ndryshuara, si p. sh.: mat matur (maturë), bëj bërë, shkruaj shkruar (shkruarë), punoj punuar (punuarë), pëlqej pëlqyer (pëlqyerë).

Është interesant dhe me interes të dihet se si e shpjegon prof. B. Bokshi këtë dukuri ndërdialektore të gjuhës sonë: *Rënia e -N-së participore (*-O/n: OU, UO : UA UE), që e la temën të përfundonte në zanore a në diftong, ndodhi në një kohë në tërë shqipen. Me përdorimin e prapashtesave të shënuara (mbiemërore të rindërtuara) gegërishtja zbulon për atë kohë ndarjen e saj në katër zona nëndialektore; në zonën ku u seleksionua prapashtesa -M, në zonën ku u seleksionua prapashtesa -NË, në zonën ku u përdor prapashtesa -TË dhe në zonën ku u ruajt prapashtesa ZERO, ndërsa toskërishtja doli me seleksionimin unik të prapashtesës -RË (B. Bokshi, vepra e cit. f. 38). Edhe shtrirjen e prapashtesën -Ë të gegërishtes ndaj asaj -UR të toskërishtes tipi hapË (hapUR), matË (matUR), prekË (prekUR), prof. B. Bokshi nuk e sqaron me përfundim analojik nga tipi: dalë, vjelë, mbjellë etj, por nga sinonimia e prapashtesave -në (-unë, E) dhe -M, duke kaluar në kuptimin e participit me -NË në përdorim mbiemëror. Ndryshimi i kuptimit të kësaj pjesoreje të së tashmes pësore, që shënonet edhe njëkohësisht, në kuptimin e pjesores pësore të së kryerës është mundësuar edhe nën presionin e participit me -SHËM (...) është për të përfunduar se kuptimi i njëkohësisht me të ardhmen, që nga e tashmja, u mor nga pjesorja pësore e futuri me -SHËM, ndërsa kuptimi i njëkohësisht me të shkuaren sollti barazimin e kësaj forme me participin në -N (Vepra e cit. f.63/64), d.m.th. në trajtën me mbaresë zero.*

Sidoqoftë, kështu me parapëlqimin e formës së pjesores së toskërishtes (të rindërtuar në të njëjtën kohë si edhe prapashtesat e gegërishtes) që mbeti stabile deri në kohën tonë, u godit aktualisht, pra, tërthorazi e dretpërdrejt edhe gjymtyra e dytë e paskajores me "me", përkatësisht u godit tërë forma e paskajores me + pjesore, madje ajo u bë formë e papëlqyer edhe për ata tipa të foljeve, siç janë tipat më -Ë dhe -NË, edhe pse dialektorisht atyre nuk u ndryshon forma e pjesores.

2. Qëndrimi subjektiv shkak për mënjanimin e plotë të paskajores me + pjesore nga norma e shqipes së sotme letrare

Përveç arsyeve me mbështetje objektive ose fakteve të objektivizuara që u cekën në nëntullin e mësipërm, për mënjanimin a lënimin jashtë normës letrare të formës së paskajores me + pjesore edhe për ato koncepte kuptimore

e stilistike që nuk mbulojnë tërësisht me format e tjera sinonimike, do përmendur si fakt edhe qëndrimin subjektiv të kuadrove të caktuar, të cilët ishin të implikuar rreth vendosjes së çështjes në fjalë. Me "qëndrim subjektiv" këtu nuk kuptohet diçka e keqe a subjektivist, por në radhë të parë kuptohet qëllimi i lartë idealist i ndërgjegjshëm i kuadrove të caktuar, të cilët si cak kishin: njësimim e gjuhës letrare kombëtare shqipe, shenjë kjo dalluese që e karakterizon çdo popull a bashkësi folëse të civilizuar. Në këto rrethana çështja e paskajores me + pjesore u la e pafavorizuar. Ç'është e drejta, paskajorja me "me", e cila ishte, në të vërtetë, "dallimi më i madh strukturor" në mes të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes ndaj ish-shqipes letrare mbi bazë të toskërishtes, mbeti e tillë edhe ndaj gjuhës së sotme letrare. Pse u la një çështje e tillë e pazgjidhur, ose më mirë me thënë, pse "u zgjidh" me mënjanimin e saj nga norma, edhe pse kishte mjaft fakte objektive e subjektive që dëshmonin se kjo formë nuk ishte aq e papeshë sa të mos merrej fare në konsideratë si "rast i veçantë", kanë të drejtë brezat e tashëm dhe të ardhshëm të kërkojnë përgjigje?

Në këtë kontekst sigurisht janë shtruar pyetje por edhe janë dhënë gjykime të ndryshme teorike në atë kohë edhe brenda grupeve të ngushta intelektualësh e gjuhëtarësh që janë marrë me përzgjedhjen e normës letrare të gjuhës së sotme letrare. Lidhur me ato diskutime e trajne mendimesh, ne nuk dimë shumë. Në këtë kontekst për lexuesit dhe për studiuesit jo të paktë, ndër të cilët jam edhe unë, do të ishte me interes që të jepen sqarime, madje edhe përgjigje në një sërë pyetjesh, nga vargu i të cilave po i shkëput këto, ngase sqarimet a arsyetimet që po dëgjojmë, si ato që u cekën pak më sipër, nuk dalin aq bindëse:

1. Në ç' shkakllë profesionale njihe dhe vlerësohej atëherë problemi i paskajores me + pjesore nga faktorët me ndikim që ishin të implikuar dhe të ngarkuar në zgjidhjen e çështjes së ndërlikuar të shqipes së njësuar letrare në përgjithësi dhe të çështjes së paskajores me + pjesore në veçanti?

2. Sa përfilljeje në gjykime, atëherë, koncensusi pluralist në mendime, kur në politikë praktikohet metoda "e luftës së klasave", e cila propagandonte se "kundërshtari" jo vetëm se duhej mënjeluar, por edhe duhej asgjësuar plotësisht, prandaj, mos vallë, edhe në kundërvëniet sinonimike u kuptuan dhe u zbatuan jo ndërgjegjshëm kriteret të tilla?

3. Për hir të qëllimeve të larta sa ishte e pranishme në ato rrethana vetëdija e sakrificës nga vetë studiuesit e intelektualët gegërishtfolësi vetëm e vetëm të sendërtohet me çdo kusht dëshira gjakim: "Një komb – një gjuhë letrare të njësuar",⁶ prandaj flijimi i paskajorja me + pjesore, ishte pre e lehtë sakrifikimi, edhe pse mbase nga dikush–dikushi dihej pesha jo e lehtë për mungesën e saj?

4. Në rrethana të tilla kohore sa ishte i qartë koncepti se "gjuha zyrtare – administrative" nuk e përfaqëson tërë gjuhën standarde të një kombi a të një bashkësie folëse dhe se shikuar nga ky këndvështrim formës së paskajores me + pjesore pragmatikisht nuk mund t'i mohohet qëndrimi në normën e sistemit të gjuhës standarde, kur kemi parasysh kuptimin autonom që shpreh formë–fjala e tillë, sidomos kur dihet fakti se vetëm forma e tillë nuk ka mundur të zëvendësohet me ndonjë formë tjetër të vetme dysore paralele në dialektin tjetër, por me disa sosh?

5. A ishte i qartë koncepti se paskajorja, për hir të kuptimit autonom që ka, mund të shkëputet si "rast i veçantë" nga struktura paradigmore e sistemit foljor të gegërishtes dhe, madje, si rast më vete mund të integrohet në normën e shqipes së sotme letrare?

Pra, për çështjet e sipërshtuara e të ngjashme, del e nevojshme të jepen sqarime më të hollësishme, pasi nga një veprim i tillë, çështja do të njihet e qartësohet më mirë, por edhe zgjidhja do të gjendej më me lehtësi dhe do të ishte më e drejtë dhe më bindëse.

Për që kanë ekzistuar debate, polemika dhe rrahje mendimesh edhe për këtë çështje mësojmë nga kjo sekuencë a shprehje e nxjerrë nga një punim i studiuesit dhe njohësit të mirënjohur të problematikës së gjuhës së sotme letrare shqipe, prof. A. Kostallari, të botuar që në vitet '70, ku thuhet:

"Jeta provoi tashmë qartë se i ashtuquajtura problem i "infinitivit ose paskajores" në polemikat gjuhësore të mëparshme ka qenë mbivlerësuar. Norma letrare nuk mund të zgjidhte këtë problem në planin sintaksor shkëputurazi nga plani morfologjik. Ajo zgjodhi kështu drejtimin e rrudhjes së ndërtimeve që lidhen me "paskajoren e tipit me + pjesore" dhe kjo e ka pakësuar

⁶ Shih edhe kumtesa e prof. Ali Hadrit: "Një komb – një gjuhë letrare", Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1972), Prishtinë 1974, f. 203 – 204).

shumë në shkrim dallimin themelor sintaksor midis varianteve letrare të veriut dhe të jugut, duke lehtësuar kristalizimin e një forme të njëjshme sintaksore".⁷

Nga citati i lartpërmendur mësojmë jo pak gjëra me interes për temën që po trajtohet këtu, mësojmë pikërisht për faktin se si është vepruar për zgjidhjen a "pakësimin" e dallimit "themelor sintaksor midis varianteve letrare", d. m. th., me "rrudhjen e ndërtimeve" me formën e paskajores me + pjesore. Sa ka qenë me vend "thjeshtësimi morfologjik" ose një "rrudhje" e tillë për sintaksën e gjuhës shqipe në tërësi është çështje më vete. Është çështje tjetër gjithashtu edhe nëse në ato rrethana do të mund të ishte e arsyeshme rrudhja e tillë. Dihet fakti se "rrudhje e ndërtimeve në shkrim" a "reduktimi i rasteve të përdorimit" nuk nënkupton edhe mënjanimin e plotë a "zhdukjen" e një forme të tillë nga gjuha letrare, prandaj pikërisht procesi i mënjanimin të plotë të formës me + pjesore nga norma letrare paraqitet si çështje e diskutueshme e jo "rrudhja e ndërtimeve" mbi këtë bazë.

Është e vërtetë, në asnjërin nga burimet shkencore të kohës, as në burimet teorike e as në doracakët normativë të gjuhës së sotme letrare, duke filluar nga "Rregullat e drejtshkrimit të shqipes" (1967) e deri te "Kongresi i Drejtshkrimit të Shqipes" (1972), "Drejtshkrimi i gjuhës shqipe" (1974) etj. nuk ceket fare çështja e paskajores së tipit me + pjesore, fakt ky që do të na kumtonte a arsyetonte fazën e veprimit nga "rrudhja e ndërtimeve" deri te "mënjanimi i plotë i ndërtimeve të tilla". Në të vërtetë, asgjëkundi nuk patëm rast të lexojmë a të mësojmë, sadopak, pse u bë mënjanimi i tillë i plotë, cili asociacion ka vendosur, nga kush dhe kur është miratuar. Nuk dimë për ndonjë konsultë, sesion shkencor, simpozium, konferencë a kongres gjuhësor ku do të jetë shqyrtuar si pikë e veçantë kjo temë. Nëse ka ngjarë, vërtet është mirë që materiali i tillë t'i bëhet i dihur opinionit të gjerë, sidomos tani, kur çështja e tillë është riaktualizuar mjaft fuqishëm. Me një arsyetim a publikim të tillë do të dihet më së miri dhe do të hiqet dilema, që po dëgjohet jo rrallë, se goja vendimi për mënjanimin e paskajores në fjalë është marrë në mënyrë subjektive, madje subjektivistive. Nëse nuk jepet një sqarim i tillë lë shteg për t'u kuptuar se vendimi i tillë është marrë nga organi i caktuar, mirëpo "arsyetimi me shkrim" para përmbarrimit dhe më vonë, siç thuhet në zhargonin e të drejt-

⁷ A. Kostallari, Mbi disa veçori strukturore funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë, "Studime mbi leksikon..." I, Tiranë 1972 f. 38.

tës, është lënë në heshtje, mbase për të provuar reaksionin rreth përbarimit të tij. Ç'është e drejta, përbarimin e zbatuar e mësojmë në gramatikën normative të gjuhës së sotme letrare (morfologji (1976)),⁸ ku forma e paskajores me + pjesore nuk merret fare në trajtim si fomë e normës letrare. Në këtë burim paskajorja me + pjesore përmendet vetëm atëherë kur merren në shqyrtim format e pashjtelluara të normëzuara të foljes mbi bazë të pjesores. Kështu që në të njëjtin grup me format e favorizuara të tipit: **pa larë, duke larë** rradhitet edhe forma e pafavorizuar e tipit: **me la**, për të cilën jepet sqarimi se “përdoret vetëm në të folme geqe”. Edhe kur bëhet fjalë për format foljore të zgjedhimit vepror të ndërtuara me anë të foljes ndihmëse **jam** jepet sqarimi se “sikurse e kryera e formës së pashjtelluar mohore dhe e përcjellores: **pa qenë larë, pa qenë hapur; duke qenë larë, duke qenë hapur** – po kështu e ndërton formën edhe paskajorja dialektore e tipit **me la** që ndeshet vetëm në të folme geqe: me qenë la, me qenë hapur”. Edhe më qartë shprehet gjykimi mbi mënjanimin e saj nga norma, sipas këtij burimi, kur analizohet tipi i favorizuar i paskajores së tipit “për të larë”, ku në fushatë jepet sqarimi se trajta e tipit me **la**: “ka karakter dialektor (përdoret vetëm në gegërishte” dhe për këtë shkak, siç konstatohet aty: “nuk ka hyrë në shqipen letrare kombëtare”. Pra ky konstatim mund të cilësohet si përmbajtje e klauzolës së aktvendimit të shqiptuar më përpara, të cilin nuk patëm rast ta lexonim kaq qartë në asnjërin nga burimet e tjera “zyrtare” normative të kohës.

Këtu s'ka kurrfarë ndërzyrjeje, pikërisht të dhënat e tilla duhet të jepen në tekstet normative në fjalë, siç është edhe gramatika. Pra, jo vetëm se nuk është kontestuese kompetenca e gramatikës normative për paraqitjen dhe sqarimin e konstatimeve tëaktuara që kanë të bëjnë lidhur me normën letrare, por ajo është edhe detyrë e saj, por këtu del çështja të burimi mbështetës, ngase ky fakt, sipas mendimit tonë, nuk del mjaft i qartësuar, pra, duhet të dihet, ku e kur u mor ai vendimi dhe si qëndron arsyetimi, a është marrë vendimi i tillë me koncensus apo është vendim i marrë arbitrarisht, siç po thuhet, d. m. th., në parim a “në paketë” pa u trajtuar fare çështja si pikë më vete. Fakti se forma e tillë i mungon dialektit bazë në parim nuk del si arsye bindëse, pasi që ka edhe elemente të tjera të veçanta mbi bazë të dialektit tjetër d. m. th., të gegërishtes, por janë marrë në konsideratë dhe janë integruar a përvetësuar nga norma e shqipes së përbashkët letrare, kurse paskajorja në fjalë jo.

⁸ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976 f. 255, 262, 294.

Sidoqoftë, gjykimi i tillë i sanksionuar a i konstatuar në gramatikën në fjalë nga zbatuesit a përbaruesit “e disiplinuar” të normës letrare u kuptua si një anatemë a blasfemi, ose, më mirë me thënë, u keqkuptua, saqë nuk lejohet, ose stepej, siç nuk lejohet e stepet edhe sot e kësaj dite nga disa redaktorë e lektorë të ne, që nuk lejohet të përdoret edhe në “tipizime letrare” ose për efekte të caktuara stilistike e shkencore(!).

Edhe më subjektivë e dorështrënguar në përbarimin e dispozitivit të ndalimit (mënjanimi) u treguan hartuesit e sintaksës së periudhës,⁹ të cilët, në *Sintaksën e gjuhës shqipe* nuk e panë fare të arsyeshme së paku të shënojnë ndonjë ndërtim si rast me paskajoren në shqyrtim. Madje ata nuk dhanë as sqarimet e nevojshme, si arsyetim, pse nuk u morën në konsideratë konstruktet me paskajoren me + pjesore. Së paku është dashur të sqarohet dukurinë ashtu siç u veprua nga hartuesit e morfologjisë, siç u cek më sipër.

Siç dihet, forma e paskajores me + pjesore ka shtrirje sinonimike në tërë strukturën sintaksore të shqipes standarde, sipas kuptimit të gjerë, prandaj injorimi i formave të tilla, së paku sa për sqarim, nuk i ka kontribuar as kristalizimit të ndërtimeve që konsiderohen si forma të normëzuara, as njohjes sa më të thellë globale të sintaksës shqipe të shtrirë në dialekte.

Vërejtja që iu bë sintaksëhartuesve vlen edhe për hartuesit e fjalorit normativ shpjegues të gjuhës sonë që u botua me titullin “*Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*” (1980). Nuk di pse hartuesit e fjalorit në fjalë nuk e panë të arsyeshme të shënojnë së paku ndonjë **fjalë të urtë a shprehje frazeologjike** të ndërtuar me paskajoren me “me”, kur dihet fakti se gjuha e sotme standarde shqipe (qoftë edhe mbi bazë popullore) është mjaft e pasur me thënie a shprehje të tilla, të cilat, me abstraksionin e lartë që shprehin, paraqesin një specifikë autentike kuptimore e stilistike, e cila nuk mund të zëvendësohet plotësisht me asnjërin nga format e tjera të këmbësime sinonimike.¹⁰ Ç'është e drejta, njëfarë përjashtimi është bërë, nëse mund të thuhet kështu, në Fjalorin e

⁹ Është fjala për tekstin “Gramatika e gjuhës shqipe Sintaksa (Sintaksa e periudhës), (ribotim) Prishtinë 1991 si dhe për tekstin “Gramatika e gjuhës shqipe (Sintaksa) për kl. II AMO” të bashkautorëve: A. Kelmendi e M. Hasimja, Prishtinë 1989.

¹⁰ Jo vetëm sa për kërshtëri po e përmend faktin se në librin “Fjalë të urta dhe thënie popullore” të Destan Bajraktarit, Prishtinë 1975, janë shënuar afro 150 shembuj që fillojnë me paskajoren e tipit me + pjesore, kurse brenda tekstit numri i tyre është shumë më i madh. Ndërsa në veprën e tij të dytë: “Fjalë të urta e thënie popullore shqipe”, Prishtinë 1994 janë afro 840 shembuj që nisin me paskajoren me “me”. Shembuj të tillë ndeshim edhe në burime të tjera, ndër të cilat për nga vlera po veçojmë veprën: “Fjalë të urta popullore shqipe”.

shqipes së sotme (1984),¹¹ ku si sinonim sqarues për shprehjen: “me nder jush” është dhënë barasvlerësi si shprehje e ndërmjetme: “me nder me thënë” e asgjë tjetër?!

Është e udhës të përmendet lidhur me këtë se në FGGSSH (1980) kur jepet përkufizimi i kuptimit leksikor të pjesëzës “me”, nën 2. jepet ky sqarim: “përdoret zakonisht në të folmet e Veriut me pjesoren për të formuar një nga trajtat e paskajores” dhe për ilustrim jepen shembujt: “me qenë, me marrë, me dalë”,¹² duke mos u shënuar asnjë rast ilustrues të paskajores karakteristike të gegërishtes (më –UE dhe –0 (zero)) që nuk përkon me trajtën e pjesores së shqipes së sotme letrare.

Qëndrimi i tillë jofavorizues ndaj paskajores me + pjesore është shprehur edhe në veprën e Fadil Sulejmanit “Praktikumi i gjuhës shqipe” (Prishtinë, 1981), ku autori ndër të tjera konstaton se paskajorja e tipit “për të larë” është “normë letrare e jo format me la / me u la, me mësua / me u mësua etj.” Nuk di pse autori nuk i shënon veçan trajtat e pjesores geqe: me mësue / me u mësue ose ato të letrarëzuarat si p.sh. me mësuar / me u mësuar, të cilat ndeshen mjaft shpesh, sidomos te ne, por e shënon trajtën me mësua ?!). Ky autor, duke qenë i ballafaqur me realitetin, sepse jeton e vepron në mjedisë ku paskajorja me + pjesore ka përdorim të gjerë, këshillon: *nëse nuk jemi në gjendje që në të folur ose në të shkruar të bëjmë dallimin e formave të gabuara të paskajores me fjalëzën “me”: me la / me u la, atëherë në vend të formave të paskajores së tipit për të larë, për të mësuar etj. mund të përdoren fare lehtë format foljore të mënyrës lidhore.*¹³

Porosia e tillë është në përputhje me normën letrare, ashtu siç është edhe porosia që jep autori se pas fjalëve që shprehin vullnetin dhe qëndrimin e folësit si dhe pas foljeve me vlerë modale duhet të përdoren format e lidhore e jo ato të paskajores së tipit me “për të”, por nuk di pse, së paku për nevojë praktike për t’u ndihmuar nxënësve e studentëve dhe lexuesve të tjerë, nuk e përmend faktin se pikërisht janë format e paskajores me + pjesore ato të cilat qëndrojnë si sinonime me barasvlerësi të barabartë kuptimore me format kohore të lidhore e jo format e paskajores me “për të”, për çka tërhiqet vërejtje aty. Edhe nga ky konstatim i prof. F. Sulejmanit del qartë se paska-

¹¹ Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1994 f. 758.

¹² Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 1104.

¹³ Fadil Sulejmani, Praktikumi i gjuhës shqipe, Prishtinë 1981, f. 123.

ajorja me “për të” nuk është aspak e denjë për të shprehur nocionin e paskajores së mirëfilltë me “me”, prandaj zgjidhja përcillet te format e lidhore. Në të vërtetë, në raportin: paskajore e tipit me + pjesore, format kohore të lidhore dhe të formës së paskajores me “për të” edhe sot e kësaj dite kanë mbetur gjëra që duhen qartësuar. Në këtë kontekst mendoj se, sot për sot, roli i paskajores me + pjesore del i minimizuar. Me fjalë të tjera, ndërsa dikur, sipas vlerësimit të prof. A. Kostallari, çështja e formës së paskajores me + pjesore mbivlerësohej, tashmi mund të thuhet se çështja e tillë kaloi në skajin a ekstremimin tjetër, d.m.th. nënvlerësohej.

Gjithsesi, qëndrimi i tillë sa është nënvlerësues e sa jo, do të dalë sheshit më mirë me rasën e rikthimit të çështjes në fjalë në tryezën e diskutimeve me qëllim rivlerësimi pa pretendime mbivlerësuese a nënvlerësuese.

3. Reagimi i pamjaftueshëm i studiuesve tanë shkak i pasivizimit të paskajores me + pjesore në shqipen letrare kombëtare

Nuk di sa është i mbështetur gjykimi që dëgjohet jo rrallë në kuloare të caktuara se për pasivizimin e paskajores me + pjesore, d. m. th., edhe për ato nënfisha semantike për të cilat shprehet nevojë a domosdoshmëri, në radhë të parë, janë fajësues vetë studiuesit e shkrimtarët gegërishtfolës e pastaj mund të fajësohen edhe të tjerët. Fajësohen studiuesit e shkrimtarët gegërishtfolës, të cilët ose e heshtën çështjen e paskajores ose nuk reagoan me faktet që mund t’i kenë pasur për të argumentuar nevojën për integrimin e saj, si rast të veçantë, në normën e përbashkët letrare të shqipes për nënfisha të caktuara. Kjo formë, ç’është e drejta, për hir të kuptimit autonom që ka, nuk është dashur që patjetër të jetë e kushtëzuar me qenë e ndërlidhur me format e tjera të asaj strukture (paradigmat), të cilat paraqitin pengesë a nuk do të mund t’i qëndronin konkurrencës ndaj formave gjegjëse të letrarishtes së sotme gjithësi më vitale. Pikërisht, si rast i veçantë, nuk di sa është trajtuar kjo çështje nga studiuesit tanë më parë.

Me sa dimë ne, në vitet ‘70 lidhur me nxjerrjen e saj jashtë normës letrare, nuk pati reagime të veçanta. Përjashtim bën te ne, reagimi i prof. Rexhep Ismajlit, i cili në artikullin “Tingulli, fjala e lidhur, ligjërimi (1972),¹⁴ duke e

¹⁴ Rexhep Ismajli, Shenjë dhe ide, Prishtinë 1974, f. 114.

përmendur karakterin mbidialektor të sistemit të shqipes standarde, pos të tjerash veçon edhe rastin e paskajores me + pjesore dhe tërheq vërejtjen se nocioni i formës së tillë në gjuhën letrare “jo gjithmonë mund të zëvendësohet, meqë është mënyrë jo vetore e të shprehurit dhe formë shumë e lartë e abstraksionit” dhe se mospërfshirja a mospërfillja e trajtës së tillë në normën e gjuhës letrare të “standardizuar” paraqet “pos tjerash një problem të madh për kulturën tonë, ndoshta më të madhin nga problemet e gjuhësore, për shkak se në këtë mënyrë shtrohet edhe çështja e traditës, qoftë gojore, qoftë të shkruar, por shumë të pasur” dhe përfundon me brengosjen e ligjshme se nëse nuk shtrohet e nuk zgjidhet në kohën tonë, kjo çështje “ndoshta do të jetë një nga problemet që brezat do t’i kthehen më së shumti”.

Reagimi i prof. Rexhep Ismajlit pati jehonë periferike, ashtu si edhe reagimet e studiuesve nga diaspora, siç ishin M. Camaj, Arshi Pipa, mbase edhe Solano e ndonjë tjetër, të cilët në fakt (e kam me të dëgjuar) shprehën rezervë a mospajtim rreth zgjidhjes së tërësishme të gjuhës letrare kombëtare të njësuar përgjithësisht mbi bazë të toskërishtes të miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes (1972), e në këtë kuadër përmendin si fakt të lënë jashtë norme veçmas edhe paskajoren e tipit me + pjesore. Kur është fjala te mohimi i rezultateve të Kongresit në fjalë nuk u japim të drejtë, ngase me një veprim të tillë është fituar më shumë kombëtarisht sesa të mbetet gjuha e shkruar e fytyruar në shumë variante letrare.

Merita e prof. R. Ismajlit qëndron në faktin se ky nuk e vë në dyshim sistemin e pranuar foljor të normës së shqipes së sotme letrare, por e veçon rastin e paskajores me “me” si një çështje më vete, pa e lidhur domosdo me strukturën paradigmore të sistemit foljor të gegërishtes.

Është e vërtetë se në fillim të viteve ‘70 (që nga viti 1968)¹⁵ në Kosovë e përgjithësisht në viset shqiptare në ish – Jugosllavi njëzimi i gjuhës letrare që pritur me entuziazëm dhe eufori të ligjshme, sidomos nga intelektualët e rinia shkollore. Kjo eufori e ndërjegjshme arsyetohet nga rrethanat e kohës, ngase me gjuhën e njësuar ndjehej një frymëmarrje e re që na lidhte idealisht me jetën dhe frymën e bashkimit kombëtar, bashkim ky (së paku kulturor) të cilin e kemi ëndërruar përherë, madje duke bërë edhe sakrificime jo të vogla.

¹⁵ Shih: “Konsulta gjuhësore” te “Gjurmime albanologjike” 1/68, Prishtinë 1968, ku në “Konkluzat” e asaj “Konsulte” thuhet se “Tubimi shpreh bindjen se njësimi i shqipes nga Rilindja e këndej”.

Prandaj në këso rrethanash edhe flijimi i paskajores me + pjesore nuk vihej në pyetje, edhe pse, me thënë të drejtën, te të gjithë gegërishtfolësit mënjanimi i formës së tillë sillte, siç sjell edhe sot vështirësi, ngase paskajorja me + pjesore është shenjzë e skalitur fort në sistemin ligjëror të tyre. Megjithatë, në këtë fazë të zotërimit të normës letrare te ne nuk pati reagime të tjera, pos atij të R. Ismajlit që u cek më sipër.

A pati reagime të tilla në Shqipëri apo jo nuk e di. Edhe atje, me sa jemi të informuar, vijonte fushata e propagandimit institucional të mësimi dhe të përhapjes së normës së njësuar letrare kombëtare, madje me intensitet të shtuar, që nënkuptohet, pa formën në fjalë.

Mirëpo në fillim të viteve ‘80 te ne del edhe një reagues tjetër, dhe pikërisht autori i librit të cekur më përpara “Praktikumi i gjuhës shqipe”, ligjëruesi i lëndës së morfologjisë në Fakultetin Filozofik të Prishtinës, Dega e gjuhës shqipe, prof. Fadil Sulejmani, i cili në kumesën e tij me titull “Çështje të normës letrare” të lexuar në simpoziumin shkencor “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës” të mbajtur në Prishtinë më 15, 16 dhe 17 dhjetor 1980,¹⁶ pos tjerash, në pikë të veçantë cek çështjen e paskajores me + pjesore në formë pyetjeje: “Edhe me punue apo vetëm për të punuar?”

Kur kemi parasysh faktin se ku është thënë (lexuar) dhe kur është thënë, nga cili dhe para kujt, mendoj se ia vlen të rishënohet më poshtë tërë teksti integral i reagimit në fjalë:

“Pse mos të ngrihet në normën letrare në gjuhën e sotme shqipe edhe paskajorja e ish-variantit letrar gegë? Ç’është keqe do t’i sillte gjuhës së sotme letrare shqipe edhe përdorimi i paskajores geqe me punue? Kurrnjë të keqe, vetëm mirë. Ç’ dëm do të bëronte gjuha jonë letrare, po të miratonte edhe përdorimin e paskajores geqe me punue. Asnjë dëm, përveçse dobi. Mos përdorimi i paskajores geqe me punue në gjuhën e sotme letrare do ta varfëronte atë, si nga ana gramatikore, ashtu edhe nga ana stilistike. Përkundrazi, përdorimi i këtij tipi të paskajores do ta pasuronte gjuhën e sotme letrare shqipe: strukturën gramatikore dhe mënyrën e shprehjes së saj stilistike e kuptimore. Pra, që të kemi një gjuhë letrare sa më të të pasur me forma e konstruke fjalësh, të cilat do t’i mundësonin asaj që, ndër të tjera, ta realizojë

¹⁶ F. Sulejmani, Çështje të normës letrare te “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës”, Prishtinë 1983 f. 95.

më lehtë misionin e vet komunikues ndërmjet njerëzve, do të duhej që, përkrah paskajores toske për të punuar, të përdoret edhe paskajorja gege me punue. Si paskajorja toske për të punuar, ashtu edhe paskajorja gege me punue, janë që të dyja konstruktë të gjuhës shqipe, janë vetë gjuha shqipe. Madje konstruktë i paskajores gege me punue është i lehtë për ta thënë e për ta shkruar edhe pjesëtarët e të folmeve toske. Në këtë mënyrë, pra duke lejuar njëkohësisht edhe përdorimin e konstruktit foljor me punue gjuha e njësuar letrare shqipe do të mësohej e do të përvetësohej shumë më lehtë e më shpejtë në këtë pikë gramatikore, si nga folësit e dialektit toskë, ashtu edhe nga ata të dialektit gegë. Kështu, me përdorimin e paskajores me punue, edhe të huajt do ta mësonin më lehtë e më shpejtë gjuhën tonë letrare dhe ne do të mësonim më lehtë e më shpejtë gjuhët e huaja, kryesisht ato indo-evropiane, që janë të një tringu me gjuhën shqipe, sepse siç dihet, paskajorja e tyre, pothuajse e të gjithave shkon me paskajoren shqipe të tipi gegë me punue, si arbeshten, lavorare, raditi etj. që i përgjigjen paskajores gege me punue. Ndër të tjera, s'ka dyshim se me përdorimin edhe të paskajores gege me punue përkrah paskajores toske për të punuar do të kapërcehej njëra nga pengesat më të mëdha e më të vështira në mësimin dhe përvetësimin sa më lehtë e më shpejtë të gjuhës së sotme të njësuar letrare shqipe, të paktën nga pjesëtarët e të folmeve gege. Edhe mospërdorimi i paskajores me punue, s'është gjë tjetër veçse një përjashtim që i bëhet me të padrejtë gjuhës së sotme letrare shqipe, duke e varfëruar kështu strukturën e saj gramatikore dhe mënyrën e shprehjes së formave të saj stilistike e kapitimore. Nga gjithë kjo sa u tha më lart del se kështu do të kishim edhe në këto pika drejshkrimore e të tjera si këto të gjuhës së sotme letrare shqipe më pak përjashtime e më shumë përgjithësime. Në këtë mënyrë do t'ua bënim më të lehtë mësimin e gjuhës letrare shqipe, si tanëve, ashtu edhe të huajve, për ta përvetësuar atë me lehtë e më shpejtë¹⁷.

Në këtë paraqitje F. Sulejmani, edhe pse është përqendruar më tepër në aspektin morfologjik të trajtave paralele në raportin paskajore "gege" ndaj asaj "toske(!)", pa u ndalur edhe në raporte të tjera, siç është sinonimia me format kohore të lidhore, të së tashme së dëftores e të tjera, prek mjaft çështje, të cilat duhen pasur në konsideratë edhe aktualisht, në mënyrë që faktet e shtruar nga ai të vlerësohen e sqarohen me objektivitet të plotë nga kuadrot tanë kompetentë.

Edhe njëherë shpreh keqardhje për faktin se nuk di për reagime të tjera, të cilat lidhen kryekëput me paskajoren me + pjesore, përkatësisht që kanë të bëjnë lidhur me mënjanimin e saj nga norma letrare e shqipes së sotme dhe që janë publikuar para viteve '80 e '90.

4. Riaktualizimi i çështjes sforcim i qëndrimit subjektiv apo qasje re në zgjidhjen me integrim të paskajores me + pjesore

Klima e re politike që u krijua në Shqipëri nga fundi i viteve '80 dhe fillimi i viteve '90, d.m.th. pas ndryshimit në sistemin shoqëror-politik, bëri të mundur edhe riaktualizimin në njëfarëdore edhe të çështjes së gjuhës letrare kombëtare në përgjithësi, e në veçanti riaktualizoi edhe çështjen e paskajores me + pjesore, e cila, siç e pamë ishte e prekur e nuk ishte çështje e heshtur edhe më përpara. Lidhur me normën e shqipes letrare kombëtare përgjithësisht, gjuhëtarët dhe intelektualët tanë (edhe ata nga Kosova), patën qëndrim të drejtë, ngase e mbrojtën gjuhën e njësuar aktuale, sepse gjuha nuk ka karakter klasor, partiak e politik të karakterit të ngushtë. Sistemet e regjimit mund të ndërrohen, por gjuha mbetet, ashtu siç mbetet edhe atdheu. Mirëpo, siç dihet, si për atdheun ashtu edhe për gjuhën, sidomos për gjuhën letrare kombëtare, duhet punuar pandërprerë. Vjijimisht duhet pasur kujdes e përkujdesje në ruajtjen, pasurimin, përmirësimin, përsosjen dhe këndelljen e gjendjes së këtyre dy kauzave të shenjta: atdheut dhe gjuhës, krahas sfidave që sjellin rrymat e moteve, ngase "shkenca jonë nuk mund t'i bjerë ndesh praktikës"¹⁷ që ndiqet kudo në vendet e kulturuar. Sidoqoftë, në këtë kontekst të trajtimit të gjendjes së gjuhës letrare kombëtare, jo pa arsye, u riaktualizua edhe çështja e paskajores në shqyrtim. Kjo u bë edhe në Konferencën shkencore (gjuhësore) që u mbajt në Tiranë, në nëntor të vitit 1992,¹⁸ ku u mbrojt, me të drejtë, baza e gjuhës së sotme letrare kombëtare shqipe, por edhe u tha se ajo bazë duhet përsosur.

¹⁷ Lulëzim Gazheli (bashkëpunëtor shkencor i ASHSSH). Në artikullin "Demokratizimi i shkencës – detyrë e kohës", i botuar në gazetën "Rilindja demokratike", Tiranë 1993 f. 2, ku, pos tjerash, thuhet se "Shkenca jonë e re që po rilind, nuk mund t'i bjerë ndesh praktikës (...) traditës së pasur materiale e shpirtërore".

¹⁸ Konferenca shkencore me temën bosh "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot", mbajtur në Tiranë më 20 – 21 nëntor 1992.

Pikërisht aty, siç e pohon edhe M. Halimi, “në diskutim u tha se përkundër disa plotësimeve në kuadër të morfologjisë: të shumësit të emrave të përdorur në dy variante dhe mungesës së paskajores (infinitivit), i cili e varfëron gjuhën tonë letrare, sepse paraqiten vështirësi edhe gjatë përkthimeve nga gjuhët e huaja, ndaj mund të shqyrtohet e të analizohet çështja e përdorimit të tyre, duke mos prekur në sistemin e gjuhës së njëसार letrare dhe duke iu përmbajtur motos së *Konsultës gjuhësore të Prishtinës* (1968): Një komb – një gjuhë”, ashtu siç ngjet me të gjithë popujt e civilizuar të botës¹⁹

Me fjalë të tjera, aty përkitazi me paskajoren me + pjesore pos paraqitjeve në mbështje të normës së sotme²⁰ lidhur me këtë pikë, duke e cilësuar si çështje tashmë të zgjidhur me “mënjanim”, u tha se ajo (çështja e paskajores) nuk mund të konsiderohet kurrsesi si çështje e mbyllur. Ajo ende mbetet çështje e hapur e normës së gjuhës letrare shqipe. Aty shprehëm mendimin se zgjidhja më e mirë do të ishte që paskajorja me + pjesore “si rast i veçantë” të rizgjidhet me integrimin e saj në normën letrare e jo me mënjanimin e saj. Madje rreth këtij veprimi u përmenden dy fakte:

e para, mungesën e formës së tillë e ndjen vetë baza e gjuhës standarde kombëtare, e cila, me integrimin e paskajores në fjalë e disa elemente të tjera, do të marrë konotacion të ri kuptimor dhe

e dyta, me një veprim të tillë nuk do të pësojë kurmjë të keqe struktura e normës së sotme të shqipes letrare kombëtare.

Këto dy parakushte si garanci, d.m.th. nevoja për një formë të tillë si dhe mospësimi i strukturës së përgjithshme të shqipes letrare, që u cekën aty, do të trajtohen mjaft gjerësisht në kreutë vijues të këtij punimi.

¹⁹ M. Halimi, të “Gjurmime albanologjike” seria e shkencave folologjike, nr. 22/92, Prishtinë 1993 f. 157.

²⁰ Prof. Sh. Demiraj, *Gjuha letrare shqipe e njëसार dhe çështja e paskajores*, te revista “Dodona” 3 nëntor /94, Prishtinë 1994.

Kreu III

RRETH NEVOJËS PËR INTEGRIMIN E PASKAJORES ME + PJESORE NË SHQIPEN STANDARDE KOMBËTARE

Çështja e të kuptuarit të nevojës për (ri)integrimin e paskajores së tipit me + pjesore në normën e gjuhës sonë letrare kombëtare është kërkesë që zë vendin kyç në këtë punim. Është pikërisht ai parakushti apo pikësynimi i objektivit të vështrimit sinkronik, përmbushja e të cilit nëse mund të paraqitet me argumente bindëse, jo vetëm se do të arsyetonte diskutimin, por edhe do ta bënte të mundur zgjidhjen njëherë e përgjithmonë të çështjes në shqyrtim.

Siç është përmendur edhe nga të tjerë, çështja e tipit të paskajores me + pjesore ka mbetur si dallimi më i madh strukturor në raportin në mes të strukturës së gjuhës së sotme letrare, në njërin anë dhe të gegërishtes a të ish–shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, në anën tjetër. Pikërisht për këtë arsye d.m.th. për të zgjidhur përfundimisht këtë çështje sa brendagjuhësore (psikolinguistike) sa jashtëgjuhësore (sociolinguistike), ky krye i punimit do të jetë më i vëllimshmi, do të përfshijë çështjet në nëntemat, si vijon:

së pari, rezervat a kundërshtitë e shprehura nga gjuhëtarë të caktuar ndaj zgjidhjes me mënjanim a lënie jashtë normës letrare të formës në fjalë;

së dyti, dëshmitë si prova nga burimet tona informative e të tjera të vjela nga masmedia e përditshmëria jonë për të argumentuar se trajta e tillë me kriter e pa kriter, është duke u përdorur, jo vetëm në gjuhën e folur, por edhe në atë të shkruar, duke u paraqitur kështu si çështje e hapur me trysni gjithnjë në rritje në mbarë truallin shqipfolës;

së treti, të dhënat që dëshmojnë se forma e paskajores me + pjesore nuk del si çështje e thjeshtë dialektore, por, për arsye të specifikës formale e kuptimore që paraqet ajo, kalon në suaza më të gjera;

së katërti, faktet se forma e paskajores në shqyrtim si fjalë formë–koncept nuk mund të mbulohet me një formë tjetër të vetme paralele sinonimike, por me disa sosh, e së këtejmi fitohet përshtypje se koncepti i saj nuk del i mbuluar tërësisht me asnjërën nga format sinonimike, madje as nga të gjitha ato së bashku;

së pesti, jepen katër fakte si vëzhgime të nëpërdukshme, sipas të cilave provohet se përdorimi i paskajores me + pjesore del jo vetëm i nevojshëm, por edhe i domosdoshëm për disa sfera a nënfusha të caktuara semantike;

së gjashtë, përmenden disa dukuri devijuese konkrete te ne, të cilat dalin të shfaqura si pasojë e mënjanimit nga përdorimi i normëzuar i formës së paskores me + pjesore në gjuhën e sotme letrare;

së shtati, jepen prova se edhe sipas metodologjisë hulumtuese bashkëkohore linguistike mbështetet nevoja e integritit të formës së paskajores në shqyrtim në shqipen standarde kombëtare, për arsye se ajo në fakt ekziston në sistemin standard të shqipes dhe se tradicionalisht është në përdorim aktiv për nënfusha të caktuara semantike dhe së fundi;

së teti, ceket përmbledhtas aftësia si dhe detyrimi i strukturës së letrarishtes standarde për të përfshirë në gjirin e vet edhe formën e paskajores me “me” për nënfusha të caktuara konkrete semantike.

a) Rezervë e shprehur ndaj zgjidhjes me mënjanim të paskajores me + pjesore nga norma letrare

Duke qenë të ballafaqar me problemin e paskajores me + pjesore në kuadër të tërë ndërlikueshmërisë që paraqitet rreth ndërkëmbimit të formës së tillë ndaj formave të tjera paralele sinonimike disa studiues tanë bashkëkohorë, edhe pse përkrahës dhe zbatues të normës së shqipes së sotme letrare të njësuar, kanë shprehur rezervë, madje edhe kundërshti rreth zgjidhjes me mënjanim të paskajores në fjalë nga struktura e shqipes së njësuar letrare, ngase, siç shprehen ata:

– Trajta me + pjesore “jo gjithmonë mund të zëvendësohet (...)”; “zor se mund të zëvendësohen të gjitha funksionet e saj, kur kemi parasysh rrafshin e realizimeve të ndryshme stilistike e sociokulturore”¹ (Rexhep Ismajli).

– Ka “struktura të zëvendësueshme e të pazëvendësueshme të lidhores e të paskajores (...), në ndërtimet me paskajoren me “me” dalin mjaft grupe që mjaft herë është vështirë të kapen (...)”² (Tafil Kelmendi).

¹ Rexhep Ismajli, Shenjë dhe ide, Prishtinë 1974 f. 114; Gjuhë dhe etni, Prishtinë 1991, f. 316.

² Tafil Kelmendi, Përdorimi paralel dhe jo paralel i lidhores dhe i paskajores në gjuhën popullore, te “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, Prishtinë 1983 f. 305.

– “Mospërdorimi i paskajores me punue, s’është gjë tjetër veçse një përjashtim që i bëhet me të padrejtë gjuhës së sotme letrare shqipe, duke e varfëruar kështu strukturën dhe mënyrën e shprehjes së formave të saj stilistike e kuptimore”³ (Fadil Sulejmani).

– “Cungimi i paskajores u bë si pasojë e qëndrimit subjektiv ndaj gegërishtes”⁴ (Mehmet Çeliku).

– Të përjashtuarit e paskajores “nga norma apriori ka lënë një zbraztësi-rire jo të vogël në strukturën e gjuhës letrare shqipe”⁵ (Fadil Raka).

– Mund të thuhet se pa të drejtë “letrarishtja e vitit 1972 e ka fshirë nga norma ndër të tjera infinitivin e gjuhës shqipe”⁶ (Ardian Klosi).

– Përveç të tjerash si problem “përmendim heqjen me dhunë të paskajores si fakt i pahijshëm, madje i shëmtuar”⁷ (Pal Doçi).

– “Gjuha letrare shqipe ka nevojë për formën e paskajores me + pjesore”⁸ (Tomor Osmani).

– “Çështja është mjaft e ndërlikuar pikërisht te paskajorja, sepse nuk e prek vetëm gjuhën e folur në sistemin e saj morfosintaksor, por edhe elementin më të rëndësishëm etnosociologjik të popullit shqiptar”⁹ (Engjell Sedaj).

– “Mund të pohoj se çështje e paskajores mbetet problem i hapur për hulumtuesit e mirëfilltë” si te ne ashtu edhe më gjerë...¹⁰ (Dr. A. Presheva).

³ Fadil Sulejmani, Çështje të normës letrare te “Probleme aktuale të kulturës së shqipe”, Prishtinë 1983, f. 81.

⁴ Mehmet Çeliku, citat i nxjerrë me të dëgjuar nga kumtesa “Gjuha e sotme letrare shqipe – arritje e rëndësishme kombëtare” e lexuar nga autori në Konferencën shkencore “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot”, mbajtur në Tiranë më 21 – 22 nëntor 1992 (Shih: “Programi” i konferencës f. 3).

⁵ Fadil Raka, Gjuha letrare e standardizuar, artikull i botuar në gazetën “Bujku”, 18. IX. 1992 f. 6.

⁶ Ardian Klosi, nga intervista dhënë revistës “Zëri”, 14. V. 1994 f. 7.

⁷ Pal Doçi, Etapa e planifikimit gjuhësor, artikull i botuar në gazetën “Bujku”, 12. VIII. 1994, f. 7.

⁸ Tomor Osmani, citat i nxjerrë me të dëgjuar nga kumtesa “Disa probleme të normës morfologjike drejshkrimore” të lexuar në Konferencën shkencore sipas shënimit 5, të këtij kreu.

⁹ Engjell Sedaj, GSH (Prishtinë), 2. IV. ‘98, f. 29.

¹⁰ Dr. A. Presheva, Filozofia e gjuhës, Prishtinë, 1998, f. 309.

–”Paskajorja me “me”, e them me keqardhje, ka qenë mënjauar nga norma e gjuhës letrare (...) e kanë pasë injoruar pikërisht këtë trajtë, të cilën e kanë përdorur me shekuj dhe ende e përdorin dy të tretat e tërë popullit shqiptar...” (Mehmet Gjevari, citat nga *vlerësimi me shkrim* i këtij punimi, 8. 12. '99).

Këtu nuk janë përfshirë mendimet e atyre gjuhëtarëve, të cilët (e kam me të dëgjuar) parimisht a në përgjithësi e mohojnë dhe nuk e zbatojnë normën e gjuhës së sotme letrare (p. sh. A. Pipa, M. Camaj e ndonjë tjetër), punimet teorike të të cilëve, ç'është e drejta, as që kam pasur rast t'i konsultoj, prandaj edhe mund të gaboj në gjykim.

Gjithashtu nuk janë marrë parasysh e as që përkrahen edhe mendimet e individëve të caktuar që aty–këtu mund të dalin me propozimin transparent që aludojnë, si të themi, për një separatizëm të letrarishtes. Të jem më i qartë. Pata rast të mësoj nga shtypi se më 26. VI. 1993 në Shkodër është mbajtur një simpozium shkencor me temën bosht: “Shkodra në shekuj”, ku është theksuar, ndër të tjera, se “në vitin 1972 (nga Kongresi i Drejtshkrimit të Shqipes) u hodh poshtë dialekti i gegërishtes që është një nga vlerat kombëtare” (Shih te gazeta “Bujku”, 27. VI. 1993 f. 6), dhe kjo mund të lërë shteg për t'u kuptuar nostalgjia që shprehet për “gjuhën e vjetër letrare” të variantit gegë, mbase të nënvariantit të shkodoranishtes ?!

Ç'është e vërteta, këtu as që bën të kontestohet “vlera kombëtare e gegërishtes” as e “shkodranishtes”, ngase ky është konstatim me vend, por nuk duhet ndërlikuar me të për të keq çështja e njësimin të gjuhës sonë letrare kombëtare, pasi me njësimin e gjuhës letrare në plan kombëtar, pa dyshim është fituar shumë më shumë kombëtarisht, sesa të vazhdonte gjuha e ndarë në disa variante e nënvariente letrare. Këtë të mbërrime e kemi ndër dhe e ndiejmë, mbase më mirë se gjithë të tjerët ne në Kosovë. Mirëpo, këtu nuk duhen ngatëruar gjërat, tjetër është vlera historike, tjetër është edhe vlera letrare–artistike tipizuese e ambientit përkatës gjuhësor që mund të shfrytëzohet pragmatikisht edhe sot e gjithë ditën, sepse tjetër është vlera e prezantimit zyrtar etj?! Madje, tjetër gjë është nëse kërkohen përplotësime e përsosje të normës së caktuar standarde të gjuhës letrare kombëtare, siç është edhe tema që po trajtohet këtu, çështje kjo që për arsye të ndryshme nuk është marrë parasysh për t'u futur në normizim, ndoshta edhe për shkaqe subjektive, prandaj, për këtë arsye edhe rezervat e shprehura lidhur me këtë nga studiuesit tanë janë të arsyeshme dhe duhen pasur në konsideratë, sidomos kur

kemi parasysh faktin se të gjithë këta rezervëshprehës rreth “zgjidhjes” së tillë, janë gjuhëtarë a intelektualë të afirmuar, të cilët edhe me shkrimet e tyre kanë dhënë ndihmesë jo dhe aq modeste, pikërisht në të kuptuarit dhe në të zbatuarit e normës së sotme letrare të gjuhës sonë.

Në pamundësi që të njihem me hollësitë, sipas të cilave qenë motivuar si dhe për arsyet që i shtynë autorët e lartpërmendur të shprehin rezervë e kundërshti rreth zgjidhjes së tillë, nuk e kemi lehtë të gjykojmë se cilat janë argumentet konkrete dhe cili është qëllimi final i tyre, çfarë mesazhi kanë, megjithatë një gjë dihet qartë, ç'është e vërteta, çështja e paskajores me + pjesore mbetet si një ndër pikat më të mprehta në tryezën e diskutimeve të gjuhëtarëve dhe të intelektualëve tanë. E thënë me fjalë të tjera, çështja e paskajores me + pjesore paraqitet aktualisht si një çështje e hapur që kërkon zgjidhje dhe se ajo zgjidhje, s' do mend, duhet kërkuar jo gjetiu, por pikërisht nën patronazhin a përkujdesjen e vetë gjuhës standarde kombëtare.

b) Paskajorja me + pjesore – problem i hapur aktualisht edhe në gjuhën e shkrimit

Përkundër qëndrimit subjektiv dhe propagandimit të organizuar zyrtar e shoqëror për mënjanimin e plotë nga përdorimi të formës së paskajores me + pjesore, përveç në gjuhën e folur, ajo vazhdon të përdoret edhe në gjuhën e shkrimit. Pasi nuk është fjala për fryrje artificiale të çështjes, por është fjala për një trysni spontane të vetëvetishme që del natyrshëm nga masa shumicë që e ka të ngulitur formën e tillë në sistemin e vet ligjërorim, por edhe nga të tjerët, në vazhdim, sa për ilustrim, do të përmend disa raste nga përditshmëria jonë, d.m.th. nga shtypi i ditës dhe nga burime të tjera, pa e bërë ndonjë përzgjedhje të qëllimite, por duke i shënuar më tepër ato burime, të cilat, në brenda tekstit të shkruar a të përdorur në letrarishten e sotme del e shënuar ose e thënë paskajorja me + pjesore. Pothuajse në të gjitha këto raste nuk bëjnë pjesë në të ashtuquajturin “tipizim letrar”, sipas kuptimit të ngushtë, por kanë të bëjnë me paskajoren si “rast të veçantë”, brenda tekstit të letrarishtes së sotme.

1. Në doracakun “Komunikim praktik – Fjalor bisedimesh” të botuar në Tiranë 1992 brenda tekstit të shkruar në letrarishite ndeshëm këto trajta në

paskajoren me “me”: me u la, me qenë i veshur, me u falë, me vendos(ë), me bërë njet ... (Aty f. 63). Edhe në librin e shenjtë “Kur’ani” në shqip (Prishtinë 1985) pos tjerash ndeshim këto raste të paskajores: me u shmangur, me i futur, me pas mundur, me dalë, me gjetur, me marrë shpërblim, ke me parë, keni me u marrë vesh ... (Aty f. 159, 251, 394, 590). Në gazetën “Ittifak”, Prishtinë, nëntor 1994 “fëmijët ... një ditë kanë me qenë të dobi-shëm” (f. 7). Edhe në një libër të P. Françesk Malajit ndeshëm këto raste: me jetuar, me krijuar, me menduar, me pa, me shuguruar, me ngajkue (Shih: Kuvendi i Arbërit, Prishtinë 1998)

2. Nga gazeta “Bujku” e Prishtinës ku kam ndeshur mjaft shembuj, ndër ta shkëputa: “mos me pa, me shti” (18. VII. 1993 f. 6); “me nis(ë), me ndigju(e), me shku(e) (19.VII. 1993 f. 6); “me krijuar” (4. V. 1993); “me i thënë” (12. VII. 1994 f. 6); *Rilindja*: kishin me u plasuar, kishin me u shtuar, kishin me u ndikuar, kishin me u pasuruar (20. I. 2000, f. 4) etj.

3. Në revistën “Rrezja jonë”, 2/92 (Tiranë): me pa, me pushue (Aty f. 43, 45); në revistën “Zëri” (Prishtinë): për me liruar, per me lirue (6. II. 1993 f.5), me tradhtue (20. III. 1993 f. 4), don me demonstruar (6. VIII. 1994 f. 14); në “Shëndeti”, 4–5/88 (Prishtinë): “me gëzuar”, nr.4/89: “ka nisë me punue”, “Gazeta shqiptare”: me harrue, me u dorëzuar, me fluturuar, me shkuar, me rrethuar, me u kthyer, me mbaruar, me dal(e) (29. IV. ’97 f. 2; 34, 35).

4. Te revista “Republika” 9/10 1993 (Ljubjanë): “ku me gjetë” f. 48), “me ble, me luftue” (f. 41), “me u zënë frymën”(f. 32), “me pasë, jetën me dhënë, me u abonua” (f. 14); në fletshkën “Pena” (Prishtinë): “ndalohet me bërë plaçkë” (f.3), “çka me bërë?” (f. 10); në gazetën “Fjala jonë” nëntor 1994 (Prishtinë): “për mos me u koritë; me i sprastruar” (f. 23).

5. Në gazetën “Zëri i popullit”, 21 e 22. XI. 1992: “me lanë, me zanë, me përdhosë, me arth(ë), me drithë” etj., forma këto që sa i përket letrarizimit janë të shkruara pa kriter, ndërsa sa i përket faktologjisë zgjojnë interes.

6. Në të përjavshmen “Jehona” të Tëmovcit të Bujanovcit nr. 13 / maj 1993: “kish me pasë me fluturue (f. 7), me dalë, me ardhë” (f. 10), por edhe format: “kam me vdekur, me mbrojtur” (të përdorura nga rilindësi Risto Deda).

7. Në disa emisione (informative) të “Radio-Tiranës” (gjatë vitit 1993) m’i kapi veshi këto trajta të paskajores në shqyrtim: “duhet me përfaque (15. II. 1993, ora 15.35), me nxjerrë jashtë (23. II. 1993, ora 14.45), me luftue (5. III. 1993, ora 14.40), me thënë të drejtën (22. IV. 1993, ora 18.50), me pritë (3. V. 1993, ora 14.30), do të vazhdojmë me qenë (3. V. 1993, ora 10.35), me marrë

masa, kishte me qenë mirë (17. V. 1993, ora 19.25), kanë me ndeshë, kisha me u thënë (14. VII. 1993, ora 21.10), me ndihmuar (1. VIII. 1993, ora 22.40), kanë me ndihmuar (23.X. 1993, ora 22. 45), ka pasur me ateruar (22. XI. 1993, ora 22.35)” etj.

8. Vetëm në seancën e një pasdite të simpoziumit shkencor me temën bosh: “Aspekte gjeografike dhe gjeopolitike të Kosovës dhe të trojeve etnike shqiptare në Ballkan”, të mbajtur në Prishtinë më 4 e 5 qershor 1993, nga referuesit e kumesave dhe diskutimet mbi 50 herë u përdor trajta e paskajores së tipit me + pjesore. Më së shumti u përdorën format: për me + pjesore, kisha + paskajore me “me”, pastaj folje modale + paskajorja me “me” etj. Pjesorja si gjymtyrë e dytë e paskajores në fjalë u përdor rëndomë në trajtën e ish-gëgërishtes letrare, por pati raste të përdoret edhe në trajtën shqipes së sotme letrare si p. sh: me luftuar, me tubuar, me u kacafytur etj. Mjaft shpesh u përdorën ndërtimet modale frazeologjike si ndërtime të ndërmjetme siç janë konstruktet: si me thënë, qysh me thënë, më mirë me thënë, me thënë të drejtën, me i ra shkurt etj.

Sigurisht edhe në burime të tjera ndeshen raste të ngjashme të përdorimit të formës së paskajores me + pjesore, çka do të thotë se forma e tillë, e cila është e pranishme në gjuhën e folur bën presion të vazhdueshëm që të shfaqet edhe në gjuhën e shkruar. Madje, përveç në vepra letrare edhe në shtypin e ditëve tona (*Koha ditore, Zëri, Hylli i dritës, Rilindja* etj.) kemi raste të përdorimit pothuajse normal të paskajores në fjalë.

Sipas mendimit tonë faktet që u sollën më sipër janë të mjaftueshme për të dëshmuar se problemi i paskajores me + pjesore nuk mund të quhet: çështje “e mbyllur”¹¹ e shqipes letrare kombëtare, por duhet të konsiderohet si çështje e hapur, e diskutueshme për shqipen standardre përgjithësisht. Kur të kujtojmë edhe mendimet e sjella në nëntiullin e pakpërparshtëm nga gjuhëtarët rezervëshprehës rreth zgjidhjes me mënjanim së kësaj çështjeje, atëherë, ma thotë mendja se pa prituri trysni të reja, autoritetet tona kompetente duhet ta (ri)trajtojnë këtë temë edhe më shtuar pa paragjykimë a ide-fikse që mund t’i kenë të ngulitura individët e caktuar, qoftë nga bindja e tyre

¹¹ Si çështje e mbyllur del edhe nga artikulli i M. Totomit “Struktura sintaksore e gjuhës letrare dhe probleme të normës, “Bujku”, 14. VII. 1993 f. 6.

vetjake, qoftë nga fakti se nuk mund ta kuptojnë problemin se mbase nuk e kanë të përvijuar formën e tillë në sistemin përkatës të tyre ligjërimor, qoftë nga propagandimi që është bërë lidhur me këtë nga forca të organizuara institucionale të caktuara për një kohë relativisht të gjatë. Gjithsesi nuk është mirë që kjo çështje t'u lihet brezave të ardhshëm për ta zgjidhur, siç shprehet me brengosje prof. Rexhep Ismajli, kur kjo mund të zgjidhet fare lehtë nga kuadrot tanë po në kohën tonë, me sadopak mirëkuptim. Duhet pasur parasysh fakti se kjo formë mund të paraqitet e ndarë nga struktura paradigmatore e sistemit foljor të ish–gegërishtes letrare. Gjithashtu duhet pasur parasysh faktin se, qoftë përdoruesit (autorët), qoftë drejtuesit, lektorët e redaktuesit e organeve të botimeve që lejuan infiltrimin e formës së tillë në masmediat e sipërcekura, që u përmenden pak përpara, nuk mund të etiketohen si “anal-fabetë” a mosnjohës të normës së shqipes letrare, ngase shumica prej tyre janë intelektualë që kanë njohuri dhe përgatitje solide shkollore e gjuhësore dhe çka është më e rëndësishme nuk e mohojnë letrarishten e sotme të njësuar. S'do mend se me integrimin e paskajores me + pjesore në normën e shqipes standarde kombëtare do të bëhet më i lehtë zotërimi i kësaj norme edhe nga kjo shtresë jo e vogël “popullore” e shqipfolësve. Sidoqoftë, ndjekja e kësaj çështjeje si dhe diskutimi nga kuadrot tanë intelektualë e gjuhësorë do ta kristalizonte më mirë zgjidhjen e çështjes në fjalë.

c) Paskajorja me + pjesore si çështje jo e thjeshtë e të folmeve dialektore

Është fakt që dihet nga gjithkush se në gjendjen e sotme të shqipes letrare nuk mjafton të thuhet se paskajorja me + pjesore paraqitet si një problem i “qenësishëm” ndërdialektor “ndërmjet gegnishtes e tosknishtes”¹² ose si i “vetmi ndryshim i rëndësishëm me karakter dialektor në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe”¹³, përkatësisht si “dallimi më esencial gramatikor i dialekteve kryesore të shqipes”¹⁴, sepse raporti ndërdialektor në

¹² Gani Lubotini, “Ndryshime ma të qenësishme dialektore ndërmjet gegnishtes e tosknishtes”, “Përparimi” II/60 f. 764, Prishtinë 1960.

¹³ Sh. Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Prishtinë 1989 f. 244.

¹⁴ A. Desnickaja, Gjuha shqipe dhe dialektet e saj, Prishtinë, 1972, f. 39.

një masë të konsiderueshme ka evoluar. Tash për tash duhet pasur parasysh fakti se dialekti i toskërishtes në njëfarë mase i përpunuar dhe i përplotësuar në shumë pika, është ngritur në një shkallë më të lartë, të avancuar. Për këtë kanë dhënë ndihmesë të vetëdijshme edhe gegërishtfolësit duke e përfaqëuar dhe duke e përpunuar e përvetësuar atë. Kështu që kjo gjuhë duke u bërë bazë e shqipes së sotme letrare u bë njëherazi edhe pronë e gjithë shqipfolësve, atëherë edhe raporti i paskajores “gege” me + pjesore nuk i referohet më sipas kuptimit të ngushtë toskërishtes, por pikërisht *shqipes së sotme letrare*, përkatësisht *shqipes letrare kombëtare*. Me të drejtë, kjo dukuri është vërejtur nga hartuesit e Fjalorit shqip – gjermanisht (1977), të cilët në fjalën sqaruese (parathënie) çështjen e paskajores në shqyrtim e paraqesin si “dallimin më të madh strukturor në mes të gegërishtes dhe të gjuhës letrare shqipe”¹⁵. Mirëpo, sipas mendimit tonë, përveç kundërvënies në raportin: gegërishte / gjuhë e sotme letrare, duhet pasur parasysh edhe fakti tjetër, d.m.th. raporti: ish–shqipe letrare mbi bazë të gegërishtes / shqipe letrare kombëtare, ngase siç dihet paskajorja me + pjesore që është “tipar dallues i mbarë kryedialektit të gegërishtes”¹⁶ e jo i ndonjë të folmeje të veçantë, e cila para viteve '60, '70, e kuptohet edhe më përpara, ishte formë e shqipes letrare, e cila gëzonte prestigjin e normës së sanksionuar implicitivisht, të cilën, siç tregojnë faktet, e përdorin jo rrallë edhe toskërishtfolësit, së paku kështu e ndeshim në gjuhën e shkrimit të rilindësve të parë e të mëvonshëm, por nuk përjashtohet edhe përdorimi i saj nga intelektualët edhe në gjuhën e folur. Atëherë, pothuajse ashtu sikurse sot, forma në fjalë gjente përdorim në situata të caktuara për arsye stilistike, retorike, politike, por edhe për nevoja të komunikimit thjesht ligjërimor etj.

Gjithsesi problemi i paskajores me + pjesore, formë kjo e cila, siç e thekson Shaban Demiraj, “ka qenë dhe është e gjallë në të folmet veriore”¹⁷ i kalonte, ashtu siç i kalon edhe sot, caqet e një problemi thjesht dialektor. Edhe J. Gjinari konstaton drejt kur e quan këtë formë si “formë dominante”, e cila në “gegërishte e kryen edhe funksionin e lidhores” (Shih: Dialektologjia shqiptare, Tiranë 1988, f. 95).

¹⁵ Oda B., Wilfried F., Gerda U. – Fjalor shqip – gjermanisht, Leipzig 1977, f. 19.

¹⁶ Mehmet Halimi, Kërkime dialektologjike, Prishtinë 1985, f. 335.

¹⁷ Sh. Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988, f. 634.

Shfrytëzohet rastin të cek këtu konstatimin e Besim Bokshit, i cili në mënyrë implicite ndihmon në të kuptuarit e çështjes në shqyrtim, mund të ngase konstatohet se paskajorja me + pjesore nuk është as pjellë dialektore as që mbetet si çështje e ngushtë dialektore, sepse “*zhdukja e infinitivit (me + pjesore) në të folmet e toskërishtes nuk është aq e hershme*”, madje “*edhe në toskërishte zgjerimin e funksioneve të paskajores me funksione shumë të kufizuara, tipi: për të + pjesore e ka penguar prania e paskajores më të lashtë e tipit me + emër prejpjesor i panyjshëm*” (Vepra e cit. f.139; 167).

Edhe pse, pra, një prani e tillë nuk ndeshet tani në toskërishten e sotme, faktet flasin se çështja e paskajores edhe historikisht i kalon caqet e të folmeve dialektore, përkatësisht edhe aktualisht nuk paraqet një problem thjesht drejtshkrimor të shqipes letrare ose një problem thjesht morfologjik, ngase problemi i tillë i hapur sot shkon e rrah zemberek në rrafshin sintaksor (fjalior), të atij leksikologjik e sidomos në atë semantik e më gjerë. Forma e tillë ndeshet si njësi e vetme e fjalës, në njësinë e togëfjalëshit, madje si fjalë bosht del e shprehur në shprehjet frazeologjike të qëndrueshme dhe të lira, e ndeshim në fjalë–fjalë (në fjalitë eliptike e gnomike), kurse si sintagmë të kallëzuesit e ndeshim në të gjitha farët e llojet e fjalive e të periudhave (me fjalë të bashkërenditura ose të nënrenditura). Prof. A. Xhuvani (Shih Vepra I, Tiranë 1980 f. 326) me të drejtë e thekson se ajo përdoret në fjalitë e varura: “*kryefjalore, kundrinore, përcaktore, qëllimore, kushtore, kohore, shkajkore, rrjedhore, lejore*”, fakt ky që është vënë re dhe trajtuar edhe më thellësisht nga studiues të tjerë, sidomos nga prof. B. Bokshi. Paskajorja në shqyrtim si fjalë–koncept (formë e pavarur) përdoret edhe në fjalinë pyetëse, fjalinë urdhërore si dhe, sipas prof. Sh. Demirajt, “përdoret pas foljeve modale: *mund(em) e duhet* si dhe pas foljeve me vlerë aspektore që “shënojnë fillimin, vazhdimin dhe mbarimin e veprimit”¹⁸.

Edhe studiuesi T. Kelmendi ka konstatuar me të drejtë se “përdorimi i lidhëzave dhe i fjalive lidhëzore me paskajore është tregues i qartë i natyrës fjaljore të paskajores” dhe vazhdon se “ndërtimet me paskajore janë të gjymtyrëzuara më shpesh, ashtu si edhe fjalja me kundrina të drejta, të zhdrejta ose pa parafjalë, me rrethanorë të ndryshëm...”¹⁹.

¹⁸ Po aty f. 959.

¹⁹ Tafil Kelmendi, Mbi përdorimin e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe, te “Gjurmime albanologjike” seria e shkencave filologjike, Prishtinë 1990 f. 235.

Me fjalë të tjera, nga sa u tha më sipër, pra, e vërtetuar nga studiuesit tanë, del se nga paskajorja me + pjesore është përshkruar tërë sintaksa tradicionale e gjuhës shqipe në tërësi ashtu edhe kjo e sotmja aktualisht, si sintaksa e fjalisë ashtu edhe sintaksa e periudhës, edhe pse asaj, si njësi e pavarme në gjuhën e sotme letrare, nuk i është dhënë liri konkurrimi. Ajo, pra, në të vërtetë, vazhdon të kryejë funksionin e vet në sistemin e ligjëritimit të gjallë (aktiv) jo vetëm të gegërishtfolësve, por edhe të vazhduesve a zbatuesve të normës së ish–shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes e të tjerëve. Njëherazi ajo intuitivisht është e pranishme ose edhe tërthorazi merr pjesë në kristalizimin a mirëkuptimin e normës së sotme letrare, kur kemi parasysh ndërkëmbimin paralel asociacionor, përkatësisht të koncepteve që shprehin nocionin e paskajores në shqyrtim, edhe brenda gjuhës shqipe, edhe në raport me gjuhët e huaja, kundrejt formave paralele ekuivalente.

Nga sa u tha më sipër del se paskajorja me + pjesore i kalon përmasat e një çështjeje të thjeshtë dialektore në raportin ortologjik, fakt ky që do të dalë i argumentuar edhe më bindshëm nga paraqitja në vijim.

ç) Forma e paskajores me + pjesore si koncept i pambuluar me një formë të vetme sinonimike

Siç është theksuar edhe në hyrje të këtij punimi, nocioni i paskajores me + pjesore, formë kjo që mbulon mirëfilli nocionin e infinitivit të gjuhëve simotra indoevropiane e të tjera, në gjuhën shqipe nuk del e ndërkëmbeshme a e zëvendësueshme me një formë të vetme sinonimike, por del e mbuluar, sadokudo, nëse mund të thuhet kështu, me disa forma fjalësh kategorish të ndryshme morfoleksikore.

Për të pasur një ide edhe më të qartë rreth kësaj dukurie, për të cilën dëshirojmë t’u tërheqim vëmendjen si studiuesve, ashtu edhe lexuesve e të interesuarve përgjithësisht, në vazhdim po përpigemi ta paraqesim, sadokudo të plotë, skemën përkatëse të strukturës së formave ndërkëmbëse të nocionit të paskajores në shqyrtim, në aspektin morfologjik, pa hyrë në atë sintaksor e semantik.

Struktura e formave të ndërkëmbimit të paskajores me + pjesore me format e tjera sinonimike²⁰

| Format e paskajores me + pjesore tipi: me punue | Kategoria ndërkëmbëse | Format e ndërkëmbimit në gegërishte | |
|--|--------------------------------|--|---|
| | | në letrarishten | et sotime |
| 1. me punue * | paskajorja II | për të punue | për të punuar |
| 2. me punue | paskajorja II (hibride) | për me punue | ? |
| 3. me punue kam me punue | dëftorja " | punoj do të punoj (do të punon?) | punoj do të punoj (do të punosh) (do të punojsh?) |
| 4. kisha me punue | kushtorja " | do të punojsha (do të punojkë?) | do të punoja (do të punonte) |
| 5. me punue me pasë punue | lidhorja " | do të kisha punue të punoj (të punon?) | do të kisha punuar të punoj (të punosh) (të punojë) |
| | " | të punojsha të kem punue | të punoja të kem punuar |
| | " | të kisha punue (Pse) punoj?... puno! | të kisha punuar (Pse) punoj?... puno! |
| 6. (Pse?) me punue** | me punue (?) pyetëse urdhërore | duhet punue puna, punimi, punuemit tue punue | duhet punuar puna, punimi, punuarit duke punuar |
| 8. duhet me punue | pjesorja emri | | |
| 9. me punue | | | |
| 10. me punue (lodhet) përcjellorja | | | |

* Këtu nuk janë përfshirë mundësitë e të shprehurit figurativ.

** Si t'ia bëj? Përgjigjia: Me shkue (= Shko! Duhet me shkue / Duhet të shkosh!)

Siç po shihet nga skema e mësipërme e paraqitur prej nesh, janë afro dhjetë forma të ndërkëmbimit (paskajorja e dytë, dëftorja, kushtorja, lidhorja, pyetësja, urdhërore, pjesorja, emri, përcjellorja), ndërsa trajtat kohore të foljeve të shtjelluara janë më shumë, e kjo varet nga vetat si dhe nga konteksti që shprehet. Në të vërtetë, forma e paskajores me + pjesore e tipit me punue (ashtu si e të gjitha foljeve të shqipes) në trajtën e së tashmes konvencionale me "me",²¹ del e ndërkëmbëshe në shtatë raste, ndërsa trajtat

²⁰ Struktura e tillë është formuluar sipas vëzhgimeve vetjake.

²¹ "E tashme konvencionale" është quajtur sipas tekstit Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976 f. 294.

e përbëra të saj në katër raste (kam me punue, kisha me punue, me pasë punue (si paskajore e kryer) dhe duhet (mundet, lypset) me punue). Të gjitha këto 11 forma të paskajores dalin të këmbëra me formën përkatëse sinonimike në ish-gegërishten letrare, përkatësisht në gegërishten e sotme. Pra në krahasim me format e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, gjuha e sotme letrare përsa i përket numrit, ka dy forma më pak, që janë:

1. forma e paskajores e tipit: **me punue**, si paskajore të zakonshme dhe

2. forma e tipit **për me punue**, si paskajore të dytë "hibride"²², e cila është kontaminim i dy formave, ngase pjesëzën "për" e ka marrë analogjikisht nga paskajorja e dytë mbi bazë të lidhores me "për të"+ pjesore, ndërsa pjesën tjetër e ka nga paskajorja e mirëfilltë.

Të vihet re çështja se vetëm një pjesë e nocionit të paskajores së mirëfilltë e tipit me + pjesore ndërkëmbet me format e paskajores së dytë në gegërishte: **për të punue** dhe **për me punue**, koncept ky që në letrarishten e sotme shprehet plotësisht vetëm me formën e tipit **për të punuar**. Pra me formën e letrarishtes "për të punuar" mbulohet koncepti i shprehur në ish-gegërishten letrare në dy format: "*për me punue*" dhe "*për të punue*", por jo edhe koncepti strumbullar që shprehet me formën "**me punue**". Ky fakt nuk duhet mbuluar me heshje nga studiuesit që e dinë. Atë duhet pasur në konsideratë. Të vihet re, gjithashtu, se si janë zgjidhur ndaj letrarishtes ndryshimet thjesht dialektore a të të folmeve të caktuara të gegërishtes që mund të shihen sadopak edhe në skemën e mësipërme si p.sh. do të punon²³ = do të punosh a do të punojë; punojsha, punojshje punojkë = punoja, punoje punonte etj. Gjithashtu edhe trajta e pjesores "*punue*" del e ndërkëmbëshe me trajtën e letrarishtes "*punuar*", ndërsa trajtat e tjera dalin identike, d.m.th. nuk ndryshojnë, sepse i takojnë bazës së përbashkët trashëguese të shqipes (letrare). Me një fjalë, të gjitha trajtat foljore dialektore të ish-gegërishtes letrare a dialektore janë gjitha trajtat foljore dialektore të paskajores letrare a dialektore të zakonshme, përveç formës bazë të tipit: **me punue**, e cila s'mund të mbulohet tërësisht me asnjërën nga format paralele sinonimike, por vetëm pjesërisht, madje me anë kategorish të ndryshme morfologjike. Kjo specifike, vërtet, u sjell vështirësi në përvetësimin e normës së sotme letrare, jo vetëm të huajve, por

²² Formë hibride është quajtur nga M. Tottoni, artikulli i cituar më përpara në këtë vështrim-trajtesë.

²³ Sa për të arsyetuar lajthijet e tilla po përmend ndonjë rast nga gazeta "Bujku" si p. sh. M. të kujton, kurrë s'do të harron, gjithmonë do të vajton (16. VI. 1993 f. 7); do ta pranon, do ta mban (27. VIII. 1993 f. 2) etj.

edhe të gjithë atyreve që e kanë të përvijuar në sistemin e tyre ligjërimor formën e paskajores me + pjesore.

Pra, vështirësia del te format e ndërkëmbimit (zëvendësimit), sepse, siç mund të shihet paksa edhe nga format e ndërkëmbimit që u sollën më sipër, mungon forma sinonimike dysore e kategorisë së tipit të njëjtë paralel.

Të krahasojmë trajtat dysore plotësisht të zëvendësueshme, si b.f. punojke : punonte; të lexon : të lexosh a të lexojë; punue ; punuar; për të punue a për me punue : për të punuar etj., të cilat i takojnë së njëjtës formë ndërtimore, ashtu si edhe shembujt e tjerë të zëvendësueshëm të së njëjtës kategori morfoloksikore si p.sh.: asht : është; shikoj a shiqoj : shikoj; i gjanë : i gjerë; tue punue : duke punuar; i ndaluem : i ndaluar; vorr : varr, votër : vatër; i shkëlqem : i shkëlqyer etj.

Kështu, pra, në rastet e tilla ndërkëmbimi është kryer nga kategoria e njëjtë morfologjike ose më mirë nga tipi a nëntipi i njëjtë fjalëndertues që ka barasvlerësi të plotë kuptimor (zgjidhje kjo që, sa i përket normëzimit, s' ka nevojë të diskutohet), ndërsa te rasti specifik i formës së paskajores me "me" nuk është gjetur a nuk ka pasur mundësi të gjendet formë adekuate, qoftë nga ndërtimi, qoftë nga barasvlerësia semantike. Paskajorja e dytë me funksion të kufizuar sintaksor e tipit "për të punuar" ka ndërtim tjetër dhe, siç e pamë, ajo zëvendëson trajtën: "për të punue" si dhe atë "për me punue" të gegërishtes që janë koncepte a "funksione shumë të kufizuara", siç e thotë prof. B. Bokshi.

Edhe zëvendësimi i nocionit të paskajores me + pjesore me trajtat e tjera, siç janë: format kohore të lidhores, të dëftores, kushtores ose format e pjesores, përcjellores, emrit (tipash të ndryshëm), bëhet në mënyrë të tërthortë dhe sipas formës së jashtme, nuk është i plotë barasvlerësisht, por është i pjesërishtëm edhe sa i përket përmbajtjes.

Nga kjo që u tha më sipër del i drejtë mendimi se forma e paskajores së mirëfilltë e tipit me + pjesore si koncept, mbetet i pambuluar me një formë të vetme sinonimike, prandaj barazimi iluzor që tentohet të bëhet, qoftë me zëvendësimin me formën e paskajores së dytë ose vetëm me ndonjë formë kohore të lidhores, del artificial, si një punë me zor dhe jo si një veprim i natyrshëm, i qëndrueshëm si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga ajo praktike. Gjithashtu ia vlen të theksohet dukuria e zgjerimit pa sukses të plotë të kuptimit të formës së pjesores si formë ndërkëmbuese lidhur me nocionin e paskajores në shqyrtim, për çka do të bëhet fjalë shkarazi edhe më poshtë në këtë punim, po ashtu s'mund të përfillet edhe ndonjë mendim i hedhur pa

mbulesë se gjoja trajtat e tipit: *me të larë, me të dalë, me të punuar* mund të shprehin koncepte ndërkëmbuese të paskajores me "me"²⁴. Lidhur me këtë do të mjaftohem me konstatimin e prof. B. Bokshit: "*forma më e re e sintagmës prepozicionale me të kënduem (me të kënduar) mori zhvillimin e shënuar e nuk u bë infinitiv, sepse infinitivi ishte krijuar shumë më parë në tërë shqipen*".²⁵

d) Katër vëzhgime si fakte të nëpërdukshme që dëshmojnë nevojën e përdorimit të paskajores me + pjesore në shqipen letrare kombëtare

Para se të parashtroj faktet e nëpërdukshme që dëshmojnë nevojën e përdorimit të paskajores me + pjesore në shqipen standarde, do të më lejohet të rrëfëhem paraprakisht. Si adhurues dhe zbatues i disiplinuar i normës së shqipes letrare, sikurse shumica e intelektualëve tanë, sidomos pas shtysës që na u dha me qëndrimin e miratuar në "Konsultën gjuhësore" të Prishtinës (1968), kur u vendos, si të themi "zyrtarisht", që te ne të zbatohet përpikërisht "Projekti i drejtshkrimit" i hartuar nga ekspertët e vendit amë, përkatësisht ku u dha zotimi se "tash e tutje" do të zbatohet të gjitha "rregullat e drejtshkrimit të shqipes" posa të aprovohen dhe të marrin formën e prerë (gjë që ne e bëmë pa e pritur atë formë), andaj edhe mënjanimin e paskajores me + pjesore (nëse bëhej që më parë nga ekspertët, ndaj të cilëve kishim besim absolut) e kam konsideruar si zgjidhje të drejtë, pa u thelluar në arsyet që lejojnë një sakrificim të tillë dhe sa ishte i domosdoshëm një veprim i tillë. Mirëpo, duke qenë i ballafaquar me një problem të tillë në jetën e përditshme, sidomos pas *Kongresit të Drejtshkrimit* (1972), pasi që, duke e vërejtur faktin, se jo vetëm nxënësit, studentët e intelektualët e rëndomtë, por edhe profesorët e fakultetit, madje edhe ata të Degës së gjuhës shqipe "çalonin", siç po "çalojnë" disa edhe sot në gjuhën e folur, lidhur me përdorimin a zëvendësimin e paskajores me + pjesore me format adekuate, më shkrepri ideja që të gjurmoj një metodë a mënyrë sa më të lehtë për nevojat shkollore e më gjerë, me qëllim që të mund ta kapërcenin këtë pengesë që

²⁴ A. Hajdaraj, Njësimi rezultat i një zhvillimi normal të shqipes, reagim i botuar në gazetën "Bujku, 1.IX. 1994 f. 6, ku pos të tjerash thuhet: "Të mos harrojmë se gjuha letrare shqipe ka sot tri trajta të paskajores (për të larë, pa larë dhe me të larë)".

²⁵ Besim Bokshi, Pjesorja e shqipes, Prishtinë '98, f. 152.

nuk ishte aq e vogël, sepse përkundër vullnetit për vetëmohim, s'mund ta përvetësonim si duhet, edhe pse faktikisht me tërë forcën për këtë pikë na duhej e na duhet ndrydhur sistemin ligjërimor ekzistues që kishim dhe që e kemi edhe sot. Gjatë analizës së raportit gjuhë e sotme letrare / gjuhë letrare kombëtare / gjuhë e folur dhe gjuhë zyrtare etj. në këtë kompleks çështjesh vetvetiu u imponua bindja se kjo çështje nuk dilte aq e thjeshtë sa e pandehja në fillim. Vërtet, shfaqeshin vështirësi në mbulimin e nocioneve që shprehte kjo formë, prandaj më dukej se zgjidhja me mënjanim e pranuar si zgjidhje përfundimtare, ishte punë jo e urtë. Me fjalë të tjera, tek unë filloi të mbizotërojë gjykimi se kjo çështje, jo vetëm meritonte të diskutohej, por ia vlente edhe të rivlerësohej në ndonjë pikë, sepse vërtet për hir të natyrës specifike autonome që ka dhe me funksionet që kryen forma e tillë, s'mund të barazohet me elemente të tjera dialektore të zëvendësueshme me format përkatëse, prandaj meritonte ta kishte vendin e veçantë jo jashtë, po brenda shqipes standarde kombëtare. Në mbështetje të një gjykimi të tillë dolën të hetueshme nja katër fakte të nëpërdukshme, të cilat mund t'i kenë vërejtur edhe të tjerët, mirëpo, nga asnjëri nga rezervëshprehësit as nga të tjerët, nuk di se do të jenë cekur konkretisht faktet si më poshtë:

së pari, del çështja e përdorimit të kësaj forme në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhëve simotra indoevropiane e të tjera (së paku si mjet konkretizimi për nevoja shkollore e shkencore etj.);

së dyti, del i domosdoshëm përdorimi i saj në disa thënie a shprehje frazeologjike të qëndrueshme e të lira, për hir të abstraksionit specifik që shprehjet me konstruktet e tilla, tipi: mos me folë me thumba etj.;

së treti, kjo formë del se një mjet i fortë simbolik specifikues i pamohueshëm për qëllime të caktuara poetike, retorike, politike, ideo-estetike etj. dhe

së katërti, del e nevojshme të përdoret për qëllime të ndryshme si një sinonim i lejueshëm kuptimdalues që në situata të caktuara, qoftë për nuanca kuptimore e stilistike (aspektore), qoftë në ligjërim të përgjithshëm.

Të gjitha këto "argumente" ia pata paraqitur në bisedë të lirë prof. A. Kostallari, përgjigjia e tij ishte se norma e njësuar e gjuhës letrare kombëtare, e arritur, jo pa mund, duhet të ruhet e të mbrohet, patjetër, nga gjuhëtarët e mirëfilltë e jo t'u lihet në dorë atyre që e injorojnë atë, por në kuadër të

kësaj norme, – ishte porosia e tij, – vërtet bëhet mirë të diskutohet edhe të zgjidhet edhe çështja e paskajores, ngase kjo do të shkonte në dobi të kristalizimit dhe të përvetësimit më të lehtë të normës së gjuhës letrare kombëtare.

Edhe prof. Sh. Demiraj, kur e diskutova paksa botërisht këtë çështje në Tiranë në simpoziumin "*Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot*" (1992), më ndau veç dhe më tha se ai nuk është kundër diskutimit qëllim-mirë, mbase edhe të zgjidhjes së çështjes së paskajores, siç propozova unë, por ma tërhoqi vërejtjen se për ndonjë koncept që unë e diskutova aty duhet ta kem parasysh faktin se shqipja e sotme letrare, tashmë e përdor a e rekomandon njëjësën e vetës së dytë të lidhore dhe, për këtë e shqiptoi thënieën e njohur hamletiane, të shqiptuar nga Fan S. Noli: *Të rrash a të mos rrash është çështja(!)*, ku lidhorja e shqipes qëndron si barasvlerës i plotë ndaj paskajores së anglishtes.

Sidoqoftë, meqenëse unë nuk e krijoi problemin, por vetëm e diskutova atë, d.m.th. ekzistuesin, me qëllim të zgjidhjes përfundimtare të tij, më poshtë po i sqaroi më në hollësi "argumentet" e sipërpërmendura, si fakte të nëpërdukshme, të cilat shkojnë në dobi të integritit të paskajores me + pjesore në normën e shqipes standarde.

1. Domosdoja e përdorimit të formës së paskajores me + pjesore në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhëve të huaja

Lidhur me faktin e parë, i cili në raste të caktuara do të mund të vlerësohet si një fakt i domosdoshëm i përdorimit të paskajores me "me" në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhëve të tjera, të cilat janë të pajisura me këtë formë, më poshtë po i sjell disa shembuj sa për ilustrim:

a. Në Fjalorin shqip – serbokroatisht (1981)²⁶ për trajtën përfaqesuese shqipe të foljes "**pjek**" në serbokroatisht është shënuar barasvlerësi "**peći**", formë kjo përfaqesuese në paskajore, si dhe trajta "**pećem**", njëjësi i së tashme së dëftores veta e parë. Domethënë se trajta "pjek" e shqipes (e tashmja e dëftores veta e parë njëjësi) si barasvlerës është e ngarkuar për dy trajta (koncepte) të serbokroatishtes: "peći" dhe "pećem".

²⁶ Fjalori shqip – serbokroatisht, Instituti Albanologjik, Prishtinë 1981, f. 730.

Të jem më i qartë, për togfjalëshin e shqipes b.f. **pjek bukë** në serbo-kroatishte qëndrojnë barasvlerësit: “peći hleb” dhe “pećem hleb”. Tofjalëshi i parë: “peći hleb” është trajtë e papërcaktuar sa i përket numrit, kohës e vetes që në shqipe i përgjigjet plotësisht trajta: “**me pjekë bukë**” (trajtë kjo me paskajoren me + pjesore që ishte trajtë normative në ish-shqipen letrare), ndërsa për trajtën “pećem hleb” në shqipe, plotësisht i përgjigjet barasvlerësi “(unë) pjek bukë”, ku janë të përcaktuara kategoritë gramatikore të foljes: numri, veta, mënyra, madje edhe modaliteti – të cilat mungonin te rasti i parë: “me pjekë bukë”.

b. Po ashtu në Fjalorin anglisht – shqip të S. Mannit²⁷ për foljen “have” të anglishtes në shqipe është shënuar barasvlerësi “**kam**”, edhe ai “**me pasë**”, d.m.th. është shënuar e tashmja “kam” si dhe paskajorja me “me”: “me pasë”. Na është e ditur se në anglishtë për trajtën “(unë) kam” del barasvlerësi “I have”, ndërsa për trajtën “me pasur” del “(to) have”, sikurse b.f. (unë) dal – “I leave”, ndërsa “me dalë” – “to leave”.

Siç mund të vërehet nga teksti i shkruar prej nesh për hir të sqarimit (konkretizimit) u detyruam që domosdo ta shënojmë a ta përmendim gjatë shpjegimit paskajoren me “me”, edhe pse e dimë se ajo nuk njihet a del “*e zdukshme*” nga norma e gjuhës së sotme letrare.

c. Duke u mbështetur po në arsyet që u cekën pak më sipër, forma e paskajores me + pjesore e shqipes domosdo del e nevojshme të përdoret (së paku si sqarim plotësues) edhe për rastet e ngjashme ndaj gjuhëve të tjera, siç është b.f. gjuha gjermane, ajo frënge e të tjera²⁸. P.sh.: në gjermanishtë “sprechen” d.m.th. me folë, ndërsa “spreche” – flas, më qartë: “Ich spreche” do të thotë “(unë) flas”. Krahaso: Ich wünsche ihm zu sprechen – Dua të bisedoj me të (fjalëpërfjalë: Unë dëshiroj me të me folë). Ose frëngjisht: parler – me folë, ndërsa: (je) parle – (unë). flas. Krahaso: “Parler bien (de quelqu’un)” – Flas mirë për dikë (fjalëpërfjalë: Me folë mirë (për dikë), ndërsa “Je parle de set èlève” – (unë) Flas për këtë nxënë.

ç. Duke u mbështetur po në këtë ecuri që u ndoq më sipër, vërtet mund të duket jo normale që nxënësve e studentëve kosovarë (por jo vetëm atyre) infinitivi i latinishtes b.f. “exire” t’u shpjegohet vetëm me barasvlerësin “dal”, si formë kjo përfaqësuese e foljes, e cila as që kontestohet prej nesh, por për

²⁷ S. E. Mann, Fjalor anglisht – shqip, Cambridge, 1957, f. 170.

²⁸ Të gjithë shembujt ilustrues janë nxjerrë (kopjuar) nga fjalorët përkatës dygjuhësh.

rrethanat për të cilat po flasim këtu nuk mjafton, prandaj del e nevojshme të ceket edhe forma barasvlerëse: *me dalë*. Çështja ndërlihet edhe nga pikë-pamja metodike e konkretizimit të temës.

Gjithashtu nuk duket se del e mjaftueshme që barasvlerësia e tillë të shpjegohet vetëm me formën e paskajores së dytë të tipit me “për të” ose të mjaftohemi me konstatimin se “infinitivi i latinishtes” në raste të caktuara përkthehet në gjuhën tonë me trajtat kohore të lidhore “të dal” ose “të dalësh” etj., kur dihet mirëfilli se vetëm trajta e paskajores me + pjesore në shqipe ka barasvlerësi të plotë me trajtat e tilla të gjuhëve indoevropiane e të tjera. Këtë fakt po e theksoj në mënyrë të veçantë, ngase pikërisht në këtë pikë nuk është vepruar drejt dhe qartë as metodikisht as shkencërisht në tekstet përkatëse, për mësimin e latinishtes të botuara te ne²⁹, pasi që në shpjegim nuk është përmendur fare pikërisht forma e paskajores me + pjesore. Dihet se për një lëshim të tillë nuk mund të fajësohen autorët e teksteve në shqipe, pasi për profesionalizmin e tyre as që dyshohet, por vërejtja i drejtohet së paku “ndërgjegjes” së imponueshme që lidhet me të kuptuarit e rekomandimit a të keqinterpretuarit e porosisë së normës, kod ky i formëzuar që kuptohet me “rregulla të ngurtësuar”, të cilat na qenkan “zgjdhur” si duhet njëherë e përgjithmonë, kur është fjala edhe për mënjanimin e paskajores me + pjesore (?).

Përveç keqkuptimit a keqinterpretimit, s’di si mund të shpjegohen anomalitë e tilla logjike! Ç’është e vërteta, paskajorja me + pjesore është një fakt që ekziston për “jetë e mot” realisht në gjuhën tonë dhe s’ka sesi të mos shfrytëzohet në raste të tilla?!, kur një element të tillë e kanë në sistemin ligjorimor edhe mësimdhënësit edhe mësimarrësit? Për mendimin tim edhe barasvlerësi që jep prof. I. Ajeti për gjuhën serbokrate:

Uzeti nekoga ljepotom shq. E marr me të mirë dikë (!),

në shqipen standarde më drejt duhet të dilte: **Me e marr me të mirë dikë**, ngase e marr me të mirë dikë në serbishte ka barsvlerësin (*Ja uzimam*

²⁹ Është fjala për tekstet: Gjuha Latine për kl. I dhe II gjimnaz (E. Sedaj), Prishtinë 1979 f. 136 etj. dhe për tekstin Gramatika latine (Gorton, Gorski, Paush të përkthyer nga I. Kryeziu), Prishtinë 1980, 62, 843.

nekoga ljepotom,³⁰ mirëpo sipas normës së shqipes së sotme letrare në fuqi, barasvlerësi që jep prof. I. Ajeti është i drejtë.

Lidhur me këtë do të mjaftohem me sjelljen edhe të një rasti tjetër me lokucion foljor në disa gjuhë duke tërhequr vërejtjen në trajtën përfaqësuese të shqipes:

shq. **me marrë pjesë**: serb. učestvovati,
(marr pjesë) rus. učestvovatj,
gjerm. teilnehmen,
fr. prendre part, participer,
it. partecipare, aver parte,
turq. katılmak, iştirak etmek,
angl. to participate.

Siç dihet në të gjitha këto gjuhë trajta përfaqësuese del në infinitiv, ashtu siç është vënë edhe në shqipe, ndërsa për konceptin e vetes së parë njëjës: *si b.f. në shqipe (Unë) marr pjesë* të gjitha gjuhët përkatëse si në serbishte b.f. që është: *(Ja) učestvujem*, kanë forma përkatëse të veçanta që për temën që po trajtohet, nuk del e nevojshme të përmenden.

Sidoqoftë, na thotë mendja se mungesa e paskajores me “me”, së paku si element plotësues, në situata të tilla është aq e ndjeshme, sa që përdorimi i saj mund të cilësohet si i domosdoshëm. Sigurisht nuk qëndron kurrfarë *logjike* që të lëshuarit në veprim të një mjeti të tillë konkretizues do t'i shkaktonte dëm normës letrare të shqipes.

Lidhur me këtë, më duket se nuk është e tepërt të theksohet edhe fakti i efektit psikik e kuptimor që lidhet me barasvlerësit e caktuar brenda kontekstit. Është e vërtetë se çdo shqipfolës që sadopak ka njohuri nga latinishtja dhe e ka të përfshirë në sistemin e vet foljor formën e paskajores me + pjesore, nuk e ka vështirë të parapëlqejë barasvlerësin më kuptimplotë e të qëndrueshëm për shprehjet e mëposhtme:³¹

³⁰ Akad. I. Ajeti, Shqiptarët dhe gjuha e tyre, Prishtinë 1994, f. 86.

³¹ Shprehja latine dhe barasvlerësi i parë është marrë nga Fjalori latinisht – shqip i H. Lacaqit dhe F. Fishtës (ribotim), Prishtinë 1980), f. 843, 62.

1) lat. offerre se morti pro patria:

shq.: – me dhënë jetën për atdhe;
– jap jetën për atdhe;
– të japësh jetën për atdhe;
– të jepet jeta për atdhe.

ose:

2) lat. capere consilium:

shq.: – me marrë një vendim;
– marr një vendim;
– të marrësh një vendim;
– të merret një vendim.

Sigurisht paskajorja e dytë me “për të”: “për të dhënë jetën për atdhe” ose “për të marrë një vendim” si barasvlerës përfaqësues nuk qëndron, prandaj edhe është e përjashtuar nga konkurrenca a e drejta e përfaqësimit.

Ndër katër variantet konkurruese, të shembulli i parë, varianti i parë si barasvlerës konsekuent i përgjigjet më së miri formës së latinishtes, por edhe asaj të shqipes, natyrisht po të mos ishte nxjerrë “jashtë norme” forma e paskajores me + pjesore. Themi “më së miri” për arsye se që të dyja format barasvlerëse shprehen me formën karakteristike të infinitivit, d.m.th. pa u cekur veta, koha, numri i caktuar dhe së ketejmi edhe koncepti i dëshiruar i përgjithshëm shprehet qartë e nga ana tjetër një paraqitje e tillë i përgjigjet plotësisht natyrës përfaqësuese të nocionit, d.m.th. vlen për të gjitha kohët, vetat e nuk përcaktohet as numri i caktuar i kryerësve të veprimit.

Format e varianteve të tjera (të kallëzuesve): në dëftore, lidhore e pavetore edhe në latinishte mund të kenë forma përgjegjëse barasvlerëse si p.sh. lexoj (= me lexue) – legere, lego – (unë) lexoj, të lexoj – legam, të lexoshi legas... etj.

Dihet se për shembullin e parë (sipas versionit të dytë në shqipe), përgjigjet veta e parë, për shembullin (versionin) e tretë përgjigjet veta e dytë dhe për shembullin e katërt përgjigjet veta e tretë (formë kjo e papërcaktuar). Po kjo nuk do të thotë se përshtatja mund të bëhet pa pasur parasysh

edhe natyrën shprehëse të gjuhëve të huaja ashtu si dhe mundësitë shprehëse të gjuhës sonë.

Edhe nga gjendja e sotme e shqipes letrare, e kemi fjalën për përdorimin e trajtës së paskajores, nuk duhet të quhet pa vend barasvlerësia e përkthimit që e jep b.f. prof. Selman Riza³² për shembullin:

Shq. *Ash marre me rrejhtë*: fr. Il est honteux de mentir.
(Është marre të rrejsh) gjerm. Es ist schaedig zu lügen.

Po të gjykohet objektivisht lidhur me raportin ndërmjet shprehjeve të mësipërme, pra, duke i pasur parasysh faktet edhe nga pikëpamja e ndër-këmbimit të ndërsjelltë a të mundësisë së përngjasimeve, mendoj se përligjja e përdorimit të paskajores me + pjesore si formë përfaqësuese, sidomos në shprehje të qëndrueshme del gjithsesi e nevojshme, e arsyeshme dhe së këtijmi edhe me elemente të domosdoshë, kriter ky i mjaftueshëm sa për ta arsyetuar integrimin e paskajores me + pjesore në kuadër të strukturës së normës së shqipes standarde.

Për mendimin tonë është vepruar drejt në "Fjalorin italisht – shqip / shqip – italisht" të F. Toçit (Tiranë 1993, f. 13–22) si dhe në gazetën "Rilindja javore", 9–15 qershor, Tiranë 1996 ("Ju ftojme të mësoni gjuhën esperanto" f. 14), ku, në raste të caktuara, del e shënuar si barasvlerës edhe paskajorja me + pjesore.

2. Domosdoja e përdorimit të paskajores me + pjesore në thëniet frazeologjike me abstraksion të lartë

Duke e pasur parasysh sistemin e përgjithshëm semantik të gjuhës shqipe në tërësi dhe në këtë kuadër "sistemin leksikor e fjalëformues të gjuhës së sotme letrare shqipe" në veçanti, i cili "është gjithnjë i hapur", siç e theksonte prof. A. Kostallari, sidomos për të pranuar "elemente të veçanta veriore", përkatësisht "çdo njësi leksikore e frazeologjike që e pasuron atë" (gjithnjë citohen fjalët e prof. Kostallarit, të cilat, gjithsesi, nuk janë thënë sa për sy e

³² Selman Riza, *Vepra I*, Prishtinë, '96, f. 126.

faqe, por nga penda e mendja e një dijetari të merituar me vizion të qartë për ardhmërinë e shqipes së njësuar letrare). Ma thotë mendja se po të zbërthej drejt mendimi i prof. Kostallarit, atëherë duhet të kenë vend, për mos me thënë, është dashur të kenë pasur vend patjetër edhe më përpara, në normën e sotme letrare edhe disa togfjalësha frazeologjike të ndërtuar mbi bazën e paskajores me + pjesore.

Është e vërtetë se ndërtimet e tilla karakterizohen me një abstraksion të lartë specifik autonom, koncepte këto që në shqipin letrare, me elementet e tashme, vështirë se do të mund të shpreheshin plotësisht.

Është fjala për formën e paskajores së integruar brenda togfjalëshit të caktuar, me të cilën shprehet "një formë shumë e lartë e abstraksionit",³³ siç e thekson prof. Rexhep Ismajli, përkatësisht kemi të bëjmë me mënyrën e tillë me të cilën "shfaqet një send i përgjithshëm e nuk shprehet qëndrimi i folësit a i vepruesit lidhur me veprimin a gjendjen që përmban folja",³⁴ siç e thekson prof. Idriz Ajeti.

Më poshtë po japim skemën me disa shembuj të tillë dhe njëherazi tërheqim vëmendjen për format e ndërkëmbimit konkret që u cekën pak më përpara, por që këtu paraqitet si një proces i ndërlidhur dhe i gjallë në veprim e sipër.

³³ R. Ismajli, *Shenjë dhe ide*, Prishtinë, 1974, f. 114.

³⁴ Akad. Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes III*, Prishtinë 1985 f. 191.

Shembuj të ndërkëmbimit të shprehjeve frazeologjike e të tjera

| Shembuj me paskajoren me + pjesore | Ndërkëmbimi në gjuhën e sotme | Vërejtje |
|--|---|---|
| 1 | 2 | 3 |
| a. Thënie të qëndrueshme frazeologjike | Sipas FGJSSH ³⁵ (1980) | Kategoria karakteristike |
| 1. me folë me thumba /kthehen me plumba. | "flet me thumba" d.m.th."e ngacmon" f. 2071 | njëjësi i së tashmes së dëf- tores v. III |
| 2. me i ra kokës me grushte | "i bie kokës me grushte" d.m.th. "pendohem rëndë" f. 842 | " v. I |
| 3. me mbajtë në pëllëmbë të dorës | "e mban në pëllëmbë të të dorës" d.m.th. "e mban me të gjitha të mirat" f. 1415 | " v. III |
| 4. me marrë nën mbrojtje | "marr nën mbrojtje", d.m.th. "i dal zot" f. 1402 | " v. I |
| 5. me i vu gishtin kokës | "i vë gishtin kokës", d.m.th. "mendohem mirë", f. 843 | " v. I |
| 6. me marrë vesh me fjalë | "marr vesh me fjalë", d.m.th. "kuptoj", f. 2137 | " v. I |
| 7. mos me ngrënë hudhër nuk të vjen era | "po nuk hëngre hudhër nuk të vjen era" f. 695 | v. II aoristi |
| 8. me mbetë me gisht në gojë | "mbeti me gisht në gojë", d.m.th. "mbeti pa gjë" | v. III |

³⁵ FGJSSH – Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980 (Këtë shkurtesë do ta përdor edhe më tej në këtë punim).

b) Shembuj të tjerë: Sipas normës së sotme:

| | | |
|--|---|--|
| 1. s'vyen me u ligshue | "s'vyen të ligshohesh" | lidhorja v. II nj. dëflorja v. I shumës paskaj. II v. I sh. lidhorja v. III nj. pyetëse urdhërore emër veprimi emra abstraktë |
| 2. ma mirë me heshtun se me folë shumë (F. Bardhi) | "më mirë të heshtim se të flasim shumë" | |
| 3. me qenë të gatshëm me mbrojtë atdheun | të jemi të gatshëm për të mbrojtur atdheun | |
| 4. kush nuk di me heshtë nuk di edhe me folë. | Kush nuk di të heshtë nuk di edhe të flasë. | |
| 5. a me i dalë përballë? | a t'i dal përballë? | |
| 6. me punue natë e ditë! | punoni natë e ditë! | |
| 7. me mësue është detyrë. | mësimi është detyrë. | |
| 8. me (v)dekë e me le me shitë e me ble (veprime që) s'ndalen dot. | lindja dhe vdekja shijja dhe blerja (veprime që) s' ndalen dot. | |
| 9. (puna)kur do me ecë, ecën. | kur do të ecë, ecën(?) | lidh. |
| 10. (e mira) kur do me ardhë, vjen. | kur do për të ardhur, vjen (?). | pask. II |
| 11. (e keqja) kur do me dalë, del. | kur do për të dalë del (?). | pask. II |

Edhe pse pa u bërë analiza më të thella nuk është mirë të nxirren konkluzione, megjithatë nga shembujt e mësipërm mund të thuhet ndonjë konstatim me interes, që mund të shërbejë si bazë për hulumtime të mëtejshme.

Siç mund të shihet nga rubrika "vërejtje" ndërkëmbimi i paskajores me + pjesore në gjuhën e sotme letrare nuk bëhet vetëpërvetëm nga një formë e caktuar përfaqësuese të foljes sa i përket mënyrës, numrit, vetës a kohës, por ai bëhet në disa forma. Megjithatë mund të flitet për ndonjë prirje:

a) Kështu pra thëniet e qëndrueshme me konstruktin e paskajores me + pjesore, në gjuhën e sotme, pra sipas shembujve të regjistruar në FGJSSH, janë të ndërkëmbeshme zakonisht me të tashmen e dëftores, veta e parë njëjës, formë kjo që konsiderohet trajtë përfaqësuese e foljes.

b) Ndërsa te shprehjet e lira, si të themi, pa kuptim figurativ, paskajorja priret të dalë e ndërkëmbyeshme me vetën e dytë njëjës të lidhores, por në shembujt e mësipërm nuk dallohet shumë nga ndërkëmbimet me vetën e tretë e forma të tjera, varësisht nga konteksti që shprehet.

Lidhur me këtë sa për ilustrim po dalloj një shembull karakteristik të vjelë po nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980): “Të rrimë shtrembët e të flasim drejt”, d.m.th. “të themi të vërtetën” (Shih aty f. 170 e 1936), thënie kjo që del edhe në trajtën “Rri shtrembët e fol drejt” (f. 1936). Për të dyja këto trajta, por edhe për atë të mundshmen me veten e dytë njëjës të lidhores: “Të rrih shtrembët e të flasësh drejt” etj., në ish-gëgërishten letrare që është aktive edhe sot, përgjigjet konstrukti: “Me ndejtë shtrembët e me folë drejt”.

c) Siç mund të shihet nga shembujt përfaqësues të shënuar në skemën e mësipërme, ka raste që paskajorja në shqyrtim të ndërkëmbet edhe me paskajoren e dytë, me trajtën e aoristit, me një trajtë foljore pyetëse, urdhërore, me një emër abstrakt etj., raste këto që secila meriton trajtim të posaçëm.

Me fjalë të tjera, forma e paskajores me + pjesore del e ndërkëmbyeshme me shumë trajta, duke zënë kështu një vend specifik pak a shumë më përgjithësues (abstrakt) se sa format e tjera.

Edhe pse nuk i kam dhënë vetes detyrë të jem shterues në paraqitjen e kësaj çështjeje, megjithatë s’ mund të anashkaloj pa e tërhequr vëmendjen edhe për një dukuri të një rëndësie të posaçme me të cilën edhe karakterizohet përdorimi i paskajores në shqyrtim. E kam fjalën për aftësinë e paskajores me + pjesore për të shprehur asi koncepti abstrakt brenda thënieve a shpejheve frazeologjike, të cilat vështrirë ose assesi s’ mund të shprehen plotësisht me forma të tjera përkatëse ndërkëmbyeshe, siç janë format kohore të lidhores, të dëftores a të kushtores etj., pa lënë keq diçka. Ata shqipfolës që e kanë të rrvijëzuar në sistemin e tyre ligjërimor funksionin e paskajores në fjalë e kanë lehtë ta kuptojnë e përceptojnë specifikën e tillë kuptimore, për të cilën po e tërheq vëmendjen këtu, por edhe për shqipfolësit e tjerë e studentët nuk do të jetë diçka e pakapshme. Të vihat re se po të vështrrohet me kujdes nga pikëpamja semantike b.f. togfjalëshi i parë i qëndrueshëm nga skema e mësipërme “**me folë me thumba**”, kundrejt barasvlerësit të dhënë në Fjalor: “**fjet me thumba**”, gjithësesi kuptohet se forma e dytë del më e

konkretizuar, sepse të ai togfjalësh del transparente kategoria e numrit, e vetes, e kohës, madje edhe njëfarë modaliteti, ndërsa me formën e parë “**me folë me thumba**” shprehja mbetet e pakonkretizuar e përgjithshme. Me një fjalë, qëllimi bosht i thënies mbi bazë të paskajores me “me”, si me thënë, është jo konkretizimi, po abstraksioni a përgjithësimi i qëllimit, ndërsa te shembujt me forma të tjera është konkretizimi i qëllimshëm. Po të thuhet zakonisht në një odë a “kuvend burrash” në Dukagin a kudo në Malësi e gjetiu shprehja: “**Mos me folë me thumba**” ajo do të kuptohej përgjithësisht, nuk preket askush dhe njëherazi i tërhiqet vërejtje gjithkuj, sidomos atij që e ka “mizën mbi kësulë”. Ndërsa po të thuhej b.f. “**mos fol (folni) me thumba**”, “**folke me thumba**”, “s’ është mirë të flasësh me thumba” madje edhe “**mos të flitet me thumba**” etj. vetvetiu përcautohet pala të cilës i tërhiqet vërejtje, ngase ajo ceket a konkretizohet me treguesin gramatikor të vetës. Kjo karakteristikë specifike e thënieve me paskajore është e përgjithësueshme edhe për shembujt e tjerë. Koncepti i abstraksionit a ai i përgjithësimit të qëllimshëm mund të zbatohet edhe te shembujt si p.sh.: “Qëllimi është: me i v gishtin kokës”, “Me dalë fitues me faqe të bardhë – është çështja” etj.

Pra, edhe për hir të këtij koncepti specifik abstrakt përgjithësues që s’ mund të shprehet kaq natyrshëm e në mënyrë koncize me forma të tjera, paskajorja e tipit me + pjesore ka nevojë të rivlerësohet apo të integrohet në normën e shqipes letrare kombëtare. Me një veprim të tillë edhe shumë “fjalë të urta” e “thënie të ndryshme tipizuese” d.m.th. me konstruktin e paskajores me “me”, më me lehtësi do të gjenin vendin e merituar dhe do të përligjeshin në kuadër të gjuhës letrare, ngase kështu si është norma e sotme ato janë të goditura të mbesin të pashprehura nga etiketimi a urdhëri përcëmues “jashtë norme”(!). Është e vërtetë se për shkak të mospërfshirjes së paskajores me + pjesore në normën e gjuhës së sotme letrare shqipe, është goditur rëndë mu “shtylla kurrizore” e sintaksës së shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes. Me një veprim të tillë nuk i është bërë shërbim i mirë as sintaksës së gjuhës shqipe si tërësi, madje as për atë mbi bazë të toskërishtes në veçanti, sepse ajo duke qëndruar në kundërvënien e oponencë vërtet mbeti paksa e karakterit të mbyllur. Vetvetiu një gjendje e tillë lë shteg hapur që të rilindë e të fuqizohet një strukturë tjetër “rivale”, jashtë norme, fare pa nevojë, në vend që të bashkëveprojnë format e caktuara a të ushqejnë ndërsjelltas njëra tjetrën brenda

(2) FOLJET E PREJARDHURA ME PRAPASHTESËN -O ME ZGJERIM

Siç është përmendur më përpara numrin më të madh të foljeve në shqipe, jo vetëm me prapashtesim, por përgjithësisht, e përbëjnë foljet më -O- pa zgjerim me temë të qartë fjalëformuese. Ky fakt vërtetohet edhe nga lënda e vjetër nga FGJSSH, mirëpo edhe numri i foljeve me prapashtesën -O- me zgjerim nuk mbetet fort prapa. Ç'është e vërteta, në raportin rreth foljeve të pathjeshta më -O- pa zgjerim ndaj atyre më -O- me zgjerim është me interes të veçohen këto karakteristikë:

E para, foljet me -O- me zgjerim, në përdorim e sipër, me i marrë të gjitha së bashku ia kalojnë numrit të përgjithshëm të foljeve me -O- pa zgjerim²⁸, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, kur kemi parasysh formimet e karakterit paronimik, diatezor etj., d.m.th. formimet paralele mbi të njëjtën temë prodhuese si dhe mundësia e pakufizuar që jepet mbi këtë bazë, numri i foljeve -O- me zgjerim del shumë herë më i madh. Së këtejmi, si nga ana teorike, dhe sidomos nga ajo praktike del e nevojshme të bëhet trajtimi dhe vlerësimi i përfundimtar të foljeve me prapashtesën -O- me zgjerim në jetën tonë gjuhësore.

E dyta, në këtë kuadër, vlen për t'u cekur, edhe një fakt tjetër shumë i rëndësishëm. Pothuajse tek të gjitha rastet e përfutimit të foljeve me variantet e tilla, d.m.th. të prapashtesave -O- me zgjerim, kemi të bëjmë me formime mbi temë të qartë motivuese, përkatësisht pothuajse të gjitha foljet e tilla (-O- me zgjerim) kanë mbështetje në fjalë-temat e burimit aktiv të shqipes, qofshin këto fjalë autoktone, qofshin të huazuara, por të përvetësuara që me kohë, prandaj analiza e formimeve në fjalë nuk zgjon vetëm zbërthimin e studuesit dhe të çdo shqipfolësi për të njohur dhe për të kthyer thjesht një thesar me vlera të pakrahasueshme të gjuhës sonë, por edhe nxit e i mundëson atij për ta njohur më mirë dhe për ta shfrytëzuar këtë thesar tejet me vlerë, të cilin na e dhuron veçanësisht vetë natyra e sistemit foljor të gjuhës shqipe.

²⁸ Numri i foljeve më -O- pa zgjerim i vjetër nga FGJSSH-ja, sipas një njehësimi të lirë, kap shumën 630 që është më i vogël në krahasim me numrin e foljeve -O- me zgjerim, të cilat tani, siç u cek, se pothuajse të gjitha foljet më -O- me zgjerim janë të formuara mbi fjalë-temat autoktone shqipe, ndërsa ato më -O- pa zgjerim janë të përfuara me shumë mbi fjalë-tema të huazuara.

E treta, gjithashtu, në këtë kontekst, del e nevojshme të njihet edhe një e vërtetë tjetër. Ndërsa mbi fjalë-temat e huazuara mbizotërojnë përfutimet më -O- pa zgjerim, në një shumicë rastesh del se fillimisht mbi fjalë-tema të shqipes dalin të përfuara në gjuhën tonë foljet përkatëse me -O- me zgjerim, duke u anashkaluar, si të themi, forma e shkallë së parë model "-O- pa zgjerim". Shembuj konkretë do të cekem gjatë analizës së formanteve të caktuara veç e veç, dukuri kjo që vazhdon në raste edhe sot e kësaj dite, mirëpo mundësia e daljes së foljes me prapashtesën -O- pa zgjerim si model për çdo fjalë-temë kuptimplotë të shqipes nuk mohohet në asnjë mënyrë.

E katërta, ndërsa te foljet më -O- pa zgjerim, siç u tha, ndërmdikimi a reflektimi i drejtpërdrejtë i fjalëve të huaja të huazuara është i madh, te foljet më -O- me zgjerim, një ndikim i tillë, pothuajse, nuk hotohet fare, pos foljeve më -IZ/O- e vetëm ndonjë rast më -TO-, ngase në gjuhën e sotme, pothuajse pa përjashtim të gjitha foljet më -O- me zgjerim janë zhvillim i brendshëm i gjuhës sonë.

E pesta, po të gjurmohet etimoni i disa tingujve ndërhyrës të -O-së me zgjerim, domosdo na nxisin të konstatojmë vazhdimësinë e mundshme reliktove të prapashtesave përkatëse, qoftë, me origjinë mbiemërore, qoftë "të sistemit participor të protoshqipes" siç e cek prof. Besim Bokshi, siç janë tingujt -i (*to); -m (*MO), -s (*ntio), -j/ë (*l-ë), -n/r (*no/a) e -sh/ëm (*sio-mo).²⁹ Me fjalë të tjera, gjatë analizës domosdo duhen pasur parasysh zgjidhjet e supozimet e dhëna më përpara në këtë drejtim, dukuri kjo, e cila sadokudo na detyron që çështjen ta trajtojmë, jo vetëm në aspektin aktual, sipas vijës horizontale, por edhe në atë historike, sipas vijës vertikale.

Sidoqoftë, dukuritë e lartpërmendura del e nevojshme dhe e rëndësishme të njihen me tërë ndërlikueshmërinë që i shoqëron, ngase jetojmë në aso rrethanash të zhvillimit shoqëror, kur ndikimi i gjuhëve të huaja ndaj gjuhës sonë, edhe në sistemin foljor, është gjithnjë më i theksuar, sidomos në nënfusha të caktuara semantike, siç është edhe "gjuha teknike" dhe sigurisht në këtë drejtim shënohen trysni të ndjeshme, qoftë në formë leksemash (fjalë të huazuara), qoftë si elemente formantesh të veçanta. Tash nuk e kam fjalën vetëm për gjuhën teknike, sipas kuptimit të ngushtë

²⁹ Besim Bokshi, Pjesorja e gjuhës shqipe, Prishtinë 1998, f. 45, 90.

ç. Po këso vlerësimi sa i përket qëllimit mund të thuhet edhe për shprehjen klithmë “Qysh me pritë...” të përdorur nga A. Cena në një shkrim të botuar në gazetën “Bujku” të Prishtinës, më 30.XII.1992 f. 3.

d. Në poezinë “Pela e zezë”, të botuar në gazetën “Bujku” më 7.I.1995, f. 9, Ukë Buçpapa brenda tekstit të shkruar në letrarishten e sotme përdor këto paskajore me “me”: Ndalohet me folë, me pa, me puthë, me ndukë mërzi, me qeshë në sy. Ndalohet me vra morra... me na zbutë ndjenjat... ndalohej me qa...

dh. Nga një poezi e Agim Gjakovës veçova vargjet: si zog i mbyllur që kurrë nuk po do me dalë në rrëshimën e fatit... Po e lypa tëhuajsimin, mundet me më vra Zoti... (Fjala, tetor '98 f. 16); ndërsa nga poezia “Drenica 1998” të Rajmonda Meleckës ndava: vargun karakteristik: Fluturon amaneti i të parëve: hasmin *me e djegë* n' flakë të maleve (Rilindja, 22.I.2000, f. 16).

e. Të një natyre, paksa tjetër nga shembujt e mësipërm, por brenda suazave që synohet të tregohet në këtë punim, janë thënieat e sekuencat e mëposhtme, të cilat i shkëputëm nga disa shkrime të kohëve të fundit të autorëve të ndryshëm, të cilët paskajoren me + pjesore nuk mund të thuhet se e kanë përdorur spontanisht a pavetëditë, por ashtu e kanë parë të arsyeshme:

1. “...të gjitha kontributet në këtë vëllim në aspektin e interesave italiane ndaj Ballkanit, merren kryesisht me këtë problematikë: **Me jetue** pa Jugosllavinë” (Rexhep Ismajli, revista “Zëri, 22.I.1994, f. 27);

2. “Për në asnjë mënyrë nuk duhet vënë freri gjuhësor krijimeve me karakter artistiko – emocional dhe shkrimtari duhet të jetë i lirë, tokë apo gegë qoftë, **me e shprehë** shpirtin e vet me atë gjuhë, cila i krijon emocionet që e trondisin ...” (I. Zamputi, “Bujku”, 30. IV. 1994, f. VI);

3. **Me i rrah(ë) gjokës** sot njëri tjetri, kur dihet se ... (ku jemi e qysh jemi) është marrë” (Mr. Sylë Dreshaj, revista “Koha”, 30.III.1994 f. 49);

4. Nga shkrimet e z.Hans Jaochim Lanksch: “Nuk dua të tallem mbi shpinën e atyre që shkruajnë jopoezi, ndër ata sigurisht ka asish që kanë qejf **me dalë në nam...**” (revista “Koha”, 31.VII.1994 f. 38); Domethënë (mbetet detyrë) **me vazhduar** me reagimet për të treguar se albanologjia ka një *lobby* të fortë (Zëri, 17.IV.'97, f. 41).

5. “Masmediu më perëndimore ende e heshtin edhe e injorojnë këtë shtet (Shqipërinë), ose **më mirë me thënë**, në të kërkojnë vetëm pika të zeza” (Ismail Kadare, sipas gazetës “Bujku”, 10.XII.1994, f. 2).

6. Folja “**me lëmue**” në gojën e poetit besoj se jep shënime të posaçme për poemin, po edhe për heroinën” (Aurel Plasari, Bujku, 7.X.'98 f. 13).

ë. Nga një cikël poezish në dorëshkrim veçova:

a) “*Me dalë a mos me dalë?!*”

(...)

Me dalë e pa dalë

Thashetheme:valë, valë

Me dalë...

(Vasha zgjidh dilemën)

b) Flisni burra, *me folë* në daçi,

s' është si pitja si kulaçi...

(Fjalë filozofore!)

Edhe te këta dy shembujt e fundit ashtu si edhe të shembujt e tjerë shihet konkretisht se mund të bashkekzistojnë trajtat paralele: paskajorja me + pjesore / lidhorja / e tashmja njëjës / urdhërorja / pyetësja etj. dhe secila trajtë mund të shprehë efekte të caktuara estetiko–emocionale të veçanta. Një veprim i tillë harmonik bashkëjetese mund të vërehet edhe në shkrimet letrare–poetike që nga Rilindja jonë Kombëtare e këndej, madje ka raste që forma e paskajores me + pjesore të paraqitet në një farë mënyre si formë e pazëvendësueshme. Për të ilustruar këtë gjykim do të sjellë ca shembuj nga vepra folklorike “*Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare*”, botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë 1978 dhe nga vepra artistike “*Lahuta e Malcisë*” (1937) e Gj. Fishtës:

a) Nga *Këngë popullore...*:

1) Nja dy djem n' Prishtinë kanë dalë

S'lanë me hi as s'lanë *me dalë*

Krejt Prishtinën dojnë *me kallë!*...

2) Po ban pushkë, po ban piskamë

Po donë zojat meç *me i dalë...*

3) *Me luftue* për këtë tokë shqiptare

Mos me lëshue për pa dalë fare...

b) Nga *Lahuta e Malcisë*:

- 1) Njizetë shokë hekur me bre,
Zanin pushkë, synin rrufe...
... Djalë me bre hekur me dhambë,
Synin gacë, qafën dy pëllambë...
- 2) N' te dy faqet me i plasë gjaku
Kaçadre me i ndejtë mustaku...
- 3) Me një brimë qi kryet me t'ça
Fulikare turrë janë n' shkja!
...Fyt a fyt e ballë për ballë
nandë me mbetë, një me pshtue gjallë!
...Gërvishë duer e gërvishë fytyrë
Mos me mujtë t' mjerin me këqyrë... etj.

Shembuj të tillë janë me dhjetëra e dhjetëra në dy veprat e konsultuara, ndërsa në burime të tjera, si të themi, janë të panumërt dhe zëvendësimin e trajtës së paskajores me “me” me forma të tjera shprehëse nuk e pengon vetëm çështja e rimës ose pasqyrimi i tipizimeve të ambientit etj., por, për mendimin tonë, është diçka më tepër. Në të vërtetë, ajo që pengon është diçka që lidhet edhe me aso konceptesh që megjithatë s’ mund të zëvendësohen a të shprehen me fjalë a forma të tjera pa lënë keq diçka, qoftë nga ana mendimore, qoftë nga ajo ideo-estetiko e letrare, edhe pse nuk përjashtohet mundësia që të gjitha konceptet mund të parafrazohen, mirëpo parafrazimi, njëfjalëzimi e ngarkesa polisemike etj. nuk janë një me origjinalin.

Lidhur me këtë po i shpreh shkarazi edhe nja tri mendime që e plotësojnë sadopak arsyetimin për çështjen në diskutim:

e para, ma thotë mendja se nëse nuk ligjësohet (kultivohet) në kuadër të shqipes letrare paskajorja me + pjesore, atëherë çdo shqipfolës i brezave më të rinj në të ardhmen do ta ketë vështirë të mund të shijojë dhe të kuptojë

bukurinë artistike shprehëse të thesarit tonë të traditës të shprehur edhe me ndihmën e formës së paskajores në fjalë, siç janë edhe dy veprat e sipërcëkura;

e dyta, duhet pasur parasysh faktin se këtë formë e përdoren në krijimet e tyre artistike edhe poetët e njohur toskë si p.sh. Naimi, Samiu, Konica, Asdreni, Mihal Grameno, Skënder Luarasi, Pirro Floqi (tosk, i cili e shkroi gëgërisht poemën: “Kosova e lirë”) etj. dhe me një veprim të tillë ata nuk nderuan vetëm gëgërinë, por në radhë të parë nderuan botëkuptimin atdhetar dhe artin e tyre letrar;

e treta, nuk shoh kurrfarë arsye që edhe tashti e në të ardhmen letrarët e rinj të mos shfrytëzojnë në mënyrë legale formën me + pjesore ne krijimet e tyre artistike, pra pa kurrfarë druajtje se po bëjnë shkelje të normës letrare etj., ngase tashti mbase nuk u kanoset rrezik “as nga tanët as nga të huajt” siç ankohej A. Konusheci në poezinë e tij me titull mjaft simbolik e transparent: “Mbrojtja i infinitivit”:

“Me të dashtë Ty/ do me thënë me i hy rrezikut; Me të dashtë Ty/ do me thënë me i vu lojë vdekjes”

(...)

“Me të dashtë Ty/ do me thënë me i hapë rrugë lirisë;/ me të dashtë Ty do me thënë shumë!” (Bujku, 24.XII.1994, f. 9).

Siç po shihet jo vetëm poetët, por edhe të tjerët formën e tillë të paskajores e përdorin, pothuajse, farë natyrshëm, por duhet të tërhiqet vërejtja se nëse rikthimi në përdorimin e paskajores me + pjesore do të përligjet përdorimi duhet të bëhet sa më me kriter.

4. Paskajorja me + pjesore sinonim i mundshëm dhe i nevojshëm paralel krahas formave mbi bazë të lidhores e me forma të tjera të ndërëkëmbeshme

Nga një vështrim jo aq sipërfaqësor që u bëra fjalive e periudhave të gjuhës së sotme letrare shqipe të marra si model nga burimet përkatëse, të cilat i krahasuam me mundësinë e ndërëkëmbimit, d.m.th. të formave të kalëzuesve përkatës të ndërtuar mbi bazë të paskajores me + pjesore që kon-

siderohet si formë karakteristike e gegërishtes, përkatësisht të ish–shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, në njërën anë dhe të formave paralele sinonimike mbi bazë të formave kohore të lidhores e të tjera që vlerësohen si trajta të normëzuara në gjuhën e sotme letrare, në anën tjetër, mund të arrihet në përfundimin se bashkëjetesa e tyre si forma paralele sinonimike jo vetëm se është e mundshme edhe sot e gjithë ditën, por po të shikohet pak më hollë e në thellësi, del edhe shumë e dobishme. Madje kur kemi parasysh semantikën në përgjithësi sinonimia e tillë në situata të caktuara del edhe me elemente të domosdoshë.

Shembuj krahasues të varianteve të kallëzuesit në fjalitë e varura:³⁷

| Fjalja e varur | Kallëzuesi në variantin e letrarishtes së sotme letrare | Kallëzuesi në variantin e geg. |
|--|---|--|
| 1 | 2 | 3 |
| 1. kryefjalore: Është zakon të përcjellësh mikun deri te dera e oborrit. | | Është zakon me përcjellë mikun deri te dera e oborrit. |
| 2. kallëzuesore: Ai shtrirej sikur flinte. | | Ai shtrirej si me fjetë. |
| 3. kundrinore: E merrja me mend se atje nuk kisha me qenë i qetë. | | E merrja me mend se atje nuk do të isha i qetë. |
| 4. përcaktore: Ngul këmbë se vetëm me respektin e ndërsjellë mund të ruhet harmonia familjare. | | Ngul këmbë se vetëm me respektin e ndërsjellë mundet me u ruajtë harmonia familjare. |

³⁷ Shembujt janë nxjerrë e modifikuar sipas lëndës së përfshirë kryesisht në këto burime: "Sintaksa" (Sintaksa e periudhës), Prishtinë 1991 dhe "Sintaksa" për kl. II të AMO-s (nga A. Këlmendi dhe M. Hasimja), Prishtinë 1989.

| | | |
|--|---------------------------------------|--|
| | Kish ca llafe që ta prishnin mendjen. | Kish ca llafe me ta prishë mendjen. |
| 5. rrethanore: | | |
| a. vendore: Ata morën rrugën andej nga nuk do të kthehen. | | Ata morën rrugën andej nga nuk kanë me u kthye. |
| b. kohore: Para se të flasësh para auditorit duhet të marrësh frymë thellë. | | Para se me folë para auditorit duhet me marrë frymë thellë. |
| c. mënyrore: Si të ishin marrë vesh, menjëherë morën plaçkat e dolën. | | Si me u pasë marrë vesh, menjëherë morën plaçkat e dolën. |
| ç. qëllimore: Janë fjalë që t'i mbajsh mend. | | Janë fjalë me i mbajtë (për t' i mbajtur) mend. |
| d. shkakore: Mos je i dëshpëruar që do të dalësh në gjyq. | | Mos je i dëshpëruar që ke me dalë në gjyq. |
| dh. rrjedhimore: Është tepër i vogël (që) të dalë në vend të babait. | | Është tepër i vogël me dalë (për të dalë) në vend të babait. |
| e. kushtore: T'i kisha kuptuar me kohë ato fjalë, ndryshe do të më dilte puna. | | Me i pasë kuptue me kohë ato fjalë, ndryshe kishte me më dalë puna. |
| ë. lejore: Sido (që) të jetë vëllai, vëlla i thonë. | | Sido me qenë vëllai, vëlla i thonë. |
| f. krahasore: Sa më shpesh të dalësh në shetitje, aq më mirë do të jetë për shëndet. | | Sa më shpesh me dalë në shëtitje, aq më mirë kish me qenë për shëndet. |

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm pjesorja si gjymtyrë e dytë e paskajores me “me”, është shënuar në trajtën e ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes, por sa i përket kuptimit, fjalia nuk do të pësonte asnjë të keqe, po të ishte shënuar në trajtën e shqipes së sotme letrare. Me qenë se që të dyja versionet e kallëzuesit janë të njohura dhe të përdorshme nga gegërishtfolësit, përkatësisht nga vazhduesit e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes dhe të tjerë, prandaj është mirë t'i jepet vendi i caktuar parësor e dytësor secilës trajtë nga vetë përdoruesi. Nga konsultimi që u bëra të gjitha llojeve të periudhave me fjali të varura në raportin paskajore / forma tjetër përkatëse barasvlerëse fitova bindjen se dalin çështje me shumë interes që meritojnë studim të veçantë. Meqë puna e tillë do të na merrte shumë vend këtu, hoqa dorë nga një përimtim i tillë, por s'mund të anashkaloj tash për tash pa i rikujtuar dy gjëra:

së pari, një rast sinonimik karakteristik të periudhës me fjali përcaktore me ngjyrim rrethor rrethimor, tipi: *Kish ca llafe që ta prishin mendjen (që t'i luanin mend e kresë)* që në gegërishte shprehen pothuajse normalisht me paskajore: *Kish ca llafe me ta prishë mendjen (me t'i luejtë mend e kresë)* dhe

së dyti, konstatimin e prof. B. Bokshi lidhur me paskajoren e dytë: tipi “për të bërë edhe si formë e pashtjelluar foljore ka mbetur në funksion të SP-së (sintagmës prepozicionale) pa arritur të kalojë në funksion të një sintagme të një SN-je (sintagme nominale), d.m.th. në funksion të kryefjalës a të kundrinës as në toskërishte ku nuk ishte më në përdorim paskajorja e vjetër” (Shih. B. Bokshi, Pjesorja ... f. 168), prandaj në këtë kuadër duhet shtuar përkujdesjen në trajtimin e raportit: lidhore / paskajore me + pjesore si raste dysore në periudhat me fjalitë përkatëse.

Lidhur me këtë dhe për gjëra të tilla është me interes të sqarohen a të njihen (a rinjihen) më mirë edhe këto katër çështje:

e para, si bëhet ndërkëmbimi i formave kohore mbi bazë të lidhores ndaj formave mbi bazën e paskajores me “me”;

e dyta, si mund të bëhet konkretisht ndërkëmbimi i formave paralele në të njëjtën fjalë a periudhë;

e treta, treguesit e vetës të foljeve parashoqëruese zbutës së abstraksionit të thënieve me paskajoren me “me”;

e katërta, pse e drejta e paskajores me + pjesore për konkurrencë lojale s'bën të mohohet dhe

e pesta, prirja për zëvendësimin e konceptit të paskajores nga veta e dytë në njëjës e së tashmes së lidhores.

1) Rregullat e ndërkëmbimit të formave kohore mbi bazë të lidhores ndaj formave të paskajores me + pjesore

Në vijë të përgjithshme rregulla e ndërkëmbimit të formave kohore mbi bazë të lidhores me format e paskajores me + pjesore paraqitet në skemën e mëposhtme:

Skema e ndërkëmbimit³⁸

| Mënyra | Koha | Trajta e letrarishtes së sotme | Trajta mbi bazë të paskajores me “me” | Raporti |
|-------------------|---|--|---------------------------------------|----------------|
| dëftore: | e tashme e ardhme | jam do të jem (kam për të qenë) | me qenë kam me qenë | 1 : 1 2 ; 1 |
| kushtore: | e tashme e kryer | do të isha (kisha për të qenë) do të kisha ? qenë | kisha me qenë | 2 : 1 |
| lidhore: | e tashme e pakryer e kryer më se e kryer | të jem të isha të kem qenë të kisha qenë | me qenë me pasë qenë | 1 : 1 3 : 1 |
| Gjithsej raporti: | | | | 9 : 5 |

³⁸ Skema është hartuar prej meje pa ditur për burime përkatëse, ku mund të jetë trajtuar lënda e tillë.

Siç po shihet nga skema e mësipërme, e cila mund të konsiderohet si njëra nga rregullat e përgjithshme të ndërkëmbimit, ngase del e zbatueshme për të gjitha foljet: kështu që e tashmja e dëftores këmbëhet në raste përfaqësimi me të tashmen “konvencionale” të paskajores, e ardhmja e dëftores këmbëhet me trajtën e përbërë kam + paskajore me “me”, e tashmja dhe e kryera e kushtores këmbëhen me trajtën e përbërë: kam + paskajore me “me”, e tashmja e lidhore këmbëhet me trajtën konvencionalisht të tashme të paskajores me + pjesore, ndërsa e pakryera, e kryera dhe më se e kryera e lidhore këmbëhen me të ashtuquajturën paskajore e shkuar a e kryer: me + (ndihmësja) pasë + pjesore.

Lidhur me trajtat e kushtores do sqaruar dy gjëra: e para, trajta e së tashmes së kushtores përputhet me trajtën e së ardhmes së shkuar të dëftores (do të isha, kisha për të qenë) dhe e dyta, e kryera e kushtores pos me trajtën kam + paskajore me “me” që ndeshet rrallë, këmbëhet edhe me trajtën kam me (pasë) qenë, do të kisha me (pasë) qenë, për këtë arsye është vënë pikëpyetje.

Të vihet re gjithashtu se me trajtat e mënyrës lidhore paskajorja e dytë nuk mund të ndërkëmbëhet.

Ç’është e vërteta, pas foljeve që shprehin qëndrimin a vullnetin e folësit e pakryera e lidhore ndërkëmbëhet si e tashmja me paskajoren me “me” (konvencionalisht të tashme) d.m.th. në rastet e tilla si e tashmja ashtu edhe e pakryera e lidhore ndërkëmbëhen me formën me + pjesore. P.sh.: **Kërkoja** (kërkova, pata kërkuar, kisha kërkuar) të dal (të dalësh... / të dilja (të dilje, të dilnin...) atje. ose **Kërkoja** (kërkova, pata kërkuar, kisha kërkuar) **me dalë** atje.

Pra, pa hyrë në hollësi, edhe pse nuk janë pa interes të dihen, siç është b.f. ekonomimi gjuhësor, qartësia e shprehjes, nevoja e sinonimisë etj., hë-përhë, mund të konstatohet se këto janë trajtat ndërkëmbëse, të cilat janë të pranishme në jetën tonë të përditshme dhe për shumë arsye është e nevojshme të njihen dhe do të ishte me interes që të trajtohen veç e veç si tema të veçanta për hir të konversacionit të drejtë.

Meqenëse trajtat e sipërpërmendura mbi bazën e lidhore kanë përdorim të dendur në sintaksën e gjuhës shqipe, atëherë edhe ndërkëmbimi me paskajoren me + pjesore del mjaft i theksuar dhe i larmishëm. Ç’është e vërteta, format mbi bazën e lidhore (dëftorja, kushtorja e lidhore) ashtu si edhe format mbi bazën e paskajores me “me”, që nga fazat e hershme të shqipes së

dokumentuar nuk ishin të panjohura për shqipfolësit, si me thënë, ato janë përdorur paralelisht e vazhdojnë të përdoren edhe sot e gjithë ditën nga gegërishtfolësit e folës të tjerë, përkatësisht nga vazhduesit e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes dhe asnjëherë nuk janë paraqitur si forma kundërvënese të natyrës së ashpër, por bashkë edhe me paskajoren e dytë janë paraqitur si sinonime të nevojshme harmonike edhe në kohën tonë. Sa për të dëshmuar këtë, si rast, shkëputëm nja tre shembuj nga një punim i Dr. Hakif Bajramit: (...)*“Ideologët shqiptarë do të mundohen për t’i lënë me një anë ndasitë krahinore, fisnore, fetare, dhe t’i dalin për ballë tërë asaj force që synonte me i spastruar tërësisht...”*

“Ideja kombëtare kishte filluar me u pjejë tërësisht për të dalë fuqi politike – popullore në vete dhe për vete ...”

“A duhet shqiptarët t’ia lënë evolucionit ekonomik për mos me u koritë para pasardhësve dhe mos me i përdhosë të parët?”

(Shih) gazeta “Fjala jonë”, nëntor 1994 (Prishtinë) f. 23)

Siç del edhe në burime të tjera, secila trajtë në kontekst ka gjetur vendin e vet, prandaj ende mund të shtrohet pyetja se a ka arsye që edhe në gjendjen e sotme paskajorja me + pjesore të mos jetë e përligjur nën patronazhin e normës së gjuhës së sotme letrare? Lidhur me këtë dalin edhe dy çështje të ndjeshme që gjithsesi duhen theksuar:

e para, ka të bëjë me diferencimin kuptimor në mes të formës: *do të jem* dhe të asaj: *kam me qenë* dhe

e dyta, ka të bëjë me faktin që lidhet me mjaft raste nga praktika, kur paskajorja me “me” parësorisht nuk këmbëhet me format kohore të lidhore, por me forma të tjera.

a) Rasti i kundërvënies të së ardhmes së domosdosë ndaj së ardhmes së dëshirës

Në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes, dhe kjo mund të vërehet edhe sot në ligjërimin e përditshëm të gegërishtfolësit, e te të tjerë vërehet prirja e diferencimit kuptimor në mes të trajtës me paskajore (me + pjesore) në njërin anë dhe të trajtës do + lidhore të tipit do të punoj, në anën tjetër.

Është cekur në fillim të këtij punimi se trajta kam + paskajore quhet futur i domosdoshë a i domosdosshmërisë, ndërsa do + lidhja quhet futur i dëshirës a i dëshirueshmërisë. Këto forma, si të thuash, e lidhin gjuhën shqipe edhe me gjuhët evropërdimore edhe me kulturën gjuhësore paksa postbizantine ballkanike (evrolindore).

Lidhur me këtë dukuri ja si shprehet prof. I. Ajeti "Është shumë interesant të vërehet që forma e futurit kam me infinitivin pajton për mrekulli me mënyrën e sajimit të futurit në gjuhët romane, ital. lavorero = lavorare + ho, frëngj. s' ecirai = ecir + j'ai, me ndryshim që në formimin e futurit të gjuhëve romane elementi i foljes ndihmëtare, në kundërshtim me të shqipes, rri në pozicion fundor. Sa i përket pozicionit do + konjuktiv, shumica e lingvistëve janë të mendimit që ajo është një zhvillim relativisht i ri, që u sajua nga ndikimi i pandërpemë i greqishtes i hyrë pastaj në bullgarishten, në disa të folme serbokroate dhe në rumanishten. Në anën tjetër me kaq dësh-mohet që shqipja si gjuhë e formuar në sferën perëndimore dhe lindore të truallit indoevropian".

Gjithashtu lidhur me përdorimin e të dy futurëve të sipërcekur në shqipe, po ky autor, thekson: "Gega sa herë që do t'i dallojë dy veprime të ardhshme, futurin e tipit me "kam" do të përdorë për të shprehur një veprim me kuptim detyrimi e tjetrin me "do" me vështrim dëshire, vullneti". Sa për ilustrim, lidhur me këtë autori shënon fjalinë: "Kam me gatue, por s' do të gatuej"³⁹.

Ja se si e shpjegon këtë fakt dashamirësi dhe njohësi shumë i mirë i normës së shqipes së sotme letrare, ortologu veteran Mehmet Gjevori, në krahasim me trajtat gjegjëse të dy gjuhëve të huaja: serbisht e anglisht:

shq. kam me dalë (patjetër): serb. moram izaci; angl. must go;
do të dal (jo patjetër): trebam izaci; shell go, will go.

Po këtë fakt, si prof Idrizi, e ka vërejtur më përpara edhe prof. Selman Riza që në vitet '40, por edhe më vonë duke konstatuar se nga "shpërdorimi i konstruktit" për detyrimin e ardhshëm, p. sh. kam me folë edhe unë si kon-

³⁹ Akad. I. Ajeti, Studime gjuhësore në fushë të shqipes II ('85), f. 279; III, Prishtinë 1985 f. 65.

strukt për kohën e ardhshme do të flas edhe unë – praktikisht ka pushuar së qeni letrar ... në periudhën e mbasçlirimit".⁴⁰

Dhe vërtet, lidhur me dukurinë e sipërcekur të "shpërdorimit", siç e quan prof. S. Riza, përkatësisht koncepteve të ndryshme edhe në gjuhë të huaja, shtrohet pyetja pse mos të favorizohet shtrirja e një mundësie të tillë në gjuhën standarde kombëtare? Sa ka arsye logjike e gjuhësore që t'i mbyllen dyert e mundësisë së specifikimit a të konkurrencës së formave të caktuara për nënfusha të caktuara semantike, vetëm pse njëra formë i takuaka atij dialekti që nuk është marrë për bazë për normën e gjuhës së sotme letrare?! E di se jo vetëm për këtë, por edhe për mjaft koncepte të tjera që mbulohe me paskajore bëhet përpjekje për t'i zëvendësuar me forma të tjera, qoftë duke i ngarkuar polisemisht format ekzistuese paralele, qoftë duke toleruar përfitime të formave të reja, madje edhe "neveritëse", të cilat shpesh edhe dalin si thyerje e normës.

b) Raste të ndërkëmbimit të paskajores me "me" jo parësorisht me format kohore mbi bazë të lidhores

Të një natyre pak më tjetërfare dalin disa shembuj me paskajoren me + pjesore, ngase paskajorja në funksionin e kallëzuesit, në situata të caktuara, nuk këmbëhet parësorisht me format kohore të lidhores, por me forma të tjera.

Disa shembuj të ndërkëmbimit joparësorisht të paskajores me + pjesore me format kohore të lidhores⁴¹

| Fjalja me paskajoren me "me" | Ndërkëmbimi |
|------------------------------|----------------------------|
| 1. Duart janë me punue. | Duart janë për punë |
| 2. Shtirej si me fjetë. | Shtirej sikur (po) flinte. |

⁴⁰ Selman Riza, Tri monografina, Tiranë 1944, f. 129; Vepra 2, Prishtinë 1997 f. 93.

⁴¹ Shembujt janë nxjerrë nga teksti i punimit të T. Këllmendit me ndonjë modifikim sipas përvojës sime.

3. Mbahet si me ditë shumë.
4. Herë bëj sikur me qa,
herë bëj sikur me qeshë.
5. Me vdekë se me vdekë,
më mirë me hangër peshk
me hala sesa speca djegës.
6. Sa nisëm me punue,
ai ia filloi gjëmës.
7. Me e rrahë dikë më
hallelig se veten ke me
u koritë.
8. Me e zbatue urdhërin e
arsyes mbetet detyrë jona.
9. Qëllimi është me e ruejtë
fytyrën nga koria.
10. Për nxënësin vlen
rregulli: me mësue, me
mësue dhe vetëm me mësue.
11. Me marrë masa parandaluese
është në të mirën tonë.
12. Me i trembë kuajt e huaj
nuk ka me të ra mirë.
13. Me dalë, dola, me thënë,
thashë, por ai nuk desh
me marrë vesh.
14. Me punue, punova, me
ndëgjue, ndëgjova, po
ai mbeti se mbeti i
pakënaqur.
15. Flaka po do me më dalë.
16. Shkurt me pre, ngatërresë
nuk ke, me e lënë zhag e
gjatë ka me pjellë shamatë.

Mbahet sikur (po) di shumë.
Herë bëj sikur qaj, herë bëj
sikur (po)qesh.
I vdekur se i vdekur, më mirë
po ha peshk me hala sesa speca
djegës.
Sa ia nisëm punës, ai ia
filloi gjëmës.
Po e rrahe dikë më hallelig se
veten koritësh.

Zbatimi i urdhërit të arsyes
mbetet detyrë jona.
Qëllimi është ruajtja (të
ruajturit) e fytyrës nga
koria.

Për nxënësin vlen rregulli:
mësim. mësim dhe vetëm
mësim

Marrja e masave parandaluese
është në të mirën tonë.

Po i trembe kuajt e huaj
nuk do të bjerë mirë.

Sa për të dalë, dola, (sa) për
të thënë, thashë, por ai
nuk desh i të marrë vesh.
Sa i përket punës punova, sa
për të dëgjuar, dëgjova,
po ai mbeti se mbeti i
pakënaqur.

Flaka sa s' po më del (sa
s'më doli ... etj.).

Shkurt po u pre, ngatërresë
nuk ke, po u la zhag e
gjatë ka për të pjellë
shamatë.

- | | |
|---|---|
| 17. Me t'ia futë dajak, ka me i vu gojës kapak. | Po t'ia fusësh dajak do t'i vërë gojës kapak. |
| 18. Aq keq foli sa meritonte: me t'ia dhënë shuplakë fytyrës. | Aq keq foli sa meritonte: shuplakë fytyrës. |
| 19. Kënaqet me i ngacmue të tjerët. | Kënaqet kah (nga) i ngacmon a duke i ngacmuar të tjerët |
| 20. Me lexue lodhet. | Nga leximi a duke lexuar lodhet. |
| 21. Me vdekë, s'mërzitet. | Nga vdekja nuk mërzitet. |
| 22. Me qenë i zoti, s'të shkon keq moti | Kur je i zoti, nuk të shkon keq moti. |
| 23. Me ta ngrehë mirë veshin nuk ta ha macja përseshin. | Po ta ngrihja mirë veshin nuk (do) ta ha(jë) macja përseshin. |

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm, paskajorja me + pjesore rëndom del e ndërkëmbyeshme me një emër foljor, me paskajoren e dytë si dhe me trajtën pavetore të lidhore, madje edhe me trajtën e përcjellores, me një emër etj., e jo parësorisht me trajtat e mirëfillta kohore të lidhore. Prandaj konstatimi se paskajorja me + pjesore “zëvendësohet plotësisht prej lidhorese ose paskajores së dytë” me të drejtë duhet të pranohet me rezervë.

Gjithsesi tema e sapocekur këtu nuk është pa interes të gjurmohet e të përshohet më tej, ngase shembujt si këta nuk ndeshen si raste të vetmuara a të konservuara mbeturinore, por ato ndeshen si krijime potenciale të gjalla dhe mjaft aktive e frekuentuese në ligjërimet tona të ditës, por edhe në gjuhën e shkruar poetike.

Prandaj, faktet si këto, siç është edhe rasti i kundërvënies së trajtave të futurit si dhe rasti i ndërkëmbimit joparësorisht i paskajores me “me” me trajtat e lidhore, duhet të trajtohen edhe nga këndi i dobisë që mund t'i sjellin format e tilla strukturës së përgjithshme sintaksore të shqipes standarde kombëtare. Në të vërtetë, kur kemi parasysh raportin hierarkik të njohur se gjuha standarde duhet të jetë superiore ndaj sociolekteve e të dialekteve,

atëherë, nëse nuk bëhet integrimi i formës në fjalë në normën e shqipes standarde, s'ka sesi të tregohet ai superioritet i gjuhës sonë letrare.

2) Sinonimi e nevojshme dhe aspak e dëmshme e me mundësi përdorimi dhe ndërkëmbimi paralel

Këtu nuk do të bëhet fjalë për sinonimet e pjeshme me prirje të difrencimit stilistik a kuptimor, siç u zunë në gojë mësipër, por kemi të bëjmë me sinonime jo të pjeshme po semantikisht të plota dysore, të cilat i përgjigjen kuptimit në planin referencial përkatës. Këtë karakteristikë të veçantë të sinonimisë do ta ilustrojmë me këta dy—tre shembuj:⁴²

1. Duhet të guxoxh që të mos kesh frikë.
Duhet të guxosh për mos me pasë frikë.
Duhet me guxue që të mos kesh frikë.
2. Sado i zoti të jesh, pa punuar s' mund të fitosh.
Sado i zoti me qenë, pa punuar s' mundesh me fitue.
Pa punuar s' mund të fitosh, sado i zoti me qenë.
3. Më mirë të të dalë syri se të të dalë nami i keq.
Më mirë me të dalë syri se me të dalë nami i keq.
Më mirë të të dalë syri sesa me të dalë nami i keq.

Përdorime dhe ndërkëmbime paralele, siç janë edhe shembujt e mësipërm, paskajorja me + pjesore, në njërin anë, dhe format kohore të lidhore në anën tjetër, pothuajse bëhet normalisht. Ka raste që kombinimet e tilla të ndeshen në të njëjtën fjalë a periudhë.

Një dukuri të tillë e kemi vërejtur edhe në veprat e Gj. Fishtës, të A. Xhuvanit, E. Koliqit etj. Lidhur me këtë kam shkëputur si shembull një secuencë të vogël nga fjalimi i z. Mihal Zallarit, të mbajtur në Asambleenë Popullore të Shqipërisë, më 22.X.1943, të shkruar toskërisht, në pajtim me nor-

⁴² Edhe këta shembuj janë njërrë nga burimet përkatëse sintaksore, por ndërkëmbimi është bërë prej meje arbitrarisht.

mën e atëhershme, ku autori ka përdorur normalisht a, si të themi, në mënyrë të natyrshme si paskajoren me "me", ashtu edhe format e lidhore: "Virytet e racës shqiptare janë karakteri i fortë: mos me patë frikë nga vdekja, mos me patë frikë nga përgjegjësia, me patë ndërgjegjen e përgjegjësisë kombëtare (...) Për me qenë në gjendje të gjykojmë, është nevoja para të gjithave t'i ndajmë e t'i lidhim punët mirë"⁴³ (Shih te gazeta "Fjala", 24. V. 1993 f. 8).

Paskajoren me + pjesore e ndeshim në gojë e toskërishtfolëse në stilin administrativo-politik edhe më vonë. Kështu në një dokument të Byrosë politike të PKSH më 1948 del se aktivistet e lartë të atëhershëm të shtetit e të partisë (toskë)⁴⁴ e përdorin, pothuajse normalisht edhe paskajoren me + pjesore. Ç'është e vërteta, edhe pse në vitet '70 kur pothuajse "zyrtarisht" përdorimi i paskajores me + pjesore nuk ishte "i lejueshëm", në gjuhën e folur kemi pasur rast të dëgjojmë (siç kemi edhe sot) se paskajorja me + pjesore përdorej, madje edhe nga udhëheqësit më të lartë të shtetit dhe të partisë, prandaj mund të themi se kjo trajtë mbase doli e pafavorizuar nga vetë gjuhëtarët "kompetentë", e jo si pjellë diktati nga jashtë nga individë të caktuar shoqëror-politikë të kohës?!

Vërtet, lidhur me ndërprerjen e një praktike të tillë të ndërkëmbimit a të përdorimit paralel të formave në fjalë në vitet '70, dhe kjo përligjeje edhe me gramatikën (toske) të Ilo Sheperit e të tjera, del e nevojshme të jepen sqarime plotësuese, ngase arsyeja e thjeshtësimit të formave si kjo nuk duket aq bindëse dhe punë e urtë. Thjeshtësimet e tilla (me zhdukje), marrë përgjithësisht, më tepër i sjellin dëm sesa dobi gjuhës, ngase secila formë gjatë përdorimit ka mundësi të specifikohet për nunca të caktuara stilistike e kuptimore. Te rastet si më sipër të përdorura nga Zallari dhe të tjerë, nuk është çështja se si të shkruhet b.f. pjesorja (si gjymtyrë e dytë e paskajores): me patë, me patur, me pasë a me pasur; me punue a me punuar etj. Kjo çon pak peshë. Çështja kryesore qëndron te shprehja e konceptit të paskajores me formën e caktuar e jo te formanti prapashtesor temëformues i pjesores.

⁴³ Shih: Fjala, 24.V.'93, f. 8.

⁴⁴ Shih: Zëri (Prishtinë), 21.II.'97, f. 40.

2) Treguesi i vetës nga folja parashoqëruese zbutës i abstraksionit të paskajores me + pjesore

Është cekur më përpara se paskajoren e karakterizon abstraksioni mendor, pasi që ajo vetëm për vetëm nuk është e pajisur me kategoritë e foljes së shtjelluar, siç janë: veta, numri, koha, modaliteti, mirëpo, siç u pa nga shembujt e mëparmë edhe kallëzuesi mbi bazë të paskajores me “me”, ashtu si edhe, kallëzuesi mbi bazën e formave të lidhore, shprehin procese, veprime a gjendje pothuajse të barasvlershme si nga fusha abstrakte ashtu dhe nga ajo konkrete.

Me një fjalë, edhe me anë të kallëzuesit të përbërë mbi bazë të paskajores, sa herë që paraqitet e nevojshme përcaktohet veta, koha, numri etj. ashtu siç ndodh edhe te format e shtjelluara të foljes siç është mënyra dëftore, kushtore, ajo lidhore etj. Përcaktimi i tillë të kallëzuesit mbi bazë të paskajores, bëhet me zgjedhimin e foljes ndihmëse a gjysmëndihmëse a të foljeve modale (aspektore) që e parashoqërojnë atë.

Po ashtu përcaktimi i tillë bëhet edhe me ndihmën e vetorëve (përmrave) përkatës, të cilët nuk janë aq të domosdoshëm te trajtat kohore të foljeve të shtjelluara. Pra, për dallim nga versioni i kallëzuesit mbi bazën e paskajores, ku zgjedhohet folja shoqëruese gjysmëndihmëse, te versioni i kallëzuesit mbi bazë të trajtave foljore të shtjelluara gjysmëndihmëseja e tillë del trajtë e shtanguar, por ka raste që të zgjedhohen të dyja gjymtyrët foljore të kallëzuesit të përbërë.

Lidhur me këtë, sa për ilustrim, do të mjaftohemi me disa shembuj që po i paraqesim në skemën e mëposhtme, raste këto te të cilat vlen të përqendrohet vëmendja te treguesi i vetës sipas versioneve të kallëzuesit:

Skema e strukturës kallëzuese

| Kallëzuesi mbi bazë të lidhore: | Kallëzuesi mbi bazë të paskajores me “me”; |
|---|--|
| 1. nuk do të kthehem (kthehesh...) atje; | 1. – nuk kam (ke...) me u kthye atje; |
| 2. do të jem (jesh...) i lirë; | 2. kam (ke...) me qenë; i lirë; |
| 3. mund të isha (ishe...) mund të kem (kesh...) qenë mund të kisha (kishe...) qenë më i përmbajtur; | 3. mundem (mundesh...) me qenë; mundem me pasë qenë ; (?) “ ” ; më i përmbajtur; |
| 4. do të isha (ishe...) më i përgatitur sikur...; | 4. kisha (kishe ...) me qenë; më i përgatitur sikur...; |
| 5. dua të di (do të dish...) se si të veprohet; | 5. due (do...) me ditë; se si me veprue; |
| 6. nisa të flas (nise të flasësh...) me rrëmbim; | 6. nisa (nise...) me folë me rrëmbim; |
| 7. kam (ke...) ndërmend të punoj (të punosh...). | 7. kam (ke...) ndërmend të punue. |

Pra, kjo është skema e dallimit strukturor të kallëzuesve të përbërë të ndërtuar mbi bazë të ndryshme të foljeve, por kryesisht me kuptim të njëjtë sinonimik. Kjo rregullsi⁴⁵ vlen për të gjithë kallëzuesit foljorë të përbërë analitikë, përkatësisht vlen si rregull e zbatueshme për të gjithë tipat e foljeve.

4) E drejta e paskajores me “me” për konkurrencë lojale

Mund të thuhet se format e shtjelluara të foljes i karakterizon konkretizimi, ndërsa formën e paskajores me “me” e karakterizon abstraksioni, mirëpo,

⁴⁵ Kjo rregullsi a dukuri nuk është e panjohur në gramatikat tona.

siç u pa më sipër, me rastin e zgjedhimit, përkatësisht nga roli i treguesve të vetave që të dyja mënyrat e të shprehurit afrohen semantikisht, ngase tregojnë konversacionisht (shkëmbryazi) pothuajse të njëjtin koncept. Jo vetëm në rastet që u sollën në këtë punim, por edhe në situata e rrethana të tjera secili version i të shprehurit e gjen vendin e vet në kuadër të kontekstit të caktuar.

Siç e kemi përmendur edhe më parë në shumicën e rasteve format e kallëzuesit në versione të ndryshme bashkëtojnë, d.m.th. i ndeshim madje në të njëjtën fjali a periudhë. Ky fenomen, që del i lejueshëm dhe i zbatueshëm nga vetë jeta e ligjërimit, kryesisht të dialektit gegë, sot e gjithë ditën dhe që ishte i pranishëm në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes, nuk është keq të përpunohet dhe lidhur me të të përcaktohen kriteret e mundshme të përdorimit edhe në gjuhën standarde kombëtare. Me një fjalë, formave të paskajores me + pjesore është mirë t'u lejohet konkurrenca e lirë lojale, krahas formave të tjera, që aktualisht konsiderohen të normëzuara.

Trajtimi me kompetencë i çështjes në fjalë do të sqarojë të vërtetën se jo pak shqipfolës e studiues e konsiderojnë dukurinë e përdorimit të paskajores në shqyrtim jo si një "mish të egër", brenda trupit të shëndoshë të shqipes letrare, por si një pjesë të dobishme organike a si një mjet të përdorshëm dhe të nevojshëm që shërben, së paku sinonimisht, për të shprehur nuanca konceptesh të caktuara, duke e sforcuar kështu bazën shprehëse të shqipes letrare kombëtare. Ka mendime se me përdorimin e paskajores me "me" në nënfusha të caktuara semantike, jo vetëm se nuk pëson saktësia e mesazhit, përkundrazi, shtohet qartësia si dhe ngjyrimi stilistik i shprehjes, jepet edhe si një ndihmëse potenciale në ekonominimin gjuhësor.

Lidhur me paskajoren me + pjesore në raportin "gegënishte / toskënishte" prof. S. Riza pati vërejtur se "gegënishtja tregon epërsi të rrastë", ngase, kur infinitivi përdoret "me masë e me rasë lejon thënie sintetike të një elegance klasike, të një koncepti lapidar, epërsi e rrastë mbasandej se infinitivi shpëton gegërishten prej dykuptimësive".⁴⁶ Fundja edhe prof. E. Çabej nuk e nënvlerëson qenshmërinë e infinitivit, ngase, siç shprehet ai, "infinitivi është një përfitim që lidhet me njëfarë përparimi kulturor (...) lidhet me një zhvillim të një mendimi, të një abstraksioni mendor"⁴⁷, prandaj pse mos të përligjet me

⁴⁶ S. Riza, Vepra 1, 1996, f. 126.

⁴⁷ E. Çabej, Studime gjuhësore VII, Prishtinë 1986 f. 119.

urtësi konkurrenca e lirë e kësaj forme në kuadër të gjuhës letrare kombëtare. Vërtet, për koncepte të caktuara s'ka arsye të kërkohen fjalë e forma nga gjuhët e tjera ose të ngarkohen format tona ekzistuese me kuptime të reja polisemike, kur ato tashmë i kemi në kuadër të gjuhës sonë të cilat shprehen normalisht, me ndihmën e paskajores me + pjesore?!

Ja se si e shpjegon arsyen e përdorimit të paskajores me + pjesore për çështje praktike shkencore studjuesi A. Zymeri në veprën e tij mbi leksikon e të folmeve shqipe në Mal të Zi: "Bëjmë me dije lexuesin se pjesët e ligjëratës të marra si fjalë bazë e fjalësit ... i kemi dhënë sipas udhëzimeve të FGJSSH-së, mirëpo sistemin leksikor foljor e kemi dhënë në mënyrën paskajore, për të mos i ikur origjinalitetit të tij",⁴⁸ d.m.th. këtë "shkelje" e bën autori ndërjegjësisht për hir të pasqyritit a të afrimit me realitetin që e trajton.

Edhe nga T. Kelmendi përmendet kjo çështje, por nga një kënd tjetër. Ja si shprehet ai: "Përdorimi paralel dhe jo paralel i lidhore dhe i paskajores dhe i ndërtimeve të tyre është çështje që duhet parë më tej për të pasur një pasqyrë më të drejtë e më të saktë. Studimi i përimësuar do të ishte një kontribut jo vetëm për sintaksën dialektore, por edhe për sintaksën letrare shqipe".⁴⁹

Gjithsesi vlera e formës së tillë do të dilte në pah më mirë, nëse legalizohet konkurrenca e saj në kuadër të shqipes letrare. Madje forma e tillë njëherëpërnjëherë duhet edhe të ndihmohet, ngase subjektivisht ka qenë dhe ende është e dëmtuar. Zgjdhja e paskajores do të konsiderohet e plotë kur toskërishtfolësi e konsideron si pronë të veten të shqipes, edhe pse nuk është i detyruar ta përdorë, ashtu si edhe gega e të tjerët b.f. trajtën e tipit "një të punuar", edhe pse, si trajtë e normuar, si të tillë në atë formë, nuk është i detyruar ta fusë në përdorim askush, madje pale a paraqitet e nevojshme të përdoret ndonjëherë, kur e kemi detyrorin sinonimik më të përshatshëm: *me të punuar*.

⁴⁸ A. Zymeri, Leksiku bujqësor, blegjoral i të folmeve shqipe në Mal të Zi, Prishtinë 1996, f. 20.

⁴⁹ T. Kelmendi, Paskajorja, përdorimet e saj dhe ndërtimet me paskajore në gjuhën popullore shqipe te "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare" 7/82, Prishtinë 1982 f. 61.

5) Prirja e zëvendësimit të paskajores me “me” me vetën e dytë njëjës të së tashmes së lidhore

E lyp vendi të trajtohet këtu edhe prirja e zëvendësimit të nocionit të paskajores me “me” me anën e një trajte të vetme, pikërisht me veten e dytë njëjës të së tashmes së lidhore të foljes përkatëse.

Ndonëse ka rasta që zëvendësimet e bëra arbitrarisht duhen korrigjuar, rasti i zëvendësimit të paskajores me + pjesore me vetën e dytë njëjës të lidhore e ka bekimin e gjuhës së sotme letrare shqipe. Në tekstin e sintaksës normative lexojmë: “Veta e dytë e mënyrës lidhore përdoret gjerësisht me vlerë të përgjithësuar, sidomos në fjalë të pavarura e kryesore të shoqëruara nga foljet modale mund e duhet, në pyetjet retorike dhe në tipa të ndryshëm të fjalive të pavarura: *Mendimit krijues duhet t’i lësh fushë të lirë veprimi*. Në këto fjali veta e dytë nuk tregon bashkëfolësin, po njerëz në përgjithësi ku mund të përfshihet edhe bashkëbiseduesi, por edhe vetë folësi” (Sintaksa f. 384).

Përse pikërisht ky koncept polisemik i takoi si ngarkesë vetës së dytë njëjës të së tashmes së dëftores (që vjen edhe si kompensim për të zëvendësuar konceptin e paskajores) e jo vetave të tjera, nuk është vendi të zgjatem këtu, por po theksojmë se kjo edhe e ka logjikën e vet, ngase pikërisht veta e dytë ka përparësi përfaqësimi të nocionit në fjalë, sepse veta e dytë është ajo që pranon kumtimin dhe se asaj mund t’i urdhërohet, sugjerohet, ankohet, rrefehet etj., për arsye se vetës së parë s’ke sesi t’i flasësh dhe se vetën e tretë nuk e ke të pranishme.

Pa marrë parasysh faktin se kjo dukuri mund të ketë paralelizëm me ndonjë gjuhë tjetër, kjo që u tha prej nesh është në përputhje me logjikën e shkakut të përzgjedhjes së formës së tillë, vetëm kur mungon paskajorja, e cila edhe e mbulon këtë koncept, pa pasur nevojë favorizimi. Mirëpo, përkundër propagandimit të tillë, sa i del zot mbulimit të konceptit të paskajores me + pjesore, veta e dytë në fjalë është çështje më vete, sidomos kur kemi parasysh faktin kur shqipfolësi, konceptin në fjalë e ka të mbuluar me vetë formën e paskajores dhe se ngarkesa me një kuptim të ri të vetës së dytë të lidhore nuk i duket e pranueshme, mosprani kjo që vjen nga vetë sistemi i ngulitur ligjërimit. Ta krahasojmë shembullin e mësipërm:

Mendimit krijues *duhet t’i lësh fushë të lirë veprimi*
me versionin e përcaktuar:

Mendimit krijues *duhet me i lënë* (a duhet lënë) fushë të lirë veprimi.

Sigurisht, versioni i dytë ka fuqi më të madhe shprehëse sa i përket përgjithësimi. Ta ilustrojmë këtë mendim edhe me një shembull tjetër, por tash duke ua ndërruar vendin e përparësisë versioneve:

– Me i dalë zot atdheut është detyrë mbi detyra.

– T’i dalësh zot atdheut është detyrë mbi detyra.

Të dyja versionet shikuar nga pikëpamja e të shprehurit të realies janë dysores të barasvlershme, ndërsa në gjuhën e sotme letrare vetëm forma e dytë është e lejueshme. Është e vërtetë se prejse është atakuar ose është nxjerrë jashtë norme trajta e paskajores me “me”, forma e lidhore e tipit “të dalësh” gjithnjë e më shumë është sforcuar e favorizuar, nën ndikim e shkollës, për të shprehur nocionet abstrakte në gjuhën e shkrimit në vend të paskajores në fjalë edhe nga gegërishtfolësit. Nuk di sa ka arritur të ketë shtrirje të sukseshme në këtë rrugë të abstraksionit forma e lidhore në fjalë, sidomos në gjuhën e folur të ne, por një gjë dihet se në gjuhën e sotme letrare kjo trajtë ndeshet gjithnjë e më shpesh po në këtë funksion, edhe pse për këtë veprim të saj të posaçëm nuk pata rast të lexoj ndonjë punim a rekomandim, sidomos nga gjuhëtarët tanë, pos konstatimit të mësipërm nga sintaksa. Ç’është e drejta, T. Kelmendi, në punimin e tij thekson se “e përdorur në veten e tretë njëjës në trajta jo veprorë e në veten e dytë njëjës, lidhorja ka mundësi për të dhënë veprime e gjendje në mënyrë të papërcaktuar a të përgjithësuar të përdhënë veprime e gjendje në mënyrë të papërcaktuar a të përgjithësuar të përdhënë veprime a si të kryera ose të bartura nga një vetë e papërcaktuar a e përgjithësuar”⁵⁰, porse këtë funksion të lidhore në shqyrtim prej nesh nuk e thelloim më tej. Pa e kontestuar qëndrimin parimisht të drejtë të autorit, në vazhdim të do të trajtojmë pikërisht raportin ndërmjet të dy versioneve në mbështetje të fjalive të sipërsënuara.

Po të shtrohet pyetja e njëjtë para dy versioneve të fjalive të mësipërme, b.f.: Për kë vlen (+ thënia e mësipërme)? Përgjigjia për versionin e parë do të dilte vërtet e papërcaktuar sa i përket vetës. Nënkuptohej menjëherë se si të bëjmë me kuptim të plotë mund të dalë cila do nga trajtat: ...vlen për gjigje me kuptim të plotë mund të dalë cila do nga trajtat: ...vlen për

⁵⁰ Po aty në punimin e T. Kelmendit.

mua, për ty, për atë, për ne, për ju për ata (ato), pra vlen për të gjithë. P.sh. **Për mua** (për ty...) **me i dalë zot atdheut është detyrë mbi detyra.** Ndërsa për versionin e dytë, nëse mund të pyetet kështu: Për kë vlen t'i dalësh zot atdheut? Përgjigjia imponohet në radhë të parë "Për ty"... "t'i dalësh zot...!", ndërsa trajtat e tjera nuk janë të imponuara fillimisht. Ndoshta për një pjesë folësisht mund të jenë të kapshme vetëm në sajë të rekomandimit që jep sintakse?!!

Gjithsesi, formulimi i fjalisë së dytë kuptohet më me rezervë, në krahasim me formulimin e fjalisë së parë tek ata shqipfolës, të cilët e kanë të përvijuar në sistemin e tyre ligjërimor trajtën e paskajores me "me".

Krahaso:

– Për ty t'i dalësh zot atdheut është detyrë mbi detyra. – Për ne (si për të gjithë) t'i dalësh(!) zot atdheut është detyrë mbi detyra(!?).

Sigurisht më i kapshëm del versioni: – Për ne (si për të gjithë) t'i dalim (me i dalë, t'i dalësh) zot atdheut është detyrë mbi detyra.

Kam bindjen se për një masë jo të vogël shqipfolësish ende nuk del i pranueshëm një përgjithësim i tillë i abstraksionit të lidhores të tipit "të dalësh". Dua të them se, nëse i rikthehet e drejta e konkurrencës paskajores me + pjesore, kjo ka më shumë gjasa për të shprehur konceptin në fjalë ndaj formës së lidhores së tipit "të dalësh", mirëpo kjo nuk do të thotë se forma e tillë e shprehjes del e paqëndrueshme. Këto dy trajta mund të qëndrojnë si sinonime të përfillshme.

Po të shtrohet një pyetje tjetër, b.f. pyetja "Kush?" para të njëjtës fjalë, përkatësit të njëjtës fjali, sipas dy versioneve, atëherë kuptohet se kjo pyetje përshtatet vetëm për versionin e parë, ndërsa për versionin e dytë jo, ngase trajta "të dalësh" del e përjashtuar nga mundësia për t'u përgjigjur ndaj pyetjes: *Kush?* Ç'është e vërteta, tani sinonim i paskajores me + pjesore del pavetorja *dilet*. P.sh.:

– Kush (cili...) **me i dalë zot atdheut** e ka detyrë mbi detyra?
ose

– Kush (cili...) **t'i dalë zot atdheut** e ka detyrë mbi detyra?

Përgjigjia për versionin e parë do të dilte e pranueshme për të gjithë përemrat përkatës: unë, ti... etj. Pra cilido nga përemrat do të jetë i vetë-

mjaftueshëm, ndërsa për versionin e dytë trajtat e foljes i përshtatet vetes së përemrit përkatës, prandaj trajta "të dalësh" del e papërgjithësuar, ndërsa ajo "me dalë" mbetet e pandryshueshme. Krahaso:

– Unë (ti...) **me i dalë zot atdheut** e kam (ke...) detyrë mbi detyra.

– Unë (ti, ai...) **t'i dalë zot atdheut** e kam (ke, ka...) detyrë mbi detyra.

Po të përdoret trajta jovepre "t'i dilet", përgjigja në pyetjen e parë ka përputhshmëri semantike me përgjigjen e versionit të parë, por me ngjyrimë pak a shumë të dalluara stilistike, ndërsa forma e tillë nuk mund të bashkëjetojë me pyetjen e dytë: "Kush?", ngase forma "t'i dilet" nuk duron kurrfarë përemri vetor në konstruktet e tilla. Në sintaksë thuhet "*veçantia e foljes në fjalitë pavetore është se pranë saj është i pamundur përdorimi i një emri në funksion të kryefjalës* (Aty f. 386), por siç e pamë më sipër pyetja bëhet në formën: "kush (duhet) t'i dalë zot?... " ose "kush (duhet) me i dalë zot...?". Me fjalë të tjera me formën e paskajores kuptohet të përfshira të gjitha vetat, ndërsa me formën pavetore jo.

Sidoqoftë, edhe nëse riaktivizohet paskajorja me + pjesore me cilësinë e normës letrare mendojmë se praktika e përdorimit të vetes së dytë njëjtë të së tashmës së lidhores nuk duhet hedhur tej, por, si të thuash, dukuria e tillë së duhet ndjekur me vëmendje, sepse mundësia e shprehjeve sinonimike do të dalë edhe më natyrshëm.

Edhe pse me "rilejimin" e paskajores me + pjesore për shumë shqipfolës do të pushojë nevoja e domosdoshë për përdorimin e formës së lidhores në fjalë, po përsëris, ne kemi mendimin, se të dyja trajtat duhet të jenë të tolerueshme dhe të normëzuara në gjuhën standarde kombëtare si sinonime.

dh) Disa shfaqje devijuese të shkaktuara te ne nga mënjanimi i paskajores me + pjesore

Si pasojë a si kompensim për mënjanimin e paskajores me + pjesore nga gjuha e sotme letrare te ne u shfaqën disa lahjitje a dukuri "të reja" bren-gosëse, si në fushën e morfologjisë ashtu edhe në atë të sintaksës, të cilat

edhe sot e kësaj dite janë të pranishme, jo vetëm në gjuhën e folur, por edhe në atë të shkruar, madje ndeshen edhe në punime shkencore dhe sigurisht ato, siç thotë për një rast prof. Isa Bajçinca, janë shkelje “neveritëse” të normës letrare, p.sh.:

a) Dukuria e përdorimit të paskajores pa pjesëzën “me” në disa shprehje të ndërmjetme sintaksore, tipi: **më mirë thënë**, në vend: *më mirë me thënë*, norma: **më mirë të them(i)**; **shkurt thënë**, në vend: *shkurt me thënë*, norma: **shkurt të them(i)** a *shkurt e thënë* (Shih: Zëri, 1.V.'93, f.23; Bujku, 25.7.'97, f. 5 etj.).

b) Ngatërresa e zgjedhimit të foljes ndihmëse **mund** edhe para lidhoreve në grupin foljor tipi: **mundem të punoj** në vend: **mundem me punue**, norma: **mund të punoj** (Vetëm në një tekst të shkurtër të gazetës *Rilindja*, dt. 18.I.2000, f.15, ndeshëm 7 raste të tilla).

c) Mosharmonizimi i trajtave të gjysmëndihmëses **duhet/duhen a lypset/lypsen** varësisht nga numri që pasqyrohet, p.sh: duhet marrë parasysh faktin/duhet marrë parasysh faktet, në vend: duhet me e marrë parasysh faktin / duhet me i marrë parasysh faktet, norma: **duhet marrë parasysh faktin / duhen marrë parasysh faktet** (Raste lajthitjesh të tilla ndeshim edhe në punime shkencore).

ç) Ngatërresa e përdorimit të formës së më se të kryer, në vend të së tashme së kushtores, përkatësisht për të ardhmen e së krye,ës së dëftores, tipi **kisha thënë** në vend: **kisha me thënë**, norma: **do të thosha a kisha për të thënë** (Shih: Zëri,6.12.'97,f.12; Jeta, 28.10.'97, f.17; Bujku, 17.IV.'98, f.10, Fjala jonë, nr. 3-4 / 8, 35; “Rilindja”, 24.12.'99, f. 8 (tri raste) etj.)

d) Te fjalitë e tipit: Dhomën duhet pastruar, në vend: Dhomën duhet me e pastrue, norma: **Dhoma duhet pastruar**, në vend: Dhomën duhet (Dhoma duhet me u pastrue).

Sipas prof. I. Bajçinës, lajthitja qëndron te “barazimi tërësisht i gabuar i formave të pashtjelluara të paskajores (e cila mund të jetë veprare edhe pjesore) e të pjesores së shqipes, e cila është gjithnjë një formë e një ndërtimi pësor” (Shih lidhur me këtë problem edhe te “Fjala” nr. 9-10/95, f. 14 etj.)

dh) Përdorimi pa vend i paskajores së dytë, tipi për të bërë, në vend të paskajores së mirëfilltë me + pjesore ose të lidhore si p.sh. *mundem (duhet, lypset) për të punuar*, në vend: **mundem (duhet, lypset) me punue**, norma: **mund (duhet, lypset) të punoj (punuar)**.

Lajthitjet e tilla nuk bëhen vetëm në rastet e sipërcekura, por edhe në raste të tjera siç janë shembujt:

1. Më mirë është për të pyetur sesa për të paguar (F. jonë, 8/97, Dosja X, 6);
2. Ajo sikur e ndjente thellë se për të vdekur për atdhe është krenari kombëtare (Fjala jonë,5/95 f.9);
3. Amerika ka një parim: kurrë të vdekurit për t'i mos huazuar para (Zëri, 24.V.'97, f. 13);
4. Shkurt, për vatan duhet për të luftuar (Zëri, 29.11.'97, f. 29);
5. Ajo jep shenja se don për t'u martuar (Bujku, 24.V.'97, f. 11).

Në të gjitha këto raste, në vend të formës së paskajores për të + pjesore, parësisht është dashur të përdoren trajtat e normëzuara letrare me lidhore, tipi: *të pyesësh, të paguajsh, të vdesësh, të mos t'i huazosh, duhet të luftosh a duhet luftuar, do (dëshiron) të martohet*, përkatësisht trajta përkatëse pavetore tipi: *të pyetet, të paguhet, të vdiset* etj., madje edhe trajta e paskajores së mirëfilltë (e zakonshme) me + pjesore (të cilën si duket autorë nga sistemi i vet ligjërimor e kanë “përkthyer” në paskajore të dytë), tipi: *me pyetë, me pague, me vdekë* etj. e jo trajta e paskajores së dytë, ngase kjo formë në raste të tilla nuk ka mbështetje përparësie as në normë as në të folmet popullore (dialektore), prandaj edhe rastet e tilla tingëllojnë si me qenë artificiale. “Forma e paskajores për të bërë – thekson prof. B. Bokshi – edhe në vetëdijen e shqijfolësve të sotëm shpreh kuptimin e qëllimit për shkak të parafjalës për... ndërsa “për funksionet e kryefjalës e të kundrinës është thënë me të drejtë se (ajo) ka funksione tepër të kufizuara e jashtë një përdorimi të natyrshëm” (Vepra e cit. f. 168, 166). Lidhur me këtë le të rikujtohet edhe rekomandimi i prof. Fadil Sulejmanit, i cekur në kreun e mëparshëm.

e) Ndër ne, sidomos në kohë të fundit edhe në gjuhën e shkrimit sapa ka ngritur kokë edhe përdorimi i pjesores në vend të lidhore ose të paskajores në analogji me kallëzuesin e përbërë: folje gjysmëndihmëse + pjesore, të tipit: duhet (lypsen) punuar, dhe kjo paraqet sot për sot shkelje të normës. Sa për ilustrim po e sjellim shembullin: Praktikisht *nevojitet filluar* I vlen theksuar - ndërtimi nga themeli. (Rilindja, 12.8.'99, f. 12; 15. III. 2000 f. 11). në vend: nevojitet me fillue, norma: nevojitet të fillojë, nevojitet për të filluar, nevojitet vlen të fillohet.

Lajthitje a shmangie pothuajse e ngjashme është bërë edhe te gazeta "Çlirimi" 17.8.'99, f. 10), prandaj tërhiqet vërejtje që lajthitjet e tilla mos të përsëriten.

ë. Po e përmendim jo si lajthitje por si dukuri shfaqjen e pjesores geqe në kuadër të paskajores me + pjesore, si p.sh. me dashë (dashur), me vu (vënë), me hangër (ngrënë), me shpjerë (shpënë), me ndejtë (ndenjtur), me bajtë (bartur), me ra (rënë), me u untue (urëtuar/uritur), me u ungjë (ulur), me rmue (rojtur) etj. trajta këto që nuk përkojnë me pjesoren e normuar, prandaj mund të bashkëjetojnë si dysore në përdorim: me dashë/me dashur, me vu/me vënë, me hangër/me ngrënë, me shpjerë/me shpënë, me ndejtë/me ndenjtur, me bajtë/me bartur, me ra/me rënë, me u untue/me u urëtuar, me u ungjë /me u ulur, me rmue/me rojtur – natyrisht duke favorizuar normën në fuqi.

Siç shihet nga shembujt e mësipërm (hiq shembullin e fundit, pika ë.) të gjitha këto shmangie janë pasojë e mënjanimi nga përdorimi të paskajores me + pjesore në njërën anë, dhe të mosnjohjes së rregullave të ndërkëmbimit të formave në raportin paskajore me "me" ndaj trajtave kohore të lidhores e të tjera, duke u shkaktuar kështu shkelje të normës letrare, në anën tjetër.

Le të gjykohet, pra, a më mirë është t'i rikthehet statusi paskajores me "me" me prestigjin e normës letrare si sinonim i përligjur ndaj formave të lidhores e të tjera, apo të legalizohen "format e reja!", të cilat ç'është e vërteta, nuk janë gjë tjetër, por vetëm, qoftë si rezultat i amputimit arbitrar të pjesëzës "me" të paskajores së mirëfilltë të shqipes, qoftë konstruktive "neveritëse" shpifëse kundër natyrës së gjuhës shqipe, sigurisht të shkaktuara si kompensim i keq për mungesën e paskajores, të bëra nga mosnjohja e formës zëvendësuese barasvlerëse të konceptit të paskajores me + pjesore, siç ngjau edhe në shembujt e mësipërm me fryrjen me tepr të paskajores së dytë.

S'do mend se për t'u ikur shmangieve të tilla, është më së miri të rikthehet forma e paskajores në mënyrë që më lehtë ajo do të nxjerrë jashtë formën devijuese dhe më lehtë do t'i lërë vendin normës së favorizuar ose në rast nevojë, edhe të bashkëjetojë me të. Kjo është, për mendimin tonë, mënyra më e lehtë për t'u "shëruar" nga viruset e trajtave të tilla "neveritëse".

e) Konceptet bashkëkohore humluese linguistike në favor të integritit të paskajores me + pjesore në shqipen letrare

Nga kreu kjo që u tha deri këtu del se përveç arsyeve historike sociokulturore e artistike (përhapja horizontale e vertikale hapësinore, përdorimi aktual, arsyeja praktike rreth tipizimit në veprat letrare e të tjera) në favor të integritit të paskajores me + pjesore në shqipen letrare kombëtare, u përmendën edhe këto katër fakte të nëpërdokshme gjuhësore, që edhe janë në përdorim e sipër në jetën tonë gjuhësore, të cilat me dy tri fjalë e shoh të arsyeshme t'i rikujtojmë: e para, përdorimi i paskajores së tipit me + pjesore si trajtë përfaqësuese e foljes; e dyta, përdorimi i paskajores së tipit me + pjesore në disa shprehje a thënie frazeologjike konceptesh thellësisht abstrakte; e treta, shfrytëzimi i trajtës së paskajores me + pjesore nga mjeshtrit e fjalës së bukur dhe e katërta, forma e paskajores me + pjesore del e përdorshme në situata të caktuara në funksion të sinonimisë.

Të gjitha këto fakte së bashku, në njëfarë mënyre, japin vijëzimin relativisht të plotë të kuptimit leksikor të paskajores me + pjesore, koncept ky që del me elemente të domosdoshë si formë për të qenë e përfaqësuar në kuadër të normës së shqipes letrare. Përveç këtyre arsyeve e lidhur me këto fakte, duhet pasur parasysh edhe mbështetjen që del nga konceptet e reja që dalin si rezultat i zhvillimit të metodologjisë shkencore humluese të gjuhësisë bashkëkohore. Natyra e temës që po trajtohet këtu nuk na lejon të ndalemi gjatë rreth këtyre koncepteve të reja dhe interpretimeve që dalin lidhur me to, megjithatë në vazhdim në disa pika shkurtimisht fare, do të përmenden disa fakte plotësuese, të cilat mendoj se janë me interes të dihen përgjithësisht ose së paku ia vlen t'u rikujtohen studiuesve:

Së pari, rikujtohet parimi i njohur në sociolinguistikë, siç është përmendur rreshqitazi më përpara edhe në këtë punim, se "gjuha standarde detyrimisht duhet të jetë superiore ndaj gjuhës së dialekteve të asaj bashkësie folëse, të cilën e përfaqëson. Gjithsesi, gjuha standarde duhet të dallohet si medium që ka gjerësi e gjithëpërfshirje më të madhe në krahasim me "ligjërimet popullore".⁵¹ Kjo gjuhë si "sociolekt" a "etnolekt" zë vendin e parë në hierarki, kur kemi parasysh idiolektin, variantin, dialektin etj., prandaj, për të

⁵¹ Mala enciklopedija, Prosveta, 3, Beograd 1978 f. 299.

qenë e nivelit të tillë gjuha e standardizuar shqipe a s'është e natyrshme që ajo të përfshijë në normën e vet, madje edhe ta ushqejë me gjirin e vet, edhe paskajoren me + pjesore?!

Së dyti, rreth metodës a ecurisë së cila është rruga më e mirë për zgjidhjen e problemeve të tilla, që kanë të bëjnë me dysorët e caktuar po ritheksojmë mendimin e gjuhëtarit G. Morgan, i cili për një rast të ngjashëm, siç është ky yni në shqyrtim, këshillon: “njësimi si qëllim i fundit nuk arrihet me mohimin, po me kultivimin e ndryshimeve”,⁵² mendim ky që për rastin tonë mund të përshtatet kështu: “jo zgjidhje me mënjanim a zhdukje, por zgjidhje me integrim”, sepse si çdo lëndë e parë ose çdo e mirë materiale, ashtu edhe çdo pasuri gjuhësore, e krijuar sigurisht nga nevoja nuk duhet të flakët tej a të asgjësohet apriori, por ajo duket të qëndrojnë e magazinuar a lihet në dispozicioni fondit të rezervës (në ndërjtje) për t'u shfrytëzuar sa herë këtë e kërkon nevoja. Pra edhe në gjuhë, pa e mohuar procesin e evolucionit nuk duhen bërë ndalesa apriorie, pasi që edhe nga fondi pasiv i fjalësitet të gjuhës ndodh të nxirren fjalët e caktuara dhe të riaktivizohen ato. Madje dihet fakti se sinonimet bashkëjetojnë, ato gjatë procesit të përdorimit edhe mund t'i ndajnë funksionet, mund të specifikojnë për nënfusha të caktuara semantike e stilistike ose nga ato edhe mund të lindë diçka e tretë, d.m.th. një leksemë e re me koncept të ri, e cila do të luftojë pastaj për fushën a nënfushën e vet kuptimore dhe kështu në ndërlikohet dialektike do të zhvillohet vargoi i krijimeve të reja. Në këtë kuadër do të pyesnim a s'është më mirë që paskajorja mos të flakët, por të shikohet dhe të shfrytëzohet si një thesar i gatuar që më parë?!

Së treti, dua të theksoj se në gjuhësinë bashkëkohore krahas metodës strukturaliste e të ngjashme me të, po gjen zbatim gjithnjë e më shumë metoda semantike (metoda e filozofisë gjuhësore) dhe në këtë kontekst dallohet “teoria e akteve të të folurit”.⁵³ Në studimet e këtij lloji duke e përfillur dihotiminë: gjuhë /të folurit – zë vend të dukshëm edhe trajtimi i aspekteve kuptimore të

⁵² George Morvan, Jezik spoznaje – spoznaje jezika, te “Filozofska istra + ivanja”, 30/89, Zagreb 1989 f. 987.

⁵³ Nada Ivanetiç, Teorija govornih akata, te “Filozofska istra + ivanja”, 30/39, Zagreb 1989 f. 103.

foljes d.m.th. si të formave të shtjelluara ashtu edhe të formave të pashtjelluara të saj. Së këtejmi, në gjuhën shqipe për hir të objektivitetit që imponohet rreth konstatimit të së vërtetës shkencore, siç është vërtetuar nga autorë të caktuar, nuk mund të anashkalohet pa u vërejtur edhe forma e paskajores me + pjesore, madje ajo imponon përfaqësimin që në plan të parë të vështrimit. Lidhur me këtë, sa për ilustrim, po e cekim se prof. Rexhep Ismajli, duke u ballafaquar me probleme të karakterit të ngjashëm në fushën e përkthimit a të përshtatjes së tekstit në raport me barasvlerësit përkatës të gjuhëve të tjera e ka përdorur pikërisht paskajoren me “me”, kështu që si shembull të asertimit (të të thënit) ai shënon antonimin: “me qenë i sjellshëm” / “mos me qenë i sjellshëm”.⁵⁴ Ngjashëm me këtë vepron edhe studiuesi i mirënjohur i kësaj teme, dr. Tafil Kelmëdi, i cili duke i trajtuar aspektet gramatikore të foljeve (mënyrave të veprimit) në shqipe, në një punim të tij original, shënon këto perifriza foljore aspektore: “me ndërrue koha, me ndërrue vendbanimin, me marrë kohë e keqë, me marrë një cigare, me marrë ajër të pastër, me marrë një libër” etj.⁵⁵

Kështu, pra, këta dy studiues (që nuk janë të vetëm), edhe pse si zbatues e njohës të normës së sotme letrare, për qëllime thjesht të objektivitetit shkencor, përdorin shembujt përfaqësues me paskajoren me + pjesore. Gjithsesi rastet e tilla nuk janë akte që lëndojnë gjuhën letrare, përkundrazi tregojnë pasurinë a forcën e asaj gjuhe për të shprehur në mënyrë adekuate edhe ato finesash, të cilat nuk i ka përfshirë, mbase rastësisht, norma e gjuhës së sotme letrare, por që i ka të koduara norma tradicionale e gjuhës. Me fjalë të tjera, kur kemi të bëjmë me trajtime shkencore që përfshijnë dy rrafshet studimore të hulumtimit: siç është rrafshi tipologjik i situatave gjuhësore, në njërin anë dhe rrafshin tipologjik të funksioneve stilistike gjuhësore,⁵⁶ në anën tjetër, kur kemi parasysh shtrirjen reale të paskajores me “me” në mbarë sintaksën e gjuhës shqipe, mosmarrja në konsideratë të një forme të tillë mund të cilësohej mbase si një lëshim metodologjik?! Kështu po shprehem, ngase

⁵⁴ Ofsard Dykro – Cvetan Todorov, Fjalor enciklopedik i shkencave të ligërimin (përshtatur në shqip nga dr. Rexhep Ismajli), Prishtinë 1984 f. 430.

⁵⁵ T. Kelmëdi, Mënyra e veprimit, aspekti gramatikor dhe perifrizat foljore aspektore, botuar te gazeta “Fjala”, 15. IX. 1987, f. 13.

⁵⁶ Rreth rrafshit tipologjik të situatave dhe rrafshit tipologjik të funksioneve (stilistike) shih te “Filozofska istra + ivanja” 30/89.

dihet fakti se, ashtu-kështu, paskajorja në shqyrtim bën pjesë faktiktikisht në sistemin e tërësishtëm të koduar të gjuhës standarde shqipe?!

Së katërti, rikujtohet nevoja e përkufizimit më të qartë të termave të gjuhësisë shqiptare. Nuk është pa vend përkufizimi i termit “normë letrare” sipas FGJSSH-së, si “një tërësi e rregullave që përcaktojnë përdorimin e mjeteve të gjuhës letrare në mënyrë të njëllojtë për të gjithë pjesëtarët e një kombi (...) si në ligjërimin e folur ashtu edhe në atë të shkruar”,⁵⁷ mirëpo kur kemi parasysh përkufizimet e dhëna për “normën standarde” në gjuhë të tjera, që është sinonim i termit “normë letrare”, atëherë formulimi i tillë në shqipe nuk del i mjaftueshëm. Në gjuhë të tjera norma e gjuhës standarde ndahet në **normë gramatikore** (fonologjike, sintaksore dhe semantike) dhe në **normë pragmatike**. Norma pragmatike përfshin aspekte të veprimtarisë gjuhësore, siç është **norma e situatës** (sipas rrethanave) si dhe **norma e konversacionit** (e cila ndërthret në vete normën e komunikimit dhe normën e ndërkëmbimit).⁵⁸ Sigurisht edhe në gjuhën tonë konceptet e tilla duhen saktësuar e përcaktuar më hollësisht. Konceptet e tilla edhe duhet të përfshihen a të gjejnë vend edhe në mjetet përkatëse normative, prandaj krahas kuptimeve polisemike të termave, është mirë të mendohet edhe për terma të rinj, me të cilët do të ndërthehej e shkoqitej tërë ndërlidhshmëria e temave, siç është edhe kjo që po ceket në shqyrtimin tonë. Me thënë të drejtën, po të vështrohet më në hollësi termi “normë letrare” në përjasje me gjuhë të tjera, atëherë vërejmë se barsavlerësi “letrare” nuk del identik me përgjegjësin “standarde”, pasi që mbiemri “letrare” përdoret disi me kuptim më të ngushtë nga sa përdoret te ne. Me një fjalë, me përcaktuesin “letrare” kuptimi më fort lidhet me normën stilistike (me letërsinë artistike). Së këtijmi, e kemi të qartë se kemi të bëjmë me një normë tjetër që dallon paksa nga “norma standarde”, ngase, siç dihet, **norma stilistike** (letrare) është më e lirë, ajo përshkohet nga “licentia poetica”. “Licentia poetika”, përkundër normës gramatikore (standarde), e cila tenton të jetë sa më e ngurtë dhe jetëgjatë, karakterizohet me guximin që në mjaft raste do të bëjë “thyerje” a “shkelje” të normës gra-

⁵⁷ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980 f. 1270.

⁵⁸ Lidhur me këtë çështje shih edhe te Pranjić, Jezik i knjž evno djelo, Zagreb 1973 f. 23 – 32; N. Ivanetić, Norme, te “Filozofska istra ivanja” 30/89, Zagreb 1989 f. 1038; Xhevat Lloshi, Tipare të sistemit stilistik në gjuhën e sotme shqipe, te “Studime mbi leksikon ...” III, Tiranë 1989 f. 225.

matikore (të gjuhës standarde) dhe se një veprim i tillë, të shumtën e rasteve, kur “thyerja” bëhet me kriter, konsiderohet si një veprim i qëlluar dhe i mirëpritur inventiv, ngase me këputjen e rrathëve të caktuar të normave të ngurtëzuara, këputen ato fije të rregullave të cilat paraqesin pengesë për zhvillimin e gjuhës përgjithësisht. Është i njohur fakti se siç ndërrojnë normat shoqërore, ndërrojnë edhe normat a rregullat gjuhësore, mirëpo secila ruan specifikanë e vet. Prof. A. Kostallari lidhur me kristalizimin normës se shqipes letrare sqaron: “Ai që ne e quajmë kristalizim përfundimtar i normës, në të vërtetë, nuk është kurrë përfundimtar, i përvetshëm, statik; ai duhet kuptuar si vendosje e një qëndrueshmërie tipike, por relative të normës, e cila është dinamike, zhvillohet e përsoset”.⁵⁹ Sipas kësaj mund të përfundojmë se me termin “normë letrare” nuk duhet kuptuar diçka të prerë, por si një formëzim të qëndrueshëm, i cili në vetvete ruan, si të thuahet, elemente fleksibiliteti. Prandaj a s’është më e arsyeshme që edhe e ashtuqytjura normë (e vetëkuptuar ngushtësisht) për mënjanimin e paskajores me + pjesore të shihet me një rezervë të ligjshme, d.m.th. me mundësi korrigjimi a rishikimi?!

Së pesti, edhe lidhur me termin “gjuhë letrare” me variantet: gjuhë e sotme letrare, gjuhë letrare kombëtare, gjuhë letrare e njëzuar, gjuhë standarde, gjuhë zyrtare etj. del e nevojshme që në gjuhën tonë të jepen përcaktime më të sakta, përkatësisht në këtë suazë del e nevojshme që gjuhëtarët tanë t’i harmonizojnë termat, jo vetëm në kuadër të gjuhësisë sonë, por edhe në raport me barsavlerësit përkatës të gjuhëve të huaja më të përpunuara. Në një burim të kulturës së përgjithshme (enciklopedi) të një gjuhë të huaj që konsultova për termin “gjuhë standarde” ndeshëm këtë përkufizim: “gjuhë standarde quhet forma normative e gjuhës, të cilën bashkësia përkatëse folëse, e cila karakterizohet me një ngritje të konsiderueshme civilizimi, e përdor atë si gjuhë të arsimit, të kulturës, të shkencës, të administratës, të veprimtarisë së komunikimit masiv si dhe në fusha të tjera të jetës shoqërore”.⁶⁰

Gjithnjë duke pasur parasysh temën që po e trajtojmë, shtrojmë pyetjen a mund dhe a duhet të ketë vend në kuadër të gjuhës standarde a të gjuhës letrare paskajorja me + pjesore? Aq më tepër, kur dihet se gjuha letrare kombëtare

⁵⁹ A. Kostallari, Kongresi i Drejshkrimit të Gjuhës Shqipe, Prishtinë, 1974, f. 4.

⁶⁰ Mala enciklopedija, Prosveta, veper e cituar në shënimin 41., të këtij kreu.

është një “formë e përpunuar e gjuhës së një populli, e cila ka norma të caktuara të ngulitura në të shkruar e në të folur, dhe arrin njësimin në të lartë në kohën e krijimit dhe të zhvillimit të kombeve e të shteteve kombëtare” (FEJSSH f. 969), kur ajo, forma e paskajores me + pjesore, po ritheksoj me qëllim, përdoret a del e nevojshme të përdoret, pothuajse në të gjitha fushat semantike të gjuhës standarde, siç u cekën më sipër. Të rikujtojmë pra edhe një herë radhazi këto fusha semantike të sipërpërmendura, duke e paramenduar dhe vlerësuar konkretisht raportin e paskajores në këtë kontekst:

- a) “**në arsim**”, kujto përdorimin e paskajores me + pjesore së paku për nevoja konkretizimi për punën me nxënës e studentë;
- b) “**në kulturë**”, sill ndërmend veprat nga tradita historike qoftë popullore, qoftë artistike, qoftë dokumentare;
- c) “**në shkencë**”, rikujto rolin e saj si trajtë përfaqësuese në punime shkencore etj.;
- ç) “**në komunikim masiv**”, është fakt se shumica dërrmuese e popullsisë shqifolëse e ka të ravijëzuar në sistemin e vet ligjërimor;
- d) “**në të gjitha fushat e jetës**”, përdoret në idiolekte, variante, në të folme e nëndialekte, gjithsesi është e shtrirë në tërë jetën e përditshme shoqërore;
- dh) “**në administratë (?)**”.

Sa i përket administratës a në të ashtuquajturën “gjuhë zyrtare” sipas kuptimit të ngushtë, paskajorja me + pjesore “zyrtarisht”, sot për sot, nuk është e normëzuar, së këtejmi mund të thuhet se edhe nuk përdoret a nuk del e domosdoshme të përdoret, madje as që kërkohet prej nesh me çdo kusht të ekspozohet në “gjuhën zyrtare-administrative”, mirëpo dihet fakti se “gjuha zyrtare” a “gjuha e administratës” nuk e përfaqëson tërë gjuhën standarde të një kombi.

Pra këtu lypset sqaruar dallimi kuptimor i gjuhës letrare “zyrtare” ndaj kuptimit “gjuhë standarde kombëtare” dhe në këtë aspekt shtrohet çështja: duhet apo jo të përligjet vendi i paskajores me + pjesore në këtë kompleks gjuhësor ortologjik?

Së gjashti, me fjalën “integrim”, siç është titulluar ky krye i punimit, në gjuhësi nuk duhet kuptuar në mënyrë identike, siç përdoret ky term në

fushën e ekonomisë. Vërtet kemi të bëjmë edhe në gjuhësi me “bashkim forcash a elementesh” si bashkim forcash në ekonomi, por këtu nuk kemi të bëjmë me kurrfarë fuzionimi⁶¹ a shkrirjeje organesh e organizmash, sepse në gjuhë fjalë e ruan autonominë e vet formale kuptimore. Pra me integrimin e paskajores me + pjesore në normën e gjuhës letrare kombëtare nënkuptohet njëherazi ruajtja e autonomisë së saj kuptimore e stilistike në raport me trajtat e thera sinonimike, me të cilat mund të zhvillojë bashkëjetesë e konkurrencë dialektike, integrimi i paskajores në shqyrtim, s’ ka sesi të prishë ose t’i sjellë farë dëmi strukturës së caktuar të gjuhës letrare kombëtare, përkundrazi integrimi i tillë bazën e asaj gjuhe do ta bëjë më të fortë, më kombëtare, sepse kjo formë ka mbështetje të fortë pikërisht në vetë bazën (si në rrënjëzimin shpirtëror, ashtu në trupin me degë si dhe në lulëzim e frytë) d.m.th. në bazën aktualisht popullore dhe në bazën historike. Edhe nga ky prizëm del e arsyeshmë se vështirimi i çështjes në shqyrtim do ta ketë kujdesin më të duhur, nëse trajta e tillë do të rifutet në gjirin e normës letrare.

Së shtati, në formimin e opinionit për integrimin e paskajores së tipit me + pjesore në shqipen standarde, përkatësisht për përfshirjen e saj në normë, duhen pasur parasysh edhe arsye të tjera, siç janë edhe ato të natyrës politike, më saktë të politikës gjuhësore a të “planifikimit gjuhësor”, faktor ky për të cilin nuk kam ndërmend të flas gjatë, edhe pse dihet se pikërisht fati i çdo norme, pra edhe i vetë normës letrare (gjuhësore) varet nga situata shoqërore – politike dhe qëndrimi politik i forcave të caktuara drejtuese shoqërore e shkencore të bashkësisë së caktuar folëse. Edhe fati i paskajores në fjalë duhet shikuar nga prizmi i interesit kombëtar, së pari do të merren parasysh argumentet gjuhësore e pastaj arsyet politike afatgjata e jo ato të karakterit thjesht të politikës ditore,⁶² kur dihet fakti se mëse një e treta e bashkësisë sonë folëse e ka të ravijëzuar në sistemin e vet ligjërimor formën në fjalë. Në këto rrethana gjithnjë duhet pasur parasysh faktin se gjuha e njësuar

⁶¹ Knjigovodstveni leksikon, Beograd 1965, f. 246.

⁶² E mbështes në pika të veçanta mendimin e Lulëzim Gazhelit të shprehur në artikullin, “Demokratizimi i shkencës – detyrë e kohës” të botuar në gazetën “Rilindja demokratike” më 7.VIII. 1993, ku thuhet se “shkenca jonë e re që po rilind nuk mund t’i bjerë ndesh praktikës ...”, por edhe “...punimet serioze mund të bëhen objekt i një studimi kritik”, Tiranë, 1993, f. 2.

standarde ka për qëllim të shërbejë si “mediumi më i rëndësishëm i bashkimit të të gjithë pjesëtarëve (përfaqësuesve) të bashkësisë së caktuar folëse për dallim nga bashkësitë e tjera gjuhësore” (Bugarski)⁶³ ose ajo është elementi më i rëndësishëm “i shënjëzimit kombëtar të kolektivit që shërbehet me të” (M. Radulović).⁶⁴ Në këtë kuadër, vërtet, ka rëndësi se si do të komentohet a interpretohet rasti në shqyrtim. Gjithsesi përçafimi kundrejt përjashtimit duhet të jetë më i pranueshëm, kur kihen parasysh edhe arsytet e larta kombëtare? Po rrithekoj qëndrimin se trajta e tillë, sipas paraqitjes sonë, nuk i imponohet normës së sotme, si me thënë, për ta lënduar atë, d.m.th. me një integrim të tillë nuk rrezikohet favorizimi i trajtave të normuara, por kërkohet që edhe paskajorja të jetë formë e lirë me të drejtë konkurrimi për konceptet e caktuara në radhë të parë si trajtë sinonimike, por këtë të drejtë ajo duhet ta ushtrrojë në kuadër të normës së shqipes standarde e jo duke qëndruar jashtë saj.

Do ditur e vërteta se të mohosh sinoniminë do të thotë të pranosh varfërimin e gjuhës, prandaj rasti i paskajores gjithsesi ia vlen të vlerësohet edhe nga kjo pikëpamje?!

Së treti, po të shikohet çështja nga një aspekt më i gjerë i gjuhëve në kontakt, kultivimi i paskajores me + pjesore ose ruajtja e saj në kuadër të shqipes standarde mund të arsyetohet edhe asociacionisht. Kjo vjen si sfidë kur kemi parasysh edhe stazhin a vjetërsinë e përdorimit dhe shtrirjen horizontale që kishte dhe ka forma e tillë. Siç është cekur edhe më parë, forma e paskajores së mirëfilltë paraqitet në njëfarë mënyre një siurë ndërlihdëse në mes të gjuhëve evropiane, kryesisht perëndimore, në njërën anë dhe të shqipes në anën tjetër. Njëherazi dihet se shqipja është e pajisur edhe me format kohore të lidhore, të cilat konkurrojnë ndonjëherë për të njëjtin koncept dhe me këtë fakt ajo ndërlihdet edhe me gjuhët lindore ballkanike (postbizantine). Prandaj kjo mundësi a fortë ndërlihdëse, si veçori dalluese e gjuhës shqipe, s’ka kurrfarë arsyeshi të fortë, as psikolinguistike dhe as sociolinguistike, të ndërpritet “zyrtarisht” nga hartuesit e normës letrare, sidomos ajo kur ka të bëjë me ndërlihdje me gjuhët evropiane me ndihmën e paskajores me + pjesore.

⁶³ Ranko Bugarski, Uvod u opštu lingvistiku, Beograd 1991 f. 163.

⁶⁴ M. Radulović, Sociolingvistika, Beograd 1979 f. 92.

Fundja, e shikuar nga praktika, dukuria e tillë është fakt dhe fat i gjuhës shqipe, fat e fakt ky që shqipja e ka fituar gjatë rrjedhave të kohës, prandaj a s’është më drejtë që ky fakt pozitiv të ruhet, të kultivohet dhe assesi mos të zhduket?

Së nënti, përveç arsyeve të sipërcëkura lidhur me integrimin e paskajores me + pjesore duhet vlerësuar me objektivitet edhe faktin tjetër se forma në fjalë në ish-shqipen letrare e kishte statusin e elementit të favorizuar, përkatësisht të normëzuar. Madje, lidhur me këtë, del edhe arsyeja që ka të bëjë me përdorimin e saj për qëllime “tipizimi” në veprat letrare, qoftë për personazhe nga e kaluara, qoftë edhe për ata të ditëve tona, ngase, siç pyet me të drejtë, prof. Rexhep Ismajli: “s’di si do të dilte shqiptari, bari i Malësisë së Madhe duke folur pa paskajore në një vepër letrare që mton të bëjë tipizim”.⁶⁵ Ç’është e vërteta, po të shikohet sipas një kuptimi më të gjerë me fjalën “tipizim” mund të kuptoheshin edhe faktet e nëpërdokshme që janë vërejtur prej nesh, të cilat edhe u theksuan në mënyrë të veçantë në këtë punim, ngase me to tipizohet ambienti a natyra e shprehjes që imponohet.

Sidoqoftë, është e vërtetë se shumë “thënie” tipike shprehen me ndihmën e paskajores me + pjesore. Për këtë mjafton të sjellim ndërmend edhe shkrimet a reportazhet që po botohen në shtypin tonë të përditshëm. Te gazetarët e gjindshëm e me përvojë forma e paskajores në gojë e personazheve dhe në tipizimin e ambienteve gjithnjë e më shumë po del e shfrytëzuar si duhet, e ilustruar në raste të caktuara edhe me shprehjen e paskajores karakteristike me + pjesore. P.sh. *Me vdekë për këtë tokë e për këtë liri/ është si me le përsëri* (Xh. Ukëzmajli, Bujku, 28.VII.98, f.8). Po të zëvendësohet forma e paskajores me forma dysore, mbase nuk do të humbiste kuptimisht asgjë, por do t’i humbte domosdo shprehjes autenticiteti kosovar i autorësisë që lidhet me kohën e atmosferës së luftës çlirimtare, atmosferë luftë kjo që ose ndjehej ose parandjehej në çaste.

Së dhjeti, përveç fakteve psikolinguistike e sociolinguistike që pa a shumë u përmendën në këtë punim për trajtimin sa më komplet të çështjes në shqyrtim lypset pasur parasysh edhe faktin, të cilin T. Kelmendi e quan “dije jashtëgjuhësore”,⁶⁶ sepse edhe nga ky pikëvështrim mund të shihet

⁶⁵ R. Ismajli, Mbi normën gjuhësore të “Gjuhë dhe etni”, Prishtinë 1991, f. 319.

⁶⁶ Tafil Kelmendi, Mbi përdorimin e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe, “Çjurmime albanologjike”, s. shk. fil., 1989, Prishtinë 1990, f. 235.

edhe perspektiva e formës së caktuar. Na është i njohur fakti se “aktet e të folurit, përveçse realizohen me anë të njësive gjuhësore nivelesh të ndryshme ato realizohen edhe me mjete jo verbale” (N. Ivanetiç),⁶⁷ nuk është fjala vetëm për gesticulacion, por, si të thuash, kemi të bëjmë edhe për “gjuhën e zemrës si dhe për gjuhën e mendjes”, përkatësisht edhe problemi i paskajores me + pjesore duhet parë si akt a fenomen shoqëror-gjuhësor, por edhe si fenomen fizik e psikik, sikurse dukuritë e tjera, ngase siç shprehet Ahmet Hajdari: “të gjitha dukuritë, qoftë ato të gjuhësuar, qoftë ato të pagjuhësuar, vetëm në harmoni dhe në lidhje të ngushtë ndërmjet vete (në gjuhën globale) mundësojnë një komunikim të njëmendte”.⁶⁸

Pra edhe te çështja e paskajores në shqyrtim mund të aplikohen edhe faktorët gjuhësorë edhe ata jashtëgjuhësorë, d.m.th. edhe dija jashtëgjuhësore, por që kuptohet e manifestohet me gjuhë.

ë. Struktura e shqipes së sotme letrare sistem i hapur me obligim për të pranuar edhe paskajoren me “me”

Duke u nisur nga fakti se gjuha letrare kombëtare shqipe, e shpallur si e njëjësuar në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes (1972), pa dyshim mund të cilësohet si një “fitore e madhe historike” e popullit dhe e shkencës shqiptare dhe kjo gjuhë si një “gjuhë polifunkionale dhe me karakter dialektik”⁶⁹ arriti të plotësojë pothuajse të gjitha nevojat e shoqërisë shqiptare si në planin e brendshëm të komunikimit ashtu dhe në atë të jashtëm ndërkombëtar, atëherë nuk ka arsye për të dyshuar se kjo gjuhë do të ketë vëshirësi për të përfshirë në normën e saj edhe formën e diskutueshme të paskajores. Çështja, pra, tani shtrohet te përfshirja në kuadër të normës ose të aktivizimit “zyrtar” e jo në kuadër të sistemit, sepse forma e tillë është e koduar në sistemin global të

⁶⁷ Nada Ivanetiç, artikulli i cituar në shënimin 43. Po në atë revistë shih: Bulcz, Lüzsló, Sitnice mudroslovné”, ku shprehet se e vërteta nuk është në gjuhë, por jashtë saj, mirëpo pa atë ajo nuk ekziston. Ajo shprehet me anë të saj”, po aty f. 974 (Zagreb, 1989).

⁶⁸ Ahmet Hajdari, Gjuha dhe faktorët jashtëgjuhësorë te revista “Jehona” 6/86, Shkup 1986 f. 109.

⁶⁹ A. Kostallari, Diaspora e sotme shqiptare dhe gjuha letrare kombëtare e njëjësuar. Gjurmime filologjike, seria e shkencave filologjike 20/90, Prishtinë 1991, f. 67.

gjuhës sonë përgjithësisht shekuj e shekuj më parë, por që për arsye të caktuara nuk doli e favorizuar në normën e shqipes së sotme letrare në këta dhjetëvjetëshat e fundit. Nuk e kemi ndërmend të ridiskutojmë çështjen pse ndodhi një pasivizim i tillë, qoftë për shkaqe subjektive, subjektiviste e të tjera, por këtu kemi për qëllim të akceptojmë drejt aftësinë konsoliduese dhe të arrirë të kësaj norme për të pranuar në gjirin e vet edhe forma të reja, pa pësuar ndonjë të keqe ajo vetë për vete. Po në këtë kuadër po theksojmë faktin se gjuha letrare e një kombi si gjuhë e standardizuar me normën e vet është e detyrueshme të përfshijë jo vetëm forma të reja si sfida e kohës, por ajo në radhë të parë ka sidetrim të përfaqësues me normën e vet “të gjitha nivelet e strukturës gjuhësore në të gjitha rrafshet e funksioneve gjuhësore”,⁷⁰ përkatësisht të sigurojë dhe të mundësojë “komunikimin dhe krijimtarinë në të gjitha fushat e jetës dhe të punës (nga prodhimi deri te arti, nga jeta private e individit deri te veprimtaria e tij shoqërore publike, nga arsimimi i thjeshtë deri te shkencat, nga gazetaria deri te tregtia etj.)”,⁷¹ atëherë në gjuhën tonë letrare ose, më mirë me thënë, në normën e saj e ka a duhet ta ketë patjetër vendin e vet edhe mënyra e të shprehurit me formën e paskajores me + pjesore. Aq më tepër një detyrim i tillë del edhe nga fakti se shqipja jonë letrare është “varianti më i lartë që përfaqëson gjithë gjuhën e kombit”, është një “sistem sistemesh”, d.m.th. si sistem që përfshin në vete “të shkrirë organikisht elementet e përbashkëta të të dy dialekteve dhe elementeve të veçanta të tyre”.⁷² Prandaj s’del kurrfarë arsyeje që të ketë rezervë, aq më pak ndonjëfarë alergjie, lidhur me kërkesën për integrimin e formës në fjalë, kur na është e ditur e vërteta se edhe nga teoricienët më të merituar të gjuhës së sotme letrare shqipe të njëjësuar është thënë se kjo gjuhë pritet që pikërisht “strukturën e saj morfologjike” a “peshën e saj specifike” duhet ta shtojë dhe pasurojë “me elemente të veçanta veriore”,⁷³ madje ndër ato elemente specifike A. Kostallari cek konkretisht “shprehjet frazeologjike nga Veriu”.⁷⁴ të cilat, siç u

⁷⁰ Ranko Bugarski, Uvod u opštu lingvistiku, Beograd 1991, f. 160.

⁷¹ M. Radulović, Sociolingvistika, Beograd 1979 f. 92.

⁷² Shih. Fjalor enciklopedik shqiptar, ASHRPSSH, Tiranë 1985 dhe punimet e prof. A. Kostallari, fusnotë 69.

⁷³ Aty.

⁷⁴ Aty.

vërtetua dalin të ndërtuara zakonisht duke e pasur brendapërbrenda edhe paskajoren me + pjesore. Gjithashtu s'ka arsye t'i mbyllet dyert kësaj forme edhe në fushën e sintaksës, ngase siç e thekson me vend studiuesi M. Totoni: "struktura sintaksore e shqipes nuk duhet kuptuar si diçka e ngurtë, por si diçka që lëviz, që përsoset e pasurohet vazhdimisht. Këto lëvizje janë rezultat i zhvillimeve të brendshme, por edhe i ndikimeve të jashtme".⁷⁵ Në këtë kontekst, pra, përdorimi i paskajores me + pjesore, qoftë si lëvizje e brendshme, qoftë e ndikuar tërthorazi nga jashtë, nuk ka si ta rrezikojë strukturën morfologjike të shqipes së sotme letrare dhe as normën e saj, sidomos tani kur varianti i zgjedhur për gjuhë letrare nuk paraqitet më si një strukturë e brishtë, por si një strukturë stabile, natyrisht me karakterin fleksibil që e përshkon çdo normë letrare. Në krahasim me elemente të tjera dialektore, të cilat nuk janë marrë parasysh nga norma e shqipes letrare, paskajorja në fjalë paraqitet si një diçka më e veçantë, ngase siç e thekson qartë prof. Shaban Demiraj, "me përjashtim të formës së paskajores së tipit me punue, që nuk e kanë të folmet e dialektit jugor, nuk ka formë gramatikore që të mos jetë e njohur si në pjesën veriore ashtu edhe në pjesën jugore të truallit gjuhësor shqiptar".⁷⁶

Pra, kjo formë si e tillë, "që nuk e kanë të folmet e dialektit jugor", s'ka arsye të mos jetë e pranishme për të përfaqësuar vetveten, konceptin e vet, në kuadër të normës së përgjithshme të gjuhës sonë standarde, ngase është trajtë e njohur dhe e kuptueshme për komunikim nga të gjithë shqipfolësit pa përjashtim. Ajo nuk del vetëm si një formë e thjeshtë gramatikore, siç është cekur edhe më përpara por del si fjalë boshë e togfjalëshit (sintagmë), si njësi karakteristike e thënieve dhe e shprehjeve frazeologjike, si tregues sintaksor i të gjitha llojeve të fjalive, periudhave dhe e strukturave të sekuencave të caktuara të sistemit semantik të gjuhës shqipe si tërësi dhe për strukturën sintaksore mbi bazë të gegërishtes në veçanti etj. Prandaj jo pa arsye paskajorja me + pjesore është cilësuar si një formë që e karakterizonte shtyllën kurriore të sintaksës së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes. Si e tillë kjo formë jo vetëm detyrimisht duhet të njihet, por pa asnjë të keqe duhet të zërr vendin e merituar në kuadër të normës së sotme letrare.

⁷⁵ Është fjala për konstatimin e M. Totonit, të shprehur në artikullin "Struktura sintaksore e gjuhës letrare dhe probleme të normës", të botuar në gazetën "Bujku", 14. VII. 1993, f. 6.

⁷⁶ Sh. Demiraj, Gjuha shqipe dhe historia e saj, Prishtinë 1989, f. 230.

Nuk është i pabazë mendimi se me një integrim të tillë do të sforcuhej, si të themi, edhe vetë shtylla kurriore e sintaksës shqipe në përgjithësi dhe do të bëhej e mundshme që më mirë e më me lehtësi të përvetësohej edhe norma standarde, sidomos ajo pjesë që ka të bëjë rreth formulimit e përdorimit të fjalive dhe të njëjësive të tjera të larta sintaksore–semantike në një aspekt më të gjerë. Sistemi i gjuhës sonë standarde si dhe norma letrare në raport me paradigmat rivale të të dy dialekteve (ish–variante letrare), edhe pse i thyer, i pëzier, organikisht i tjetësuar në pika të caktuara, paraqitet mjaft stabil dhe i qëndrueshëm, prandaj integrimi i paskajores me + pjesore nuk do të paraqiste diçka të jashtëzakonshme që do të pësonte për të keq strukturën e tillë e "trumbullakësuar" paradigmore e letrarishtes së sotme. Vërtet, bregosje për një veprim të tillë nuk duhet të ketë askush. Dihet se ndërhyrjet për qëllime të përsosjes së gjuhës letrare janë dukuri normale të çdo gjuhë letrare në botë, edhe të gjuhët e zhvilluara dhe të përpunuara, përkatësisht të norma e saj, e cila poqese ngurtëzohet e mbetet e tillë është po aq e dëmshme, sikurse edhe nëse lejohet spontaniteti a ndryshimet në mënyrë stihike.

"Gjuha, – thotë A. Kostallari, – përherë ndeshet me nocione e ide të reja",⁷⁷ prandaj edhe ka nevojë për fjalë e shprehje të reja me + pjesore, më adekuate, qoftë të marra nga gjuhët e tjera, qoftë duke i krijuar vetë në mbështetje të modeleve fjalëformuese brenda sistemit a nën sistemeve të caktuara, mirëpo është gjë e njohur, gjithashtu, në gjuhësi se para se të bëhen huazime ose edhe risime, përdoruesit e gjuhës patjetër duhet ta shfrytëzojnë tërë materialin nga trashëgimia e vetë gjuhës, kështu që natyrisht në vazhdimësi krahas zhvillimit bëhet edhe përpunimi i normës së saj. Me veprime të tilla edhe komunikimi bëhet më i afërm me pranuesit e komunikimit të caktuar. Sa më e pasur të jetë një gjuhë sa i përket fondit leksikor dhe të modeleve formëzuese e fjalëformuese që e përcjellin si dhe formave të caktuara morfologjike, do të ketë më lehtë t'u përgjigjet sfidave të caktuara që i sjell koha.

Në situata ku mendohet e gjykohet me gjakftohësi del sheshazi fakti se në stilë të caktuara, format e ngjashme, ç'është e vërteta, nuk mund të jenë të ndalueshme nga askush, ngase një ndalesë të tillë nuk e lejon fare natyrisht as norma pragmatike e situatës as ajo e konversacionit, madje, me e marrë logjikisht, as norma tradicionale e gjuhës.

⁷⁷ Shih: Androkli Kostallari, vepra e cit. f. 68.

Sidoqoftë, “korrigjimi” bëhet më i lehtë kur të kuptohen drejt çështjet. Krahas kthimit në “normë” për segmente të caktuara nuk duhet të mungojnë as sqarimet nga autoritetet kompetente gjuhësore lidhur me to. Aq më tepër sqarimi del i nevojshëm të bëhet pasi që kjo çështje tashmë doli sheshazi si çështje e diskutueshme dhe se kemi të bëjmë me një dukuri kyçe të ligjëritimit. Dihet se paskajorja me + pjesore bën pjesë në kuadër të sistemit foljor dhe se folja “shpreh karakterin reprezentativ të gjuhës” (Mishel Fuko)⁷⁸ ose siç thuhet në gramatikën tonë normative: “folja e përbën bërthamën kryesore të fjalisë”,⁷⁹ ndërsa siç dihet fjalja “është baza e analizës” gjuhësore e të thenit, prandaj paskajores me + pjesore nuk mund t’i mohohet as “karakterit reprezentativ” dhe as roli si “bërthamë kryesore e fjalisë” në raste të caktuara. Gjithsesi me rastin e rivlerësimit a të (ri)integritimit të paskajores në shqyrtim në normën letrare duhen pasur parasysh faktet që u shtruan më sipër. Shfrytëzimet rasë të përmendim qëndrimin me vend të prof. S. Rizës, i cili pati thënë: “gramatikisht letrarishja e verit do të sendërgjohet, simbas mundësinave, për një pjesë tue njajtësue e për pjesën tjetër tue u gjeçjësue me letrarishten e jugut me anë të bashkëpunimit vetëm ndërmjet të të gjitha ndëngëgnishteve me kusht që kësi s’afëruei prej toskënishtes gegënishtja të m.c.s dali as e vorfnuene as e bastarduene” (Shih: S. Riza, Vepra I, Prishtinë, 1996, f. 112).

Meqenëse nga lënda e paraqitur deri këtu u provua a u bë përpjekje që sa më bindshëm të paraqitet çështja në drejtim të dëshmisë se gjuha jonë standarde kombëtare, vërtet, ka nevojë jo vetëm ta diskut jë, por edhe ta përdorë, siç është duke e përdorur për nënfusha të caktuara semantike formën në fjalë. Njëherazi këtu u argumentua me fakte që s’lë të dyshohet në aftësinë dhe detyrimin e normës së letrarishtes së sotme për ta riaktivizuar formën e tillë në gjirin e vet, prandaj tashti mbetet të trajtohet mënyra se si mund të bëhet sendërtimi a integrimi i tillë mundësisht me fërkime sa më të vogla. Mirëpo, para se të kalohet në analizën e tillë konkrete më në hollësi, po i ripërmend edhe njëherë nja tri fakte të natyrës psikologjike që janë me interes të rikujtohen:

e para, nuk është fjala për rikthimin në normë të tërë strukturës paradigmore të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, por është fjala vetëm

për formën e paskajores me “me” si element të veçantë, pasi që nuk del e zëvendësuar plotësisht me asnjë formë tjetër të vetme paralele,

e dyta, nuk kërkohet që kjo formë t’i ngarkohet si barrë toskërishtes, por pikërisht të integrohet a të përligjësohet në kuadër të gjuhës letrare kombëtare të njësuar, e cila edhe nëse cilësohet si “toskërishte e përpunuar”, gjithsesi tashti paraqet një sistem më vete më të avancuar dhe si e tillë tani ajo e përfaqëson edhe dialektin e gegërishtes dhe

e treta, integrimi i formës së tillë, nuk nënkupton detyrimin që forma e tillë patjetër të përdoret në gjuhën zyrtare-administrative, madje as nuk i obligon ta përdorim as individët e caktuar që nuk e kanë të përvijuar në sistemin e tyre ligjërimor, pos rasteve kur ata ndiejnë nevojë ta përdorin, qoftë në veprimtarinë e tyre intelektuale, qoftë për nevoja komunikative, varësisht nga situata e rrethanat e caktuara.

Prandaj, integrimi i tillë, pos ndonjë vështirësie të karakterit thjesht psiko-asociacionor të përkohshëm tek individët e caktuar, tjetër vështirësi e pengesë nuk do të ketë. Me fjalë të tjera zgjidhja e problemit në shqyrtim do të thotë njëherësh sukses i gjuhësisë sonë në përgjithësi dhe për gjuhën e njësuar letrare në veçanti.

⁷⁸ Mishel Fuko, Rijeçi i stvari, Nolit, Beograd, 1971, f. 156.

⁷⁹ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë, 1976, f. 221.

Kreu IV

RRETH INTEGRIMIT KONKRET TË PASKAJORES ME + PJSORE NË KUADËR TË STRUKTURËS MORFOSINTAKSORE TË SHQIPES STANDARDE

U tha në kreun e mëparshëm se parakushti i parë për integrimin e paskajores me + pjesore, përkatësisht për përfshirjen e saj në normën e shqipes letrare bëhet i përmbushshëm nga vetë ndërgjegjësimi që lidhet me të kuptuarit e nevojës nga kuadrot kompetentë të gjuhës sonë letrare dhe nga vetë nevoja që ndjen gjuha letrare, përkatësisht përdoruesit e saj, për një integrim të tillë, së paku për nënfusha të caktuara semantike. Ndërkaq sendërtimi praktik bëhet i mundshëm, pa dyshim, brenda strukturës morfositaksore e semantike të sistemit ekzistues të shqipes letrare kombëtare dhe se një sidetyrim të tillë e ka vetë struktura e gjuhës sonë letrare. Integrimi i formës në fjalë bëhet me qëllim, që jo vetëm të përligjësojë pranimin e një elementi të tillë në gjirin e normës letrare, por edhe për t'ia dhënë asaj kështu prestigjin institucional të normëzimit që momentalisht i mungon.

Lidhur me këtë, për hir të shlyerjes së çdo dileme a ndërdyshjeje dhe për arsye të metodës së punës, shtrohet pyetja jo a ka aftësi dhe hapësirë të mjaftueshme sistemi standard ekzistues për të pranuar e aktivizuar një formë të tillë, por si duhet bërë zbatimin i caktuar konkretisht në rrugën sa më të lehtë, që të mos e dëmtojë as më të voglin koncept rreth strukturës së sotme të normës letrare.

Sendërtimi konkret i paskajores me + pjesore në kuadër të normës së shqipes letrare kombëtare

Për sendërtimin konkret të paskajores me “me” në kodin ekzistues të gjuhës letrare kombëtare të njësuar, pasi një dukuri e tillë nga auditori tash-

më hyri në laboratorin e analizës, na merr mendja se del e nevojshme të trajtohen a të sqarohen më në hollësi këto çështje:

e para, të zbërthehet formëndërtimi dygjymtyrësh i paskajores me "me" si veçori të ashtuquajtur dialektore, duke u ndalur veçmas në pjesëzën me, si formant special trajtëformues për formën në shqyrtim dhe me shtrirjen e saj në funksione të tjera në shqipen letrare;

e dyta, të shihet vendi i paskajores me "me" në kuadër të vargut të prejpjesorëve;

e treta, të bëhet përqasja e formës së pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes si gjymtyrë e dytë e paskajores në shqyrtim, kundrejt formës së letrarishtes së sotme si formëzim "hibrid" i mundshëm i paskajores me "me", d.m.th. formëzimi mbi bazë të letrarishtes së sotme;

e katërta, të krahasohen dhe vlerësohen përparësitë rreth parapëlqimit të formës përkatëse të pjesores (gjymtyrë e dytë e paskajores), pikërisht në raportin ish-formë e shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes në njërën anë dhe të formës "hibride" të shqipes së sotme letrare, në anën tjetër;

e pesta, të jepet zgjidhja alternative e çështjes së paskajores me + pjesore me integrim, në kuadër të normës së gjuhës letrare kombëtare.

1. Formanti "me" si element formëndërtues i paskajores me + pjesore dhe shtrirja e përdorimit të tij

"Paskajorja perifrastike me "me" – thotë T. Kelmendi, nga pikëpamja morfologjike sajohet nga pjesorja e foljes me formantin me (parafjalë për nga origjina) që ka humbur veçoritë leksiko-gramatikore dhe është kthyer në një mjet për formimin e trajtës foljore të tipit me punue,¹ përkatësisht "në studimet diakronike të paskajores është pranuar me të drejtë se pjesëza me (me këputë etj.) është përfutur nga transformimi funksional i parafjalës me"³⁶.

Pra, sa i përket formëndërtimit të paskajores në shqyrtim, s'ka paqartësi. Ndërtimi i saj përbëhet prej dy gjymtyrësh: nga pjesëza "me" si gjymtyrë e parë dhe nga pjesorja përkatëse e foljes së caktuar, si gjymtyrë e dytë. Mirë-

¹ Tafil Kelmendi, Paskajorja, përdorimet e saj dhe ndërtimet me paskajore në gjuhën popullore shqipe, Seminarin ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 7/82, Prishtinë 1982 f. 63.

³⁶ B. Bokshi, vepra e cit., f. 136.

po, sa i përket kohës së formëzimit të një forme të tillë si koncept i vetëm, mendimet e studiuesve nuk përputhen. Ndërsa prof. S. Riza b.f. mendon se "krijimi i paskajores me parafjalë me që pasojë e nevojës me u diferencue infinitivi morfologjikisht prej participit"...ngase "trajten e paskajores së thjeshtë të lashtë duhet ta kërkojmë ndër trajtat e sotme të pjesores si te konkordansat: duhet shkue a duhet shkuar dhe duhet me shkue",³⁷ d.m.th. sipas tij, pjesëza me do të jetë shtesë e mëvonshme, prof. S. Mansaku mendon ndryshe, sipas tij, "pjesëza me e paskajores nuk është shtesë e mëvonshme. Ajo duhet të ketë qenë pjesë përbërëse e paskajores që në krijimin e saj, ngase... po të ishte shtuar më vonë një paskajoreje sintetike... do të pritej që paskajorja të përdorej edhe me parafjalë të tjera sipas funksionit që kryente..."³⁸. Sidoqoftë, pa hyrë në aspektin diakronik, për ne është me rëndësi fakti se edhe në aspektin sinkronik dalin paksa pika problemore, por të një natyre tjetër. Që të dyja gjymtyrët, edhe pjesëza "me", edhe pjesorja si koncept sot thuhet se i takojnë dialektit të gegërishtes dhe pikërisht për këtë shkak kjo formë doli e mënjeluar nga norma e shqipes së sotme letrare. Në të vërtetë, pa marrë parasysh faktin se forma e tillë është e pandarë për konceptin që shfaq, ndërtimisht ajo mund të trajtohet sipas pjesëve përbërëse në mbështetje të së ashtuquajturës "analizë komponentesh formëzuese". Këtë e bëjmë me qëllim për të parë raportin e saj se sa mund të jetë e pengeshme për normën letrare.

Edhe pse mund të duket e panevojshme, shrohet pyetja: Pjesëza "me" si formant formëformues a mund të cilësohet si element i pengeshëm për strukturën e sotme të shqipes letrare? Përgjigja logjike do të ishte e menjëhershme mohuese, mirëpo kur kemi parasysh botëkuptimet e njerëzve të formuara nga shkak i mospërdorimit të formës së caktuar për një kohë relativisht të gjatë si dhe për shkak të propagandimit se goja rinteprimi i formës së tillë "do të nxirte shumë punë" a do të prishte harmoninë tashmë të "çime-tuar fort" të strukturës së caktuar gjuhësore të letrarishtes së sotme, atëherë kjo çështje meriton qasje të veçantë. Mbase te individë të caktuar mund të jenë formuar iluzione se vërtet forma në fjalë, duke përfshirë edhe pjesëzën "me", i sjellin dëm të madh normës së sotme letrare, për ndryshe pjesëza "me" si formant formëformues, vërtet, s'ka sesi t'i sjellë dëm normës së shqipes letrare, kur dihet fakti se ky formant ka përdorim të gjerë në gjuhën

³⁷ S. Riza, Vepra 1, Prishtinë, 1996, f. 126.

³⁸ Sipas B. Bokshit, Vepra e cituar f. 14.

shqipe dhe si i tillë është i pranishëm në sistemin e shqipes së sotme letrare në shumë nënfusha. Siç dëshmohet edhe nga lënda e regjistruar në FJGSSH,³⁹ kjo trajtë ndeshet në funksion parafjale për pesëmbëdhjetë kuptime, ndërsa në funksion të pjesëzës del për dy kuptime. Për kuptimin e parë si pjesëzë thuhet se “përdoret me një emër foljor asnjans, për të formuar një trajtë të pashtjellë, me kuptim kohor “sapo, sa” të tipit *me të dëgjuar*”. Ndërsa për kuptimin e dytë jepet shpjegimi se “pjesëza “me” përdoret zakonisht në të folme të Veriut me pjesoren për të formuar një nga trajtat e paskajores së tipit: *me qenë*”.⁴⁰ Kur dihet fakti se po kjo trajtë e paskajores është quajtur, madje quhet edhe sot e kësaj dite *paskajore e zakonshme* ose “paskajorja e mirëfilltë e gjuhës shqipe”, është provë që dëshmon funksionin e posaçëm që ka edhe pjesëza në shqyrtim.

Më duket se e lyp puna këtu të përmendim kalimthi edhe ndonjë veçori të formantit në fjalë. Formanti *me* del si gjymtyrë e përngjitur edhe në disa funksione të tjera si p.sh.:

- në funksion të lidhëzes në lokucionet e njëfjalëzuara: megjithatë, megjithëkëtë, megjithëqë, meqenëse, meqenëqë; mesa;
- në funksion të lokucioneve ndajfoljore: menjëherë, medoemos, mezi;
- në funksion parashtesor fjalëformues: merendoj merendues, merendim, medurues, menderues, mengues,⁴¹ merandoj, merendues, merandim⁴² e ndonjë tjetër;
- në funksion përngjitime të disa fjalë që formanti “me” del i mishëruar, saqë vetëm me anë të analizës etimologjike, del qartë një kontaminim i tillë. Të kujtojmë p.sh. foljen mbri me mbrije me + mbrije me + bri (të shënuar nga prof. I. Ajeti),⁴³ mbiemri: i mermë = me erë (bar me erë, i mermë), ndajfoljen: mezi (figurativisht: me (të) zi). Mund të sjellim edhe shembujt të

³⁹ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980), f. 1103–1104.

⁴⁰ Po aty f.1104.

⁴¹ Shih: N. Veselaj, *Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesioit në gjuhën shqipe* (dissertacion i doktoratës në dorëshkrim), Prishtinë 1991, f. 224: mengues, mendores, medorës.

⁴² Fjalorthi i Gazullit, Tiranë 1941 f. 260.

⁴³ Dr. Idriz Ajeti, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes IV*, Prishtinë 1989 f. 211.

tjerë⁴⁴ si mëditje, (me + ditë), mëkëmb mëkëmbës, mëkëmbje (me këmbë), mënjanoj mënjanim (me një anë), mënjëzaj (me njësh d.m.th. me një fije), mërrudhem, mërrudh mërrudhje (me rrudha) etj. Në procesin e errësimit të E-së në –Ë në raste të caktuara nuk kontestohet as parafjala e vjetër “mbë”, e cila për nga funksioni nuk është e largët nga simotra “me”.

Lidhur me këtë s’mund të anashkalohet edhe raporti antonimik i formanteve infinitivore: *pa/me*: pa dalë/ me dalë, ngase ato kushtëzojnë dhe e ushqejnë ekzistencën e njëra tjetrës, për të cilat prof B. Bokshi shpjegon se “në sistematikën e parafjalëve, parafjalët *me dhe pa* përbëjnë çift opozitiv si në aspektin nocionor me kuptim antonimik (*me –komitativ–sociativ–instrumental*; *pa –privativ*), ashtu edhe në aspektin e synimit të drejtimit: *me –synim afrimi*, *pa –synim largimi*”.⁴⁵ Pasi që lidhur me këtë raport antonimik do të bëhet fjalë edhe pak më poshtë, këtu nuk po ndalem më shumë.

Pra, kur kemi parasysh faktet e sjella më sipër, pa hyrë në funksionin sintaksor që kryen formanti *me*, del fort i pabazë dyshimi se gjoja formanti “me” si komponentë përbërëse e paskajores bashkë me trajtën e pjesores “gege” mund t’i sjellë farë dëmi normës letrare. Sigurisht del i dëmshëm botëkuptimi nëse dikush mjerisht mund ta konsiderojë gegërishten a elementet e saj të nevojshme si diçka të huaj e jo si një komponentë organike e gjuhës shqipe dhe të sistemit të saj?!

Një gjykim dyshues i tillë del aq më tepër i paqëndrueshëm, kur dihet se përveç rastit që përmendëm më sipër, në shqipe formëzohen edhe shumë forma të tjera sipas mënyrës së paravendosjes së formanteve të tjera formëzuese, siç janë edhe format e tjera të pashtjelluara analitike si p.sh.: *pa + pjesore*, *duke + pjesore*, për të + pjesore, *me të + pjesore*, *një të + pjesore*.⁴⁶ Madje formime të ngjashme, për nga forma e jashtme, janë edhe emrat e nyjshëm nocionesh abstrakte, siç janë emrat e gjinisë femërore të tipit: e ardhmja, e pamja; të gjinisë asnjansë të tipit: të errët, të menduarit etj. si dhe emrat pluralia tantum të tipit: të hollat.⁴⁷

⁴⁴ Shembujt janë marrë nga fjalori i gjuhës së sotme shqipe, f. 1116 dhe 1122.

⁴⁵ B. Bokshi, *Vepra e cit*, f. 137.

⁴⁶ Formulimi për të + pjesore etj. është marrë konvencionalisht. Ka mbështetje në konstatimin e prof. Sh. Demirajt, i cili thotë “në studime historike...” forma e tillë është interpretuar herë si pjesore, herë si pjesore e emëruar” (Shih: *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1988, f. 955).

⁴⁷ Fonetika e gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976, f. 114.

Sipas shpjegimit të prof. B. Bokshit “duhet menduar se infinitivi u krijua në rrethana që i imponuan parafrjalës me në realizimin e një kuptimi tjetër, brenda kuptimeve të saj... ky kuptim del të ketë qenë fillimisht kuptim instrumental, si kuptim zanafilës i sintagmës prepozicionale me + pjesore për të kaluar drejtpërdrejt në infinitiv”⁴⁸. Së këtejmi po sipas shpjegimit të prof. Bokshit u kalua në funksion të fjalive kushtore, shkakore, lejore, qëllimore, rrjedhimore etj. duke shërbyer një formë e tillë edhe në funksion të kryefjalës, kundrinës etj., me një fjalë, kjo formë duke u përdorur në funksione të tilla, depërtoi, si të themi, në palcën e sintaksës së protogjuhës shqipe, para se të paraqitej dukuria e rotacizmit si formë dalluese ndër-dialektore.

Kur kemi parasysh argumentet e tilla, nënkuptohet vetvetiu, se pjesëza “me” si formant formëndërtues, qoftë si parafrjalë, qoftë si pjesëz, assesi nuk paraqet as që mund të paraqesë pengesë për integrimin e formave të caktuara, siç është edhe paskajorja, në normën e shqipes letrare kombëtare, megjithatë më parë mund të thuhet se si rezultat i veprimeve propaganduese kundër tërë formës së paskajores në fjalë, në disa pjesë të opinionit gjuhësor është krijuar njëfarë hutie dhe paqartësie më tepër e natyrës psiko-asociacionore rreth kësaj çështjeje, edhe pse një hutim të tillë nuk duhet ta ketë askush, as tërësishtfolësit, as adhuruesit e apasionuar të normës së letrarishtes së sotme. Siç dihet, rregullat drejtshkrimore e të tjera (gamatikore e semantike) të normëzuara edhe pse dikush i quan Bibël a Kuran, nuk duhet të konsiderohen si “fjalët e Zotit” për besimtarët, ngase ato rregulla edhe mund të modifikohen, kurse “Fjalët e Zotit” në librat e shenjtë s’kanë se si të ndryshojnë ngase ashtu qëndrojnë në origjinal, por harrohet fakti tjetër se edhe lidhur me to mund të ndryshojë interpretimi. Në të vërtetë, interpretimi i tyre bëhet varësisht nga aftësia a zhvillimi i njeriut dhe i gjuhës së interpretuesit, ndërsa norma, siç e thotë një studiues “sipas natyrës së saj është konservative, që do të thotë se ka tendencë të pengojë a të ngadalësojë zhvillimin spontan të gjuhës, por ajo në këtë punë asnjëherë deri në fund nuk mund të dalë e suksesshme”. Mos të harrohet fakti se norma gjuhësore ka edhe një detyrë tjetër, që paksa bie nënesh me konservimin e rregullave e ajo është “të parashikojë dhe të orientojë evolucionin gjuhësor, në mënyrë që ky mjet i fuqishëm komunikativ (gjuha e standardizuar) sa më me efikasitet të mundet me përcjellë zhvillimin e përgjithshëm shoqëror”, të përcjellë kështu edhe zhvillimin e

⁴⁸ B. Bokshi, *Vepra e cit.*, f. 153.

vet, d.m.th. nevojat për ndryshime e përsosje, duke shfrytëzuar në radhë të parë, rezervat e brendshme të veta. Gjithsesi gjuha letrare ka për detyrë që të veprojë si element bashkues kombëtar për tërë bashkësinë e caktuar folëse që e përfaqëson. Pikërisht në këto korniza duhet parë edhe forma e paskajores në shqyrtim, me të cilën karakterizohet pjesa më e madhe bashkësisë sonë folëse.

Përveç pjesëzës “me” e cila nuk del e pengesshme, pra, në asnjë mënyrë, duhet parë edhe specifikën e formës së pjesores, e cila, siç u tha, në formëzimin e paskajores del si gjymtyrë e dytë. Dihet se këto të dyja formojnë **paskajoren e mirëfilltë të shqipes**, përdorimi i së cilës është parë i pafavorizuar nga hartuesit e normës së *gjuhës së sotme letrare shqipe*.

2. Vendi i paskajores me + pjesore në kuadër të vargut të prejpsjorëve

Për të qenë më i kapshëm thelbi i çështjes lidhur me formën e pjesores si gjymtyrë e dytë e paskajores në shqyrtim në vazhdim do të paraqitet paskajora e vargut të prejpsjorëve, d.m.th. të rrjedhojave të pjesores sipas këtyre rubrikave:

1. E tashmja e dëftores, si formë përfaqësuese e foljes, përkatësisht paskajorja me + pjesore “hibride” e letrarishtes së sotme, si një formë e mundshme konkurruese.
2. Pjesorja e letrarishtes së sotme si një trajtë bazë.
3. Emri prejpsjor i veprimit.
4. Emri prejpsjor i vepruesit.
5. Mbiemri prejpsjor i nyjshëm.
6. Emri prejpsjor nocionesh abstrakte.
7. Trajta e paskajores konkurruese e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes dhe
8. Raporti i përparësisë⁴⁹ së temave prodhuese mbi bazën e pjesores sipas versionit përkatës: shqipja e sotme letrare / ish-shqipja letrare (gegërishtja).

⁴⁹ Me raportin e “përparësisë” kuptohet prirja e formimit të prejpsjorëve mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme kundrejt pjesores mbi bazë të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes.

Për arsye thjesht praktike e jo pse disa gjuhëtarë nuk i konsiderojnë si emra prejpjesorë, por si emra të nyjshëm abstraktë, në pasqyrën e mëposhtme nuk janë shënuar format e tjera të pashtjelluara analitike: pa + pjesore; duke + pjesore; për të + pjesore; me të + pjesore; një të + pjesore, mirëpo edhe këto do të përmenden gjatë analizës kur e lyp puna.

PASQYRA E VARGUT TË PREJPJESORËVE

| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
|--|---|---|---|---|---|---|---|---|
|--|---|---|---|---|---|---|---|---|

1) Pjesorja me prapashtesën -Ë:

| | | | | | | | | |
|--|----------------|------|------|-------|--------|----------|----------|-----|
| | dal | dalë | daje | dalës | i dalë | të dalët | me dalë | 0:0 |
| | <u>me dalë</u> | | | | | e dala | të dalat | |

2) Pjesorja me prapashtesën -NË:

| | | | | | | | | |
|----|-----------------|-------|--------|--------|---------|-----------|----------|-----|
| a) | jap | dhënë | dhënie | dhënës | i dhënë | të dhënit | me dhënë | 0:0 |
| | <u>me dhënë</u> | | | | | të dhënat | | |
| b) | zë | zënë | zënie | zënës | i zënë | të zënë | me zënë | 0:0 |
| | <u>me zënë</u> | | | | | | | |

3) Pjesorja me prapashtesën -UR:

| | | | | | | | | |
|----|-------------------|---------|---------|---------|-----------|---------------|-----------|-----|
| a) | mat | matur | matje | matës | i matur | të maturit | me matë | 3:2 |
| | <u>me matur</u> | | | | | të maturat | | |
| b) | djeg | djegur | djegje | djegës | i djegur | të djegurit | me djegë | " |
| | <u>me djegur</u> | | | | | e djegura | | |
| c) | mbaj | mbajtur | mbajtje | mbajtës | i mbajtur | të mbajturit | me mbajtë | 2:3 |
| | <u>me mbajtur</u> | | | | | i mbajturshëm | | |

4) Pjesorja me prapashtesën -R(Ë):
- me prapashtesën -rë

| | | | | | | | | |
|----|----------------|------|-------|-------|--------|----------|---------|-----|
| a) | lar | larë | larje | larës | i larë | të larat | me larë | 4:0 |
| | <u>me larë</u> | | | | | të larit | | |

| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
|----|------------------|--------|---------|---------|----------|-------------------|---------|-----|
| b) | blej | blerë | blerje | blerës | i blerë | të blerat | me ble | " |
| | <u>me blerë</u> | | | | | të blerët | | |
| c) | fshij | fshirë | fshirje | fshirës | i fshirë | të fshirët | me fshi | " |
| | <u>me fshirë</u> | | | | | të fshirat | | |
| ç) | bëj | bërë | bërje | bërës | i bërë | të bërët | me bë | " |
| | <u>me bërë</u> | | | | | i bëshëm të bërat | | 4:1 |
| d) | fryj | fryrë | fryrje | fryrës | i fryrë | të fryrët | me fry | 4:0 |
| | <u>me fryrë</u> | | | | | e fryra | | |

-me prapashtesën -r:

| | | | | | | | | |
|----|-------------------|---------|-----------|---------|-----------|--------------|---------------|-----|
| a) | shuaj | shuar | shuarje | shuarës | i shuar | të shuarit | me | 4:0 |
| | <u>me shuar</u> | | | | | e shuara | <u>shue</u> | |
| b) | thyej | thyer | thyerje | thyerës | i thyer | të thyerit | me | 4:1 |
| | <u>me thyer</u> | | | | | i thyeshtëm | <u>thye</u> | |
| c) | pëlqej | pëlqyer | pëlqyerje | | i pëlqyer | të pëlqyerit | me | 4:2 |
| | <u>me pëlqyer</u> | | | | | i pëlqyeshëm | <u>pëlqye</u> | |
| ç) | shkruaj | shkruar | shkrim | shkrues | i shkruar | të shkruarit | me | 3:2 |
| | <u>me shkruar</u> | | | | | e shkruara | <u>shkrue</u> | |
| d) | punoj | punuar | punim | punues | i punuar | të punuarit | me | 2:3 |
| | <u>me punuar</u> | | | | | i punueshtëm | <u>punue</u> | |

Si dihet dhe siç mund të shihet nga pasqyra e mësipërme, në shqipen e some letrare trajtat e pjesores ndërtohen me këto katër prapashtesa temëformuese: -Ë, -NË, -UR dhe -R(Ë).⁵⁰

Lidhur me temën që po trajtohet këtu vlen të theksohet se te tipi i foljeve me temë më -Ë dhe ato me temë më -NË nuk ndryshon trajta e pjesores së shqipes letrare (si gjymtyrë e dytë e paskajores me "me" për nga ndërtimi, kundrejt trajtës së pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes), prandaj forma e tillë e pjesores, si pjesë përbërëse e paskajores në shqyrtim, faktikisht nuk paraqet kurrfarë pengese formale e drejtshkrimore

⁵⁰ Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976 f. 149.

Sa u përket rasteve si *me zanë, me dhanë, me bā* etj., që ishin karakteristike për ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes, e quaj rast të zgjidhur sipas "Drejtskkrimit të gjuhës shqipe" me rregullën, ku thuhet se "shkruhen me -Ë të gjitha fjalët të të cilat kjo zanore e theksuar i përgjigjet historikisht një A-je të ndjekur nga një bashkëtingëllore hundore",⁵¹ prandaj, për këtë arsye në këtë punim të gjithë shembujt janë shënuar sipas trajtës së parapëlqyer: *me zënë, me dhënë, me bë* (bërë), edhe pse në dialekt mund të ndeshen me A-në nazale.

Hiq vërejtjet e mësipërme, mund të thuhet se format e foljeve më -Ë dhe ato më -NË mund të përdoren pa diskutim, siç u tha më sipër, nëse mbizotëron gjykimi i autorit se një trajtë e tillë del e nevojshme për të shprehur koncepte të caktuara. Ndërsa për format me prapashtesën temëformuese -UR dhe ato më -R(Ë) dalin çështje të diskutueshme, sepse atyre u ndryshon prapashtesa temëformuese në krahasim me format e pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes.

Po shtoj se format e padiskutueshme: më -Ë dhe -NË kapin 3 tipa foljesh, ndërsa ato të diskutueshmet: më -UR dhe -R(Ë) kapin 13 tipa. Por kur kemi parasysh faktin se disa tipa të foljeve me pjesore të diskutueshme, siç janë foljet më -OJ dhe ato me temë në bashkëtingëllore, paraqesin numër të pakufizuar foljesh, atëherë vetëkuptohet ndërlikueshmëria që del lidhur me këtë.

3. Përqasja, dallimi, prirjet fjalëformuese të formave konkurruese të pjesoreve më -UR : -Ë dhe -R(Ë) : -O (zero)

Nga përqasja që mund t'i bëhet formës së pjesores, duke u mbështetur në pasqyrën e sipërhënuar, del se prapashtesa temëformuese -UR e letrarishtes së sotme (që del fituese ndaj formantit -UN/ËN të gegërishtes: *matu/matun matën*) ballafaqohet me kundërvënien me prapashtesën rivale temëformuese -Ë, karakteristike kjo e pjesoreve përkatëse të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, ndërsa prapashtesa -R(Ë) e letrarishtes së sotme ballafaqohet po ashtu me kundërvënien me trajtën e shkurtër të pjesoreve të ish-gegërishtes letrare. Kjo konkurrencë do të vihet re e do të krahasohet me zgjidhjet e caktuara formëzuese e fjalëformuese që janë zbatuar te she-

⁵¹ Drejtskkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë 1974 f. 40.

mbujt konkretë të preppjesorëve të tjerë, me qëllim që të vihet në pah prirja e mundshme edhe të zgjidhjes së problemit të hapur që po trajtohet këtu dhe ka të bëjë me parapëlqimin e trajtës tjetër konkurruese.

a) Kundërvënia -UR : -Ë dhe raporti mbështetës i preppjesorëve

Pjesorja e tipit me "mbaresë-prapashtesën -UR të toskërishtes", siç e quan prof. S. Riza, që përfshin foljet me temë në bashkëtingëllore dhe disa me temë në zanore, të cilat e zgjerojnë temën te forma e pjesores dhe tek e kryera e thjeshtë e dëftores me elementin -t- a -jt-, si temë fjalëformuese shërben për formimin e mbiemrave dhe të emrave preppjesorë të nyjshëm, ndërsa trajta e pjesores së ish gegërishtes letrare me prapashtesën temëformuese "inovuese" -Ë⁵² shërben si temë prodhuese për formimin e mbiemrit të nyjshëm me prapashtesën -SHËM, të emrit të veprimit dhe të emrit të vepruesit. Pra, raporti në ndonjë rast del 2 me 3 në favor të trajtës së pjesores temëprodhuese të ish-gegërishtes letrare. Meqenëse prapashtesa -UN e gegërishtes del e humbur në konkurrencë kundrejt dysorit -UR të toskërishtes, mbeten në opionencë si trajta paralele versionet e tipit: *me matë / me matur, me djegë / me djegur, me mbajtë / me mbajtur*.

Po theksojmë se formimet mbi bazën e pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes paraqesin model fort të qëndrueshëm fjalëformues.

b) Kundërvënia -R(Ë) : 0 (ZERO) dhe raporti mbështetës i preppjesorëve

Siç po shihet nga vargu i preppjesorëve foljet me prapashtesën temëformuese -R(Ë) ndahen në dy grupe: ato me prapashtesën -rë dhe ato me prapashtesën -0 (zero), përkatësisht me trajtën e shkurtër të pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes.

1) Pjesorja me prapashtesën -rë, shërben si temë prodhuese për të gjithë preppjesorët e vargut të shënuar. Raporti pra është 4 : 0 në favor të saj kundrejt formës së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, mirëpo ka

⁵² S. Riza, *Vepra 2*, Prishtinë 1987, f. 287.

raste, siç është edhe shembulli “i bëshëm” që edhe mbi bazën e pjesores së ish – shqipes letrare të formohet ndonjë tip i prejpjesorit, siç është mbiemri i nyjshëm me –SHËM. Përveç kësaj ndeshim raste që mbi këtë temë të jetë formuar edhe ndonjë emër vepruesi si p.sh.: las, bles, fshis, bës (bâs, bamës), mirëpo trajtat e tilla mbesin ose të shtresës tashmë të pasivizuar ose atyre u mbetet të konkurrojnë si raste të vetmuara në sistemin e përgjithshëm, pasi u mungon modeli normëzues i favorizuar.

Sa u përket trajtave të paskajoreve në shqyrtim mbetet të konkurrojnë format si: *me la / me larë, me ble(më) / me blerë, me fshi / me fshirë, me bë / me bërë*. Është fakt, siç mund të shihet edhe nga ndonjë shembull yni që u dha sa për ilustrim, se vërehet njëfarë prirje që edhe paskajorja me “me” të dalë me trajtën e plotë të pjesores së letrarishes së sotme të tipit: me blerë, me bërë etj., si në gjuhën e folur, po ashtu edhe në atë të shkruar.

2) Te foljet me prapashtesën –r në pjesore dalin çështje paksa më të ndërlikuara.

Për tipin e foljeve shuaj shuar dhe thyej thyer vlen sqarimi që u tha për foljet më –rë, pasi edhe te këto raporti del 4 : 0 (zero). Po kjo vlen edhe për rastet e formuara mbi pjesoren e ish–gegërishtes letrare si p.sh. shues, thyes etj. paralel me trajtat mbi bazën e pjesores së letrarishes së sotme: shuarës, thyerës etj., sepse, siç u tha më sipër, trajtave të tilla do t’u nevojitej të luftojnë për ekzistencë si raste të vetmuara, jashtë modelit të favorizuar. Sa i përket rivalitetit të trajtave të paskajores mbeten të konkurrojnë trajtat: me shue/me shuar, me thye/me thyer.

Te foljet e tipave pëlqej pëlqyer, shkruaj shkruar dhe punoj punuar raporti del 2 : 3 (dy me tre) në favor të trajtës geqe, edhe pse dihet se emri i veprimt që del me prapashtesën –IM ka mbështetje mbi bazë të pjesores së vjetër, përkatësisht mbi rrënjën (temën) që përputhet me të tashmen e dëftores: pëlqej < pëlqim (pëlqej/fim, shkruaj < shkrim shkruaj/fim), punuar < punim (pun/oj/fim). Emri i vepruesit si dhe mbiemri i nyjshëm me prapashtesën –SHËM formohen mbi bazë të pjesores së ish–gegërishtes letrare, ndërsa mbiemri i nyjshëm dhe emri i nyjshëm formohen mbi bazë të pjesores së shqipes së sotme letrare. Te paskajorja në shqyrtim mbeten të konkurrojnë trajtat: *me pëlqye / me pëlqyer, me shkruje / me shkruar, me punue / me punuar*.

Te tipi pëlqej pëlqyer/pëlqye si dallim del elementi –r si prapashtesë, e cila historikisht i përgjigjet një M–je të gegërishtes: pëlqye/m / pëlqyer, për-

katësisht një –N– je: pëlqyen. Sidoqoftë, ky dallim është më i vogël në krahasim me trajtat e tipit: shkruaj (me) shkruje / (me) shkruar dhe atij punoj (me) punue / (me) punuar, ku përveç dukurisë së rotacimit që del e shprehur te trajtat e letrarishes së sotme, del edhe dukuria e dallimit të dyzanorshit –UA– në toskërishte ndaj atij –UE– në gegërishte.

Pasi numri më i madh i foljeve të gjuhës shqipe i takon grupit të foljeve më –O/J të tipit: punoj punuar/punue, atëherë problemi i njësimt të formës së pjesores të tipi i paskajores në shqyrtim mbase është dukur i pazgjidhshëm. Vërtet, një dukuri e tillë paraqet vështirësi, prandaj edhe ky fakt mund të ketë ndikuar paksa në gjykimin që si punë më e lehtë është dukur të bëhet mënjanimi i trajtës së paskajores me “me” sesa të integrohej forma e tillë e papërfutshme, madje ky paragjykim do të ketë pasur pasojë për mos përfshirje në normë edhe për ata tipa të foljeve më –Ë e –NË, ku dallimi i tillë nuk del i theksuar. Siç dihet, dhe siç mund të vërehet, edhe nga pasqyra e vargut të prejpjesorëve në fjalëformim përdoren të dyja format (versionet) e pjesores: ato me dyzanorshen –UE dhe ato më –UA/R. Krahaso: punuar < i punuar, të punuarit – në njëhën anë dhe punue < punues, i punueshëm, punim – në anën tjetër. Gjithsesi për rastin në shqyrtim mbetet çështje e hapur: cila nga format e pjesores duhet parapëlqyer? Raporti, pra, del 3 : 2 në favor të trajtës së gegërishtes, mirëpo është interesant të përmendet edhe një dukuri tjetër se krahas rregullës a modelit tashmë të rrënjësor që emrat e veprimt për këtë tip foljesh të dalin me prapashtesën –IM si: punim, shkrim etj., ka raste që të dalë edhe një trajtë paralele mbi bazën e pjesores së letrarishes së sotme, si p.sh.: punuarje, shkruarje etj.⁵³ – natyrisht me njëfarë kuptimi sadopak të diferencuar ndaj trajtave më –IM a –ESË. Dukuria e tillë nuk është e pavërejtshme, por nuk del e përgjithshme.

Lidhur me daljen e emrit më –IM, për të gjitha rastet studiuësit kanë konstatuar se trajta e tillë del drejtpërdrejt nga pjesorja e vjetër më O (–*ON), p.sh.: *puno+IM punim, d.m.th., me zhdukjen e –O–së fundore të temës, e cila ende nuk ishte dftonguar, madje edhe trajtat e ashtuquajtura të shkurtra të pjesores të gegërishtes ishin njëkohësisht trajta të mirëfillta participore burimore në të dy dialektet, ndërsa trajtat më –NË a –MË, përkatësisht

⁵³ Në shtypin tonë dhe në burime të tjera hetohet dukuria e formimit të emrave prejpjesorë paralel me –JE, përkrash atyre me –IM dhe –ESË, por gjithsesi me nuancim a me mundësi nuancimi të ri kuptimor, si p. sh. shkrim = vepër e shkruar, shkresë + dokument i shkruar, shkruarje = procesi i të shkruarit, po këstu: dërgim, dërgesë dërguarje, e këstu me radhë.

-R(Ë) janë dytësore mbiemërore të përfuara pasi u krye diftongimi i fundores -O, sipas rrugës: O OU UO UE/UA. Krahaso: punO- punou (punounë / punourë) tash punue(m) ose punue(t) / punuar; la (la/në / larë) tash: la(më) / larë; pre (prenë/prerë) tash: pre(më) / prerë; thye (thyenë / thyerë) tash: thye(më) / thyerë.⁵⁴ Siç mund të shihet vetën prapashtesa shtuese mbiemërore e tokërishtes -R(Ë) mbeti e qëndrueshme, ndërsa ato të gegërishtes: -N(Ë) e -T(Ë) dalin pothuajse të zhdukshme në shqipen e sotme letrare, ndërsa ajo -M, ende mund të hetohet në formimin e mbiemrave të tipit të veçantë që në gjuhën e sotme nuk paraqet model aq prodhimtar. Formanti -M, reflektohet në ndonjë rast edhe në formimin e ndonjë foljeje më -O (-MOJ), si p.sh. erëmoj, ngulmoj etj.

Gjithsesi mbeten të konkurrojnë trajtat e paskajores: *me punue / me punuar, me shkruie / me shkruar* etj.

Për të parapëlqyer njëren ose tjetrën trajtë, për të gjitha rastet e diskutueshme duhen shikuar përparësitë që dalin, qoftë nga njëri, qoftë nga tjetri version i pjesores, përkatësisht i paskajores me + pjesore, siç do të paraqiten më poshtë.

4. Përparësitë rreth parapëlqimit të formës përkatëse e pjesores

Trajtat e pjesoreve me prapashtesën temëformuese më -Ë dhe ato më -NË, siç u tha më sipër, nuk dalin të diskutueshme, ndërsa te trajtat e foljeve që dalin me prapashtesën temëformuese -UR dhe atë -R(Ë) mbeten çështje të diskutueshme.

Diskutimi mund të bëhet lidhur me përparësitë që mund të paraqesë si njëra ashtu edhe trajta tjetër. Meqenëse prioriteti i fjalëformuese që u cekën më sipër për secilin tip a nëntip nuk mund të merreshin si kriteri i mjaftueshëm marrë globalisht, atëherë mbetet të zbatohet kriteri i përparësisë më hollesisht. Këtu dalin si rrugëzgjidhe dy alternativa: a) të parapëlqehet forma e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes ose b) të parapëlqehet forma e konkurrenente "hibride" mbi bazë të pjesores së shqipes së sotme letrare.

⁵⁴ Shih. B. Bokshi, *Vepra e cituar*, f. 61.

a) Përparësitë e alternativës së parë

Sipas alternativës së parë, d.m.th. për parapëlqimin e trajtës së pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, dalin këto fakte:

1. Trajta konkurruese e paskajores me + pjesore mbi bazë të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, ka traditë përdorimi. Me të edhe sot e kësaj dite shprehet autenticiteti burimor i realies, madje trajta e tillë përligjet edhe nga pikëpamja e studimeve historike si trajtë e mirëfilltë pa formante shtuese (me origjinë mbiemërore). Përputhet aktualisht me gjuhën e folur të pjesës më të madhe të bashkësisë shqipfolëse, sipas disa të dhënave më se dy të tretat e popullsisë shqipfolëse e kanë të ravyëzuar në sistemin ligjëror të tyre formën a mënyrën në fjalë, përkatësisht ajo përdoret edhe nga vazhduesit e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes. Gjithashtu ka fakte se edhe në disa të folme toske ka gjurma përdorimi po në këtë trajtë.

2. Trajta e tillë ndeshet në veprat e njohura të shkrimit shqip, qoftë nga tradita gojore, qoftë nga ajo e të shkruarit shqip. Në veprat nga thesari popullor, siç dihet, kjo formë ka përdorim të theksuar sidomos në fjalë të urta e në shprehjet frazeologjike me përmbajtje të thellë shpirtërore e mendësore të një abstraksioni të lartë. Po ashtu këtë trajtë e ndeshim edhe në veprat e kolosëve të kulturës e të letërsisë sonë, siç janë shkrimtarët e vjetër të epokës para Rilindjes, të asaj të Rilindjes e të Pavarësisë, por edhe të kohës sonë. Përligjësimi i trajtës së tillë në shqipen letrare sot do të ndihmonte jo vetëm një komunikim më të lehtë me veprat e tilla, por do të shërbente njëherazi në rrafshin sinkronik edhe për zgjerimin, sforcimin dhe përsosjen e bazës gjithëkombëtare të gjuhës standarde të njësuar, duke respektuar kështu vazhdimësinë e pashkëputur të traditës së shkrimit letrar të shqipes. Trajta e tillë, d.m.th. forma e paskajores me + pjesore si formë përfaqësuese ka traditë përdorimi edhe në fushën e studimeve gjuhësore albanologjike,⁵⁵ traditë kjo që vazhdon pandërprerë. Për këtë mjafton të cek vetëm ndonjë

⁵⁵ T. Kelmendi në punimin e tij "Mënyra, aspekti gramatikor dhe perifrizat foljore aspektore", të botuar në gazetën "Fjala", më 15. IX. 1987, f. 13, e shënon si trajtë përfaqësuese të foljes edhe të tashmen njëjës të dëftores edhe paskajoren me "me", të shembulli: vdes / me vdekë.

shembull nga veprat e gjuhëtarëve tanë, si: E. Çabej,⁵⁶ shq. me dashhtë pll, ljubiti; got. Itan, gjerm. essen gr. phagen, shq. me hangër; lat. computare, shq. me llogaritë, me numrue; gjerm. vahren shq. me ruejtë etj.; A. Xhuvani,⁵⁷ rum. a veni shq. me ardhë; rum. a strica shq. me prishë; rum. a calca shq. me shkelë; I. Ajeti,⁵⁸ gjerm. rinnen rennen shq. me rrjedhë; serb. roniti izroniti shq. me fundosë; me tretë, me u zhdukë (...) me qenë, me pasë me punua etj.; R. Ismajli,⁵⁹ me marrë gjerm. pasken, me ngritë gr. apogo; I Kryeziu,⁶⁰ gjerm. zu sprechen – me folë (= për të folur); R. Doçi,⁶¹ me hipë, me kalëruë. Te vepra *Qytetërimet antike mesdhetare* të studiueses N. Vlora – Fallaski ndeshim paskajoret: me ruejtë, me pre, me thënë etj.

Heqje dorë nga një traditë e tillë mbase nuk do të dukej si hap i urtë, kur dihet fakti se vetëm paskajorja e gjuhës shqipe e tipit me + pjesore ka arritur në rrjedha të moteve të ketë barasvlerësi të plotë me + infinitivin përkatës të gjuhëve indoevropiane e të tjera. Prandaj forma e paskajores në fjalë, si trajtë normative e ish – shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes përse mos të ruhet e tillë vetëm për të paraqitur formën e paskajores me “me”, përkatësisht të ruhet në këtë përbërje forma e pjesores së ish–gegërishtes letrare, duke u dalluar kështu nga pjesorja e letrarishtes së sotme, pasi një dallim i tillë po imponohet nga vetë rrethanat e caktuara. Fundja edhe tokërishtja e lashtë në kuadër të protoshqipes e kishte këtë formë.

Duke i pasur për bazë faktet e sipërcekura, pra, *pjesorja e ish–shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes duhet favorizuar për t’u normëzuar në shqipen letrare të njësuar si e tillë, ndërsa forma e pjesores së shqipes së sotme të përdoret për funksione të tjera, të cilat në të vërtetë edhe është duke i kryer.*

Me pak fjalë, pjesorja mbi bazë të gegërishtes, përveç funksioneve të tjera që kryen, siç e pamë në fushën e fjalëformimit, ajo do të shërbejë edhe për formën e paskajores së mirëfilltë të shqipes, e cila ekziston në sistemin e

⁵⁶ E. Çabej, Studime gjuhësore IV, f. 283; VII, f. 88, 115, 119 etj.

⁵⁷ A. Xhuvani, Vepra II, Tiranë 1989 f.409 – 411.

⁵⁸ Dr. I Ajeti, Studime gjuhësore në fushë të shqipes IV, Prishtinë 1989, f. 114; II, f. 145, 147.

⁵⁹ R. Ismajli te Fjalori enciklopedik i shkencave të ligjëritim, Prishtinë 1989 f. 281.

⁶⁰ I. Kryeziu, Kultura gjuhësore dhe përkthimi nga gjuha gjermane te “Probleme aktuale të kulturës së gjuhë shqipe”, Prishtinë 1983 f. 340.

⁶¹ R. Doçi, Mendime dhe veprime egoiste të një gjuhëtarë shqiptar te revista “Fjalorjone” nëntor 1994 f. 27.

përgjithshëm të shqipes standarde, por që duhet të përligjësohet me anë të normëzimit letrar. Kjo zgjidhje del e mundshme praktikisht, prandaj edhe arsyetohet fare lehtë edhe teorikisht.

4. Në mbështetje të asaj që u aludua në pikën e mëparshme qëndron fakti se në njëfarëdore trajta e pjesores së ish–shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes mund të quhet tashmë e integruar në normën e shqipes së sotme letrare, si në fushën e formëzimit ashtu edhe në fushën e fjalëformimit.

Së pari, të sjellim ndërmend format sintetike të habitores si p.sh.: lakam (jo: larëkam), lakështa (jo: larëkështa), lyekam (jo: lyerkam), dredhkam (jo: dredhurkam),²⁹ punuekam, shkruëkam etj. madje edhe mbetkam, shkrepkam, puthkam etj., d.m.th. të foljeve me prapashtesën –UR (–UN), formant ky që del i zhdukshëm në formimet e tilla.

Së dyti, po përmendim me këtë rast edhe parafjalën “falë” (formë pjesore që është normëzuar e ngurtësuar në trajtën e gegërishtes, siç është shembulli: Falë punës së tij...) ³⁰ etj.

Së treti, edhe më tepër se te rastet e mësipërme del e përdorur trajta e pjesores së ish–shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes në fushën e fjalëformimit, kështu që pa alternativë ajo përdoret si temë prodhuese (fjalëformuese) për formimin e emrave të vepruesit, të emrave të veprimtari si dhe të mbiemrave të nyjshëm me prapashtesën –SHËM te tipi më prodhimtar i foljeve, si p. sh.: (mat) matë matje matës, i matshëm; (punoj) punue punues, i punueshëm, punim, punesë etj. Përdoret edhe në disa togfjalësia frazeologjike të lirë e të qëndrueshëm (edhe në formën e njëfjalëzuar) në funksion të lidhëzes a të ndajfoljes, siç janë shembujt: domethënë, megenëse, me thënë të drejtën, me folë shtuar etj. Prandaj, supozimi i marrë me paragjykim se gjoja sistemi i gjuhës së sotme letrare nuk e qaska në strukturën e vet pjesoren e trajtës së ish–shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, vërtet nuk qëndron. Kjo formë, siç u provua më sipër, veçse është e pranishme në strukturën e gjuhës së sotme letrare shqipe të njësuar dhe se një fakt i tillë s’mund të mohohet. Fundi i fundit, kur dihet e dhëna se paskajorja me + pjesore bën pjesë në sistemin e përgjithshëm standard të gjuhës shqipe dhe se gjuha le-

²⁹ Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1984, f. 1507.

³⁰ Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1980, f. 447.

trare patjetër është a duhet të jetë një "sintezë organike"³¹ e elementeve të të dy dialekteve, ose më mirë, siç thuhet në "Fjalorin enciklopedik shqiptar": "kjo gjuhë (d.m.th. gjuha letrare kombëtare) ka një sistem të vetin mbidialektor (...) është ndërtuar si një koine sui generis, në të cilën janë shkrirë organikisht elementet e përbashkëta të të dy dialekteve dhe elementeve të veçanta të tyre"³² dhe, do të shtonim, ka "strukturë të hapur" për të pranuar elemente të reja a të nevojshme po nga këto dy kryedialekte, atëherë as që mund të dyshohet se a do të mund të integrohet, apo jo, forma e paskajores geqe me + pjesore në kuadër të strukturës së gjuhës së sotme letrare?

Kur është fjala, pra, se cila nga format e pjesores të pranohet në kuadër të paskajores me + pjesore, atëherë më me përparësi del trajta e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes sesa ajo e "hibridizuara", d.m.th. të përdoret pjesorja pa prapashtesën temëformuese -R(Ë), -UR, e cila në formimin e disa prejpesorëve paraqitet e paqëndrueshme. Dihet mirëfilli se në letrarishten e sotme janë integruar edhe forma të tjera të gegërishtes si "elemente të veçanta", të cilat mbase edhe nuk ishin aq të domosdoshme sa është forma e paskajores me + pjesore. Të rikujtojmë disa raste, siç janë emrat me prapashtesën -Ë: kullotë, pritë, shtrojë etj.; trajtat e parotacizuara e të tjera si: ranë e ranishtë, e bardheme e lisanjë, e pame (pamje), pastaj trajtat e parotacizuara si: zanore, e ndërmjetme, hapësinore etj.³³ Të kujtojmë gjithashtu edhe foljet më -OJ me zgjerim me prapashtesën -NO-, përkatësisht -MO-, kundrejt asaj -RO-, si p.sh.: bishtnoj, pleqnoj; erëmoj, ngulmoj etj.³⁴

Në këtë kontekst do veçuar me qëllim rasti i ndërkëmbimit të mbiemrave paralelë prejpesorë të tipit: e ardhur e ardhme. Për të pasur ide më të qartë se për çka tërhiqet vëmendja këtu. Më poshtë po paraqesim strukturën ndërkëmbëse të formave të mbiemrave të zënë në gojë si zhvillime mbi bazë

³¹ Shih edhe te Dr. Idriz Ajeti, Studime gjuhësore në fushë të shqipes IV, Prishtinë 1986 f. 263.

³² Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë 1885 f. 351.

³³ A. Kostallari, Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë te Studime mbi leksikon (...) III, Tiranë 1989 f. 21.

³⁴ N. Veselaj, Foljet e prejardhura të formuara me prapashtesën -O- me zgjerim, gazeta "Ritindja", 16.IX.1989, f. 12.

të foljeve: vij (ardhur), ngrij (ngrirë) dhe punoj (punuar), sipas këtyre tri rubrikave: gegërisht, toskërisht dhe letrarishte e sotme:

Skema e trajtave të mbiemrave prejpesorë

| Gegërisht | Toskërisht | Letrarishte e sotme |
|---|---|--|
| 1) i (e) ardhun i ardhëm e ardhme i ardhshëm e ardhshme i (e) ardhët | i (e) ardhur ? ? ? ? ? | i (e) ardhur i ardhëm? e ardhme (term) i ardhshëm e ardhshme; ? |
| 2) i ngrimë e ngrime i (e) ngritë | i (e) ngrirë - i (e) ngritë | i (e) ngrirë ? i (e) ngritë |
| 3) i punuëm e punueme i punuëshëm e punuëshme i (e) punuët | i(e) punuar - i punuarshëm? e punuarshme! ? | i (e) punuar ? i punuëshëm e punuëshme ? |

Siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm në toskërishte edhe në shqipen e sotme letrare te tipi i emrave prejpesorë: i(e) ardhur, i(e) ngrirë, i(e) punuar – trajta e pjesores në njëjës in e pashqar nuk ndryshon në gjini a nuk përshatet me njëjen e përparmë sipas gjinisë, çka në dialektin e gegërishtes ngjan. Në atë dialekt, përkatësisht në shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes, trajtat e tilla si: e ardhme, e ngrime, e punueme dalin në trajtën femërore, çka në toskërishte nuk ka formë dysores paralele. Si rezultat i një fenomeni të tillë në shqipen letrare është pranuar trajta e gegërishtes "e ardhme" (si term gramatikor), dhe kjo do të thotë se edhe shembujt të tjerë, po qe nevoja, mund të ndjekin po këtë rrugë. Pra, për koncepte të ndryshme sipas kësaj analogjie mund të letrarëzohen edhe trajtat: e pame, e ngrime, e vyeme, e

bardhme (e bardheme) etj. Në këto raste formanti –ME (m+e) merr funksionin e një prapashtese fjalëformuese.

Sido që të jetë, forma e pjesores së gegërishtes i ka përparësitë e sipër-përmendura krahasuar me formën e letrarëzuar “hibride”.

Arsyet e parapërmendura marrë objektivisht, mund të qëndrojnë, por edhe mund të diskutohen e përplotësohen, siç mund të diskutohen e plotësohen edhe provat dëshmuese që do të paraqiten si përparësi për alternativën tjetër.

b) Përparësitë e alternativës së dytë

Në mbështetje të parapëlqimit të alternativës së dytë, d.m.th. për parapëlqimin e formës së pjesores së letrarishtes së sotme, si gjymtyrë e dytë e paskajores me + pjesore, mund të paraqiten këto argumente:

1. Pjesorja e gjuhës së sotme letrare tashmë paraqitet si një trajtë e vetme e normëzuar dhe si e tillë nuk ka arsye të mos zbatohet në të gjitha funksionet që dalin para saj, prandaj duhet të përdoret si e tillë edhe në formën e paskajores me + pjesore. Aq më tepër një veprim i tillë ka mbështetje, kur dihet se forma e pjesores, përkatësisht prapashtesa temëformuese e saj nuk luan kurrfarë funksioni diferencues kuptimdalles lidhur me paskajoren në shqyrtim, ngase funksionin e tillë kuptimor e kryen pjesëza “me”, si të ishte formant a ndajshitesë speciale fjalëformuese. Atëherë, kur kemi parasysh këto fakte, s’duhet të ketë kurrfarë pengese që edhe për rastin në fjalë, në letrarishtë të përdoret po kjo formë e pjesores, e cila edhe e mbart në vetë, tash për tash, prestigjin e normës d.m.th. të normës së shqipes letrare kombëtare të njësuar. Prandaj po të shikohet çështja nga ky këndvështrim, trajta e gegërishtes, si trajtë dialektore, nuk del fare e nevojshme për t’u përdorur.

2. Në fushën e ndërhuazimeve (interferencave gjuhësore), kur një fjalë (formë) hyn në një sistem tjetër, është i njohur fakti se ajo normalisht do të pësojë njëfarë përpunimi, duke iu përshtatur sistemit marrës, prandaj edhe trajta në shqyrtim, pasi i takon një sistemi tjetër, sistemit të ish–shqipes let-

rare mbi bazë të gegërishtes, sistem ky i goditur dhe i tejkaluar kohe edhe për këtë pikë, është e udhës që forma në diskutim t’i përshtatet sistemit të ri, sistemit të shqipes së sotme letrare, sistem ky i cili edhe i ka dhënë provat e para të një gjuhe të njësuar gjithëkombëtare. Kështu, pra, trajtat si: me matë, me pëlqye, me punue mund të modifikohen mjaft natyrshëm: *me matur, me pëlqyer, me punuar* e kështu me radhë. Shtrirja e letrarishtes edhe për këtë formë morfosintaksore favorizohet edhe nga arsyeja se për të gjitha format e pashjtelluara analitike, tashmë përdoret pjesorja e letrarishtes së sotme, e cila me kohë i ka nxjerrë jashtë konkurrencë dytorët përkatës që ekzistonin. Krahaso: duke punuar / tue punue; pa punuar / pa punue; për të punuar / për të punue; me të punuar – me të punuem; një të punuar / një të punue(m). Së këtejmi, pra, mund të shtrohet pyetja, pse të bëjë dallim vetëm forma e paskajores me + pjesore? Prandaj edhe në paraqitjen e paskajores mund të përligjen trajtat si p.sh. *matur / me matur, shkëlqyer / me shkëlqyer, bërë / me bërë, ditur / me ditur, punuar / me punuar* etj.

3. E lidhur ngushtë me pikën e mësipërme del edhe raporti kundërvënës i paskajores me + pjesore, kundrejt paskajores mohore pa + pjesore, madje prof. Selman Riza³⁵ pasi konstaton se të pjesorja e tipit i foljeve më –O/n (ue/ua) dhe –UR (n/m) “toska kthen në –r n–në e shqipes së lashtë e jo atë të gegnishtes”, shpreh mendimin se në raportin e ndërmikimit të lindjes së paskajores me “me”, e cila shtrihet në mbarë truallin e shqipes, përparësi ka trajta mohore pa + pjesore, në analogji të së cilës, sipas tij, do të ketë dalë forma me + pjesore. Sidoqoftë, ky raport është me rëndësi të shqyrtohet në kuadër të temës që po trajtohet këtu, ngase ndërmikimi i tillë ekziston edhe sot e kësaj dite. Kjo dukuri, madje, është e lidhur edhe me forma të tjera brenda strukturës paradigmore. Në të vërtetë, forma e pashjtelluar e pjesore (ku pjesorja e toskërishtes del e normëzuar) është quajtur paskajore e mungesës,³⁶ paskajore mohore³⁷ a formë e pashjtelluar mohore,³⁸ prandaj,

³⁵ Selman Riza, Tri monografina albanologjike, Tiranë 1944, f. 125.

³⁶ Ragip Mulaku, Sistemi foljor në gjuhën e shkruarëve të vjetër veriorë, Prishtinë 1987, f. 147.

³⁷ Latif Mulaku e Fadil Sulejmani, Vepër e vlefshme gjuhësore (recension) të gazetës “Fjala”, 15.XI.1978, f. 10.

³⁸ Fonetika e gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976 f. 289.

kundërvënia në mes të këtyre dy versioneve të paskajoreve, mund të ndikojë edhe në përcaktimin e formës që po parapëlqehet këtu. Të shohim konkretisht ndërlidhjen kuptimore e formale të këtijfarë ndërndikimi te shembujt e mëposhtëm, në disa variante:³⁹

1. Me vdekë pa vdekur është vdekja më e madhe.
Me vdekur pa vdekur është vdekja më e madhe.
Pa vdekur me vdekur është vdekja më e madhe.
2. Me nisë kryhet çdo punë, pa nisur nuk kryhet asnjë.
Me nisur kryhet çdo punë, pa nisur nuk kryhet asnjë.
Pa nisur nuk kryhet asnjë, me nisur kryhet çdo punë.
3. Me punue bën, pa punuar nuk bën.
Me punuar bën, pa punuar nuk bën.
Pa punuar nuk bën, me punuar bën.
4. Me shkëlqye shitet, pa shkëlqyer nuk shitet.
Me shkëlqyer shitet, pa shkëlqyer nuk shitet.
Pa shkëlqyer nuk shitet, me shkëlqyer shitet.
5. Me shkruë e pa shkruar, çuni do uruar.
Me shkruar e pa shkruar, çuni do uruar.
Pa shkruar e me shkruar, çuni do uruar(?).
Me e pa shkruar, çuni do uruar.
6. Me ble e pa blerë, malli ka vlerë.
Me blerë e pa blerë, malli ka vlerë.
Me e pa blerë, malli ka vlerë.

Ndërkëmbimi i formave brenda një fjalie a periudhe mund të jetë i barasvlershëm, mirëpo kur të kihen parasysh faktorët e tjerë, siç është asociacionimi i rimimit si dhe prestigji i formës letrare, si fakt i sanksionuar për

³⁹ Shembujt janë marrë nga burime të ndryshme dhe janë rikonstruara ndërkëmbjeve me qëllim prej meje.

formën mohore, si dhe të formës së pjesores në përgjithësi, i pranuar me vetëdije, atëherë, gjithësi, përparësi fiton trajta e letrarishtes së sotme. Krahaso: “Pa blerë e me ble(rë), malli ka vlerë” ose “Me e pa blerë, malli ka vlerë”, pastaj: “Me shkruar e pashkrue (-uar), çuni do uruar” ose “Me e pa shkruar, çuni do uruar” etj.

Fundja, kur tërë sistemi paradigmor funksionon me sukses mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme, siç janë 11 (njëmbëdhjetë) format e shtjelluara të kohëve analitike:⁴⁰ pesë të dëftores: kam / pata / kisha / do të jem / do të kem + pjesore e letrarishtes së sotme; dy të lidhores: të kem / të kisha + pjesore; dy të habitores: paskam/paskësha + pjesore si dhe dy të dëshirores: paça / do të kisha + pjesore e letrarishtes së sotme e tipit: matur, punuar, shkëlqyer etj. dhe po t'i shtojmë edhe 5 (pesë) format e pashjtjelluara analitike,⁴¹ siç është edhe tipi pa punuar (pa + pjesore), atëherë vërtet, s'di sa ka arsye të bëjë dallim vetëm kjo formë nga vargu i formimeve të tilla analitike të foljeve të shtjelluara dhe të pashjtjelluara. Tekembranja, pse mos të zbatohet njëfarë kompromisi (edhe pse në dukje mund të duket jo bindës, për mos me thënë naiv): *ish-letrarishtja geqe e jep konceptin e paskajores me + pjesore, me pjesëzen “me” karakteristike, ndërsa letrarishtja e sotme e jep pjesoren e vet*. Sigurisht, qëllimi kryesor është të mbulohet koncepti i caktuar. E konceptin e mbulon formanti i specializuar, d.m.th. pjesëza me. Me një veprim të tillë hibridizues do të përmbushet kërkesa për integrimin e formës së caktuar që mbulon nocionin e infinitivit të mirëfilltë dhe njëherazi nuk do të krijojë kurfarë problemi formëzues a drejtshkrimor, si rregull i veçantë, lidhur me përdorimin dyzor të pjesores. Një mundësi e tillë na ofrohet sipas kësaj zgjidhje dhe nuk ka vështirësi të zbatohet. Ç'është e vërteta, një trajtë e tillë ndeshet, qoftë në shkrime të mëhershme nga toskërishtfolësit, qoftë edhe të mëvonshme, kryesisht nga gegërishtfolësit, siç e dëshmojnë edhe afro 60 rastet që u sollën në këtë punim si ilustrim. Pra, trajta e tillë vazhdon të përdoret, edhe pse nuk e ka legjitimitetin e normës letrare, për arsye të qarta.

⁴⁰ Fjalori i shqipes së sotme (1984), Zgjedhimi i foljeve, Tiranë 1984 f. 1500.

⁴¹ Për format e pashjtjelluara të ndërtuara mbi bazë të pjesores, përkatësisht mbi bazë të emrit asnjansë, shih edhe te Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976 f. 288, 292.

4. Është e vërtetë se trajta e paskajores me + pjesore, edhe pse në tërësi nuk paraqitet me shtrirje të gjerë, ajo nuk ishte trajtë e panjohur në atë dialekt, siç nuk është e panjohur, në të vërtetë, edhe sot e kësaj dite. Në ndonjë të folme, sipas dëshimive të pamohueshme, madje ajo del edhe në formën e “toskëzuar” d.m.th. me formën e pjesores së letrarishtes së sotme. Po e shënoj vetëm faktin se Mehmet Çeliku, në të folmen e Kavajës,⁴² përveç trajtave të paskajores si: me marrë, me ruajtë, me qenë etj. ka ndeshur edhe në trajtat: me u tharë, me hyrë, me i qitur(ë). Kur kemi parasysh lëvizjet e popullsisë veri – jug e anasjelltas, si dhe tash së voni lindje – perëndim e anasjelltas, nuk besoj se ka mbetur ndonjë kënd i trojeve shqipfolëse, ku, jo vetëm nuk kuptohet, por edhe ku nuk dëgjohet a përdoret paskajorja me + pjesore. Pa e vënë në dukje fare këtë çështje, në vazhdim do të paraqes fakte se në të kaluarën jo të largët, edhe një numër jo i vogël toskësh këtë trajtë e kanë përdorur në gjuhën e shkrimit. Kështu, pra, vetëm në disa vjersha të Asdrenit,⁴³ poetit tonë të shquar, i cili që në atë kohë njihej si “përfaqësuesi më i shquar i letërsisë së shquar në dialektin e toskëve”,⁴⁴ ndeshim në këtë dukuri, d.m.th. në përdorimin e paskajores me + pjesore, madje në tri mënyrat e interferencës:

a. Në vjershat e tij ndeshet trajta e paskajores me + pjesore sipas ashtuquajturës interferencë “transfer”,⁴⁵ d.m.th. pa e ndryshuar asnjë element të saj, si p.sh.: me pi, me nigje, me përpjekun, me shpëtuemun, me dekun, me punu.

b. Ndeshen trajtat e paskajores me + pjesore sipas interferencës së ashtuquajtur “hibride”, d.m.th. është huazuar forma duke bërë ndonjë përshtatje a modifikim rasti, si p.sh.: me bë, me thënë, me arth (geg. me ardhë), me qëndru (geg. me qindru) etj.

c. Ndeshen edhe trajtat të toskëzuara të paskajores me “me”, përkatësisht bëhet “integrimi” i plotë me përshtatje të formës së pjesores, si p.sh.: me ditur (geg. me ditë a me ditun), me rrëmbyer (geg. me rrëmbye), me luftuar (geg. me luftue) etj.

⁴² Mehmet Çeliku, Të folmet e Kavajës, Dialektologji shqiptare II, Tiranë 1974, f. 180.

⁴³ Asdreni, Vepra, Ëndra e lote (ribotim) Prishtinë 1971, f. 138.

⁴⁴ Rexhep Qosja, Asdreni, Jeta dhe vepra e tij, Prishtinë 1972, f. 138.

⁴⁵ Vejsel Nuhui, Ndikime ndërgjuhësore, Prishtinë 1990, f. 14, 15 dhe q. 99.

Sa për kërshtëri po cek se në disa vjersha të M. Gramenos raporti del 10: 1 në favor të trajtave të “toskëzuar”.⁴⁶ Edhe në veprën poetike (përkthim) të L. Poradecit ndeshim trajtën me lar(ë) (Shih: Hajne, Poeti, Prishtinë, 1981, f. 59).

Ç’është e vërteta, forma të toskëzuara të paskajores me + pjesore, përkatësisht të pjesores përkatëse si gjymtyrë e dytë e saj ndeshim në dokumente të shkruara edhe më herët se në shkrimet e Asdrenit, të M. Gramenos, të L. Poradecit etj. Kështu paskajorja në trajtën e toskëzuar ndeshet që nga shkrimet e Dozonit,⁴⁷ të Nikollë Filja, De Rada, A. Santori, G. Dara i Riu, Z. Skiroi e arbëreshët e tjerë. E ndeshim edhe në shkrimet e toskëve si: N. Frakulla, J. Vreto, Th. Mitko, Sami e Naim Frashëri dhe të tjerë.

Sa për kuriozitet po përmend se në “Kanonizëm e Stambolli” i ndeshim trajtat: “me mundurë”, “me diturë”.⁴⁸

Më vonë, në Sintaksën e S. Pritit⁴⁹ të botuar në kohën tonë, janë shënuar si forma përfaqësuese të foljes përkatëse trajtat e toskëzuara me + pjesore: me bërë, me qenë, me plasur. Edhe në gramatikën normative të gjuhës sonë letrare (morfologji 1976)⁵⁰ është shënuar trajta “me qenë hapur”, në vend “me qenë hapë” a “me qenë hapun”, mbase edhe mund të jetë edhe gabim shtypit, por sido që të jetë, vetë dukuria e një “lajhtitjeje të tillë” zgjon jo vetëm kërshtërinë, por edhe tregon prirjen potenciale që pjesorja edhe si gjymtyrë e paskajores me “me”, të shënohet parësorisht në trajtën e “letrarëzuar”. Pa

⁴⁶ Mihal Grameno, Vepra I, Këngëtoresha shqipe “Plagët”, Prishtinë 1979.

⁴⁷ Dozoni e përdor formen e paskajores me “me” në trajtën: tuk me parë, tuk me mbaruar, tuk me thënë; N. Filja: do me thënë, me bërë, me gjykuar, me ardhurë; A. Santori: për me kënduar, me i dërguar, për me kujtuar, me u bënë; De Rada: me vjen me rarë, me vatur, me i thënë, me i njohur, me i ndihur, me dajtur, me e bërë; G. Dara i Riu: me thënë, pa me luftuar, me ardhur; Z. Skiroi: për me bamun, me e caktuar, me u hipur, për me luajtur; J. Vreto: me qenë, me thënë, me u mërguar, me u dukurë, me dalë; Th. Mitko: me qenë marrë, me na marrë. Sami Frashëri: mos me shkruarë e kënduarë, me qenë, duk me qenë; Naim Frashëri: me qenë, mos me lënë, me mos pasurë, me mos marrë, me mos prishurë, me mos dashurë, për me marrë, me arthë etj.

⁴⁸ “Kanonizma e Stambolli” e botuar në librin “Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit”, Tiranë 1972, f. 411–414.

⁴⁹ Prof. Stefan Priti, Sintaksa e gjuhës shqipe, Prishtinë 1972, f. 271, 272, 269, 419.

⁵⁰ Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976, f. 262.

hyrë në gjurmime të tjera po përmend një rast atraktiv: Në *Lahutën e majcisë* (f. 64) të Gj. Fishtës ndeshim trajtën me shpjerë:

*Se këtu po ish puna me derë
E s'muj mbrendë këdo me shpjerë.*

Pa u thelluar në motivet që i kanë shtyrë rilindësit tanë (toskë) si dhe të tjerët ta toskëzojnë paskajoren me “me”, për ne është simptomatik fakti se tashti vetë gegët po e letrarëzojnë paskajoren, përkatësisht pjesoren për këtë tip të paskajores. Është e vërtetë se pas viteve '70, d.m.th. pas njësimi të drejtshkrimit të shqipes, i cili nuk u kuptua si një normëzim i rregullave të drejtshkrimit, por edhe sa i përket normëzimit të rregullave “gramatikore, fonetike e leksikore”,⁵¹ edhe pse siç është cekur edhe më përpara në këtë punim, pikërisht në këto fusha mbeten jo pak çështje të pakristalizuarra, përkatësisht të patrajtuara me gjerësinë dhe thellësinë që meritojnë, ngase edhe kushtet nuk ishin krijuar që të njihje sa e si duhet gjuha shqipe me tërë ndërlukeshmërinë që e përfshin. Ndër çështjet e “zgjidhura” jo në mënyrë plotësisht të drejtë, do të përmendim edhe çështjen e paskajores me + pjesore. Në të vërtetë, me mënjanimin e kësaj forme nga norma letrare, te gegërishtfolësit, përkatësisht te zbatuesit e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, mbeten zbraztësi në strukturën e sistemit të tyre ligjërimor, prandaj, si mbulesë për formën e tillë në ndërditje doli spontanisht dhe u përfaqua forma e “letrarëzuar” e pjesores si gjymtyrë e dytë e paskajores me “me”.

Është e vërtetë se po të mos ishte dora harresë e redakturës dhe e (vetë) censurës e zbatuar nga autorët dhe “specialistët” e normës letrare, dukuria e përdorimit të paskajores me + pjesore edhe në formën “hibride” në gjuhën e shkrimit të ne do të ishte shumë më e madhe.

Me fjalë të tjera, po të pranohet trajta e tillë “hibride” si trajtë normative, do të krijoheshin, me të vërtetë, lehtësi për t'u nxënë shpejt e lehtë norma letrare e gjuhës standarde kombëtare pa ndonjë trysni në sistemin ekzistues ligjërimor dhe njëherësh do të zgjidhej njëherë e përgjithmonë çështja e përdorimit të paskajores si “dallimi më i madh strukturor” në raportin letrarishte / dialekt.

⁵¹ Prof. Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia saj*, Prishtinë 1989, f. 274.

5. Forma dysore e pjesores – hëpërhë alternativë e ofrueshme

Meqenëse si për njërin ashtu edhe për tjetrën alternativë ekzistojnë argumente mjaft të qëndrueshme, të cilat nuk i bien ndesh aq njëra-tjetrës, edhe pse nuk janë pa ndërfërkime, duke pasur parasysht gjendjen e sotme të zhvillimit të gjuhës sonë letrare, për çështjen në shqyrtim, mendoj se si zgjidhje më e mirë, hëpërhë, do të ishte që të dyja trajtat të lihen të lira në përdorim d.m.th. të jenë të tolerueshme a të lejueshme si forma dysore të normëzuara.

Ç'është e vërteta, siç e pamë nga shembujt që u morën për ilustrim, që të dyja trajtat në fjalë ndeshen në përdorim në jetën e përditshme, që të dyja kanë shtrirje të konsiderueshme. Përdorimi a parapëlqimi i njëres a i tjetrës trajtë le të varet nga bindja e lirë e përdoruesit dhe nga natyra e lëndës që shprehet. Intimisht mendoj se trajta e ish-gegërishtes letrare, e cila pasqyron originalitetin burimor të një areali të gjerë, duhet të ketë përparësi për të shprehur nuanca të caktuara e stilistike që lidhen me të ashtuquajturin “tipizim” dhe se këtë të drejtë s'mund t'ia mohojë kurrfarë “etiketimi”, ndërsa trajtat e letrarëzuara mund të gjejnë përdorim për nuanca kuptimore e stilistike që u përshtaten materialeve të “letrarëzuara”, d.m.th. natyrës zyrtare të shprehjes, perspektivës a qëllimit për njësimin a thjeshtëzimin e dysorëve etj., edhe pse, siç e pamë nga shembujt konkretë, del jo vetëm tek arbëreshët e Italisë, por edhe nga të tjerët. Gjithsesi mendoj se kjo çështje ia vlen të ndiqet nga kuadrot kompetentë. Të kihet parasysht e të favorizohen prirjet formëzuese e fjalëformuese që u zunë në gojë në këtë punim me rastin e përcaktimit të vendit të paskajores në strukturën e vargut të prejpesorëve. Konkretisht, të ndiqet konkurrenca e trajtave paralele: me mbajtë/me mbajtur, me matë/me matur, me le/me lerë, me ble/me blerë, me fryrë/me fryrë, me shue/me shuar, me pëlqye/me pëlqyer, me shkruë/me shkruar, me punue/me punuar.

Nëse dikush (qoftë toskërishtfolës, qoftë zbatues “i disiplinuar” i normës së sotme) nuk e sheh “të justifikueshme dhe të pranueshme” përdorimin e trajtës së letrarëzuar “hibride” dhe e kundërshton me forcë atë, atëherë një veprim i tillë, gjithsesi, shkon në dobi të përdorimit të trajtës autentike të paskajores me “me” d.m.th. të formës së pjesores së ish-gegërishtes letrare, sepse përdorimi i formës në shqyrtim del si një domosdo e jetës sonë gjuhësore. Gjithashtu normimin e paskajores me “me” e dëmtojnë gjithsesi edhe ata gegërishtshkrues, të apasionuar me elemente fanatizmi të normës së ish-

–shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, të cilët s'mund ta ndajnë këtë formë nga struktura paradigmore dialektore të foljes përkatëse.

Sidoqoftë, për t'u normalizuar çështja në të mirë të zgjidhjes së këtij problemi përfundimisht në plan kombëtar, është mirë që të dyja palët t'i zbusin qëndrimet duke mos kundërshtuar përdorimin e formës së paskajores së tipit me + pjesore si “rast të veçantë”, sa herë që këtë e kërkon nevoja.

Ç'është e vërteta, përdorimi dhe përpunimi i dialektit gegë, por edhe i atij toskë, po që nevoja, nuk ka sesi ta dëmtojë gjuhën standarde kombëtare të njësuar. Nga trajtimet dhe shkrimet e tilla gjuha standarde, norma e saj, do të sforcohet edhe më mirë, qoftë duke i specifikuar format e veta, qoftë duke marrë elemente të reja nga dialektet. Me fjalë të tjera, veprimet e tilla, duke vënë në pah vlerat e pashfrytëzuara të dialekteve ia shtojnë pakontestueshëm vlerën edhe gjuhës standarde kombëtare, e cila ato vlera, sigurisht ka si detyrim t'i përthithë në gjuhën e vet dhe patjetër ka për detyrë t'i pranohet e t'i cilësojë si vlera të veta. Sa i përket paskajores me + pjesore, është e vërtetshme dukuria që trajta e tillë po ndeshet gjithnjë e më shpesh në shkrimet e njerëzve të pendës në mbarë truallin shqipfolës, siç janë b.f. Sabri Hamiti, Musa Ramadani, A. Konushevi, Ukë Buçpapa, Ali Cena, Bahri Brisiku, Avdi Baleta, Agim Gjakova, Behram Hoti etj. etj. Sa për ilustrim po i shënojmë një dy shembuj tipikë: “Turku... assesi s' ka mujtë me vu hyqymet në Ulqin” (B. Brisiku); “Drenicë besnike, shqipe e lashtë/ Pa ty Shqiptarinë nuk di me dashitë” (B. Hoti), por ajo po gjen përdorim të lirë edhe në artikuj të veçantë edhe në gjuhën e ndonjë reviste shkencore letrare a informative si b.f. *Hylli i dritës, Koha ditore* e të tjera, të cilat, në të vërtetë, nuk pata mundësi t'i konsultoja të gjitha.

Kreu V

ALTERNATIVË PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHËTJES SË PASKAJORES ME + PJESORE NË SHQIPEN E STANDARDIZUAR KOMBËTARE

Meqenëse në kërret e mëparshëm të këtij punimi nga vështrimi sinkronik i çështjes faktikisht jo vetëm u diskutuan, por edhe u provuan si të përbuara të dy parakushtet:

së pari, parakushti që kishte të bënte me të kuptuarit e nevojës për integrimin e paskajores me + pjesore në normën e shqipes letrare kombëtare, sepse ajo gjithsesi duke qenë si pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm të shqipes dhe duke mbuluar fushë të caktuar specifike semantike, s'mund të përjashtohet as nga sistemi as nga norma letrare e tij dhe

së dyti, u diskutua dhe u provua si i përbushëm edhe parakushti tjetër që kishte të bënte me përfshirjen domosdo a me sidetyrim të kësaj forme në strukturën morfosintaksore në kuadër të normës së shqipes standarde pa e rrezikuar fare atë, e cila me një veprim të tillë vetëm sa pasurohet, sforcohet e përsoset e nuk dëmtohet aspak, këtu si përfundim për krejt çështjen e shtruar, të diskutuar e të analizuar, na mbetet të propozojmë si *projekt – amandament* zgjidhjen e qëndrueshme përfundimtare të formuluar në formë *propozim–vendimi* që përbëhet prej katër pjesëve:

- e para, përfshin mbështetjen në faktet precedente,¹
 - e dyta, përmban propozim–zgjidhjet alternative si klauzola dispozivi²
- me katër rregulla të këshillueshme;

¹ Toggjalëshi “fakt precedent” është parapëlqyer, për arsye se i përgjigjet rastit që po trajtohet këtu, pasi kemi të bëjmë me fakte specifike që i takojnë vetëm gjuhës sonë, natyrës së saj, prandaj edhe duhet të zgjidhet çështja në mbështetje të fakteve specifike po të kësaj natyre.

² Termi “dispozitiv” këtu është përdorur sipas kuptimit të dytë, i cili është rezervuar në Fjalorin e gjuhës së shteteve shqipe për fjalën “dispozitë” dhe që ka të bëjë për pika të veçanta të një “rregulloreje a të një vendimi” që ka karakter rregullorë të një dispozitivi me të cilin kërkohet përbarimi i caktuar.

e treta, përfshin arsyetimin e shkurtër dhe e katërta, një konstatim përmbyllës për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së diskutuar.

1. Mbështetja në faktet precedente

Në mbështetje të faktorëve logjiko-semantikë, psiko-asociacionorë dhe socio-linguistikë duke u bazuar në kontinuitetin e formimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe konsiderohet fakti se shqiptimi për mënjanimin e paskajores me + pjesore nga norma e gjuhës së sotme letrare nuk është bërë në përputhje me kodin tradicional të gjuhës shqipe dhe se një zgjidhje e tillë nuk del si konkluzion i veçantë i ndonjë organi kompetent shkencor gjithëkombëtar, madje nuk ka as dëshmi se ndonjë tubim shkencor: konsultë, sesion, simpozium, konferencë a kongres të ketë miratuar me koncensus një vendim të tillë, por si të themi, gjykimi është marrë, siç thuhet në zhargonin e së drejtës, “në paketë”, pa u shqyrtuar fare çështja “nen për nen” a si pikë më vete, duke u lënë kështu vend, si manipulimeve ashtu edhe ndonjë gjykimi subjektiv e subjektivist, fakt ky që bie ndesh me normën pragmatike (situate e konversacionore) të gjuhës standarde dhe e të çështjen të diskutueshme, prandaj për të mos mbetur kjo çështje, si të thuash, përherë e zvarur dhe e pazgjidhur, më poshtë si propozim-zgjidhje alternative, jepen këto katër dispozita:

2. Propozim – zgjidhjet alternative:

1. Ndaj paskajores së tipit me + pjesore, e cila del si realie a si element faktik i pamohueshëm në kuadër të traditës së shqipes letrare kombëtare dhe se kjo në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes ishte trajtë e normëzuar, ndryshohet qëndrimi a konsiderohet si i paqenë etiketimi: “jashtë normës letrare” i shqiptuar apriori në tekste gramatikore të gjuhës së sotme letrare të viteve ‘70–‘80, formulim ky i cili nuk dilte aq i qartë dhe se në interpretimin e tij pati keqkuptime e teprime. Në bazë të faktëve e interpretimeve të reja, forma e paskajores me + pjesore pragmatikisht mbetet e lejueshme të përdoret së paku për këto nënfusha semantike:

a) Si trajtë përfaqësuese e foljes qoftë në punime shkencore, qoftë për nevoja praktike shkollore të punës me nxënë e studentë si p. sh. lat. *liscere* – serb. *učiti* – shq. me mësue, kundrejt lat. *disco* – serb. *učim* shq. mësoj etj., pa i mohuar rolin përfaqësues trajtës së dëftores, veta e parë njëjës.

b) Në kuadër të shprehjeve frazeologjike tipike me kuptim specifik, me të cilat shprehen nocione të një abstraksioni të lartë si p.sh. *me dalë faqe-bardhë, mos me folë me thumba* etj.

c) Si mjet shprehës në krijimtari për qëllime ideo-estetike, poetike, politike etj., e drejtë kjo e pajetërsueshme e autorit. Nuk është fjala vetëm për “tipizime thjesht letrare”, por edhe më gjerë. P.sh. “për kosovarin sot *me mbetë gjallë* do me thënë më shumë se fitore, do të thotë më shumë se verbimi i syrit të shpresës së armikut tinzar” etj.

ç) Si formë e nevojshme sinonimike, si p.sh.:

– në shprehje të ndërmjetme (në funksion të lokucioneve ndërlidhëzore e të ngjashme), si b.f.: *si me thënë, qysh me thënë, më mirë me thënë, kisha me thënë, me thënë të drejtën, me thënë të vërtetën, me thënë troç, me thënë shtruar, me thënë shlirë, me thënë me fjalë të tjera etj.; me folë si burrat, me ndejtë si njeri, me marrë ndryshe, me tjerë holl e hollë, shkurt me pre, shkurt me i ra, drejt me pleqne, drejt me këqyrë etj.;*

– në disa fjalë karakteristike, në të cilat paskajorja me + pjesore nuk del e ndërkëmbyeshme parësorisht me format kohore të lidhores si b.f.: *Shtirem si me fjetë; Me dalë, dola, me folë fola; Me u lagë se me u lagë më mirë po stërpikem vetë; E ka bërë veten: me t’ia dhënë shuplakë fytyrës; Kur do me ecë, ecën; Kur do me ardhë, vjen etj.*

– në disa shprehje të ngurosura mbi bazë të kësaj forme si b.f.: *Është i fortë: çelik me bre... Është e tillë: me prekë s’duron. Mos të raftë (rëntë) me harrue etj.*

– në raste të diferencimit të të dy futurëve të domosdoshë dhe atij të dëshirës si b.f. *Kam (kisha) me dalë e me ia thënë haptazi kundrejt: Do të dal dhe do ta përqafoj me plot dëshirë etj.*

– Në disa raste thjesht sinonimike, si b.f. *Me qene (të jesh) plak e me nda (të ndash) pleqni* do të thotë me qenë (të jesh) i drejtë dhe me gjyuke (të gjykosh) me urti etj. *Ka me ia ndërë* (ka për t’iu ndërë) *larg era kësaj pune!* etj.

Pra, në këto nënfusha semantike, përdorimi i paskajores me + pjesore duhet të përligjet për ta rifituar, kështu, të drejtën e konkurrencës së lirë si njësi e barabartë morfosintaksore, leksikore e semantike për konceptin e caktuar brenda sistemit përkatës të shqipes standarde³ në shkallë kombëtare.

II. Sipas paragrafit të mësipërm, të drejtë pjesëmarrjeje në konkurrencë, kanë të gjitha format e lejueshme sinonimike të shqipes letrare, të cilat sipas praktikës së deritashme konsideroheshin si të vetme të normëzuara për mbulimin e nocionit që mund të shprehet me paskajoren me + pjesore, siç janë format kohore të lidhore, ato të dëftores, paskajorja e dytë e forma të tjera, të cilat edhe mund të jenë të favorizuara individualisht, mirëpo parapëlqimi a favorizimi i formës së caktuar paralele, duke përfshirë këtu edhe formën e paskajores me “me”, do të varet nga bindja e lirë vetjake e shqippërdoruesit.

III. Të gjitha format a mënyrat sinonimike të të shprehurit lidhur me nocionin e paskajores që u cekën më sipër: paskajorja me + pjesore në një-rën anë dhe format kohore të lidhore, paskajorja e dytë si dhe format e tjera, nga ana tjetër, konsiderohen si forma të normëzuara, prandaj redaktura nuk ka të drejtë t'i ndërkëmbejë a t'i korrigjojë apriori pa pëlqimin e autorit, pos rasteve kur kemi të bëjmë me lajhtitje të rënda gjuhësore, për shkak të mosnjohjes së rregullave themelore të caktuara të kulturës së të shkruari. shqip.

IV. Para ekspertëve të cilët sipas funksionit shoqëror e shkencor (institucional) e kanë për detyrë të përcjellin qëndrueshmërinë e normës së shqipes së standardizuar, shrohet sidetirim që të ndjekin me vëmendje çështjen e paskajores me + pjesore, ta vlerësojnë me objektivitet dhe, lidhur me këtë, të përcaktojnë rregullsitë e përdorimit të saj, duke i përcaktuar edhe më mirë nënfushat semantike, në të cilat, së paku, pragmatikisht (sipas normës situatore dhe asaj konverzionore), assesi nuk mund të ndalohej përdorimi i formës në shqyrtim.

Prandaj, nga sa u tha më lart, si zgjidhje alternative orientuese hë për hë do të propozojm këto katër rregulla të këshillueshme drejshkrimore:

³ U parapëlqye termi “gjuhë standarde” a “normë standarde” në vend të epitetit “letrare”, në togfjalëshat “gjuhë letrare kombëtare” / “gjuhë standarde kombëtare a “gjuhë e standarde letrare”, për arsye se epiteti “letrare” ka mundësi specializimi vetëm për stilin letrar, d.m.th. për stilin poetik a të letërsisë në përgjithësi.

Katër rregulla të këshillueshme alternative

1. Gjatë përdorimit të paskajores me + pjesore, gjithsesi, duhet të respektohen rregullat e drejtshkrimit të shqipes si dhe rregullat e tjera gramatikore të normës letrare në fuqi, të cilat as që preken me integrimin e paskajores me + pjesore si element i veçantë në normën e shqipes së standardizuar kombëtare.

2. Pjesorja si gjymtyrë e dytë e paskajores me “me” në cilëndo version që përdoret, duhet të shënohet në trajtën e plotë, siç është shënuar a shënohet në variantin letrar përkatës. P.sh; **me dalë** (jo: me dal, me dalur, me ndalun, me dalen), **me dhënë** (jo: me dhanë, me dhënë, me dhëtur), **me qenë** (jo: me kenë, me kanë, me kjenë), **me marrë** (jo: me marrun, me marrur, me marren) **me pasë a me pasur** (jo: me patur, me pasën, me pas, me pasun), **me matë a me matur** (jo: me matun, me mat, me maten) **me mbajtë a me mbajtur** (jo: me mbajt, me mbajtur), **me vendosë a me vendosur** (jo: me vendosun, me vendos, me vendosen), **me derdhë a me derdhur** (jo: me derdh, me derdhun), **me bë a me bërë** (jo: me ba, me barnë, me bamun, me bënë), **me la ose me larë** (jo: me lam, me lamë), **me ble a me blerë** (jo: me blenë, me blemun), **me fshi ose me fshirë** (jo: me fshimë, me shirë), **me fry ose me fryrë** (jo: me frymun, frynen), **me shue ose me shuar** (jo: me shuen, me shuem, me shu, me shua), **me thye ose me thyer** (jo: me thy, me thym), **me pëlqye ose me pëlqyer** (jo: me pëlqy, me pëlqyam, me pëlqyen), **me shkruë ose me shkruar** (jo: me shkru, me shkruem, me shkrua), **me punue a me punuar** (jo: me punu, me punua, me punuem, me punuem).

Pra, pavarësisht nga shqiptimi që u bëhet fjalëve të tilla në dialekte a të folme të caktuara në gjuhën e autorëve, duhet të shënohen në format morfologjikisht të arsyeshme, siç u cekën më sipër. Këtë çështje po e theksoj, ngase kam vërejtur se aktualisht, sidomos në gjuhën e shtypit (pra nuk është puna e tipizimit letrar a të ndonjë trajtimi shkencor), trajtat e pjesores në kuadër të paskajores në shqyrtim po shënohen qoftë pa Ë–në fundore karakteristike (te trajtat me bashkëtingëllore fundore) *me vendos, me pas vendos* në vend: *me vendosë, me pasë vendosë* etj., qoftë pa njëzëri zane të diftongut, si p.sh. *me punu, me shkëlqy, në vend: me punue, me shkëlqye* etj.

3. Forma e pjesores së ish–shqipes letrare mbi bazë të gëgërishes tipit: *me matë, me mbajtë, me vendosë, me la, me ble, me pëlqye, me shue, me punue* etj., e cila është e lejueshme të përdoret vetëm si gjymtyrë e paskajores

me "me", sidomos në "tipizime" sipas kuptimit të gjerë, nuk është e lejueshme të shtrihet edhe te format e tjera analitike (dialektore) në gjuhën e autorëve. Pra: "kam me punue" a "kam me punuar", por jo: kam punue (...), sepse norma njih vetëm trajtën **kam punuar** (...), e kështu me radhë.

4. Hë për hë dora e korrjigjesit duhet të largohet lidhur me parapëlqimin e trajtës së caktuar në shqyrtim. Me një fjalë, nuk duhet anuar, e aq më tepër propaganduar apriori, për ndonjë trajtë të caktuar. Duhet të konsiderohen të dy trajtat barabar si të normëzuara, si trajta dysore të paskajores. Cila trajtë do të përdoret, le të varet nga bindja e vetë autorit, dhe natyrisht, kjo duhet t'i përshtatet a të varet nga specifika (situata, rrethana, tipizimi etj.) që shprehet në kontekst. Këtë qëndrim lypset mbajtur për derisa kuadrot kompetentë t'i kristalizojnë rregullsitë, lidhur me çështjen në shqyrtim dhe të japin rekomandimin e nevojshëm përkatës.

Vërtet, siç doli nga analiza, asnjëra nga format dysore të pjesores, si gjymtyrë e dytë e paskajores me "me", nuk rrezikon në asnjë mënyrë strukturën morfosintaksore e semantike të gjuhës letrare kombëtare të njësuar.

3. Arsyetim i shkurtër

Edhe pse qëllimi kryesor i këtij punimi ishte vështrimi sinkronik, përkatësisht diskutimi i çështjes, megjithatë, gjatë analizës, me njëfarë guximi të ligjshëm u bë trajtimi i kësaj teme mjaft gjerësisht dhe hollësisht duke vajtur deri atje sa të sugjerohet a të jepen ide edhe për zgjidhjen konkrete të çështjes. U parapëlqye këmbëngulja se zgjidhja më e mirë e problemit të shtruar do të ishte të bëhet me integrimin e formës në fjalë për koncepte të caktuara në kuadër të normës letrare e jo me mënjanimin a fshirjen e saj krejtësisht nga norma. Krejt tema e shtruar deri këtu mund të shërbejë si arsytim i dispozitave të rekomanduara që u shënuan më sipër si propozim-zgjidhje alternative. Këtu po mjaftohem me konstatimin se rikthimi i legjitimitetit të paskajores me + pjesore në normën e gjuhës letrare kombëtare, jo vetëm se del i mundshëm, i drejtë dhe i domosdoshëm për ndonjë pikë të strukturës morfosintaksore në veçanti, por del edhe si një akt i dobishëm edhe për vetë bazën e shqipes standarde marrë globalisht, sepse, me këqyrë hollë e hollë, sistemi i tillë ka nevojë për formën në fjalë si mjet shprehës i

të të thënit, qoftë edhe mbi-bazë sinonimike. Është e vërtetë se me një integrim të tillë hapet një derë shumë e lirshme për hyrje – dalje dhe komunikim më të lehtë ndërkëmbjes në raportin dialekt + ish-shqipe letrare mbi bazë të gegërishtes, në njërën anë dhe të gjuhës standarde kombëtare (të njësuar), në anën tjetër.

Njëherazi, integrimi i tillë do të lehtësonte lidhjen me format adekuate të gjuhëve të njohura evropiane, me të cilat gjuha shqipe është në takim e në ndërlidhje gjithnjë e më të madhe. Në të vërtetë, te këto gjuhë infinitivi luan rol in pothuajse përfaqësues të foljes përkatëse në sistemin foljor, funksion ky që në një farë dore e luan a mund ta luajë edhe paskajorja me + pjesore të shqipes për koncepte të caktuara, pa ia mohuar një funksion i tillë trajtës së njëjësit të së tashmes së dëftores, sidomos te përfaqësimi i fjalëve në fjalorët shpjegues etj.

4. Konstatim përmbyllës përfundimtar

Në fund po theksoj se e bëj timin mendimin e dr. Rexhep Ismajlit, i cili ka konstatuar se "gjuha letrare standarde është normim i dyfishtë: norma e parë është veçori e çdo gjuhe që varet nga sistemi, ndërsa e dyta, ajo bëhet me vetëdije".⁴ Pra, formën e paskajores me + pjesore e kemi të trashëguar, na e jep vetë sistemi, ashtu si edhe format dysore të pjesores, ndërsa normë-zimin duhet ta bëjmë në bazë të vetëdijes. Vërtet normëzimi duhet të bëhet me ndërgjegjësim të plotë, sepse këtë na e kushtëzohet nevoja edhe brenda-gjuhësore edhe ajo jashtëgjuhësore. Sigurisht, po të shtrohet dhe të kuptohet drejt kjo nevojë, këtë ndërgjegjësim do ta përfaqonin dhe favorizimin më me lehtësi, siç thuhet, masat e gjera të bashkësisë sonë folëse, me intelektualët dhe subjektët kompetentë të të gjitha profileve, me gjuhëtarët në krye, të cilët edhe duhet ta japin ndihmesën e vet në vlerësimin objektiv të çështjes në shqyrtim.

⁴ Shih: Rexhep Ismajli, Gjuhë dhe etni, Prishtinë 1991, ku në artikullin "Mbi normën gjuhësore" autori tërheq vërejtjen se "në shkrimet tona termi gjuhë letrare dhe normë e gjuhës letrare kanë marrë vlerë absolute si e vërtetë gjuhësore e përherëshme, edhe pa u pasë përkufizuar mirë" (Aty f. 316) dhe po në atë artikull shpjegon se "Andre Martinet-ja dalton tri njësi në kuadër të një gjuhe të caktuar: gjuhë (e dikujt), gjuhë zyrtare dhe gjuhë letrare (Po aty f. 318). Pra të gjitha këto nocione si: gjuhë ligjërmore, gjuhë zyrtare dhe gjuhë letrare mund të nërthehen në termin togfjalësh "gjuhë standarde kombëtare", siç u përpoqa ta paraqes këtu.

* * *

Po qe se kjo paraqitje kuptohet drejt dhe, si të themi, legalizohet zbatimimi a përdorimi normal i paskajores me + pjesore, pra, pa etiketimin përcëmues “jashtë normës letrare” duke e lënë të lirë t’i shtrohet konkurrencës lojale, sidomos për nënfusha të caktuara semantike, atëherë mendojmë se ky problem si “më i madhi i gjuhës sonë” në raportin gjuhë e sotme letrare / ish-shqipe letrare mbi bazë të gegërishtes, mund të quhet i zgjidhur a në fazën e zgjidhjes përfundimtare, pa marrë parasysh natyrën fleksibile të rregullave të normëzimit letrar. Nëse mbeten trajta dyore për disa tipa të pjesoreve të foljeve për një kohë, kjo nuk duhet të na brenqosë aspak, ngase, në të vërtetë, në fjalëformim e semantikë trajtat dyore mund të bashkëjetojnë. Sipas mendimit tonë më brenqosëse dalin dy fakte të tjera:

e para, ka të bëjë pikërisht me mbetjen e mëtuqeshme të pazgjidhur të çështjes duke cunguar të drejtën e të shprehurit normal të shtresës më të madhe shqipfolëse, d.m.th. me lënien jashtë normes letrare të paskajores me + pjesore dhe

e dyta, ka të bëjë me dukurinë, që si pretekst të merret pikërisht çështja e pazgjidhur e paskajores me + pjesore duke lënë shteg që të bëhen përpjekje për formimin, përkatësisht rikthimin në formën paralele krahas strukturën foljore të shqipes së sotme, një strukturë e re rivale duke e rigjallëruar strukturën paradigmore foljore të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, dukuri kjo që nuk është e pasinjaluara në kohën tonë.

Fundja, duke i hequr etiketimin përcëmues “jashtë normës letrare” dhe duke i dhënë liri konkurrimi formës së paskajores së mirëfilltë për nënfusha të caktuara semantike me cilësinë e normëzimit brenda gjirit të letrarishtes standarde, atëherë do të verifikohet më së miri nevoja reale për përdorimin ose jo të saj dhe njëherazi do të dobësohet a do të shuhet fare preteksti për “rikthimin” në jetë të tërë strukturës rivale paradigmore verbale mbi bazën e gegërishtes letrare me paskajoren me + pjesore në krye.

Kam bindjen se me një veprim të tillë d.m.th. me integrimin e paskajores me + pjesore, gjuha standarde kombëtare e njësuara do të pasurohet, do të përsoset, do të fitonte shumë e nuk do të humbiste asgjë.

PËRFUNDIM

Në shqipen letrare të njësuara që nga vitet ‘70 e këtej, çështja e paskajores së zakonshme me + pjesore është konsideruar si çështje e zgjidhur me mënjanimin e saj nga norma letrare (për shkak të origjinës dialektore veriore të saj e për ndonjë arsye tjetër), duke i konsideruar të mbuluara konceptet që shprehte dhe shpreh ajo me trajta të tjera sinonimike, siç është paskajorja e dytë me “për të”, “format kohore” të lidhores e të tjera. Lidhur me një zgjidhje të tillë disa gjuhëtarë tanë, edhe pse adhurues e zbatues të normës së gjuhës së sotme letrare të njësuara, jo pa arsye, patën shprehur rezervë. Kjo çështje u prek paksa edhe në simpoziumin shkencor “Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot”, të mbajtur në Tiranë më 21 – 22 nëntor 1992, ku u hodh mendimi se çështja e paskajores me “me” s’mund të konsiderohet e mbyllur, por mbetet si një çështje e hapur për diskutim dhe rivlerësim.

Edhe në këtë punim, si edhe në atë tubim, do të paraqiten prova si argumente, të cilat dalin të arsyetuara, qoftë nga riinterpretimi i disa fakteve të njohura më parë, qoftë edhe të kushtëzuara nga sjellja e fakteve të reja si dhe kriterëve të aplikuar hulumtuese në gjuhësinë bashkëkohore. Në të vërtetë, zgjidhja e kësaj çështjeje kërkohet të bëhet ndryshe nga praktika e derisotme, d.m.th. jo me lënien e saj krejtësisht jashtë norme, por pikërisht me integrimin e saj, për nënfusha të caktuara semantike, në “normën letrare” të shqipes së standardizuar kombëtare dhe për një ndërmarrje të tillë jepen kushtëzimisht dy “garanci”:

e para, ka të bëjë me faktin se për një integrim të tillë ka nevojë të shqippja e standardizuar kombëtare si një “sistem sistemesh”, si “sistem mbidialektor” a si “varianti më i lartë” gjithpërfshirës i shqipes mbarë kombëtare dhe

e dyta, me rastin e sendërtimit a të zbatimit në jetë të integrimit të tillë nuk do të pësojë aspak struktura e tashme morfosintaksore e shqipes së sotme letrare.

1. Lidhur me çështjen e parë që u shtrua si parakusht, d.m.th. rreth ndërgjegjësimit të nevojës, si përgjigje përveç arsyeve historike, socio-kulturore e artistike (përhapja horizontale e vertikale, aktualiteti e perspektiva) si dhe pos faktit se pjesa dërrmuese e shqipfolësve, jo vetëm se e kanë të njohur ose e kanë të përvijuar në sistemin e tyre ligjërimor formën në fjalë, duhen pasur parasysh edhe arsyet praktike rreth tipizimit, “tipizimeve letrare” e të tjera si dhe realiteti specifik që shprehen me të. Ç’është e vërteta, po të shikohet më në hollësi, kjo formë morfosintaksore me funksionet e ndryshme që kryen a mund të kryejë si fjalë – bosht në togfjalësha a si gjymtyrë kryesore sintagmore që mund të ndeshet në të gjitha llojet e fjalive e të periudhave e më gjerë (në thëniet përgjithësisht), i kalon kufijtë e një elementi të thjeshtë dialektor dhe zor se mund të cilësohet vetëm si një karakteristikë e “të folmeve veriore”, siç është cilësuar në burimet normative (gramatikë, fjalor etj.) të gjuhës së sotime letrare shqipe. Në të mirë të rivlerësimit të formës së tillë del edhe fakti se kjo formë, edhe pse nuk e ka prestigjin e normës, edhe sot e kësaj dite del e përdorur dhe pragmatikisht mund të quhet e qëndrueshme për disa nënfusha të caktuara semantike të gjuhës letrare, siç do të ilustrimet më poshtë, si p. sh.:

- në rrafshin e përfaqësimit të foljes,
- në thëniet frazeologjike e të ngjashme,
- në stilin poetik si dhe
- në rrafshin e sinonimisë.

1) Është e vërtetë se forma e paskajores me + pjesore ndeshet si formë përfaqësuese e foljes jo vetëm në disa burime të traditës, por ajo edhe sot e gjithë ditën, sipas burimeve të caktuara, vazhdon të përdoret me këtë funksion edhe nga gjuhëtarët tanë të rinj. Përveç të tjerash kjo formë del e nevojshme të përdoret si barasvlerës i mirëfillt (së paku shpjegues) ndaj infinitivit të gjuhëve të tjera, qoftë për nevoja shkencore, qoftë për nevoja të punës me nxënës e studentë, si p.sh. lat. “*exire*”, serb. “*izici*” – shq. “*dal*”, më drejt: **me dalë** etj.

2) Ndeshet domosdo e përdorur në shprehje e fjalë të urta mbi bazë të gegërishtes e sidomos në shprehjet e qëndrueshme frazeologjike, kur me të shprehen koncepte të një abstraksioni të lartë specifik me kuptim përgjithë-

sues pa i cekur kategoritë foljore (morfologjike) siç janë: numri, veta, koha e modaliteti, si p. sh.: “*Mos me folë me thumba*”; “*Me dalë faqebardhë*” etj.

3) Përveç si “*lecentia poetica*” forma e paskajores me “*me*” gjithnjë e më shpesh po ndeshet në punime letrare (artistike) të kohës sonë që josh krijuesit e lexuesit si një “mollë e ndaluar” a si një mjet simbolik i përdorshëm për qëllime ideo-estetike në stilin letrar, retorik e politik, duke hyrë këshu brenda tekstit të shkruar në letrarishte, si një element freskues e atraktiv.

4) Si trajtë e nevojshme sinonimike paskajorja e tipit me + pjesore ndeshet në mjaft raste me nuanca të theksuara stilistike e kuptimore, ndër të cilat po theksojmë:

a) rastet kur duam të diferencojmë kuptimin e futurit të dosmosdosë ndaj futurit të dëshirës, si p.sh.: “*kam me dalë*” (d.m.th. “*patjetër*”) / “*do të dal*” (d.m.th. “*jo patjetër*”, karakteristikë kjo që për nga forma e lidh shqipen edhe me gjuhët evropiane perëndimore (kryesisht), por edhe indirekt me gjuhët lindore (ballkanike) postbizantine;

b) fjalitë e ndërmjetme, siç është tipi: “*me thënë të drejtën*” / “*të them(i) të drejtën*”; “*më mirë me thënë*” / “*më mirë të them(i)*” etj.;

c) fjalitë, kur me paskajoren me “*me*”, si të thuash, formulohet motto-koncepti, si qëllim i fundit i mesazhit, si p.sh.: “*Qëllimi është: me marrë pjesë në garë*”, “*Me mbetë gjallë – është çështja jonë sot*” etj.;

ç) fjalitë e caktuara, të cilat parësorisht nuk ndërkëmbehen me format kohore të lidhores, por me forma të tjera paksa të modifikuara, si p.sh.: “*Shitret si me fjetë*”, “*Unë me u lagë se me u lagë, më mirë po stërpikem vetë*”, “*Me thënë të drejtën, me marrë e mora, me lënë e lashë, po ku, me më vra(rë) nuk e di*”, “*Me ta ngrëhë mirë veshin, nuk ta ha macja përsheshin!*”, “*Me t’ia futë dajak do t’i vërë gojës kapak!*” etj.

d) kontekstet e caktuara, kur paskajorja me “*me*” del në sinonimi të barasvlerëshme, pothuajse të plotë me mundësi ndërkëmbimi të vendit me formën përkatëse paralele të lidhores, si p.sh.: “*Me qenë plak e me nda(rë) pleqni do të thotë të jesh i drejtë dhe me gjuhë (të gjykos) me urti*” etj.

dh) shprehjet, si b.f. Është i fortë: *çelik me bre*; Është e tillë: *me prekë s’duro* etj.

Nga analiza e rasteve si më sipër, sipas situatave e rrethanave të caktuara fitohet bindja se kur forma e tillë ndeshet apo përdoret me kriter nga

autorë të caktuar, jo vetëm se nuk duhet të etiketohet e të vlerësohet si “shkelje e normës letrare”, por, përkundrazi, ajo duhet cilësuar si një ndihmesë ndaj normës standarde të gjuhës sonë kombëtare dhe, si e tillë, ajo vlen të kultivohet.

2. Lidhur me parakushtin e dytë, pasi konsiderohet i nevojshëm integrimi i paskajores me + pjesore në normën e shqipes letrare kombëtare, shtrihet detyrë se si të sendërtohet një veprim i tillë konkretisht dhe çfarë vështirësish dalin në këtë proces? Si është e mundur të bëhet integrimi i formës në fjalë pa e lënduar strukturën e letrarishtes së sotme? Nga analiza del se një mundësi e tillë është e realizueshme me sadopak mirëkuptim, vullnet e dëshirë. Dihet se paskajorja në shqyrtim, si një formë analitike, e përbërë prej dy komponentësh a gjymtyrësh, kuptimin e merr nga shenjimi i përbërësit të parë, d.m.th. nga pjesëza “me” e jo nga formanti temëformues i pjesores si përbërës i dytë, mirëpo si pengesë për përfshirje në strukturën e të shkruarit (integritit) pikërisht paraqitet prapashtesa temëformuese e pjesores përkatëse të numrit më të madh të foljeve të gjuhës shqipe. Kështu, ndërsa grupet e foljeve me pjesoret me prapashtesën temëformuese më –Ë dhe –ato më –NË mund të integrohen pa vështirësi nga ky këndvështrim, sepse nuk paraqesin dallim në raportin dialekt / gjuhë letrare si p. sh. me dalë, me mjahtë, me marë, me dhënë etj., ato të grupit me pjesoret me prapashtesën temëformuese me –UR dhe ato më –R(Ë) paraqesin vështirësi strukturore në raportin dialekt a ish – shqipe letrare mbi bazë të gegërishtes, në njërin anë dhe të letrarishtes së sotme, në anën tjetër. Për këtë arsye prapashtesa temëformuese –UR e letrarishtes së sotme del në konkurrencë me prapashtesën –Ë të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, si p. sh.: *me folë / me folur, me mbajtë / me mbajtur, me stolisë / me stolisur, me kositë / me kositur, me derdhë / me derdhur / etj.*, kurse prapashtesa –R(Ë) del në konkurrencë me prapashtesën zero, përkatësisht me trajtën e shkurtër të pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, si p. sh.: *me la / me larë, me ble / me blerë, me bë / me bërë, me shue / me shuar, me thye / me thyer, me pëlqye / me pëlqyer, me shkruë / me shkruar, me punue / me punuar*.

Kur dihet fakti se shqipja standarde kombëtare si një “sistem sistemesh” a si një sistem i përpunuar mbi bazë të toskërishtes, por me elemente të përbashkëta të varianteve letrare të dy kryedialekteve, s’ka se si të mos ketë detyrim që të pranojë në gjirin e vet edhe formën e paskajores me + pjesore

dhe ta normëzojë atë në cilëndo trajtë qoftë ajo. Është e vërtetë se paskajorja me “me” ndeshet jo vetëm në burimet nga tradita të variantit toskë, përveç atij gegë, por edhe ne jetën tonë të përditshme. Në realitetin tonë gjuhësor i ndeshim mjaft shpesh, madje të dyja trajtat kanë përparësitë e veta, prandaj, lidhur me këtë arrihet në përfundimin se hë për hë zgjidhja më e mirë është që të dyja trajtat e pjesores (është fjala vetëm në kuadër të paskajores me + pjesore), të jenë të lira në përdorim si raste dysore, natyrisht trajta e ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes ka përparësi për të shprehur nuanca kuptimore e stilistike që lidhen me autenticitetin burimor, siç është tipizimi letrar etj., ndërsa trajta e letrarishtes së sotme mund të ketë përparësi për hijesa që lidhen me “letrarëzimin zyrtar” të sotëm, por gjithsesi është mirë të kihet në konsideratë rregullat fjalëformuese e formëzuese që hetohen në strukturën e vargut të prepjesorëve.

Në fund për krejt temën nxirret konkluzioni se, vërtet nuk ka kurrfarë arsye serioze, pos asaj të natyrës psiko-asociacionore (që mund të jetë e pranishme përkohësisht tek individë të caktuar) që të mund të dalë si pengesë për mosintegrimin e paskajores me + pjesore në gjuhën e standardizuar shqipe për nënfusha të caktuara semantike, barabar e normëzuar me format sinonimike, rëndom mbi bazë të lidhores, të cilat janë, por, edhe në njëfarë mënyre, mund të mbesin gjithandëj të favorizuara sipas normës së sotme “zyrtare”, e cila as që kontestohet me integrimin e paskajores me + pjesore.

Fundja duke e dhënë liri konkurrimit, tashti e tëhu, me prestigjin e normës edhe formës me + pjesore për nënfusha të caktuara semantike, krahas sinonimeve simotra të saj, vetë koha do të bëjë verifikimin e nevojës reale për përdorimin ose jo (qoftë edhe në mënyrë të reduktuar) të formës në fjalë. Me një veprim të tillë, duke u mbështetur për këtë pikë në parimin se “njësimi si qëllim i fundit nuk arrihet me mohimin, po me kultivimin e ndryshimeve”, gjuha jonë standarde kombëtare do të fitonte shumë e nuk do të humbiste asgjë, ngase në këtë mënyrë do të zgjidhej “dallimi më i madh strukturor” në mes të gjuhës së sotme letrare, në njërin anë dhe të gegërishtes, në anën tjetër dhe se kjo çështje nuk do të mbetej si një problem permanent i pazgjidhur në mes të gjuhës së sotme standarde. Njëherazi, me një veprim të tillë, nuk do t’i lihej vend pretekstit për të rigjallëruar si rivale strukturën foljore para-digmore me rrjedhojat që e pasojnë të ish-hqipes letrare mbi bazë të gegë-

rishtes me paskajoren me + pjesore në krye, dukuri kjo që nuk është e pashnjalizuara edhe në ditët tona.

Gjithsesi diskutimi dhe zgjidhja e çështjeve të caktuara si kjo do të nxisin për të mirë ekspertët e kuadrot kompetentë të gjuhës sonë, të cilët duhet të kenë parasysh edhe faktet përkatëse në rrethana të reja me rastin e hartimit të ripunimit të teksteve normative të gjuhës sonë standarde kombëtare.

Përmbyllje

Çështja e paskajores me + pjesore paraqitet në gjuhën shqipe si “dallimi më i madh strukturor” në mes të shqipes së sotme letrare, në njërin anë dhe të gegërishtes a të ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes, në anën tjetër. Kjo çështje e hapur, siç provohet në këtë punim, mund të zgjidhet përfundimisht jo me lënien “jashtë normës letrare” a me asgjësimin e saj apriori nga gjuha letrare, siç është tentuar të bëhet në normën e sotme të gjuhës letrare, por zgjidhja të bëhet duke e mundur integrimin (me normëzim) të formës në fjalë në sistemin e shqipes letrare kombëtare të njësuara. Një integrim i tillë, jo vetëm se është i mundshëm të bëhet pa e lënduar strukturën morfosintaksore të shqipes së sotme letrare, por një veprim i tillë do të dilte i dobishëm edhe për vetë bazën e kësaj strukture në veçanti dhe për sistemin e tërësishëm të shqipes standarde në përgjithësi.

Duke e lënë në konkurrencë të lirë formën e paskajores së tipit me + pjesore do të përmbusheshin zbratësitë e mbetura në sistemin e shqipes letrare dhe njëherësh do të verifikoheshin nevoja reale e përdorimit të saj, qoftë edhe në përmasë të reduktuar. Siç provohet praktikisht në këtë punim me rastin e integritimit konkret mbesin problemore nga pikëpamja e drejtformëzimit disa trajta dysore të tipave të pjesoreve (ato me prapashtesën temëformuese –UR ndaj atyre më –Ë si dhe ato me prapashtesën temëformuese –R(Ë) ndaj atyre me prapashtesë zero, përkatësisht me formë të shkurtër të pjesores së ish-shqipes letrare mbi bazë të gegërishtes). Ndryshimet e tilla nga aspekti semantik nuk paraqesin kurrfarë problemi, sepse kuptimi i paskajores me + pjesore karakterizohet jo me mbaresat e pjesores, por me formantin special “me” të paravendosur. Kështu pjesëza “me” + pjesore (e cilëso folje) si dy gjymtyrë të pandara të gramatikalizuara shprehin konceptin e paskajores në fjalë.

Nevoja e përdorimit të paskajores së tipit me + pjesore vërtetohet në këto raste:

1. si barasvlerës në raport me infinitivin e gjuhëve të tjera,
2. në formulimin e shprehjeve frazeologjike me abstraksion specifik dhe në ndërtim të ndërmjetme fjalioare,
3. në shkrime të karakterit ideo-estetik si element i dalluar shprehës dhe
4. në funksione sinonimike për të shprehur nuanca kuptimore e stilistike të caktuara.

Fundja përligjja e konkurrencës së lirë e kësaj forme ndaj formave të tjera sinonimike (siç janë format kohore të lidhore e të tjera), është zgjidhja më e logjikshme dhe e pranueshme e problemit të paskajores me + pjesore në shqipen standarde kombëtare.

The Indefinite – an Issue of the Standard Albanian

(A Synchronic Review)

SUMMARY

In the unified literary Albanian from the 70s and on, the question of simple indefinite **me + participle** has been considered as a problem already solved by its very removal from the literary norm (because of its northern dialectological origin or for some other reason), by considering covered the concepts which it expressed with other synonym forms, such as the second indefinite with "për të", "tense forms" of the conjunctive and others. In connection to such a solution, some of our linguists, although adherents and implementers of the present-day unified literary language, not without reason expressed their reservation. This issue was touched a bit also at the scientific symposium "The literary national language and the Albanian world today", held in Tirana on 21-22 November 1992, when an idea was launched that the question of the indefinite with "me" cannot be considered entirely closed, but it remains as a question open for discussion.

In this paper too, as in that meeting, proof will be brought as argument, quite justified, either from interpretation of certain facts already known before, or by bringing new facts and scientifically applied criteria in the modern linguistics. In fact, the solution of this issue demands a different approach from the usual, i. e. not by leaving it entirely outside the norm, but precisely by its integration, for certain semantic fields, in the "literary norm" of standardized Albanian. For such an enterprise two "guarantees" are given on condition:

The first has to do with the fact that such an integration is needed by the standardized national Albanian as a "system of systems", as a "sub-dialectal

system”, or as “the highest and all-compassing variant” of the Albanian, and second, on the occasion of implementing such integration the morpho-syntax structure of present-day literary Albanian will not suffer at all.

1. In connection to the first issue that has been laid out as a precondition, i.e. regarding an awareness of the need as a reply, apart from historical, social-cultural, and artistic reasons (a horizontal and vertical stretch, actuality and perspective), and also apart from the fact that the overwhelming part of Albanians, not only knew or may envisage the form in their speech system, practical reasons should also be considered concerning typization (literary typization) and others, as well as specific realities which it expresses. Indeed, if we have a closer look, this morpho-syntax form with the various functions it performs and may perform as a word – an axis in expression or as main syntagm limb which is met in all kinds of sentences and periods and wider (in expressions generally) surpasses the borders a simple dialectical element and can hardly be qualified as a feature of the “northern speech”, as it has been called in normative sources (grammar, dictionaries, etc.) of the present-day literary Albanian. In favor of the re-evaluation of this form is also the fact that this form, although lacking the prestige of a norm, continues to be in use, and pragmatically may be called as standing for certain semantic sub-fields of the literary language, as it will be illustrated below, as for example:

- in the field of verb representation,
- in phraseological and similar sayings,
- in the poetic style, and
- in the field of synonymy.

1) It is true that the indefinite form *me* + participle, as a verb representative form not only in some sources of tradition but today too, according to particular sources, continues to be in function from our young authors as well. Among others, this form comes out as necessary to be used as a true equivalent (at least an explanatory one) towards the infinitive of other languages, be it for scientific needs, or for the needs of working with school-

children and students, such as e.g. lat “*exire*”, serb. “*izici*” – Alb. “*dal*”, more rightly: **me dalë**, etc.

2) It is found as necessary in expressions and wisdom sayings on the basis of the Gheg, especially in standing phraseology expressions when expressing concepts of a high specific abstraction with generalized meaning without mentioning the verb (morphological) categories such as: number, time, persons, modality time, e.g.: “*Mos me folë me thumba*”; “*Me dale faqe-bardhë*”, etc.

3) Except as “*lecentia poetica*” the indefinite form with “*me*” has been frequently found in use in literary (artistic) works of our time attracting authors as a forbidden apple” or as a useful symbolic means for aesthetic aims in the literary, rhetoric, and political styles, thus penetrating within the literary written text as an attractive and refreshing element.

4) As a necessary synonym form the indefinite form of the type *me* + participle is frequently met with emphasized style and meaning varieties among which we should point out:

- a) in cases when we want to differentiate the meaning of the necessary future towards the wish future, such as e.g.: “*Kam me dale*” (meaning “by all means”) / “*do të dal*” (meaning “not by all means”, a feature which in its form connects Albanian with Western European languages (mainly), but also indirectly with Eastern (Balkan) post-Byzantine languages;
- b) intermediary sentences such as those of the type: “*me thënë të drejtën*” (“to be honest” – meaning, by all means) “*të themi të drejtën*”; “*më mirë me thënë*” / “*më mire të them(i)*”, etc.
- c) sentences when with the indefinite “*me*” in a way the moto-concept is formed as final aim of the message, such as e.g.: “*Qëllimi është: me marrë pjesë në garë*”, (*The aim is: to participate*”), “*Me mbetë gjallë – është çështja jonë sot*”, (*To survive – this is our aim*) etc.
- d) particular sentences which initially do not oppose tense forms of the conjunctive but with other more modified forms, such as e.g.: “*Shtiret si me fjetë*”, “*Unë me u lagë se me u lagë, më mire po*

- stërpikem vetë*", "Me thënë të drejtën, me marrë e mora, me lënë e lashë, po ku, me më vra(rë) nuk e di", "Me ta ngrënë mire veshin, nuk ta ha macja përsheshin!", "Me t'ia futë dajak do t'i vërë gojëz kapak!", etc.
- e) special contexts when the idifinite with "me" appears as an equivalent synonym with an almost full possibility of exchange of place with the parallel respective form of the conjunctive, such as e.g.: "Me qenë plak e me nda(rë) pleqni do të thotë të jesh i drejtë me gjykue (të gjykosh) me urti", etc.
- f) expressions such as "Eshhtë i forte çelik me bre; Eshhtë e tillë: me prekë s' duron", etc.

From the above case analysis according to particular situations and circumstances one gets the impression that once such a form is met or used with the criteria by particular authors should not only be labelled as "violation of literary norms", but on the contrary, it should be qualified as a support towards the standard norm of our national language, and as such it is worth cultivating.

2. In connection to the second precondition, as the integration of the indefinite me + participle is considered necessary in the literary norm of the Albanian, a task lied ahead as to how to implement it in concrete terms and what kind of difficulties lie ahead. How is it possible to integrate that form without hurting the structure of the current literary language? From the analysis it derives that such a possibility is feasible with a bit more understanding and good will. It is known that this definitive, as an analytical form, consisting of two components and limbs, attains its meaning from its first part insignia, i.e. by participle "me", and not by the subject-forming formant of participle as a second container. However, as a hindrance to its inclusion in the structure of writing (integration) appears precisely the subject-forming definite article of the respective participle of a greater number of verbs in the Albanian language. Thus, while the group of verbs with participles with the subject-forming definite article më – E, and –ato më – Në may be easily integrated from this angle as they do not represent a distinction in

the dialectical relationship / literary language, such as e.g. me dalë, me derdhë, me marrë, me dhënë, etc., those of the group with participles of subject-forming definite article me – UR and those with më – R(ë) represent structural difficulties in the relationship dialect or former-literary Albanian based on the Gheg, on one side, and present-day literary language on the other. For this reason, the subject-forming definitive –UR of the present-day literary language comes in concurrence with the definitive ë of former literary Albanian on the Gheg basis, such as e.g. *me folë / me folur, me bajtë / me mbajtur, me stolisë / me stolisur, me kostië / me kositur, etc.*, while the definitive – R(ë) comes in concurrence with the definitive zero, respectively with a shortened form of participle of former literary Albanian on the basis of Gheg, such as e.g.: *me la / me larë, me ble / me blerë, me bë / me bërë, me shue / me shuar, me thye / me thyer, me lëlqye / me pëlqyer, me shkruë / me shkruar, me punue / me punuar.*

Knowing the fact that the national standard Albanian as a "system of systems" elaborated on the Tosk basis, but with common elements of literary variants of both main dialects, may in no way not be obliged to accept in its bosom the form of the indefinite me + participle in order to norm it in any of its form. It is a fact that the indefinite with "me" is met not only in sources from tradition of the Tosk variant, apart from the Gheg one, but in our everyday life as well. In our linguistic reality we meet them very often, even in both disputable forms.

From the analysis it derives that both the forms have their own advantages, therefore, a conclusion may be drawn on this that for the time being the best solution would be that both forms of the participle (speaking only in the framework of the indefinite me + participle) should be loose in usage as secondary cases, naturally the form of the former literary Albanian on the Gheg basis has an advantage in expressing meaning and stylistic nuances in the connection to original authenticity, such as literary typization, etc., while the form of the present-day literary language may have an advantage for variants connected to the present-day "official literarization", but it is always preferable to show consideration for the word-forming and forming rules noticed in the structure of verse of part-participles.

Finally, a conclusion can be drawn on the whole that indeed there is no serious reason, aside from a psycho-associative nature (which may be present in certain individuals) which would represent a hindrance for the non-integration of the indefinite me + participle in the standardized Albanian language for particular semantic sub-fields, equal normed with synonym forms, usually on the basis of the conjunctive but which, in some way, may permanently remain favored according to the present-day "official" norm, which is never contested with the integration of me + participle.

After all, by letting the concurrence be from now on, with the prestige of norm and the form with me + participle for special semantic sub-fields, alongside its kin synonyms, the time itself will validate its realistic need or not in the usage (be it in a reduced way) of the form in question. With such an act, base on this point on the principle that "unification as a final aim is not reached with denial but with the cultivation of change", our national standardized language would gain a lot and would not lose a bit, as in this way "a larger structural distinction" would be settled between the present-day literary language, on one side, and the Gheg, on the other, and this question would continue to stay as a permanent unsolved problem in the norm of the present-day standard language. In the meantime, with such an act, one would get rid of a pretext to revive as its rival a paradigm verb structure with all its consequences of the former literary Albanian on the Gheg basis with the indefinite me + participle, a phenomenon which continues to be evident in our days.

By all means, discussions on particular issues such as this one, would incite for the better competent experts of our language, who would be considering respective facts in new circumstances on the occasion of compilation or elaboration of normative texts of our standard national language.

LITERATURA

- Ajeti, Dr. Idriz, *Studime gjuhësore në fushë të shqipes* III, Rilindja, Prishtinë, 1985.
- Bokshi, Besim, *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)* AKAK, Prishtinë, 1998.
- Bugarski, Ranko, *Uvod u opštu lingvistiku*, Beograd, 1994.
- Çabej, Dr. Eqrem, *Studime gjuhësore*, IV, VII, Prishtinë, 1986.
- Demiraj, Prof. Shaban, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Prishtinë, 1989;
- Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* (grup autorësh), Prishtinë, 1974.
- Filozofska istraživanja* (revistë), 30/89, Zagreb, 1989.
- Fjalori shqip – serbokroatisht* (grup autorësh), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1981.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.
- Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984.
- Fjalori i "Bashkimit"* (1908), (ribotim), Prishtinë, 1978.
- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe* II, (grup autorësh), Tiranë, 1976.
- Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe* (Sintaksa e periudhës) (grup autorësh) (ribotim), Prishtinë, 1991.
- Gjuha letrare shqipe për të gjithë* (red. Androkli Kostallari), Tiranë, 1976.
- Ismajli, Dr. Rexhep, *Gjuhë dhe emi*, Prishtinë 1991; *Shenjë dhe ide*, Prishtinë, 1974.
- Jović, Momir, *Latinski jezik za istoričare*, Prishtinë, 1985.
- Klaić, Bratoljub, *Veliki rječnik stranih riječi, izraza i kratica*, Zora, Zagreb, 1968.
- Kokona, Vedat, *Fjalor frëngjisht – shqip*, Prishtinë, 1990.
- Konsulta gjuhësore e Prishtinës* të "Gjurmime albanologjike", 1/68, Prishtinë, 1968.
- Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*, 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974.

Kostallari, Prof. Androkli, *Diaspora e sotme shqiptare dhe gjuha letrare kombëtare e njësuar*, Gjurmime albanologjike, s. shk. fil., 20/90, Prishtinë, 1991, si dhe të gjitha punimet e tij të botuara në “Studime mbi leksikon...”, I, II (1972) dhe III (1989).

Lacaj, H. – Fishta, F., *Fjalor latinisht – shqip*, Prishtinë (ribotim), 1980.

Mala enciklopedija, Prosveta, Beograd, 1978.

Mulaku, mr. Ragip, *Sistemi foljor në gjuhën e shkrimtarëve të vjetër veriorë*, IA, Prishtinë, 1987.

Nuhju, Dr. Vejsel, *Ndikime ndërgjuhësore*, Prishtinë, 1990.

Prifti, Prof. Stefan, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1972.

Radulović, Milorad, *Sociolingvistika*, Beograd, 1979.

Simeon, Rikard, *Enciklopedijski rječnik lingvističkih naziva*, Zagreb, 1969. *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, I, II (1972) dhe III, Tiranë, 1989.

Thomaj, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1972; *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1989.

Xhuvani, Dr. Aleksandër, *Vepra I* (1980); *Vepra II*, Tiranë, 1989.

Dr. Nuhi Veselaj – Paskajorja – çështje e shqipes standarde

Lektor: *Mehmet Gjevori*

Rezimënë e përkthëu: *Avni Spahiu*

Korrektor: *Autori*

Botues: *Pal Shtufi*

Disenji dhe realizimi kompjuterik



Shtypshkronja

VERANA

Prishtinë

2000